

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXVI nr. 83 / 2007

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXVI nr. 83 - 2007

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr.Pajazit Nushi,

Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimimi,

Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

*Sekretar i redaksisë: **Hajrullah Hoxha***

Lektor: Bislim Berisha

Korrektor: Skender Rashiti

*Realizimi: **Shtëpia Botuese***



Operator kompjuterik: Nuhi Simnica

*Shtyp: **Koha** - Prishtinë*

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXVI nr. 83 / 2007

Prishtinë
2007

EDITORIALI

Mr. Qemajl Morina

ORIGJINA E FUNDAMENTALIZMAVE

Ideologjitë fundamentaliste, ndonëse të rrënjosura në frikë dhe në dëshpërim, aq sa janë “arkaike dhe të vjetra, ato janë bashkëkohore, të reja dhe moderne”, kështu që përdorimi i forcës për eliminimin e tyre nuk është përgjigje adekuate.

Autorja Karen Armstrong, e cila është e respektuar nga të gjithë, si një studiuese objektive dhe e paanshme e fesë, në librin e saj të fundit “Lufta për Zotin” i bën një vështrim tejet objektiv fenomenit të quajtur fundamentalizëm, term, që zakonisht është i rezervuar për myslimanët. Por, studimet dhe hulumtimet e saj rreth fundamentalizmit përfshijnë një spektër të gjerë, më domethënës, më gjithëpërfshirës dhe më objektiv. Sipas saj, fenomeni i fundamentalizmit është reaksion i një ndjenje të thellë te një numër i besimtarëve të krishterë, çifutë dhe myslimanë, kundër botës laike moderne, të cilën ata nuk mund ta kuptojnë dhe në të cilën ata e ndiejnë veten të izoluar dhe të rrezikuar sipas këndvështrimit të tyre. Në të njëjtën kohë, ajo pranon se injoranca është e përbashkët, meqë edhe sekularistët kanë treguar paaftësi të konsiderueshme për ta kuptuar mënyrën e të menduarit të fundamentalistëve.

Fundamentalizmi si term për lëvizjet fetare, për herë të parë është përdorur nga protestantët amerikanë për ta dalluar vetveten nga pasuesit më liberalë të sektit të tyre, për të cilët mendohej se po e shtrembëronin fenë e krishterë. Por, duhet theksuar se dy fundamentalizmat, ai çifut dhe mysliman kanë të bëjnë krejtësisht me diçka tjetër. Kështu që përdorimi i këtij termi, në kuptimin e tij origjinal protestant, për çifutët dhe myslimanët nuk është korrekt. Sidoqoftë, mendimi i Karen Armstrongut është i dobishëm për ato lëvizje, të cilat përkundër dallimeve të mëdha kanë disa ngjashmëri. Me këtë rast ajo citon, Martin E. Maty dhe R. Scott Appleby, të cilët kanë bërë një hulumtim të gjerë rreth kësaj teme. Ata kanë ardhur deri në përfundim se fundamentalistët janë përgjigje e perceptimit të krizave dhe kanë një motiv të caktuar, angazhimin të tyre kundër atyre forcave bashkëkohore, të cilat po shfaqin armiqësi ndaj fesë. Kjo nuk është një luftë politike tradicionale, por një luftë me përmasa kozmike në mes forcave të së mirës dhe të së keqes. Nuk është me rëndësi nëse ata janë shumë të dobët, kurse armiku është shumëfish më i fort. Kjo është një luftë ideologjike. Bota patjetër duhet t’i kthehet Zotit.

Studiuesja, Karen Armstrong, për objekt studimi ka zgjedhur fundamentalizmin në Amerikë, Izrael, Egjipt dhe në Iran, për të treguar se si këto lëvizje nga tradita të ndryshme janë të motivuara me shqetësim, ankthe dhe qëllime të ngjashme, si përgjigje e çështjeve të pazgjidhura që është thelbi i principit të jetës në botën moderne laike. Këto principe të ndryshimeve, në të cilat është i angazhuar civilizimi bashkëkohor perëndimor u ka grabitur njerëzve të fesë qëndrueshmërinë dhe baraspeshën, të cilat i japin kuptim jetës së tyre. Ajo, më tutje argumenton, se kjo nuk është karakteristikë e veçantë për kohën tonë. Në çdo kohë dhe në çdo traditë fundamentalizmi është konfrontuar me modernizmin. Sipas Armstrongut, ky është një reagim kundër kulturës laike dhe shkencore që në fillim është shfaqur në Perëndim, por që më vonë është përhapur në të gjitha anët e botës. Përgjigja është unike për arsye se civilizimi prej nga është trashëguar është po ashtu unik. Ajo e ka ndryshuar botën, në të cilin shoqëritë konservatore e gjejnë vetveten në kundërtënie me jetën e tyre të vjetër. Sado që të dy ndry-

shimet si dhe natyra e përgjigjes është unike, por kjo nuk është hera e parë që qytetërimi njerëzor po ballafaqohet në rrethana të këtilla.

Në botën antike, 700 deri 200 vjet para erës së re ishte një periudhë e këtillë që vazhdoi me mija vite të një evolucioni ekonomik, social dhe kulturor që kishte filluar në Sumer (Iraku i sotëm) dhe në Egjiptin e vjetër. Shoqëria agrare jetonte një jetë të mirë, prandaj edhe kishte kohë të mendoj përtej kulturës lokale për të siguruar një perspektivë më të gjerë. Besimet e mëdha lindën mu në këtë qytetërim të ri. Me gjithë dallimet, këto fe zhvilluan idenë e një krijuesi të vetëm dhe të përsosur, një spirtualizmi të brendshëm në të cilin shprehej dhembja për shoqërinë.

Karen Armstrong hulumton rrënjët e transicionit të tanishëm në shekujt 16-të dhe 17-të të erës sonë, atëherë kur kategori të ndryshme të shoqërisë post-agrare nisën të zhvillohen në Europë, duke u mbështetur në bazat e teknologjisë, e cila mundësoi riprodhime të shumta nga burime të ndryshme. Kjo ishte periudha, kur myslimanët në kohën e Perandorisë Osmane (1300-1922), Safavite (1501-1722) dhe Mogule (1526-1857) ishin fuqi dominuese në botë. Fuqia dhe bukuria e këtyre perandorive bënë që të ringjallen vlerat dhe krenaria e qytetërimit islam dhe historia e myslimanëve të rikthehet në jetë, edhe pas invazionit famëkeq të mongolëve. Sidoqoftë, kjo ishte faza e fundit e epërsisë të shpirtit konservator, që sundoi për disa shekuj, të cilin Karen Armstrong e quan “mitologjik” dhe fillim i dobësimit në shekujt e hershëm të periudhës moderne.

Në shekujt e mëvonshëm, teknologjia e re në Perëndim solli revolucione sociale, politike dhe intelektuale të panumërta, të cilat ndryshuan jetën fetare të shoqërisë. Sipas autores, afrimi shkencor – laik, rreth të vërtetës evololoui nëpërmjet mendjes (logos) në të cilin është mbështetur qytetërimi perëndimor, i cili po infekton popujt tjerë të botës (të cilët ende janë të tërhequr në mitet e kulturave të tyre), ashtu siç u bënë skllav të ekonomisë dhe fuqisë perëndimore. Karen Armstrong nuk ka përmendur fuqinë ekonomike dhe atë ushtarake si njërin prej faktorëve emergjent të fundamentalizmit, në mënyrë të veçantë në Botën Islame. Por, është fakt, se ekziston një ndjenjë e pafuqisë së

myslimanëve në tërë botën, sepse ata po ndihen të prekur para mizorive të Izraelit në Palestinë, me përkrahjen e hapët dhe të parzervë nga ana e Qeverisë së SHBA-së, gjë që është shkak i rritjes së militantizmit në mesin e grupeve fundamentaliste në Lindjen e Mesme dhe më gjerë.

Nuk ka dyshim se ndryshimet e mëdha, të cilat era e teknologjisë i ka sjell në botë në mënyrë të vrazhdë i ka dezorientuar shoqëritë konservatore. Masat popullore në mënyrë të veçantë, nëse jo edhe elita, në botën e tretë është e pa mundur t’i përvetësojë të gjitha këto të arritura. Ky rezultat, në përgjigjet e fundamentalistëve, por ajo që ka sjell reagime të këtilla nuk janë këto shqetësime të përgjithshme, por një ndjenjë e thellë se popujt e përparuar të Perëndimit po përdorin të ardhurat e teknologjisë së përparuar për t’i dëmtuar popujt e vegjël. Keqardhja që është predikuar, nga ana e reformatorëve gjatë periudhave transitore të historisë njerëzore, tash më nuk ekziston në fjalorin e popujve të fuqishëm.

Bota konservatore e kohës para-moderne, e cila ishte produkt i “mitit” dhe “mendjes”, është shndërruar në botë të arsytimeve të ftohta. Ky arsyetim i ftohtë, si duket dikton që i varfri duhet të vdesë. Superfuqia e vetme po përdor standarde të dyfishta në marrëdhëniet e saj me vendet e varfra. Atë që e konsideron se është e mirë për vete, ajo mbahet e keqe për të tjerët. Këto mizori e mospërfillje të principeve të drejtësisë nga ana e shumicës së kombeve më të civilizuar të Perëndimit nuk mund t’u shpëtojnë vërejtjeve dhe kritikave, qoftë edhe të popujve më të prapambetur të botës. Karen Armstrong pranon këtë dhe thotë se pa ndërmarrjen e një hapi dhe detyrimi të njëmendët “arsyetimi i rastit mund të djallëzohet deri në atë masë sa që ai mund të bëjë krime aq të mëdha, ndoshta edhe më të mëdha se barbaritë që kryejnë vetë fundamentalistët”.

Me këtë, duke demaskuar mitin liberal, se raca njerëzore në fund të shekullit njëzet po përparonte në drejtim të një gjendjeje përgjithmonë më të ndritshme dhe më tolerante, sikurse dhe një mijë mite tjera, përshekruante jo vetëm dëshpërimin e vet, por edhe të shumicës së popujve në të gjitha anët e botës.

Ideologjitë fundamentaliste ndonëse janë të rrënjosura në frikë dhe në dëshpërim, aq sa janë arkaike dhe të vjetra, po aq janë bashkëkohore, të reja dhe moderne, kështu që përdorimi i forcës dhe dhunës për eliminimin e tyre nuk është përgjigje adekuate.

Ajo që nevojitet këshillon Karen Armstrong, është se që në adresën e botës bashkëkohore, ajo që quhet “ më shumë forcë” drejt frikës, ankthit dhe nevojave të popullit, i cili kujdeset ta largojë dyshimin ndaj tyre si fundamentalistë. Vetëm atëherë bota mund të jetë më e sigurt për të gjithë.

Qemajl Morina

THE ORIGIN OF FUNDAMENTALISMS

(Summary)

Fundamentalist ideologies, despite of being rooted in fear, apart from being “archaic” are modern as well, therefore, the use of force to eliminate them is not an adequate response.

In her latest book “The battle for God” Karen Armstrong deals in an objective manner with the issue of fundamentalism, a term which is usually reserved for Muslims. According to her, fundamentalism is the reaction of religious Christians, Jews and Muslims against the modern (secularist) world, which they cannot understand and in which they feel isolated and threatened. At the very same time, she states that ignorance is universal being that secularists too have proven to be unable to understand the way fundamentalists think.

كمال مورينا

منبع الاصوليات

(خلاصة البحث)

ان الايدلوجيات الاصولية بالرغم من جذورها العميقة في الخوف و القلق و كما هي قديمة جديدة أيضا / لذلك ثبت أن استخدام القوة كوسيلة للتخلص منها ليست طريقة ناجحة.

أن المؤلفة المشهورة كارن ارمسترونج و التي تحظى باحترام الجميع بسبب عدم ما إلى دين بعينه نتناول بالدراسة في كتابها الاخير "الحرب من أجل الله" الظاهرة التي تلقى عليها الاصولية التي عادة يتصف بها المسلمون وحدهم. و يجدر بالذكر هنا ان دراستها حول الاصولية تشمل اطارا واسعا و حسب رأيها ان ظاهرة الاصولية هو رد فعل لاحساس عميق لدى عدد من المؤمنين المسيحيين و اليهود و المسلمين ضد العلمانية و المعاصرة إذ ليس باستطاعتهم فهمها، لذلك هم يعتبرون انفسهم منعزلون و مهددون منها. و في نفس الوقت هي تعترف بان الجهل بين الفئتين قاسم مشترك اذ قد أظهر العلمانيون جهلا مطبقا في عدم فهمهم طريقة تفكير الاصوليين.

AKAID

Orhan Bislimaj

**‘TEKFIRI’ - AKUZIMI I MUSLIMANIT PËR
DEZERTIM NGA ISLAMI
(Shpjegim akaidologjik i thënies
së Imami A’dham Ebu Hanife r.a.)**

قَوْلُهُ: أَنْ لَا تُكْفِرَ أَحَدًا مِنْ أَهْلِ الْقِبْلَةِ بِذَنْبٍ. وَلَا تَنْفِي أَحَدًا مِنَ الْإِيمَانِ
Ebu Hanife r.a. ka thënë: ”Të mos e akuzosh për dezertim nga Islami askënd prej ‘ehlu’l-kibles (muslimanëve) për shkak se e ka bërë një mëkat. Dhe as imanin mos ja mohoj (përgënjeshtro) askujt!”¹

Hyrje

Akti i njeriut që më së shumti urrehet te Allahu i Madhëruar është mosbesimi (kufri) ndaj Tij, përkatësisht mospranimi i Fesë Islame. Ai padyshim konsiderohet si vepra më e keqe dhe më e rëndë që njeriu

¹ Transmetohet nga Nusajr bin Jahja El-Fekih, i cili ka thënë: e kam dëgjuar Ebu Muti’ El-Hakem bin Abdilah El-Belhi të thotë: E kam pyetur Ebu Hanifen, Nu’man bin Thabit r.a. për EL-FIKHU’L-EKBER - dijen më të rëndësishme, e ai më tha: *Të mos e akuzosh për dezertim...*, deri në fund të citatit. (Ebu Hanife, El-Fikhu’l-Ebsat, sipas Doç. Dr. Mustafa Öz, “Imam-i A’zamin bes esseri, El-Alim ve’l muteal-lim; El-Fikhu’l-Ebsat; El-Fikhu’l-Ekber; Risaletu Ebi Hanifete; El-Vesijeh, Stanboll, 1992, fq.44).

mund ta bëjë në jetën e vet. Nga këtu *tekfiri* – akuzimi i muslimanit për mohim apo dezertim nga Islami, konsiston një kujdes të veçant dhe si i këtillë është me përgjegjësi të madhe dhe të rrezikshme.

Fakti se kjo dukuri ka filluar të reflektojë edhe tek ne, njohja e përmbajtjes dhe e domethënies së tij (*tekfirit*) përbën një rëndësi dhe nevojë të vërtetë. Sepse, shpeshherë ai përdoret pa vend dhe pa arsye, ngase nuk dihen pasojat dhe rreziqet e tij. Edhe pse ndoshta në të shumtën e rasteve plasohet pa qëllime të synuara, por edhe atëherë ai kërkon kujdes, nga që me veprat serioze siç është *tekfiri*, pakujdesia nuk pranon tolerancë.

Domethënia gjuhësore dhe terminologjike e nocionit *tekfir*

Shprehja *tekfir* është nocion i gjuhës arabe, përkatësisht infinitivi i llojit të II-të të foljeve të prejardhura (المزيدات الثلاثي المزيد فيه) dhe rrjedh prej foljeve të rregullta. Koha e shkuar e nocionit *tekfir* bën *كفر*, koha e tashme dhe e ardhshme bën *يُكفر* ndërsa infinitivi *تكفير* i cili nënkupton: akuzimin e një personi për mohim / mosbesim.

Pra, nga aspekti gjuhësor fjala *tekfir* gjenezën e ka te fjala ‘kufër’ apo te folja ‘kefere’ të llojit të parë të foljeve (الثلاثي المجرد), e që do të thotë: *مبuloj* - غطي و ستر - fsheh një gjë.

Thuhet: *كفر الزارع البذر في الأرض إذا غطاه بالتراب* - bujku e ka mbuluar farën në tokë, d.m.th. kur e mbulon atë me dhe.² Njeriu që e posedon vetinë e kufrit quhet kafir-mbulues, fshehës. Ky kuptim konsiston jobesimtarin i cili e mbulon të vërtetën (e besimit në Allahun) me jo të vërtetën (mosbesimin në Të).

Ndërsa në aspektin terminologjik nocioni *tekfir* apo ‘*ikfar*’ do të thotë: **akuzë për mosbesim në adresë të një personi që është musliman ose që pandehet për musliman**, dhe ka lidhje me shkencën e *akaidit*, të *kelamit* si dhe drejtësinë islame (*fikh*). Po qe se shkenca e *kelamit* e provon mohimin (kufrin, blasfemin), domethënë realizimin e aktit të daljes nga kuadri i besimit, drejtësia islame zbaton trajtimin

² Ebu Abdilah Amir Abdilah Falih, “*Mu’xhemu elfadhi’l akideti*” botimi i dytë 1420 h /2000, Rijad, fq. 99.

material-fizik të personit që ka dalë nga feja (murtedd). Në këtë punim ne do ta trajtojmë çështjen në aspektin e akaidit e të kelamit.³

Poenta e *tekfirit*

Personi (muslimani) për të cilin vërtetohet *tekfiri* – dalja nga Feja Islame, çështja e tij i nënshtrohet dy procedurave:

- Të kësaj bote (دنيوي), e cila nënkupton shpalljen e vendimit për mohim ndaj një muslimani, e kjo domethënë se ai privohet nga të drejtat islame pasi paraprakisht të plotësohen kushtet shariatike dhe të evitohen pengesat, sikurse është ofrimi i mundësisë që ai të kthehet sërish, sqarimi i atyre çështjeve (bazore) me argumente në të cilat ka rënë në mohim...etj. Nëse pendohet nga qëndrimet e tij, kthehet në shoqërinë islame me të gjitha të drejtat dhe detyrimet. Në të kundërtën ekzekutohet⁴. E nëse kjo nuk mund të realizohet (zakonisht në vende ku sheriati nuk ka aplikim), atëherë atij as nuk i jepet selam e as nuk i kthehet; nuk ka mbrojtje për jetën e tij dhe pasurinë e tij; nuk mund të martohet me grua muslimane; apo nëse është i martuar shkurorëzohet; nëse vdes në këtë gjendje nuk i lahet xhenazja; nuk i falet namazi i xhenazës; nuk varroset në varrezat e muslimanëve; nuk zbatohen parimet e trashigimisë ndërmjet tij dhe të afërmeve dhe dispozita të tjera⁵, dhe
- Të botës tjetër (أخروي) – atë të jetës së ahiretit, e cila nënkupton mbetjen përgjithmonë në zjarr të xhehennemit dhe pamundësinë për pjesëmarrje në shefaatin e Resulullahit s.a.v.s.⁶

³ Prof. Dr. Bekir Topalo lu, “*Hyrje në Kelam*”, Prishtinë 2002, fq.271.

⁴ Pejgamberi a.s. ka thënë: فاقتلوه: “*Kush dezerton nga Feja Islame, mbyteni*” Ahmed bin Alij bin Haxher El-Askalanij, “*Fet’hu’l bari sherhu Sahihi’l Buhari*” Mek-tebetu’d-dari’s-selam, botimi i parë 1421 h / 2000 m, Rijad, ‘*Kitabu istitabetil murted-dine vel muanidine*’, kapitulli 2, hadithi nr.6922.

⁵ Alaud-din Ebi Bekr bin Mes’ud El-Kasanij El-Hanefij “*Bedaiu’s-sanai’i*”, darul fikri, botimi i parë, 1996/1417, Bejrut-Liban, vëll.IV, fq.198-206.

⁶ Shih: Ebu Hamid El-Gazalij, “*El-Iktisad fil i’tikad*”, kapitulli ‘*bejanu men jexhibu te-kfiruhu minel firak*’, sipas <http://www.alwihdah.com/view.php?cat=1&id=853>, i plasuar më: 29.03.2004.

وَمَنْ يَكْفُرْ بِالْإِيمَانِ فَقَدْ حَبِطَ عَمَلُهُ

”... *E kush mohon (tradhton besimin), ai ka asgjësuar veprën e vetë...*” (Kur’ani, El-Maide: 5).

Fakti se që të dy procedurat tërheqin pasoja të rënda, pikërisht për këtë shkak sjellja e një vendimi të tillë ndaj një personi, apo akuza ndaj tij është padyshim ndër çështjet më të ndieshme dhe delikate.

Historiku i çështjes së *tekfirit*

Është konstatim parimor se Resulullahi s.a.v.s. nuk i ka mohuar askujt besimin, i cili e ka deklaruar atë duke e shprehur maksimën e shehadetit dhe ka pranuar se është musliman. Ndonëse në kohën e tij dhe pas tij kanë ekzistuar brenda shoqërisë muslimane edhe të atillë të cilët pranimin e Islamit e kishin bërë vetëm deklarativisht, duke mos qenë fare besimtarë të vërtetë.⁷ Për hipokrizinë e tyre, Pejgamberi a.s. ka pasur lajmërim hyjnor. Krejt kjo që ai të ruhej prej tyre, e që me plotë të drejtë mund të thuhet se ai në parim ka qenë në dijeni për ta. Megjithatë ai (Pejgamberi a.s.) edhe pse ka mundur t’i demaskojë haptazi, ka zgjedhur heshtjen para akuzës. Ky qëndrim i Resulullahit s.a.v.s. mund të tregojë rëndësinë dhe rrezikun që bartë *tekfiri* - akuza për mosbesim, po ashtu bartë mençurinë e thellë të tij që askend të mos e askuzojë për mosbesimtar në një kohë kur Feja Islame ende nuk i kishte forcuar radhët e veta, e për të cilën kishte mjaft shumë nevojë. Dijetarët këtë e kanë quajtur si “politikë të islamizimit”. Sepse, sikur *tekfiri* të gjente një përdorim brenda shoqërisë muslimane, me arsye apo pa të, pa dyshim do të shkaktonte kaos i brendshëm dhe i gjithë mundi do të orientohej për luftë ndaj ‘vetvetes’ me vetveten, për sa kohë që kjo duhet të bëhej me armiqtë e Islamit.

Mirëpo, Resulullahi s.a.v.s. i ka vënë në spikamë tiparet apo cilësitë, të cilat kushdo që i përvetëson ka rrëshqitë nga të qenurit ‘besimtarë’. Kjo është një metodë pedagogjike, sepse duke mos përcaktuar

⁷ Shih ajetet mbi hipokritët: Kur’ani, El-Bekare:8-16.

individë, mundësohet që secili të jetë vetllogaritës i vetvetës. Të kësaj natyre kemi mjaft shumë hadithe. P.sh.:

“Besimtari për gjatë kohës kur bënë amoralitet, ai nuk është besimtar, gjatë kohës kur ai pi alkool nuk është besimtar, për gjatë kohës kur vjedh, ai nuk është besimtar...⁸. “Ndërmjet muslimanit dhe politizimit e mohimit, është lërja e namazit”⁹ Pastaj, “Sharja e muslimanit është mëkat, ndërsa lufta kundër tij është mosbesim”¹⁰ etj.

Të gjithë dijetarët janë unikë se ideja e *tekfirit* në mënyrë legale dhe të hapur fillon me grupin e havarixhëve. Ky grup i dalë nga lufta vëllavrasëse e njohur si lufta e Siffinit (37 h./656 m.) ndërmjet halifit të katër Alijut r.a. dhe mëkëmbësit të Sirisë Muaviut, i pati akuzuar, si njërin ashtu edhe tjetrin për mohim. Sipas parimeve të këtij fraksioni çdo musliman që kryen një mëkat, i vogël qoftë ai apo i madh, konsiderohet se ka dalë nga Feja Islame dhe duhet llogaritur për mosbesimtar.

Nga ato kohëra në mënyrë të theksuar do të debatohet për pozitën e mëkatarit të madh (مرتكب الكبيرة), se nëse vdes pa u penduar, a përfundon përgjithmonë në xhehennem apo jo.

Edhe mu'tezila e cila historikisht vjen pas havarixhëve mban qëndrim të 'padefinuar' ndaj mëkatarit të madh. Sipas tyre ai është në një pozitë të ndërmjetme as besimtar e as kafirë (المنزلة بين المنزلتين).

Në këtë mënyrë, *tekfiri*, që nga shekujt e parë e këndeje, do të mbetet një pikë referuese ndërmjet grupeve të ndryshme brenda shoqërisë muslimane. Kështu, mu'tezilët dhe esh'arinjtë e akuzojnë njëri tjetrin për mohim¹¹. Ehlu'l-bid'ati, të ndarë në shumë fraksione, secili prej tyre i akuzon të tjerët për mohim. Selefijje i akuzonë filozofët islamë dhe ehlu'l-bid'atin (të gjithë të tjerët sipas tyre) për rrëshqitje nga e vërteta. Ehlu-sunneti vel'xhemaati (maturidinjtë dhe esh'arinjtë) të

⁸ Sahihul Buhari, 'Kitabu'l eshribeti', kapitulli 1, hadithi nr. 5578.

⁹ "Sahihu'l Muslim bi'sherhi'n-Nevevj", botimi i parë 1347 h\1929 m, 'el-matbeatu'l-misrijetu' Kajro, 2/70.

¹⁰ "Sahihu'l Muslim" botimi i Kajros, op.cit. 2/54.

¹¹ Abdullah bin Bijhe "Et-Tekfiru:El-Vexh'hu'th-thani li'l-harbi alel ummeti'l-islamijeh", sipas: <http://www.alwihdah.com/view.php?cat=1&id=1705>, i plasuar më: 11.05.2006.

cilët mbajnë një qëndrim të mesëm, akuzën për mohim e kanë mjaft të shtrenjtë.

“Ehlu'l-Kibleti”- muslimanët

Është mjaft mediuose se si dijetarët e ehlu's-sunneti vel'xhemaati, kur diskutojnë mbi kufirin e *tekfirit*, muslimanët i quajnë apo i bashkojnë me shprehjen 'ehlu'l-kibleti'. Edhe Imami Ebu Hanife në këtë citat të tij që jemi duke e shpjeguar, muslimanët i quan me emërtim të këtillë. Pa dyshim ky model, induktohet nga Kur'ani dhe Sunneti i Resulullahit s.a.v.s. siç është hadithi:

مَنْ صَلَّى صَلَاتَنَا وَاسْتَقْبَلَ قِبَلَتَنَا وَ أَكَلَ ذَيْحَتَنَا،
فَذَلِكَ الْمُسْلِمُ الَّذِي لَهُ ذِمَّةُ اللَّهِ وَ ذِمَّةُ رَسُولِهِ، فَلَا تَخْفَرُوا اللَّهَ فِي ذِمَّتِهِ

Transmetohet nga Enes bin Malik i cili ka thënë: Ka thënë Resullahi s.a.v.s.: "Kush falet ashtu sikurse ne, që drejtohet kah kibleja nga e cila drejtohem ne, që ha nga të therurat tona, i tilli konsiderohet musliman që e meriton mbrojtjen e Allahut dhe mbrojtjen e të Dërguarit të Tij. Prandaj mos e prishni garancinë e premtuar nga Allahu"¹²

Ebu Xhafer et-Tahaviu (v. 321 h/ 933), i cili konsiderohet prej tradicionalistëve me pikëpamje henefiste, në traktatin akaidor të tij i njohur në masën e gjërë si "akidetu't-tahavijeh" thotë: "Nuk e akuzojmë me mosbesim askend nga ehlu'l-kibleti për shkak të një mëkati përderisa ky atë mëkat nuk e konsideron si të lejuar"¹³

Ibnu Ebil Izz El-Hanefij kur e shpjegon këtë thënie të imam Tahaviut mbi ehlu'l-kibleti, thotë: Imami me shprehjen "ehlu'l-kibleti" ka për qëllim atë i cili e deklaron Islamin dhe e pranon për Kible Qabën (në Mekë) edhe nëse është prej ithtarëve të pasioneve (ehlu'l-ehvai) apo prej mëkatarëve (ehlu'l-measi), por që nuk përgënjeshtrojnë asgjë

¹² Sahihul Buhari, Kitabus-salati, hadithi nr. 391. Po ashtu shih po aty hadithin nr. 392.

¹³ Ibnu Ebil Izz, "Sherhul akidetit-tahavije", op.cit. fq.316.

prej asaj me të cilën ka ardhë i Dërguari s.a.v.s.¹⁴ Ky formulim, njëherit është edhe përkufizimi më parimor i togfjalëshit ehlu'l-kibleti, edhe pse citohet se ai “nënkupton personat që falin rregullisht pesë kohë namaz” apo “në pohimet e juristëve (fukaha) e të kelamistëve (mutekel-limun), ajo bart kuptimin e atyre që pranojnë se falja e namazit duke u drejtuar nga Kabeja është obligim (farz).¹⁵

Autori i veprës voluminoze “*sherhu'l-mevakif*” Es-Sejjid Esh-Sherif Alij bin Muhamed El-Xhurxhani (v.816/1413) thotë: *shumica e kelamistëve dhe e juristëve islam mbajnë qëndrimin se asnjë prej ehlu'l-kibleti nuk duhet akuzuar për mosbesim*¹⁶

Edhe al-lame Et-Taftazaniu (vdiq 792 h) në “*sherhu'l-akaidi'n-nesefijjeti*” thotë: “*Prej parimeve të ehlu-sunnetit është që askush prej “ehlu'l-kibleti” të mos akuzohet për mosbesim*”¹⁷

Mund të shohim se edhe Pejgamberi a.s. në hadithet e tij, por edhe të gjithë imamët të cilët i ka perceptuar ymmeti me pranim, me ehlu'l-kibleti, synojnë një gjithpërfshirje të zgjeruar të të gjitha shtresave të shoqërisë muslimane, duke mos e kushtëzuar shkallën religjioze të tyre, në njërin anë, dhe ngushtim enorm të akuzës për *tekfir* apo përjashtimit nga Islami, në anën tjetër. Sepse pranimi i Qabes për Kible, edhe nëse simbolizon pranimin e gjithë asaj me të cilën ka ardhë Pejgamberi a.s., apo faljes së namazit duke e konsideruar si farz drejtimin kah Kibleja, pa dyshim është kriteri më i thjesht dhe më i lehtë për t'u zbatuar (pranuar) për secilin pjesëtar të Islamit, fatkeqësisht të shtrirë në fraksione.

Por, jo kaq, dijetari i njohur El-Xhurxhani i cili pasi bën një pajtim parimor, që ehlu'l-kible të mos akuzohet për mohim, në vazhdim

¹⁴ El-Al-lametu Ibnu Ebil Izz, El-Hanefijj, “*Sherhul akidetit-tahavije*”, vërtetimin shkenor dhe recenzimin e kanë bërë grup dijetarësh, botimi i nëntë 1408h\1988m, El-mektebetu'l Islamijj, Bejrut, fq. 313,316.

¹⁵ El-Bagdadi “*el-firak bejnel firak*” fq. 12-13, sipas Topalo lu, “*Hyrje në Kelam*”, fq.274.

¹⁶ Es-Sejjid Esh-sherif Alij bin Muhamed El-Xhurxhani, “*Sherhu'l Mevakif*”, botimi i parë, 1998/1419, boton 'darul kutubil ilmijjeh, Bejrut-Libon, 8/370.

¹⁷ Sa'dud-Dinë Mes'ud bin 'Umer, Et-Taftazani, “*Sherhu'l akaidi'n-nesefijjeti*”, tahkik Muhamed Adnan Dervish, boton 'mektebetu daril bejruni, pa vend dhe vit botimi, fq. 260.

shqyrton pikat në të cilat, megjithatë disa prej fraksioneve të ehlu'l-kibles, kanë rënë në mohim dhe për këtë nuk mund të justifikohen. Ai thotë:”Dije se mosakuzimi i ehlu'l-kibles për mohim është konstatim që pajtohet me pikëpamjet e shejh Esh'ariut dhe juristëve islamë, ashtu sikurse u përmend, mirëpo kur të kemi shqyrtuar pikëpamjet besimore të fraksioneve islame, do të gjejmë edhe të atilla që janë mosbesim pa diskutim, sikurse është besimi që kthehet në ekzistimin e një zoti tjetër rival Allahut të madhëruar, apo besimi në inkarnimin e Allahut (حلول) në disa persona, pastaj besimi që e mohon pejgamberinë e Muhamedit a.s., apo nënçmimi i tij dhe degradimi i tij, pastaj lejimi i të ndaluarave, ndërprerja e obligimeve fetare etj.¹⁸

Ky konstatim i këtij dijetari, kristalizon një mençuri parimore që konsiston se Islami i bartë pikëpamjet e gabuara deri në normalen e maksimales së tyre, si limit për të qenë në kuadër të tij, por jo edhe atëherë kur shkilen parimet fundamentale të tij apo kur dilet prej tyre. Në këtë aspekt, Feja Islame është rigoroze dhe e pamëshirshme.

Dijetarët janë unikë se mëkati i madh nuk e nxjerrë njeriun nga imani

Nga sa u tha, çështja e *tekfirit* gjenezën e vet e ka dhe e ngritë mbi mëkatin, varësisht se çfarë kategorie dhe lloji është ai. Muslimani që bën mëkate të rastit dhe të vogla, nuk është objekt që ndërlihet me *tekfirin*. Mirëpo muslimani që shkakton mëkat të madh, ka qenë objekt i diskutimeve të nxehta në mesin e dijetarëve.

Dijetarët e ehlu's-sunnetit ve'l xhemaatit janë unikë se mëkatari i madh nuk del nga kuadri i imanit për shkak të mëkatis që e bën, nëse ai këtë mëkat nuk e konsideron si të lejuar apo që lloji i mëkatis të mos jetë nga ato që konsiderohen kufër (mosbesim) dhe shirk (politeizëm).

Imam Ebu Hanife r.a., në veprën e tij “*Fikhu'l-Ebsat*”, është pyetur: Si mund ta demantoj fjalën e atij që thotë: *Ai që bën mëkate është*

¹⁸ El-Xhurxhani, “*Sherhu'l Mevakif*”, botimi op.cit. 8/375.

kafir?! Imami thotë: Atij mund t'i përgjigjesh kështu: Allahu xh.sh. thotë:

وَدَا التُّونَ إِذْ ذَهَبَ مُغَاضِبًا فَظَنَّ أَنْ لَنْ نَقْدِرَ عَلَيْهِ فَنَادَى فِي الظُّلُمَاتِ
أَنْ لَّا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ سُبْحَانَكَ إِنِّي كُنْتُ مِنَ الظَّالِمِينَ

“(Përkujto) **Edhe atë të peshkut (Junusin) kur doli i hidhëruar (prej popullit) dhe mendoi se nuk do t'i vijë më puna ngushtë, po në errësira ai tha se: “Nuk ka zot pos Teje. Ti je i pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra padrejtë vetes” (Kur’ani, El-Enbija: 87).** Sipas këtij ajeti ai me të vërtetë ishte zullumqar, por jo edhe kafir e as hipokrit¹⁹.

Kriteret që përcaktojnë kufirin e tekfirit

Kufri është oponent i imanit, ndërkohë që kufri në terminologjinë e shariatit, përdoret në dy relacione: Me nocionin kufr në shariat:

- nganjëherë synohet kufri që të nxjerrë nga ymjeti islam, e
- nganjëherë me të synohet kufri që nuk të nxjerrë nga ymeti islam.²⁰

¹⁹ Ebu Hanife “El-Fikhu’l-Ebsat” baburr-rredi ala men jukef-firu bidh-dhenbi, cituar sipas “Pesë kryeveprat e Ebu Hanifes”, parathënien doc.dr.Ibrahim Emiroglu, përktheu nga ar. Mustafë Jetish Bajrami, boton Bashkësia Islame e Kosovës, shtëpia botuese: Dituria Islame, Prishtinë 2000, fq. 102.

²⁰ Sejf El-Mazru’ijj Ebu Dhabji, “Mevkifu ehli’s-sunneti min mes’eleti’t-tekfiri” sipas <http://www2.alsaha.com/sahat/Forum2/HTML/005787.html>. i plasuar më: 18.04.1999. Ngjashmërisht me këtë është edhe shirku – politeizmi. Ekziston shirku i madh (esh-shirku’l-ekber) i cili manifestohet kur predikohet edhe një zot tjetër rival Allahut Një të vetëm. Ky shirk nxjerrë nga Islami. Dhe ekziston shirku i vogël, i cili nuk nxjerrë nga Islami porse konsiderohet mëkat prej mëkateve të mëdha. Ky manifestohet p.sh te rijaja – syfaqësia sikurse thotë Resulullahi a.s.

“Unë për ju frikësohem më së shumti nga shirku i vogël (esh-shirku’l-asgar). Ata (sahabët) i thanë: O i dërguari i All-llahut çka është shirku i vogël? (Pejgamberi a.s.) tha: Është rijaja – syfaqësia...” (Musnedi i Ahmedit, Kitabu: Bakije musnedil Ensar, Babu: hadithu Mahmud bin Lubejdi, nr. 22523).

Është mjaft e qartë se ulematë, të parët dhe të mbramët kanë përcaktuar kriteret që përcaktojnë kufirin në mes të Islamit dhe kufirit. Varësisht nga cili aspekt është trajtuar çështja, ata kanë bërë edhe sistemin e kriterëve. Sado që kriteret mund të duken të ndryshëm, ata assesi nuk largohen nga afërsia në synim. Kështu që, nëse i vështrime me kujdes konkludojmë se përcaktimet e tyre deduktohen në tri principe bazë, që njëherit konsiderohen kriteret fundamentale të tekfirit:

Lloji i parë: Kufri i madh i cili nxjerrë nga Islami dhe quhet kufri në aspektin besimor (كفر أكبر مخرج من الملة و يسمى الكفر الاعتقادي)²¹ Ky është kur njeriu mohon diç prej kushteve të imanit apo islamit, apo lejon një haram dhe ndalon ndonjë hallall, nga ato që janë të njohura në fe a priori (intuitive) dhe të pashmangshme. Sikurse është mohimi i Njeshmërisë së Allahut, apo i ringjalljes dhe tubimit, apo xhennetin dhe xhehennemin. Apo për shembull, e mohon obligueshmërinë e namazit, ose e mohon agjërimin, zekatin haxhin etj...²²

Ky lloj është që e kundërshton imanin dhe çvlerëson Islamin. Mohon ato parime pa të cilat Islami nuk mund të ekzistojë. Përmbajtja e tij është e obliguar me përjetshmëri në xhehennem. Ai mund të jetë në besim, në fjalë dhe në vepër. Ky lloj përbëhet prej pesë llojeve:

1. كفر التکذیب – kufri nga aspekti i përgënjeshtimit. Ky lloj nënkupton përgënjeshtimin e pejgamberëve, apo pretendimi se Pejgamberi a.s. ka ardhë me atë që është në kundërshtim me të vërtetën (të drejtën), apo kush pandeh se Zoti e ka ndaluar një gjë e ai (Pejgamberi a.s.) e ka nxjerrë me dijen e tij, më se dhe të tilla gjëra e lajthitin urdhërin dhe ndalimin e Allahut të madhëruar.

2. كفر الإباء و الإستکبار مع التصديق – kufri nga aspekti i refuzimit dhe mendjemadhësisë krahas ekzistimit të besimit në Allahun e madhëruar. Ky lloj nënkupton kur njeriu e lexon atë me të cilën kanë ardhur pejgamberët a.s. se është e vërtetë (hakk) prej Zotit të vet, mirëpo refuzon ta pasojë atë në shenjë arrogance dhe degradimi ndaj

²¹ Ebu Dhabji, “Mevkifu ehli’s-sunneti...”, op.cit.

²² Muhamed Seid Ramadan El-Buti “Mes’eletu tekfirin-nas” sipas:

<http://www.alwihdah.com/view.php?cat=1&id=381>. i plasuar më: 10.09.2003.

saj dhe ndjekësve të saj, sikurse është kufri i Iblisit (djallit). Është fare e vërtetë se ai nuk e mohoi urdhërin e Allahut dhe as nuk e injoroi, por e priti me refuzim dhe mendjemadhësi të cilat shkaktuan të bëhet nga pabesimtarët.

3. كُفْرُ الإِعْرَاضِ – kufri nga aspekti i distancimit (largimit) nga e vërteta. Kjo nënkupton kur njeriu largohet nga ajo që e dëgjon (prej të vërtetës) kurse zemra e tij, as nuk e beson Pejgamberin a.s. e as nuk e përgënjeshton, as nuk e pason e as nuk e kundërshton, dhe kurrë nuk i kushton ndonjë farë rëndësie. Të vërtetën e lë (prapashpinës) as nuk e mëson e as nuk vepron me të. Madje largohet nga ato vende në të cilat përmendet e vërteta. I tilli është kafir me kufër 'ië'radi' - të largimit.

4. كُفْرُ النِّفَاقِ – Kufri nga aspekti i hipokrizisë. Ky lloj nënkupton kur njeriu haptazi shpreh pasimin e asaj me të cilën ka ardhë i Dërguari i Allahut s.a.v.s., ndërsa në të vërtetë e refuzon dhe e mohon me zemër. I tilli publikisht e shpreh imanin, ndërsa e mban të fshehur kufirin.

5. كُفْرُ الشُّكِّ – Kufri nga aspekti i mëdyshjes. Ky nënkupton, kur besimtari nuk është i prerë në besim ndaj Pejgamberit s.a.v.s. e as nuk e përgënjeshton. Por dyshon në çështjen (të vërtetën) e tij dhe heziton që ta pasojë atë, ndërsa është fare e qartë se prej besimtarit kërkohet që të ketë bindje të prerë se ajo me të cilën ka ardhë Pejgamberi a.s. nga Zoti i tij është e vërtetë që nuk ka dyshim në të. Prandaj kush heziton (mëdyshet) në ndjekjen e saj (të vërtetës) pasi që me të ka ardhë i Dërguari s.a.v.s., ose e lejon që e vërteta të jetë e kundërta e saj e jo ajo, i tilli ka rënë në kufër nga aspekti i dyshimit dhe paragjykitimit.

Të gjitha këto lloje janë kufër, që obligojnë përjetshërinë në xhehennem dhe anulimin (e shpërblimit) për të gjitha veprat e 'mira', kur pronari i tyre vdes duke qenë veprues i njërit nga këto lloje²³ Allahu i madhëruar thotë:

²³ Ebu Dhabji, "Mevkifu ehli's-sunneti...", op.cit.

وَمَنْ يَكْفُرْ بِالْإِيمَانِ فَقَدْ حَبِطَ عَمَلُهُ

"... E kush mohon (tradhton besimin), ai ka asgjësuar veprën e vetë..." (Kur'ani, El-Maide: 5).

Lloji i dytë: Kufri i vogël i cili nuk nxjerrë nga Islami dhe quhet kufri nga aspekti i veprave

(كُفْرًا صَغِيرًا غَيْرَ مَخْرُجٍ مِنَ الْمِلَّةِ وَيُسَمَّى الْكُفْرَ الْعَمَلِيَّ). Duhet sqaruar se Ligjvënësi shprehjen e kufirit e ka përdorë në rol të preventivës (pengimit) dhe kërcënimit. Kjo domethënë se ky lloj i veprimeve edhe pse cilësohet si kufër, **nuk kanë karakter të kufirit i cili nxjerrë nga imani**, por kufrit i cili është prej mëkateve të mëdha (من كبائر الذنوب), që pashmangshëm meriton kërcënimin me denim (ألوعيد), mirëpo jo përjetësisht në xhehennem. Kjo vlen për të gjitha mëkatet, sepse ato janë prej natyrës së kufirit. Pra, me të (kufir) këtu nuk është për qëllim kufri i cili është antipod i imanit. Shembuj për këtë është p.sh. mbytja e muslimanit pa të drejtë, betimi në dikend tjetër pos Allahut, shkuarja te falltori dhe besimi në fjalët e tij, thënia e besimtarit ndaj vëllaut të tij 'o kafir' dhe shumë sosh prej kufirit të vogël.²⁴

Ja disa prej këtyre haditheve:

Transmeton Ebu Vail nga Abdullah bin Mes'ud i cili ka thënë: Ka thënë Resulullahi s.a.v.s.:

أَبِي وَائِلٍ عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ
قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ سَبَابُ الْمُسْلِمِ فُسُوقٌ وَقِتَالُهُ كُفْرٌ

"Sharja e muslimanit është mëkat, ndërsa lufta kundër tij është mosbesim"²⁵. Pastaj hadithi:

وَمَنْ لَعِنَ مُؤْمِنًا فَهُوَ كَفَرٌ، وَمَنْ قَذَفَ مُؤْمِنًا بِكُفْرٍ فَهُوَ كَفَرٌ

"Kush e mallkon një musliman është sikur ta ketë vlarë atë, dhe kush e akuzon një musliman për mohim është sikur ta ketë vlarë atë"²⁶. Pastaj:

²⁴ Ebu Dhabji, "Mevkifu ehli's-sunneti...", op.cit.

²⁵ "Sahihu'l Muslim" botimi i Kajros, op.cit. 2/54.

²⁶ Sahihul Buhari, Kitabul edebi, kap.44, hadithi nr.6047.

مَنْ آتَى عَرَاْفًا أَوْ كَاهِنًا فَصَدَّقَهُ بِمَا يَقُولُ فَقَدْ كَفَرَ بِمَا أُنزِلَ عَلَيَّ مُحَمَّدٍ

“Kush shkon te ndonjë falltor apo klerik që pretendon se i di fshehtësitë dhe i beson atij në atë që thotë, i tilli e ka mohuar atë që i është zbritë Muhamedit”²⁷, dhe hadithe të tjera.

Mirëpo, këto hadithe askush prej dijetarëve të ehclus-sunnetit nuk i ka kuptuar bukvalisht, sepse bien ndesh me natyren e parimeve të proklamuar nga ta, sikurse do t’i shohim më vonë.

Kur jemi te ky lloj duhet sqaruar se edhe prej veprave janë disa që kanë karakter të kufrit të madh apo që nxjerrin prej besimit. Ato janë dy sosh:

- veprimet që nga vetë esenca e tyre janë argument që e atakojnë një ‘rukn’ prej rukneve të imanit, sikurse është të bërit sexhde idhullit, apo puthja e kryqit etj., dhe
- veprimet që identifikojnë një fe tjetër, sikurse është zburkimi me aso gjëra të cilat janë specifike e pjesëtarëve të feve tjera, domethënë janë simbole fetare sikurse është vendosja e kryqit në qafë... etj.

Këto veprime kanë argumente të qarta... Shembulli i parë, të bërit sexhde idhullit, dëfton besimin në **hyjninë e idhullit** për të cilin edhe ka rënë në sexhde, kurse vendosja e kryqit referon **‘kryqëzimin e Isait a.s.’**²⁸. Nëse këto veprime dhe të ngjashme realizohen pa presion dhe me vetë dëshirë, padyshim se bartësi i tyre del nga Islami dhe konsiderohet si jomusliman.

Lloji i tretë: Kufri i cili shkaktohet nga lejimi i një mëkati që vërtetohet me argumente të prera nga Kur’ani dhe Sunneti, (إستحلال المعصية كفر). Të gjithë dijetarët e ehlu’s-sunnetit, të parët dhe të mbramët e tyre, janë unikë se konsiderimi i mëkatit si i lejueshëm, konsiderohet kufër, pamarrë parasysh se mëkati është i vogël apo i

²⁷ Musnedi i Imam Ahmedit, 4/68 & 5/380, cituar sipas: Xhemalud-din Ahmed bin Muhamed El-Gaznevijj El-Hanefijj, “Kitabu usulid-dini”, tahkik ed-duktur Omer Vefik Da’uk, boton: darul beshairi’l islamijeh, botimi i parë, 1998/1419, fq.207; “Sahihu’l Muslim” Kitabus-selam, babu:tahrimul kehaneti..., hadithi nr. 5782.

²⁸ El-Buti “Mes’eletu tekfirin-nas” op.cit.

madh, me kusht që të qenurit e tij mëkat, të vërtetohet me argument të prerë (بدليل قطعي).²⁹

Ky lloj është pikë që referon edhe llojin e parë edhe llojin e dytë. Do me thënë, çdo mëkat, qoftë ai që nga vetë esenca e tij tërheq *tekfirin*, (sikurse është lloji i parë) apo që nga vetë esenca e tij nuk e tërheq *tekfirin* edhe pse bart emër të këtillë (sikurse është lloji i dytë), në të dy rastet, konsiderimi i tyre (pra, i mëkateve) për të lejuara, e meriton akuzimin e *tekfirit* pa dallim.

Pozita e atij që e mohon një çështje koncenzuale

Ndërsa, sa i përket personit i cili e mohon një dispozitë fetare, e cila është e vërtetuar në fe me koncenzues (حكما مجمعا عليه), kurse dihet se ‘ixhmai’ është burim prej burimeve të sheriatit, pozita e tij në çështjen e tekfirit është varësi e llojit të ixhmait. Sepse, ixhmai është disa lloje: 1) El-ixhmau el-kavlijj es-sarihu; 2) El-ixhmaus-sukutij apo el-ixhmau el-kavlijj gajrus-sarih; dhe 3) El-Ixhmau’l-amelijj³⁰

Dijetarët janë unikë se mohuesi i një norme koncenzuale që nuk është e prerë në argumentim (ظني) sikurse është ‘el-ixhma’us-sukutij’, nuk bëhet kafir. Mirëpo, për njeriun që e mohon një normë koncenzuale të prerë në argumentim (قطعي), dijetarët ndahën në dysh: Disa thonë se mohimi ixhmait me normë të prerë në argumentim (قطعي), konsiderohet kafir. Ndërsa të tjerët dhe ky është mendimi i preferuar (ألراجح) thonë se nuk del prej fesë ai i cili e mohon një çështje koncenzuale, përveçëse nëse ajo është prej gjërave që dihen si të domosdoshme të fesë (معلوما من الدين بالضرورة), apo kur personi beson në lejimin e një gjëje që është e ndaluar me konsensus dhe që është prej domosdoshmërive fetare edhe nëse ajo është mëkat i vogël, pa marrë parasysh se ndalesa e tij është subjektive siç është amoraliteti (ez-zina) dhe pirja e alkoolit, apo për shkak të kundërshtimit (لعارض), si-

²⁹ Et-Taftazani “Sherhu’l akaidi...” op.cit. fq. 258.

³⁰ Prof.dr. Abdul Fetah Husejni (kryetar i mëparshëm i universitetit të El-Ez’heri) “Dirasat fi Usulil fikhi”, 1421/2000, pa vend botimi fq.179-180.

kurse është agjërimi i ditës së festës (bajramit), ku ndalesa e tij, nuk është për asgjë tjetër, përpos për shkak të kundërshtimit/konfuzionit.³¹

Atëherë, derisa njeriu (muslimani) nuk posedon në veprimet e tij ndonjë gjë prej këtyre llojeve, ai është musliman që nuk lejohet akuzimi për mosbesim (*tekfir*). Nëse jemi në dyshim për rënien e tij në një-rën prej këtyre llojeve, është parim që ai të konsiderohet i pastër nga to, dhe assesi nuk lejohet vendim ndaj tij për dezertim dhe largim të tij nga Islami, përpos duke u mbështetur në argumente të kategorisë së parë në argumentim.³²

Demonstrimi i kriterëve nëpërmjet një shembulli

Prof.dr. Ramadan El-Buti, gjersa diskuton mbi kriteret e *tekfirit*, thotë se është e nevojshme që këto pika t'i ilustron me një shembull konkret. Ai thotë: le ta marrim një çështje rreth së cilës zhvillohen debate të shumta nga predikuesit e thirrjes islame. Kjo çështje është: **“kush nuk gjykon me atë që e ka zbritë Allahu”**, se a konsiderohet jobesimtar sipas këtyre kriterëve që i kemi potencuar apo si qëndron çështja e tij.

Këtë shembull po e marrim qëllimisht, sepse ndërsa është një çështje që muslimanët në përgjithësi e frekuentojnë në jetën e tyre, me qëllim apo pa të, në anën tjetër “mosgjykimi” me atë që e ka zbritë Allahu, në një sërë ajetesh kur'anore sanksionohet me dispozitën e kufrit apo të *tekfirit*, mirëpo ajeti më i drejtëpërdrejtë në lidhje me këtë, është ajeti:

وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ

³¹ Abdul Kerim Tetan; Muhamed Edib El-Kilani, “Avnu'l muridi lish-sherhi xhevhere-t'it-tevhidi” fi akideti Ehli Sunneti ve'l xhemaati, boton Darul Beshair, botimi i dytë, 1999/1419, pa vend botimi, 2/1150.

³² El-Buti “Mes'eleu tekfirin-nas” op.cit.

“...E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ata janë mohues (kafirë)” (Kur'ani, El-Maide:44)³³.

Si qëndron puna me këto ajete, dhe si është e vërteta e atyre që janë objektiv i këtyre ajeteve. Në shikim të parë, ajetet dëftojnë ‘*tekfirin*’ e secilit njeri, musliman apo jomusliman.

Në mënyrë që përgjigjja jonë të jetë e qartë dhe e dobishme, është e pashmangshme që të bëjmë pyetje për domethënien e ‘mosgjykimit’ me atë që e ka zbritë Allahu, çfarë domethënie ka kjo?

Domethënia e kësaj është: “konkludimi i një çështje dhe miratimi i saj në lajthitje me ligjin e Allahut të madhëruar, pa marrë para sysh se njeriu këtë e konkludon rreth të drejtës së tij, të drejtës së familjes së tij, fëmijëve të tij, miqve, shokëve dhe në përgjithësi rreth ymnetit dhe shoqërisë në të cilën ai jeton”. Kështu që, ai i cili gjykon për udhëtimin e gruas së tij apo vajzës së tij moshërritur në mënyrë jo të hijeshme sipas mbulesës islame, ai konsiderohet se nuk gjykon me atë që e ka zbritë Allahu. Ai që gjykon (lejon) që në shtëpinë e tij të ekzistojë një e shëmtuar (e keqe) prej tërësisë së të këqijave, ai po ashtu nuk gjykon me atë që e ka zbritë Allahu. Pastaj anëtarët e asamblesë rezidenciale të cilët ratifikojnë dhënie-marrjen e kamatës për ligjvënës rezidencial, ata nuk gjykojnë me atë që e ka zbritë Allahu. Gjykatësi që gjykon një çështje me atë që nuk e ka zbritë Allahu, ai gjykon me atë që nuk e ka zbritë Allahu. Prokurori i cili e vërteton (beson) atë që e ka konkluduar ky gjykatës, nuk gjykon me atë që e ka zbritë Allahu....

Të gjitha këto kategori njerëzish dhe të ngjashme, pa u lëshuar edhe më tej, të gjithë konsiderohen se nuk gjykojnë me atë që e ka zbritë Allahu, dikush më pak e dikush më shumë. Atëherë, kthehemi te pyetja jonë: A hyjnë këta njerëz, bazuar në aktet e këtilla, pra, që nuk gjykojnë me atë që e ka zbritë Allahu, në grupin e jobesimtarëve dhe të dezertuarëve nga Islami, për sa kohë që janë muslimanë dhe

³³ Shih: “...E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ata janë mizorë” (Kur'ani, El-Maide:45); “...E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, të tillët janë mëkatarë të dalë jashtë rrugës së Zotit” (Kur'ani, El-Maide:47).

nuk e konsiderojnë për të lejuar akëcilën vepër që është mëkat vepri-mi i saj?

Përgjigjja do ishte kjo: këto akte, për nga esenca e tyre nuk hyjnë në llojin e parë prej atyre që janë kufër, e që është el-i'tikadat – veprimet nga aspekti i besimit, sepse ato akte nuk janë më shumë se fjalë dhe vepër. Dhe po ashtu nuk hyjnë në grupin e tretë që nënkupton konsiderimin e mëkatit për të lejuar. Dhe as nuk hyjnë në veprimet esenca e të cilëve a sfidon përmbajtjen e imanit, sikurse kemi thënë janë bërja sexhde idhullit, apo bartja e kryqit në qafë etj. Por këto veprime bëjnë pjesë në llojin e dytë, e që domethënë shkaktimin e mëkatit, apo *el-kufrul amelij*, i cili nuk nxjerrë nga imani, por vetëm konsiderohet mëkat prej mëkateve në Fe, kurse pesha e tij varet nga mënyra dhe intenziteti i bindjes në kryerjen e atij veprimi. P.sh. nuk është i njëjtë një musliman që brengoset shumë për mëkatin e vet, sikurse një tjetër që fare nuk mërzhitet.

Sipas kësaj na bëhet e qartë se nuk lejohet të akuzojmë me mosbesim askend prej muslimanëve vetëm pse i shohim se nuk konkludojnë në çështjet e tyre ose në çështjet e njerëzve me shariat të Allahut, pa marrë para sysh se veprojnë në gjykata apo në shtëpitë e tyre, në familjet e tyre apo gjëkund. Mirëpo nëse ne mësojmë se në një mënyrë a tjetër ekzistojnë argumente të prera se ai e ka mohuar me thëniet e tij ligjin e Allahut të madhëruar ose e ka nënçmuar, e që ajo dispozitë ka të bëjë me njërin prej kushteve të Islamit (si Fe) apo prej atyre që janë të njohura si të domosdoshme në fe, atëherë qëndrimi i tillë konsiderohet kufër, ndërsa njeriu i tillë bëhet kafir (pabesimtar), pa marrë para sysh se ai është prindi në familje, anëtari nëpër institucione (institute), apo mëkatar në të drejtat e tij, apo gjykatës në gjykatë, apo udhëheqës i shtetit të tij, pa kurrfarë dallimi.

Mirëpo, nëse nuk posedojmë argumente të prera për mohimin e tij ndaj ligjit të Allahut apo për ndonjë nënçmim ndaj tij, apo vendimi i tij ka të bëjë me ndonjë çështje që nuk konsiderohet prej gjërave të domosdoshme në fe, sepse janë çështje ixhtihadi, ose janë gjëra që nuk vërehen sa që nuk mund t'i dijë askush përpos profesionistët dhe

të specializuarit, atëherë vetë akti nuk na le të gjykojmë më tepër, përpos se ta konsiderojmë si mëkat të tij dhe gjynah.³⁴

Kjo do të ishte rezymeja e përgjigjes ndaj pozitës së atij i cili nuk gjykon me atë që e ka zbritë Allahu.

* * *

Ndërkaq, ata të cilët i akuzojnë muslimanët me *tekfir* në këtë çështje, bazohen në pjesën e fundit të ajetit 44, 45 dhe 47, të sures Maide, sikurse e kemi përmend edhe me herët. Mirëpo, dijetarët janë të një mendimi se këto ajete kanë zbritur për ehlu'l-kitabin (hebrenjtë dhe të krishterët) dhe kanë të bëjnë me ta, me jobesimtarët dhe me ata muslimanë që nuk gjykojnë me atë që e ka zbritë Allahu, nga aspekti i mohimit dhe injorimit.

Imam Rraziu në tefsirin e tij thotë: Këto ajete përmbajnë dy çështje:

Çështja e parë: Këto ajete e synojnë kërcenimin ndaj hebrenjve të cilët e ndryshuan gjykimin (hukm) e Allahut rreth dispozitës ndëshkuese të lavirit të martuar (في حد الزاني المحصن). Domethënë pasi ata e mohuan gjykimin e Allahut të shkruar në Tevrat, thonë: gjykimi i tillë nuk është i obliguar, prandaj ata janë pabesimtarë në përgjithësi që nuk e meritojnë emrin e besimtarit as në Musain, as në Tevrat, as në Muhamedin e as në Kur'an.

Çështja e dytë: është ajo të cilën e thonë havarixhët se kushdo që bën mëkat ndaj Allahut ai konsiderohet kafir, ndërsa shumica dërrmuese e dijetarëve e thonë të kundërtën. Kështu havarixhët (dhe të tjerët që mbajnë qëndrim ekstermë në këtë çështje), qëndrimin e tyre e argumentojnë me këto ajete.³⁵

Edhe pse shumica dërrmuese e tefsirologëve dhe hadithologëve mendojnë se kjo ka të bëjë me hebrenjtë, sikurse transmeton Imam

³⁴ Parafrazim me ndërhyrje i diskutimit të Ramadan El-Butit mbi këtë çështje. Shih: El-Buti "Mes'eletu tekfirin-nas" op.cit..

³⁵ Er-Rrazi "Tefsiru mefathi'l-gajbi-et-tefsirul kebir" mbi komentimi i ajetit 44 të kapitullit të El-Maide, sipas <http://www.altafsir.com>.

Muslimi në Sahihun e tij rreth zbatimit të dispozitës për zina ndaj një gruaje që kishte bërë zina, apo rreth të drejtës së një hebreu të cilin e kanë rrahur me shkopinj, ndërsa ai e ka merituar rrexhmin (gurëzim)³⁶, megjithatë, dijetarët, kanë mendime të ndryshme se a janë për qëllim vetëm hebrejtë, për të vërtetën e të cilëve kanë zbritur këto ajete, apo me to janë për synim të gjithë njerëzit pa dallim.

Abdullah Ibni Abbasi r.a. përmend të dy mundësitë³⁷, në anën tjetër, Fahrudin Er-Rraziu gjersa përmend deri në pesë mendime që kanë të bëjnë me fundin e këtyre ajeteve, ndalet në mendimin e pestë të Ikremeës i cili thotë:

Ajeti *لَا يَحِلُّ لَكَ أَنْ تَزُولَ إِلَيْهَا وَهِيَ كَافِرَةٌ* - *kush nuk gjykon me atë që e ka zbritë Allahu*, ka të bëjë me atë i cili e injoron me zemër atë dhe e mohon me gjuhë. Mirëpo ai i cili me zemër e njeh të qenurit e tij gjykim i Allahut dhe këtë e vërteton me gjuhë, porse vjen me vepër që e kundërshton atë, i tilli konsiderohet se gjykon me atë që e ka zbritë Allahu i madhëruar, edhe pse nuk e ka përfillë atë. Për këtë arsye ai nuk mund të hyjë në cilësimet e këtyre ajeteve. Derisa për mendimet tjera Imam Rraziu konsideron se nuk janë të qëndrueshme, për këtë thotë se është **‘përgjigje e vërtetë’**³⁸

Duke e plotësuar këtë thënie të Rraziut dhe njëherit duke e inkorporuar edhe verzionin e Ibni Abbasit r.a., ofrojmë verzionin më kuptimplotë mbi të vërtetën e këtyre ajeteve, të cilin e citon Ibni Mes’udi dhe Haseni r.a. Ata thonë: *“Këto ajete kanë karakter të përgjithshëm për secilin njeri qoftë prej muslimanëve, hebrejëve apo jobesimtarëve, të cilët nuk gjykojnë me atë që e ka zbritë Allahu duke pas bindje se nuk duhet të gjykohet me të dhe duke e konsideruar këtë legjitime (معتقداً ذلك و مستحلاً له). Ndërsa kush e bënë këtë, dhe është i bindur se është duke bërë haram, i tilli konsiderohet prej muslimanëve mëkatarë*

³⁶ Për më gjerë shih: Sahihul Muslim, Kitabu’l-hududi, kapitulli 6, hadithi nr. 4412.

³⁷ El-Buti *“Mes’eletu tekfirin-nas”* op.cit.

³⁸ Er-Rrazi *“Tefsiru mefatihil-gajbi...”* op.cit.

*dhe çështja e tij i përket Allahut, nëse do Ai e dënon sipas meritës së tij e nëse do e fal*³⁹

Pra, sikurse çështja e ‘mosgjykimit’ me atë që e ka zbritë Allahu, dhe çështjet tjera si mbytja e muslimanit pa të drejtë⁴⁰, shkuarja te falltori dhe besimi në fjalët e tij⁴¹, thënia e besimtarit ndaj vëllaut të tij ‘o kafir’⁴², amoraliteti⁴³, vjedhja⁴⁴, mbytja e vetvetes⁴⁵...etj, bërja e të cilave nëpër hadithe të Pejgamberit a.s. kërcënohet me kufër – mosbesim, e kanë karakterin e njejtë.

Duhet thënë edhe këtë se “Këto (hadithe) askush nuk i ka kuptuar bukvalisht përpos harixhinjëve, të cilët bërësin e ndonjë mëkati të madh e konsiderojnë jobesimtar. Kurse Ehli Suneti merr qëndrim se të gjitha këto hadithe duhet të komentohen në pajtim me parimin⁴⁶ se *mëkati pa marrë parasysh çfarë është ai nuk nxjerrë nga imani, derisa ai nuk konsiderohet i lejuar dhe që nuk përmban elemente të kufrit dhe shirkut.*

Në lidhje me këtë, imam Neveviju r.h. thotë: Për këtë parim (rregull) kanë ardhur argumente nga Kur’ani, synneti dhe ixhmai-koncenzuesi i dijetarëve... E nëse vjen hadithi i cili në aspektin formal (të jashtëm) të tij kundërshtohet me këtë parim atëherë është obligim që ky hadith të komentohet mbi atë parim në mënyrë që të mund të arrihet bashkimi i teksteve të shariatit. Dijetarët e ehlu Sunetit i pranojnë të gjitha ato që citohen në hadithe, por ata kanë mendime të ndryshme rreth asaj se çka në të vërtetë synohet në hadithe të tilla⁴⁷

³⁹ Kurtubiju *“El-Xhamiu li ahkami’l-Kur’ani”*, mbi komentimi i ajetit 44 të kaptinës El-Maide, sipas <http://www.altafsir.com>.

⁴⁰ Sahihu’l Muslim op.cit. botimi i Kajros, 2/54.

⁴¹ Shih: Musnedi i Imam Ahmedit, 4/68 & 5/380, burim i cituar më parë.

⁴² Shih hadithin: Sahihul Buhari, “Kitabul edebi”, kap.44, nr.6045

⁴³ Shih: Sahihul Buhari, ‘Kitabu’l eshribeti’, kapitulli 1, hadithi nr. 5578.

⁴⁴ Shih: Sahihul Buhari, ‘Kitabu’l eshribeti’, kapitulli 1, hadithi nr. 5578.

⁴⁵ Shih: *“Sahihu’l Muslim”* botimi i Kajros, ‘Kitabul imani’, kapitulli: ‘katilu nefsihi la jekfur’ 2/130-133.

⁴⁶ Dr. Muhammed Naim Jasin, *“Besimi bazat esenca negacioni”*, boton Furkan ISM, 1998, Shkup, fq. 208.

⁴⁷ *“Sahihu’l Muslim”* botimi i Kairos, op.cit., 1/217 e më tutje.

Disa prej tyre mendojnë se me këto hadithe dëshirohet vetëm të tërhiqet vërejtja në madhësinë dhe rrezikun e mëkateve të përmendura, e disa të tjerë konsiderojnë se kufri në hadithet e përmendura ka të bëjë me ata të cilët këto mëkate i konsiderojnë të lejuara. E, kush lejon çkado qoftë prej tyre, bëhet renegat...⁴⁸, dhe mendime të tjera.

Kushtet e *tekfirit*

Është më se e domosdoshme që të bëjmë dallim ndërmjet llojit (النوع) dhe subjektit (العين) në *tekfir*, sepse çdo vepër që është kufër, nuk do të thotë se edhe personi që e bën është a priori kafir. Prandaj duhet të bëjmë dallim në gjykim pse një fjalë është kufër, të gjykohet pronari i saj për kafir. P.sh. thënia se Allahu është në çdo vend është kufër, thënia se fjala e Allahut është e krijuar është po ashtu kufër, mohimi i cilësive të Allahut është kufër. Këto dhe të ngjashme janë prej kategorisë së gjykimit nga aspekti i llojit dhe fjalës. Ndërsa kur çështja varet për një person të caktuar, atëherë patjetër nevojitet të përmbahemi dhe t' mos e gjykojmë atë me kufër derisa ai nuk pyetet dhe nuk diskutohet me te për fjalët e tij, sepse është e mundshme që një bisedë të mos vërtetohet se është e tij, apo ajo të jetë një interpretim i lirë prej tij, apo ai nuk ka mundësi t'i kuptojë tekstet ose është injorantë, e kur dyshimi të evitohet pasi të debatohet ai dhe t'i ofrohen argumentet, tek atëherë çështja merr definimin e vet.⁴⁹

Në këtë kontinuitet, *tekfiri* i kërkon katër kushte të domosdoshme:

Kushti i parë: *Vërtetimi që personi / subjekti (الفاعل) i caktuar me fjalën, veprën apo lërjen e tij të ketë për qëllim domethënien e cila në kontekst konsiderohet kufr, sipas argumenteve të Kur'anit dhe Sunnetit.*

Ky kusht që nënkupton subjektin apo vepruesin, kërkon disa nënkushte:

- që vepruesi të jetë i ngarkuar me obligimet fetare (mukel-lefen), do me thënë moshërritur dhe i mençur (بالغا عاقلا)

⁴⁸ M.Naim Jasin "Besimi bazat..." op.cit. f. 208.

⁴⁹ Ebu Dhabji, "Mevkifu ehli's-sunneti...", op.cit.

- që vepruesi të bëjë atë me qëllim, d.m.th. duke e synuar veprën e tij (قاصدا لفعله)
- që vepruesi të zgjedhë veprën e tij me vullnetin e tij të lirë (مختارا بإرادته)⁵⁰

Është fare e qartë se njeriu nuk mund të akuzohet si kafir me supozim ndaj tij. Para se ta akuzojmë njeriun për dalje nga Feja Islame, për të vërtetën e tij duhet të jemi maksimalisht të sigurtë, se ajo që po e thotë, apo ajo shprehje i plotëson kushtet të konsiderohet kufr.

Poashtu është e patjetërsueshme që në radhë të parë të hulumtohet e vërteta e qëllimit të tij. Se me shprehjen e caktuar që konsiderohet kufr, a e ka synuar domethënie që e përfaqëson bindjen e tij apo jo, ngase ekziston mundësia që një shprehje të përmbajë domethënie të dyfishtë, apo ajo të jetë metafor, e njeriu ndoshta nuk e ka për qëllim domethënien e cila konsiderohet kufr. Kur njeriut bëhet me dije se fjala që ai e thotë është kufër, atëherë kërkohet nga ai nëse e pranon atë akt apo e mohon. Nëse heq dorë, mirë, në të kundërtën i bie akuza e *tekfirit*.

Kushti i dytë: *Vërtetimi që veprimi i caktuar, apo fjala apo lërja konsiderohet kufr sipas argumenteve të Kur'anit dhe Sunnetit* (ثبوت أن هذا القول أو الفعل أو الترك كفر بمقتضى دلالة الكتاب أو السنة).

Derisa kushti i parë ka të bëjë me subjektin, ky kusht ka të bëjë me veprën (الفعل) Edhe vepra kërkon disa kushte:

- Që vepra të jetë kufër që nuk ka kurrfarë dyshimi në të (أن يكون الفعل مكفرا لا شبهة فيه)
- Që vepra e mukel-lefit (të ngarkuarit me detyrimet fetare) apo thënia e tij të jetë e qartë në argumentim (përmbajtje) se është kufër (أن يكون فعل المكلف أو قوله صريح الدلالة علي الكفر)⁵¹

⁵⁰ Abdur-Rrahman bin Fuad El-Xharull-llah "Shurutut-tekfiri'l-muaj-jen", sipas http://islamway.com/?iw_s=autdoor&iw_a=print_article&article_id=1901. i plasuar më: 01.09.2006.

⁵¹ Dallimi në mes dy kushteve është ky. Kushti parë është që nuk ka dyshim në të. p.sh. thënia se Kur'ani është i krijuar, këtu nuk ka dyshim se kjo thënie është kufr. Kushti dytë: që vepra të jetë me argumentë të qartë është sikurse fjala: لا صلي الله علي من صلي عليه - e që domethënë: *kush i bën dua atij, Allahu nuk bën dua për të*. Kjo thënie bartë kuptime të mundshme, dhe nuk është e qartë në argumentim, sepse me përemrin dëftor 'atij', a synohet Resulullahi s.a.v.s. apo ndonjë person tjetër. (shih: El-Xharull-llah "Shurutut-tekfiri..." op.cit.)

- Që argumenti shariatik i cili e pohon kufrin të jetë për atë vepër që është e qartë në argumentim se është meritore për *tekfir* (أن يكون الدليل الشرعي المكفر لذلك الفعل صريح الدلالة على التكفير)⁵²

Kusht i tretë: *Arritja e argumentit nga revelata hyjnore se shprehja e caktuar, apo vepra apo lërja konsiderohet kufr* (بلوغ الحجة الرسالية)

Kur muslimani të është informuar se fjala që e thotë apo një vepër që e ka bërë apo e bën, konsiderohet kufr, atëherë kjo gjendje e tij parasegjithash duhet të polemizohet duke i ofruar argumente bindëse që e argumentojnë atë drejtpërdrejtë, p.sh. sikurse thamë më lartë, atij i cili i mohon cilësitë e Allahut xh.sh. duhet t'i sjellim argumente nga Kur'ani dhe Hadithet e vërteta, e të cilat janë mjaft shumë. Ai që mohon ekzistimin e xhennetit apo xhehennemit, po ashtu duhet t'i sjellim argumente nga bazat e fesë e të cilat janë vërtetë shumë e kështu me radhë. Të gjitha diskutimet duhet t'i bëhen në stilin e gjuhës që ai e kupton. Për çdo gjë që diskutohet, ai duhet ta kuptojë mirë në tërësi. Krejt kjo për arsye se Allahu nuk e ndëshkon muslimanin derisa ai të mos është i informuar saktë për të, sikurse thotë Allahu i madhëruar: **"...E Ne nuk denuam askë para se t'ia dërgojmë të dërguarin"** (*Kur'ani, El-Isra:15*).

Ekzistojnë mjaft shumë muslimanë, në mbarë botën të cilët kushtimisht them se bëjnë shumë vepra dhe flasin shumë fjala që në shikim të parë konsiderohen kufr. Arsyeja është se ata besimin dhe islamin e kanë shprehur në mënyrë të përgjithshme (ixhmalen) qoftë duke e trashëguar nga rrethi në të cilin jetojnë apo nga familja e vet e ngushtë. Kështu mundësitë janë të hapura që tek ta të gjenden fjala dhe vepra që konsiderohen kufr, mirëpo akuzimi i tyre për jo musliman, derisa nuk ju qartësohet me argumente të prera në formën që ata i kuptojnë, është i papranueshëm.

⁵² El-Xharull-Ilah "Shurutut-tekfiri..." op.cit.

Kushti i katër: *Mosekzistimi i elementeve që pengojnë tekfiri në të drejtën e tij* (إنتفاء مانع التكفير في حقه)⁵³

Pra, është kusht që për të ardhur në shprehje *tekfiri* ndaj një personi, duhet të evitohen elementet që e pengojnë atë. P.sh nuk mund ta akuzojmë për kufr, personin e çmendur, apo fëmiun, apo një fjalë a vepër e cila nuk është prej çështjeve që argumentohet me argument të prerë nga Kur'ani dhe Hadithi, porse është prej çështjeve që pranon interpretim dhe diskutim, përkatësisht i nënshtrohet ixhtihadit.

Dijetarët kanë koncensus se nuk mund të akuzohet me kufr, ai i cili përpiket për të vërtetën por gabon në ixhtihad⁵⁴. Normalisht, që objekt i ixhtihadit mos të jenë ato çështje, për të cilat ekziston argumenti i prerë, sepse aty nuk ka çka bëhet ixhtihad, p.sh. nuk bëhet ixhtihad për obligimin e namazit a është farz apo jo, apo për zekatin etj. Nëse muxhtehidi bën ixhtihad në këtë rrafsh, ai kalon në mohim të qartë. Por, fjala është për ato gjëra që nuk posedojnë argumentë të prerë drejtpërdrejtë, dhe si të tilla kërkojnë argumentim në një qasje tjetër. P.sh. ulematë kanë ndryshim mendimesh rreth cilësisë "*el-ismetu*" – të pejgamberëve, se a fillon kjo cilësi te ta prej lindjes e deri në vdekje apo ajo fillon pas gradimit të tyre për pejgamber; pastaj, a nënkupton mbrojtjen edhe prej mëkateve të vogla apo vetëm prej mëkateve të mëdha, e kështu me radhë, ku secili opcion, nuk e fiton mbështetjen e argumentit të prerë. Ulematë kanë koncensus se pejgamberët janë të mbrojtur në çështjet shariatike, pra që kanë të bëjnë me besimin, dhe prej mëkateve të mëdha pas gradimit të tyre për pejgamberë, ndërsa aspektet tjera i nënshtrohen fushës së ixhtihadit, domethënë nuk kanë konsensus.

⁵³ Falih, "Mu'xhemu elfadhi'l akideti" fq.99.

⁵⁴ Bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s. i cili thotë: **إِذَا اجْتَهَدَ الْحَاكِمُ فَأَصَابَ لَهُ أَجْرَانِ وَإِنْ أَخْطَأَ فَلَهُ أَجْرٌ وَاحِدٌ** – "Kur dijetari përpiket për të vërtetën dhe e qëllon atë, i ka dy shpërblime, e nëse gabon e ka vetëm një shpërblim." (Buhariu dhe Muslimi)

Ndarja e *tekfirit*

Pasi t'i kemi kuptuar kriteret e *tekfirit* dhe kushtet e tij, është prej gjërave plotësuese njohja e llojeve të tij. '*Tekfiri*' ndahet në dy lloje:

1. *tekfiri* i përgjithshëm – sipas vetive (التكفير المطلق – الأوصاف)
2. *tekfiri* i veçantë – sipas personave (التكفير المعين – الأعيان)

Ky është drejtimi i ehclus-sunnetit vel xhemaatit.

Tekfiri i përgjithshëm është kur një fjalë apo vepër, bindje, besim apo lërje, konsiderohet kufr, gjithnjë sikurse kemi thënë sipas Kur'anit dhe Synnetit, autorët e tyre gjykojnë për kafira në mënyrë të përgjithshme, pa bërë dallime veç e veç, kuptohet pasi të jenë plotësuar kushtet e *tekfirit* dhe të mos ekzistojë ndonjë element që e pengon atë.

Tekfiri i veçantë është i njëjtë në kriteret sikurse *tekfiri* i përgjithshëm, përveçse gjykimi me *tekfir* nuk bëhet në pako – në mënyrë të përgjithshme, por gjykohet për secilin person veç e veç i cili i plotëson kushtet e *tekfirit*.

Duke u bazuar në kushtet e *tekfirit* rezultohet se lloji i parë, pra *tekfiri* në mënyrë të përgjithshme, në parim është vështirë i aplikueshëm ose vetëm në raste të veçanta, dhe atë për dy arsye:

- Sepse nuk garantohet siguria e plotë në këtë dhe nuk mund të evitohen dyshimet. Imam Muhamed Abduhu (1849-1905) thotë: Nëse del një fjalë prej ndonjërit e që ajo bartë mundësinë që të jetë kufr nga njëqindë anë, kurse mundësinë e imanit vetëm nga një anë të vetme, atëherë ajo kalohet kah imani dhe nuk lejohet çuarja e saj kah kufri⁵⁵;
- Sepse nuk plotësohen kushtet e *tekfirit*, ngase prej kushteve të *tekfirit* është që para se personi të akuzohet me *tekfir*, t'i bëhet debatim pikëpamjeve të tij, duke ja bërë me dije se ajo i kundërshton bazat e fesë, e nëse ai mbetet në bindjet e tij, atëherë ai është

meritor për *tekfir*, ndërsa kjo të *tekfiri* i përgjithshëm nuk ka mundësi të aplikohet për faktin se ai është gjykim në total.

Akuza për *tekfir* është institucionale

'*Tekfiri*' është dispozitë e sheriatit (حكم شرعي) prej dispozitave tjera të fesë, i cili ka shkaqet e tij, kriteret, kushtet, pengesat dhe pasojat. Çështja e tij në këtë rast është çështje e të gjitha dispozitave të sheriatit⁵⁶

Dijetarët islamë kanë përcaktuar rregulla, kriteret, kushte dhe parime mbi *tekfirin*. Varësisht prej qasjeve kanë rezultuar edhe forma e kriterëve, mbase edhe numri i tyre. Ne pa hy në të gjitha ato, sepse disa janë potencuar deri më tani, e disa të tjera ndryshojnë nga konteksti i këtij punimi. Por, është mendim pragmatik i ulemave se *tekfiri* është çështje sheriatike, ata thonë:

Çështja e *tekfirit* i përket Allahut të madhëruar dhe të Dërguarit të tij. Për atë çështje që argumenton Kur'anit dhe Synneti se është kufr, atëherë ajo është, ndërsa atë që e argumenton Kur'anit dhe Synneti se nuk është kufr, ajo nuk është.⁵⁷

Prandaj edhe akuzimi i një muslimani për kufr është institucional, përkatësisht nga autoriteti kompetent, i cili edhe është i përgatitur profesionalisht, po edhe legal.

Nuk mund të gjykojë në *tekfir* tjetër kush, përpos dijetarit (أعلم) me anë të argumenteve të sheriatit.⁵⁸ Sepse, përmbajtjen e Kur'anit, Synnetit dhe argumentet e sheriatit nuk i njeh përpos personi që është thelluar në njohjen e tyre, dhe si i tillë është dëshmuar me rezultate. Për këtë arsye nuk lejohet absolutisht që të sjell vendimin e një çështje kaq të rëndësishme për jetën individuale dhe kolektive, njeriu që nuk është kompetent dhe institucional, sepse Allahu i madhëruar thotë: "*Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të*

⁵⁶ El-Xharull-llah "*Kavaidun fit-tekfiri*" op.cit.

⁵⁷ Falih, "*Mu'xhemu elfadhi'l akideti*" fq.99.

⁵⁸ El-Xharull-llah "*Kavaidun fit-tekfiri*" op.cit.

⁵⁵ Muhamed Ammareh, "*El-Ihtirazu minet-tekfiri*" sipas:

<http://www.alwihdah.com/view.php?cat=1&id=9>, i plasuar më: 18.01.2003.

pamët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi” (*Kur’ani, El-Isra, 36*).

Në këto relacione, Ibni Tejmije r.h. thotë: “Për këtë arsye dijetarët e shkencës dhe Synnetit nuk e akuzonin me kufër atë që i ka kundërshtuar ata edhe nëse ai kundërshtim i hedh në kufër vetë ata, sepse kufri është dispozitë e shariatit, e kjo domethënë, njeriut nuk i takon që t’i kundërvehet me të ngjashme, sikurse bie fjala: ai që të ka gënjyer apo ka bërë amoralitet me familjen tënde, nuk do të thotë që edhe ti ta gënjesh atë dhe të bësh amoralitet me familjen e tij, nga që gënjeshtria (el-kedhibu) dhe amoraliteti (ez-zina) janë haram, sepse janë e drejtë e Allahut (hak-kull-llahi)”⁵⁹

Rreziku i akuzës për *tekfir*

Nga sa u tha edhe më lartë, nuk lejohet *tekfiri* ndaj një muslimani për shkak të mëkati që ai e bën, dhe as për ndonjë gabim që e bën, sikurse janë çështjet të cilat janë të polemizuara ndërmjet pjesëtarëve të ehlul kibles. Rreshtimi i ymjetit në fraksione nuk duhet të jetë motiv i akuzës së ndërsjelltë. Fundja këtë duhet parë si të pashmangshme, e në raste më të favorshme edhe si mëshirë për ne.

Ebul Hasen El-Eshariu në fillim të veprës së tij ‘Kitabul mekalatil islamijjin’ thotë: ”Njerëzit pas (vdekjes së) Pejgamberit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem janë ndarë në mendime të ndryshme rreth shumë gjërave. Disa prej tyre, rreth këtyre gjërave, i kanë hedhur disa të tjerë në devijim (ضلل) duke u distancuar njëri nga tjetëri, me se dhe u transformuan në fraksione kontradiktore (فرقا متباينين) dhe parti të shpërndara (متشتتين أحزابا). **Mirëpo, Islami është ai që i tubon të gjithë ata dhe i pranon në gjirin e vet** (يجمعهم ويشتمل عليهم الا ان الإسلام)”⁶⁰ Ky pohim i imamit të madh bart një mendësi mirëkuptimi të gjërë dhe deklaroi se asnjë fraksion islam s’do të akuzohet për mosbesim⁶¹ Do-

⁵⁹ El-Xharull-llah “Kavaidun fit-tekfiri” op.cit.

⁶⁰ El-Esh’arij, El-Imam Ebi’l Hasen Alij bin Ismail “Kitabu mekalati’l islamijjine ve ihtilafi’l musal-line” me korrektim të Hellmut Ritter, botimi i tretë, 1400 h / 1980, pa vend botimi, f. 1-2.

⁶¹ Topalo lu, “Hyrje në Kelam”, fq. 273

methënë edhe pse ehlul-kibletit janë të ndarë në fraksione, të gjithë për referim e kanë Islamin. Xhurxhani për këtë thënie thotë se është medh’hebi i tij dhe i shumicës së hanefinjve⁶².

Havarixhët, të rrëshqitur nga feja (المارقون), luftimin e të cilëve e ka urdhëruar Pejgamberi s.a.v.s., i ka luftuar prijësi i muslimanëve Alij bin Ebi Talibi – njëri prej halifëve të dëshmuar me qeverisje të drejtë. Për luftimin e tyre kanë unanimitet të gjithë imamët e Fesë, prej sahabëve, tabiinëve dhe të tjerëve pas tyre. Megjithatë, Alij bin Ebi Talibi, Sa’d bin Ebi Vekkas dhe të tjerë prej sahabëve nuk i kanë akuzuar me kufër, por i kanë konsiderua muslimanë megjithë luftimin e tyre (جعلوهم مسلمين مع قتالهم). Mirëpo, ata nuk janë luftuar derisa nuk kanë shkaktuar vrasje (gjakderdhje) të padrejta, dhe shkatërrime të pasurisë së muslimanëve. Prandaj ata i kanë luftuar për ta evituar dëmin dhe të keqen e tyre, e jo për se janë pabesimtarë (kafirë). Për këtë arsye nuk ofendohen gratë e tyre e as nuk konfiskohet pasuria e tyre.⁶³

Dijetarët e mëvonshëm sunnitë që mbajnë qëndrim më të ashpër ndaj Havarixhëve duke i konsideruar për jomuslimanë, bazohen në akuzat e tyre që ata i kanë bërë në llogari të disa sahabëve të mëdhenjë për të cilët Pejgamberi a.s. ka dëshmuar me xhennet⁶⁴. Me se sipas haditheve të pejgamberit a.s. nëse i akuzuari me *tekfir* nuk është meritator për të, akuza i kthehet akuzuesit, e kjo domethënë akuza i kthehet Havarixhëve, sepse është e vërtetë se dëshmia e Pejgamberit a.s. mbi sahabët është më prioritare.

Mirëpo, të gjitha ato hadithe të vërteta që transmetohen në këtë kontekst, e citojnë vetëm: **وَالْإِلَّاهُ رَجَعَتْ عَلَيْهِ** – **përndryshe akuza i kthehet akuzuesit**, dhe asnjëri prej tyre nuk e precizon se kush i kthehet: a i kthehet kufri akuzuesit, pra e akuzuesi të llogaritet mosbesimtar, apo i kthehet mëkati i akuzës, e ai të llogaritet mëkatar, apo thënia në hadith ka të bëjë për parandalimin e muslimanit që ta akuzojë vëllaun e tij musliman për mohim?!⁶⁵

⁶² El-Xhurxhani, “Sherhu’l Mevakif”, 8/370.

⁶³ Ibni Tejmije “La jexhuzu tekfiru’l-muslimi bidhenbin fealehu ve la bihatain ahtaehu fihî” sipas <http://www.alwihdah.com/view.php?cat=1&id=118>, i plasuar më:14.04.2003.

⁶⁴ Shih:Sahihul Buhari, “Kitabul edebi”, kap.44, nr.6045, vëll. 10 fq.572.

⁶⁵ Sahihul Buhari, “Kitabul edebi”, kap.44, nr.6045, vëll. 10 fq.572-573.

Me sa dihet është vetëm një hadith që është i drejtpërdrejtë rreth kësaj, e të cilin e transmeton Ebu Davudi: ”Kur një musliman akuzon për mosbesim një musliman tjetër, në se ky i fundit është mosbesimtar, ashtu mbetet, në të kundërt, bëhet vetë mosbesimtar.”⁶⁶

Bekir Topalo lu thotë: Por, ç’e do se hadithi, megjithëse është i vërtetë (sahih), me që nuk është nga ato që qarkullojnë gojë më gojë (mutevatir), mund ta shpëtojë Havarixhin nga *tekfiri*⁶⁷

Prandaj kur çështja qëndron kështu me havarixhët, të cilët konsiderohen një ndër fraksionet thellë të devijuar nga rruga e vërtetë, atëherë si do të vijë në shprehje për muslimanët tjerë. Kjo do të thotë, se nëse akuza për *tekfir* është gati sa e pamundur, na përkujton se në mos asgjë tjetër, për plasimin e saj duhet qenë tepër parimor, të sigurtë dhe maksimalisht të përmbajtur.

Dijetarët vizionarë të këtij ymjeti, të parët dhe të mbramët e tij, kontributi i të cilëve në shoqërinë islame, do të mbetet një kurorë e përhershme, i kanë qëndruar besnikë rrugës së Resulullahit s.a.v.s i cili ka thënë:

أَمَرْتُ أَنْ أُقَاتِلَ النَّاسَ حَتَّى يَقُولُوا لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ فَمَنْ قَالَ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ
فَقَدْ عَصَمَ مِنِّي مَالَهُ وَنَفْسَهُ إِلَّا بِحَقِّهِ وَحِسَابِهِ عَلَيَّ اللَّهُ

“Jam urdhëruar të luftoj kundër njerëzve, derisa të thonë “la ilahe il-la’Llah” – nuk ka zot tjetër përpos Allahut. E kush thotë “la ilahe il-la’Llah” – nuk ka zot tjetër përpos Allahut, ai i ka të mbrojtura pasurinë e tij dhe jetën e tij prej meje, përveç detyrimeve (përgjegjësi) të tij juridike. Kurse llogaria e aspektit të brendshëm (për fjalën që e ka thënë) i përket Allahut...”⁶⁸ Dhe hadithi tjetër:

⁶⁶ Ebu Davud, Es-Sunen, 5, sipas Topalo lu, “Hyrje në Kelam”, fq.277.

⁶⁷ Topalo lu, “Hyrje në Kelam”, fq.277. Mirëpo, autori i “Mevakifit” El-Xhurxhani, megjithatë konsideron se havarixhët kanë rënë në mohim, sepse e kanë përgënjeshtuar Kur’anin dhe Sunnetin mbi pastërtinë (et-tezkijjetu) dhe imanin e disa prej sahabëve të mëdhenjë, e të cilët havarixhi i ka akuzuar për mohim. (shih: El-Xhurxhani, “Sherhu’l Mevakif”, botimi op.cit. 8/375).

⁶⁸ Sahihul Muslim, botimi i Kajros, fq.1/206.

مَنْ صَلَّى صَلَاتَنَا وَاسْتَقْبَلَ قِبَلَتَنَا وَ أَكَلَ ذَيْحَتَنَا،
فَذَلِكَ الْمُسْلِمُ الَّذِي لَهُ ذِمَّةُ اللَّهِ وَ ذِمَّةُ رَسُولِهِ، فَلَا تَخْفَرُوا اللَّهَ فِي ذِمَّتِهِ

“Kush falet ashtu sikurse ne, që drejtohet kah Kibleja (Qabja në Mekë) nga e cila drejtohem ne, që ha nga të therurat tona, i tilli konsiderohet musliman që e meriton mbrojtjen e Allahut dhe mbrojtjen e të Dërguarit të Tij. Prandaj, mos e prishni garancinë e premtuar nga Allahu”⁶⁹

Këto dy hadithe le të jenë pikë referuese e gjykimeve tona në *tekfir*. Që në fillim kemi përmendur se akuza e *tekfirit* ka rreziqe tepër të rënda. Nuk do koment, se pasojat që i bartë ajo, janë arsyeja qëndrore, që i bën të kujdesshëm të gjithë dijetarët në këtë çështje. Sepse vendimi për ekzekutim të një muslimani që dëshmon ‘shehadetin’, apo përjashtimi i tij nga të drejtat islame (kur ekzekutimi nuk mund të realizohet), si shkak i *tekfirit* të tij, pa dyshim është një veprim që asnjëherë nuk mund të japë qetësi të prerë. Jeta është e shenjtë dhe e shtrenjtë, dhe është e drejtë e Allahut. Definim i kufirit të *tekfirit*, nga sa mësuam nuk është i pamundur, por është jashtzakonisht i vështirë dhe kritik.

Le ta themi edhe atë se Pejgamberi a.s. e ka ndaluar vrasjen e një muslimani që dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, përpos në njërin prej tri rasteve: “Kur i martuari bën amoralitet, kur bën vrasje të njeriut, dhe kur e braktisë fenë Islame dhe largohet nga bashkësia (muslimane)⁷⁰. Pejgamberi a.s. e ka lejuar ekzekutimin e murted-dit, mirëpo kur ai deklarohet publikisht.

Është leksion i mirë se dijetari mendjeprehtë Ebu Xha’fer Et-Ta-haviu, më së shumti që ka mundur të thotë për fraksionet e dyshimta, sikurse janë mushebbëhitët, mu’tezilët, xhehmitët, xheberitët, kaderitët dhe të tjerët është se “ato janë në devijim dhe shkatërrim”⁷¹, por jo

⁶⁹ Sahihul Buhari, kitabus-salati, kapitulli 28, hadithi nr. 391.

⁷⁰ Shih: Sahihul Buhari, kitabud-dijjat, kapitulli 6, hadithi nr. 6878.

⁷¹ Shih: Ibnu Ebil Izz, “Sherhul akidetit-tahavije”, op.cit. fq. 520.

edhe të deklarohet mosbesimin e tyre, derisa ata pranojnë se janë ehlu'l-kibleti⁷²

Resulullahi në shumë hadithe të tij ka tërheqë vërejtjen nga nxitimi për *tekfir* të muslimanëve. Le t'i transmetojmë disa hadithe prej tyre:

أَيُّ أَمْرٍ قَالَ لِأَخِيهِ يَا كَافِرٌ
فَقَدْ بَاءَ بِمَا أَحَدُهُمَا إِنْ كَانَ كَمَا قَالَ وَإِلَّا رَجَعْتُ عَلَيْهِ

Transmetohet nga Ibni Omeri i cili ka thënë: *Ka thënë Resulullahi s.a.v.s.: "Se cili njeri (musliman) që i thotë vëllaut të tij 'o kafir', kjo fjalë kalon në njërin prej tyre, nëse ai është merit për të, akuza i mbetet të akuzuarit, e nëse s'është, atëherë akuza i kthehet akuzuesit"*⁷³

Transmetohet nga Ebu Dherri, i cili e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. të thotë:

لا يرمي رجل رجلاً بالفسوق، ولا يرميه بالكفر،
إلا ارتدت عليه، إن لم يكن صاحبه كذلك

*"Nuk e akuzon njeriu njeriun (muslimanin) me prishje dhe as me mohim (kufër), e që kjo akuzë të mos i kthehet vetë atij, nëse shoku i tij nuk është merit për këtë"*⁷⁴

وَمَنْ لَعَنَ مُؤْمِنًا فَهُوَ كَفَرٌ، وَمَنْ قَذَفَ مُؤْمِنًا بِكُفْرٍ فَهُوَ كَفَرٌ

*"Kush e mallkon një musliman është sikur ta ketë vlarë atë, dhe kush e akuzon një musliman për mohim është sikur ta ketë vlarë atë"*⁷⁵

Përfundim

⁷² Shih: Kemaludin Ahmed El-Bejadij El-Hanefij "Isharatu'l meram min ibarati'l imam", me tahkik të Jusuf Abdurr- Rrezak, botimi i parë, 1368/1949, Kajros, fq. 51.

⁷³ Sahihul Muslim, Kitabul imani, Babu: halu imani men kale liehivil muslim ja kafiru, botimi i Kajros, 2/49.

⁷⁴ Sahihul Buhari, "Kitabul edebi", kap.44, hadithi nr.6045.

⁷⁵ Sahihul Buhari, Kitabul edebi, kap.44, hadithi nr.6047.

Sakaq, nuk mund të kalojmë, pa u ndalur pak mbi reflektimet e *tekfirit* edhe në hapësirat tona mbarëkombëtare. Është mjaft shqetësuese teksa shohim apo dëgjojmë se si grupacione të ndryshme, të infiltuar deri tek ne në forma dhe rrugë të ndryshme, duke u mbarësuar në farë sherri, hedhin akuzën e *tekfirit* në llogari të të gjithë të tjerëve. Mjafton të mos pajtohesh në pikëpamje, aq sa nevojitet që ta bëjë me shëndet akuzën e *tekfirit*.

E kobshme është kur këtë e plasojnë ata që nuk dinë të bëjnë dallim ndërmjet Kur'anit dhe Sunnetit. Pikërisht atë element që dikur Resulullahi s.a.v.s. nuk e kishte përdorë ndaj hipokritëve në besim, ndonëse ishin merit, e që kjo ishte një politikë e islamizimit të të tjerëve, sot në emër të Sunnetit, shndërrohet në kontrast dhe *tekfiri* bëhet 'sadaka' më e padhimshme që postohet në adresë të muslimanëve.

Atëherë, le të pyesim, cilët janë ata faktorë, që *tekfirin* si akt të frikshëm, e bëjnë të dashur dhe atraktiv. Mund të radhisim me dhjetëra faktorë duke filluar nga ndërhyrjet e faktorit joislam në diskurs të manipulimit dhe instrumentalizimit e deri te fanatizmi klanor i mbërtheur në ekstremizma periferik kurse abuzues me ato fundamentale, e deri te sëmundja e zilisë. Por padyshim faktori kryesor është 'xhahilizmi' apo injoranca e thellë. Kjo nuk ka nevojë të hulumtohet shumë. Kjo vetë tregon. Pretendimet e rreshtura për ta damkosë personalitetin e Ebu Hanifes r.a., nxënësit e tij dhe autoritetet e medh'hebeve të tjera si vëllezër të tij, nuk mund të kenë diagnostifikim tjetër përpos xhahilizmin patetik.

Huxhetul islami, Ebu Hamid El-Gazalij (1058-1111), i cili edhe pse vetë e ka përdorë *tekfirin* ndaj gjashtë kategori njerëzish⁷⁶, thotë: Me të vërtetë *tekfiri* është sajësë e njerëzve injorantë. Askush nuk shpejton në të përpos injorantëve. Prandaj nevojitet përmbajtja prej *tekfirit* për derisa te njeriu mund të gjendet mënyrë që t'i iket atij. Me të vërtetë lejimi i gjakërave dhe pasurisë së atyre që falen duke u kthyer kah Kibleja, që deklarohen me dëshminë 'la ilahe il-lall-llah, Muhameden resulull-llah' është gabim i madh. Kurse gabimi për mosakuzim me *tekfir* të një mij kafirëve është më i lehtë se sa gabimi për lejimin e derdhjes së një gote gjak të muslimanit. Porosia është kjo: Që gjuhën

⁷⁶ Shih: El-Gazali "Tehafutu'l felasifeh", bot. 'daru'l-mearif', Egjipt, pa vit botimi, fq. 307-313.

ta ndalish sa të mundesh ndaj 'ehlu'l-kibleti' për derisa thonë 'la ilahe il-lallah, Muhameden Resulull-llah' dhe këtë nuk e kundërshtojnë.⁷⁷

Fare në fund, le ta prezentojmë rastin që e mban të gjallë në mënyrë të pashlyeshme në kujtesën tonë kushtin sipas të cilit nuk mund të akuzohet për mohim e të vritet një njeri që thotë La ilahe il-lall-llah'. Nga as'habët, Usame bin Zejdi ishte një i ri që Pejgamberi a.s. e donte shumë. Kur ende ishte në moshën 20 vjeçare, i Dërguari i Zotit e pati caktuar komandant në një ushtri ku ndodheshin edhe Hz. Ebu Bekri me Hz. Omerin dhe pati thënë kështu: "Është njëri midis njerëzve që dua më shumë, prandaj tregohuni dashamirës; ai është ndër më të dobishmit nga mesi juaj."⁷⁸ Usame tregon kështu:

I Dërguari i Allahut na pati dërguar një togë kundër armikut. Shkuam dhe në mëngjes u futëm në tokat e fisit Xhuhejne. Unë kapa një armik. Megjithëse tha 'La ilahe il-lall-llah', nuk e lëshova, por e vrava. Por brenda më kishte lindur një dyshim. Në kthim ia tregova ngjarjen të Dërguarit të Allahut. Dhe ai më tha: "Si e vrave një njeri që të tha 'La ilahe il-lall-llah'? (Në rrefimin e Ebu Davudit është kështu: "Në Ditën e Kijametit kush do të shpëtojë ty nga thënia e tij 'La ilahe il-lall-llah'?). Kurse unë i thash: O i Dërguari i Allahut, ai e pati thënë këtë nga frika e armës! Kurse ai më tha këtë përgjigje të ashpër: "Mos vallë ti ia çave zemrën dhe e kuptove se fjalën e njësisë (kelimetut-tevhid) e tha me sinqeritet apo nga frika e armës? Kush do të shpëtojë ty Ditën e Kijametit nga dora e 'La ilahe il-lall-llahut'?" Aq shumë e përsëriti i Dërguari i Allahut këtë qortim, sa që dëshirova më mirë të mos isha bërë musliman para kësaj dite e të mos më ndodhte një gjë e tillë!"⁷⁹

Orhan Bislimaj

⁷⁷ Ammareh, "El-Ihtirazu minet-tekfiri", op.cit.

⁷⁸ Ibn Sa'd, Et-Tabakat, II, fq. 248-250, sipas Topalo lu, "Hyrje në Kelam", fq. 277.

⁷⁹ Sahihul Muslim, Kitabul imani, botimi i Kajros 2/99, Përkthimi i hadithit sipas Topalo lu, "Hyrje në Kelam", fq. 277.

TAKFIR – THE PRACTICE OF ACCUSING A MUSLIM OF DESERTING ISLAM

(Summary)

No Muslim should be declared devoid of faith on account of any sin. Nor should they be denied their iman.

Introduction

The practice, which is most hated by Allah is that of kufr. Therefore, special attention must be paid when accusing a Muslim of deserting Islam.

The original meaning of the word kufr is to conceal.

أورحان بسليماي

التكفير – اتهام المسلمين بالارتداد عن الاسلام

(تفسير عقائدي لقوله الامام الاعظم أبو حنيفة ر.ع.)

(خلاصة البحث)

قوله: أَنْ لَا تُكْفِّرَ أَحَدًا مِنْ أَهْلِ الْقِبْلَةِ بِذَنْبٍ. وَلَا تَنْفِي أَحَدًا مِنَ الْإِيمَانِ

مدخل:

كما هو معروف فإن أكبر الكبائر عند الله عز وجل هو الكفر بالله سبحانه و تعالى أو عدم الاعتراف بالدين الاسلامي. و يعتبر هذا أكبر ذنب يمكن أن تكبه الانسان في حياته. و بناء عليه فان "التكفير" أن اتهم المسلم بأنه قد ارتد عن الاسلام. يحتاج إلى عناية خاصة و تقع عليه مسئولية كبيرة.

و بما ان هذه الظاهرة بدأت تنتشر عندنا في الأونة الاخيرة رأيت من المفيد التعرض لهذا الموضوع نظرا لاهميته و خطورته في آن واحد.

TOLERANCA ISLAME

Abdullah Nasih Ulvan

LIRIA E BESIMIT NË LIGJIN ISLAM – (3)

QËNDRIMI I ISLAMIT NDAJ HIPOKRITËVE

Karakteristikat e një hipokriti

Hipokrizia (All-llahu na mbrojti nga kjo) është pretendimi i të qenit mysliman derisa mban të fshehur mosbesimin dhe qëllimet e ulëta. Kur’ani i përshkruan karakteristikat e hipokritëve në ajetet vijuese:

“Ka disa njerëz që thonë: “Ne i kemi besuar All-llahut dhe jetës tjetër (Ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen ta mashtrojnë All-llahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë. Në zemrat e tyre kanë sëmurje, e All-llahu u shton sëmundje edhe më shumë, e për shkak se ata përgënjeshtrojnë, pësojnë dënim të dhe-mbshëm. E kur atyre u thuhet: “Mos prishni rendin në tokë!” ata thonë: “Ne jemi vetëm përmirësues (paqtues)!” Vëni re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit, por nuk e kuptojnë. Dhe kur atyre u thuhet: besoni, sikurse besuan njerëzit ata thonë: “A të besojmë ashtu sikurse besuan mendjelehtit?” Në të vërtetë ata, dhe mu ata janë mendjelehtit, por nuk e dinë”. (el-Bekare: 8-13)

Nga ajetet e lartpërmendura, na bëhet e qartë se hipokriti konsiderohet jobesimtar. Ai ka zemër të sëmurë dhe është gënjeshtar, bastard, i trashë dhe mashtrues i njerëzve.

Nga këto karakteristika të hipokritëve, kuptojmë që hipokrizia është një epidemi që e dobëson burrin dhe ndjenjën e respektit, formon karakteristikat më të rrezikshme për individin e shoqërinë dhe është cilësia më e shëmtuar e më e keqe për njeriun.

Prandaj, hipokritët do të kenë dënim të ashpër. Në të vërtetë, ata do të jenë në shkallën më të ulët të xhehenemit.

All-llahu xh.sh. thotë:

“S’ka dyshim, mynafikët do të jenë në shtresën më të ulët (në fund) të zjarrit dhe për ta nuk do të gjesh mbrojtës”. (en-Nisa: 145)

Që të mbulojmë temën nga të gjitha anët, duhet që hipokritët t’i ndajmë në tri kategori:

1. Hipokrizia në mesin e çifutëve,
 2. Hipokrizia në mesin e batinijëve,
 3. Hipokrizia në mesin e atyre që kanë ambicie të ulëta.
- Do të trajtojmë çdo grup në detaje.

Hipokrizia në mesin e çifutëve

Është vërtetuar në histori që çifutët filluan hipokrizinë para dhe pas ardhjes së Islamit, dhe këmbëngulën në të. Ky fakt është konfirmuar gjithashtu edhe në Kur’an:

“Edhe rreth jush ka beduinë që janë hipokritë, e edhe nga bano-rët e Medinës që janë përcaktuar për hipokrizi. Ti nuk i di ata, Ne i dimë ata...”. (et-Tevbe: 101)

Ata jetonin në Medinë dhe vazhduan në hipokrizi. Ata ishin lindur e rritur në hipokrizi, të cilën e trashëguan nga të parët e tyre.

Etnologët, studiuesit e fesë dhe historia pajtohen që rabinët dhe njerëzit e njohur të fesë çifute i mësuan pasuesit e tyre, të cilët jetonin si pakica në vende të ndryshme që të shpërndahen në këto vende dhe të pretendonin se ishin konvertuar në fetë e tyre. Qëllimi i gjithë kësaj

ishte prishja e feve, shtrembërimi i tyre, ndryshimi i drejtimit të tyre dhe shërbimi ndaj interesave të çifutëve e arritja e qëllimeve të tyre. Në të njëjtën kohë, u përpoqën shumë që të jenë të sigurt nga kundërshtarët e tyre dhe u përpoqën që të mbajnë pozita të larta që do t'i siguronte edhe më shumë dhe do t'i largonte nga shkaqet e rebelimit. Ata fshehtazi thurën komplete kundër armiqve të tyre brenda shoqërisë në të cilën jetonin.

Prej shoqërive në të cilën jetuan, intriguan dhe i shërbyen interesave të tyre ishte Persia, ku shumë çifutë pretenduan se ishin konvertuar në zjarrputizëm, derisa që u bënë njerëzit fetarë kryesorë. Ata ishin në gjendje të nxisnin mbretërit persianë kundër mbretërve të kombeve tjera dhe të nxisnin zjarrputizmin kundër Krishterimit e kështu me radhë.

Gjithashtu ata u shpërndanë në shoqëritë pagane në Evropë dhe treguan entuziazëm më të madh për idhujtarinë sesa vetë idhujtarët. Ata mbanin pozita të larta në qeveritë pasuese dhe disa prej tyre u bënë mbretër, siç ishte rasti i Neros, i cili ndihmoi në nxitjen e popujve paganë të luftojnë kundër Krishterimit.

Gjithashtu çifutët u shpërndanë në shoqërinë e krishterë në Evropë. Kur perandori Konstantin u konvertua në krishterim, ata depërtuan thellë dhe u shpërndanë në shoqërinë e tij. Ata arritën deri në rangun e priftërinjve. Themeluan shkollat e polemikave dhe grupet për diskutime. Para kësaj faze, ata e shtrembëruan Inxhilin dhe e interpretuan sipas tekeve dhe interesave të tyre në përputhje të planeve të tyre sekrete kundër Krishterimit.

Si rezultat, shpërthyen luftërat mes grupeve të krishtera dhe numër i madh i njerëzve u vranë. Askush nga çifutët nuk u lëndua. Kështu, arritën qëllimet e tyre dhe i shkatërruan të krishterët nga vetë të krishterët dhe përmes idhujtarëve e zjarrputistëve.

Historianët dhe studiuesit e ngjarjeve e konfirmojnë faktin që hipokritët e krishterë e morën fronin papnor më shumë se një herë dhe i nënshtroan të tjerët në shërbim të Krishterimit publikisht, ndërsa në fakt ata i shfrytëzuan në shërbim të interesave çifute.

Konfirmimi i pikës kulmore të dinakërisë dhe hipokrizisë çifute është që papa deklaroi që çifutët nuk e vranë Mesium (Isain a.s.) dhe se ata janë të pafajshëm. Në këtë mënyrë, ra ndesh me të gjithë Inxhujt dhe me papët tjetër gjatë 20 shekujve.

Përmes këtyre pozitave, ishin në gjendje të udhëheqin reformimin kundër Kishës katolike dhe lëvizjes për ndarjen mes fesë e shtetit. Si rezultat, revolucioni francez-masonit-çifut e shkatërroi Kishën. Asgjë nuk mbeti përveç ndërtesave. Lidhja mes njerëzve dhe Kishës u shkatërrua. Koha në të cilën Kisha ndikonte në mbretër e princër dhe i përdorte si kukulla kishte kaluar.

Hipokrizia e çifutëve pas ardhjes së Islamit

Hipokrizia e çifutëve ishte shumë më e rëndë dhe më e hidhur në periudhën islame, veçanërisht kur u përhap Islami dhe ishte në gjendje t'i dëbonte nga Gadishulli Arabik për shkak të tradhtisë të tyre të përhershme dhe intrigave të vazhdueshme, nga vendi në të cilën zbriti Shpallja Islame.

Ata (All-llahi i mallkoftë) luajtën të njëjtën rol që e kishin luajtur gjatë gjithë historisë, nxitjen e kryengritjeve, formimin e sekteve e grupeve, përhapjen e lajmeve shqetësuese, thurjen e intrigave fshehtas, dhe fillimin e luftërave.

Megjithëkëtë, ata nuk mund të luajnë apo të shtrembërojnë Librin e All-llahut apo madje qoftë edhe një shkronjë të tij, edhe nëse të gjithë mblidhen të bëjnë këtë gjë, sepse All-llahu xh.sh. e ka garantuar ruajtjen e tij deri në Ditën e Gjykimit. Ai thotë:

“Ne e kemi zbritur Kur’anin dhe ne do ta ruajmë atë”. (el-Hixhr: 9)

Çifuti jemenas Abdullah ibn Saba, i njohur si Ibn Sevda (që do të thotë djali i gruas së zezë), ishte djalli i hipokritëve. Ishte ai që krijoi idenë e Shi’iave¹, pasuesve të imam Aliut dhe familjes së tij. Gjithashtu ai i përshkroi hyjni atij dhe pretendoi që shpirti i All-llahut është

¹ Shi’ia apo Shi’it është degë e pasuesve myslimanë, të cilët e njohin Aliun, djalin e axhës së Muhamedit a.s. si pasuesin e tij të duhur.

i mishëruar në të. Kur u vra Aliu, ibn Saba deklaroi që Aliu nuk ishte vrasë, por ishte ngritur në qiej si Jezusi (Isai a.s.). Ai do të kthehet dhe do t'u hakmerret armiqve të tij. Gjithashtu i futi në mendje idetë e liga pasuesve të tij duke u thënë, "Aliu lëviz me re, bubullima është zëri i tij, zjarri është fshikullima e tij". Kur pasuesit e tij dëshmonin bubullimën, ai thoshte, "Paqja qoftë mbi ty, o Princ i Besimtarëve". Ai rrënjosi farën e dallimeve dhe shumëllojshmërinë e sekteve dhe krijoi fanatizmin paraislamik në shoqërinë myslimane. Ai planifikoi me çifutët e tjerë të pafe vrasjen e Omer ibn Hatabit. Vrasësi ishte një zjarrputist i quajtur Ebu Lu'lu'u. Ishte ai që ndezi zjarrin e rebelimit dhe rrëmujës gjatë udhëheqjes së Othman ibn Afanit dhe vazhdoi ta rrisë atë. Në fund, i ngrënë barrikadën dhe e vranë Othmanin.

Gjithashtu ibn Saba i nxiti havarixhët² që të rebelohen kundër Aliut dhe luajtën rol të rëndësishëm në vrasjen e tij.

Ibn Saba ishte nxitës në të gjitha këto komplete dhe ishte urrejtës i Islamit dhe i të Dërguarit të Tij. Dëshironte të zbatonte serinë e kompleteve çifute kundër Islamit si dhe kundër gjithë feve tjera, përveç Hebreizmit.

Çifuti nga Kufa, Mejmun el-Kadah intrigoj kundër Islamit e myslimanëve. U paraqit në Kufa në vitin 279 h. Dhe pretendoi se ishte mysliman në mënyrë që të thurte komplete kundër myslimanëve. Ai krijoi herezinë që tekstet kur'anore dhe hadithet kanë dy kuptime, një të fshehur dhe tjetrën të qartë. Ai sajoi gënjeshtër pasuesve të tij duke i bindur që interpretimet dhe shpjegimet e tij si dhe shenjat që i tregoi janë kuptimet e fshehta të këtyre teksteve. Përmes herezisë së tij, ai luajti me interpretimin e ajeteve kur'anore dhe hadithet e Muhamedit a.s. dhe i interpretoi sipas tekeve e qëllimeve të tij.

Gjithashtu drejtoi lëvizjen e fshehtë çifute dhe ndjeki një rrugë të re për zhdukjen e Islamit. Kjo lëvizje morri formën e organizatave sekrete që ishin të sakta, misterioze dhe të kujdesshme në faza të vazhd-

² Havarixh është një sekt i myslimanëve, të cilët pohojnë që çdokush mund të gradohet me titullin e halifatit, edhe nëse nuk është nga fisi kurejsh, poqese është i zgjedhur nga umeti islam. Emri i tyre vjen nga rrënja që do të thotë "të jetë jashtë". Ata gjithashtu janë quajtur Harixhij, të larguar dhe sektar.

ueshme, forma të ndryshme dhe qëllime të përbashkëta. Gjithashtu ishte ai që i ndau në grupe të ndryshme duke i quajtur me emra të ndryshëm. Ata arritën disa prej qëllimeve të tij atëherë kur ata dhe pasuesit e tij nuk e besuan All-llahun, Melaqet e Tij, Librat e Tij, Profetët dhe Ditën e Ringjalljes. Gjithashtu ata besuan që të gjitha rregullat e mësimet islame janë shfuqizuar dhe se të gjitha ndalesat janë lejuar. Ata madje i lejuan njerëzve të martohen me motrat e vajzat e tyre.

Hipokriti ibn Saba bëri të njëjtën gjë kur e pasoi rrugën e dinakërisë, mërisë, drejtimit të keq dhe shkatërrimit. El-Kadah dhe ibn Saba nuk ishin komplotistët e vetëm kundër Islamit. Madje, udhëheqësit çifut kanë komplotuar në shumë vende e shumë herë. Ata e kanë përdorur hipokrizinë si mbulesë për thirrjet e tyre destruktive dhe Islamit si maskim për intrigat e tyre djallëzore.

Këto janë disa prej intrigave më të rëndësishme të çifutëve kundër myslimanëve gjatë gjithë historisë:

- a. Në fillim të shekullit të parë hixhrij, halifi i dytë, i tretë dhe i katërt, Omeri, Othmani dhe Aliu u vranë. Gjatë kësaj periudhe, hipokriti çifut Abdullah ibn Sava mbjelli farën e rebelimit civil dhe sekteve. Ai ishte themeluesi i parë i sektit Batinije nën mbulesën e Shi'ia-ve, duke ndjekur gabimisht familjen e Muhamedit a.s. derisa anëtarët e familjes së tij janë të pastër nga ata. Që atëherë, shumë sekte janë themeluar pas sektit Batinije për të keq udhëzuar, shkatërruar dhe zhdukur Islamit.
- b. Në fund të shekullit të tretë hixhrij, grupet Batinije praktikuan rolin e tyre dhe u shpërndanë brenda shoqërive myslimane nën udhëheqjen e hipokritit çifut el-Kadah. Ata ndikuan te myslimanët naiv dhe të padjallëzuar, të cilët pasuan rrugën e tyre, duke pranuar besimet e tyre dhe duke u konvertuar në mosbesim.
- c. Në shekullin e pestë hixhrij, Iraku dhe Persia sundoheshin nga Batinijët në Shtetin Buvejhije³, ku çifutët patën më shumë liri dhe pozita. Ata u bënë të rrezikshëm ndaj myslimanëve dhe rritën fuqinë

³ Shteti Buvejhije ishte shtet shi'it i themeluar në Persi dhe Irak pas rënies së sundimit Abasit. Ky shtet zgjati prej vitit 334 deri në vitin 447 hixhrij (945-1055 e.s.), kur ra nga selxhukët.

politike dhe pasurinë e tyre. Si rezultat, njerëzit u revoltuan kundër autoriteteve në Irak dhe dogjën shtëpitë e çifutëve dhe shi'ive batinij në vitin 422 hixhrij.

- d. Në shekullin e shtatë hixhrij, Batinijët, të cilët ishin pasues të çifutëve, ishin një prej faktorëve kryesor në rënien e Bagdadit nga mbreti tatar Hulaku. Veziri batinij ibnu-l--Alkami e tradhtoi halifin e fundit Abasit, Mu'tesim Bil-lah, në favor të çifutëve. Më lartë përmendëm, që çifutët dhe të krishterët i dërguan mesazh tatarëve duke i ftuar që të pushtojnë Bagdadin, kryeqytetin e hilafetit. Ata i drejtuan tatarët në kalimin e fshehtë të qytetit, duke marr pjesë praktikisht në okupimin e tij, dhe i mirëpritën. Ata me këtë dëshironin që të çliroheshin nga myslimanët, të cilët i kishin ruajtur e mbrojtur.

Rënia e Bagdadit ishte një tragjedi e madhe për myslimanët. Ngjarja ishte aq e tmerrshme, sa që askush nuk mund ta përshkruaj apo ta përfytyroj. Shumë njerëz menduan që Dita e Gjykimit ishte afruar.

- e. Në shekullin e tetë, disa nga mbretërit tatar pranuan Islamin, dhe disa prej tyre besuan në besimet batinije si Gajthudin Muhamed, i cili ishte shumë më i rrezikshëm se paraardhësit e tij të lig. Ai bëri aleancë me kryqtarët dhe çifutët kundër myslimanëve. Në kohën e tij, çifutët mbanin pozita të larta në Bagdad dhe Mosul, dhe kishin shumë kompetenca që i mundësonin t'i mposhtnin myslimanët me të gjitha mjetet. Gjithashtu ai bëri aleancë me papën dhe mbretërit e Anglisë e Francës për zhvillimin e luftërave kundër myslimanëve sunitë.

Kur djali i tij Ebu Seid Bahadir Kani, i cili ndoqi sektin sunit, arriti në pushtet në vitin 716 hixhrij, i prishi marrëdhëniet me kryqtarët, i shtypi, i largoi nga postet dhe i detyroi të vishnin rroba të dalluara. Në atë kohë, myslimanët gëzonin një jetë të mirë e të sigurt. Gëzimi i tyre ishte jetëshkurtër, pasi që Ebu Seidi u vra nga kompleti çifut në vitin 736 hixhrij.

- f. Në shekullin e dhjetë, Batinijët themeluan Shtetin Safavi, në të cilin çifutët mbanin pozita të larta dhe arritën shumë autoritet. Ata i

përdornin pozitat e tyre për t'u shërbyer qëllimeve të tyre të ulëta. Ata i nxitën safavitët të luftonin kundër shtetit osman, i cili ishte sunit. Gjithashtu kërkuan ndihmën e portugezëve, të cilët kontrollonin Gjirin Arab. Ata pushtuan Ishullin e Hormuzit gjatë sundimit të Ismailit I në vitin 930 hixhrij.

- g. Në shekullin e katërmëdhjetë hixhrij, ndodhi një katastrofë e madhe e zbatuar nga agjenti tradhtar dhe çifuti i quajtur Ataturk kundër hilafetit Islam në vitin 1924 e.s. Ai deklaroi sekularizmin në Turqi, mbylli gjykatat e shkollat islame, shfuqizoi vakufet fetare dhe ligjet islame të trashëgimisë, ndryshoi ezanin nga gjuha arabe në atë turke, ndryshoi shkronjat arabe me ato latine, të dielën e bëri pushim në vend të premtës, ndryshoi kapelën e veshjet islame me ato evropiane. Të gjitha këto ndryshime përfunduan në vitin 1928 e.s.

Por, kjo nuk ishte e tëra. Hipokritët çifutë dhe pasuesit e tyre bënë krime të shumta kundër Islamit e myslimanëve gjatë gjithë historisë, duke pretenduar rrejshëm se janë konvertuar në Islam derisa brenda ishin jobesimtarë e ateistë. Qëllimi i tyre ishte ngjallja e mosmarrëveshjeve mes myslimanëve, poshtërimi i njerëzve dhe shkatërrimi i vendeve. Gjithashtu ata dëshironin të arrinin superioritet ndaj njerëzve tjerë dhe zbatuan planin e tyre të gjerë për zgjerimin e kufijve të Izraelit nga Nili deri në Eufrat. Ata veç kanë arritur sukses në disa nga planet e tyre duke themeluar një shtet, duke okupuar Jerusalemin dhe duke rritur autoritetin e tyre çdo ditë e më shumë.

Shtrohet pyetja, a do të mund të luftojnë gjeneratat pasuese kundër çifutëve? A do të arrijnë të çlirojnë Jerusalemin dhe Palestinën nga çifutët?

Shenjat e vetëdijesimit dhe vigjilencës sugjerojnë, që gjenerata e re ka filluar të lëviz përpara drejt xhihadit, në mënyrë që të lartësojë fjalën e All-llahut qoftë me fitore apo rënie martir. Ata i premtojnë All-llahut që t'i vëzhgojnë agjentët, tradhtarët dhe mercenarët në mesin e njerëzve dhe pastaj të luftojnë që të çlirojnë Vendin e Shenjtë që në fund të formojnë Shtetin islam të bashkuar. Në këtë mënyrë, do

të riarrijnë madhështinë dhe nderin e myslimanëve, dhe besimtarët do të gëzohen me fitoren e All-llahut.

Hipokrizia në besimet Batinije

Që nga fillimi i historisë islame, disa hipokritë pretenduan përmes kompleteve të çifutëve se ishin pasues të shi'itëve, por fshehurazi ishin mikrobe fatale brenda shoqërisë myslimane. Qëllimet e tyre ishin përhapja e besimeve të gabuara dhe ideve destruktive brenda mësimave islame, që të shkatërrojnë kështu ndërtesën e lartë të Islamit dhe t'i keqduhëzojnë myslimanët në fenë e tyre që ose t'i bëjnë ateistë apo t'i konvertojnë në ndonjë fe tjetër.

Ata themeluan sektin heretik të Batinijëve. Ata ishin shumë fanatikë ndaj familjes së Muhamedit a.s. dhe pretendonin se i donin ata. Rezultati i kësaj ishte devijimi nga rruga e drejtë e Islamit dhe besimi në parimet e ndryshme pagane të mbledhura nga disa fe, siç janë Hebreizmi, Hinduizmi, Krishterimi e të tjera. Gjithashtu ata i ngritën në pozitë të zotërave disa pjesëtarë të familjes së Muhamedit a.s. dhe disa të tjerë, të cilët rrejshëm u atribuuan veten atyre. Ky sekt ishte shumë më i rrezikshëm ndaj Islamit sesa idhujtarët, të cilët i adhuronin gurët.

Një degë e këtij sektit të quajtur "Dahrije" kishin besimet e tyre. Ata mohonin All-llahun, hedhnin poshtë fetë, braktisnin kryerjet e ritualeve dhe e lejonin të ndaluarën. Ekzistonin edhe shumë grupe tjera, të cilët u degëzuan nga Batinijët.

Besimet batinije mund të përmbliidhen ashtu siç vijon: adhurimi i njerëzimit, shthurja absolute, lejimi i të ndaluarës, braktisja e ritualeve, mohimi i feve, zotërimi i parasë e grave, migrimi i shpirtrave, pagabueshmërisë së imamëve, ndryshimi i fakteve dhe interpretimi i teksteve.

Përveç kësaj, ata kishin besime tjera ateiste dhe parime të rrejshme që shumë sekte e grupe u besonin.

Hipokrizia dhe pretendimi i të qenit mysliman arriti kulmin e tij gjatë periudhës së Halifëve të Drejtë dhe periudhës që pasoi pas kësaj. Nga pamja e jashtme ata ekspozonin karakterin e duhur dhe pasuan

drejtimin e duhur që t'i shfuqizonin mësimet islame dhe të shkatërronin Islamin.

Nganjëherë, hipokritët punonin fshehurazi nëse gjenin myslimanët të fortë dhe Islami mbahej i respektuar. Nganjëherë ata deklarorin urrejtjen e armiqtësinë e tyre ndaj myslimanëve nëse gjenin rastin. Nganjëherë, shfaqnin përkushtim për Islamin që të shkaktonin mosmarrëveshje e rrëmujë mes myslimanëve. Nganjëherë, iu bashkoheshin ndonjë sektit tjetër që kishte plane ambicioze dhe tendenca heretike.

Në shumë raste, ata bashkoheshin nën flamurin e parimeve e besimeve në të cilat thirrën dhe i ftonin njerëzit që të arrijnë qëllimet e tyre djallëzore e të liga.

Kjo është mënyra e hipokritëve batinij. Ata pajtohen me të gjitha sektet e grupet, adaptohen në çdo ambient dhe luajnë rolin e çdo feje që të arrijnë qëllimin e tyre të madh të shkatërrimit të bazave të Islamit dhe shtypjen e botës islame.

Megjithëse gjatë gjithë historisë këto sekte destruktive ishin në gjendje që të vënë zjarrin e kryengritjes, shkaktojnë mosmarrëveshje mes myslimanëve, përhapin rrëmujë e kaos, të ndalin çlirimet islame, thurin intriga fshehurazi që të pengojnë përparimet e myslimanëve, mbjellin farën e partishmërisë batinije e sektarizmit dhe ndikojnë te disa myslimanë, që kanë sëmundje të mendjes, moralit e besimit në zemrat e tyre, pasi që ata nuk mund të shtrembërojnë Kur'anin apo të ndryshojnë mësimet e Islamit. Kjo pasi që All-llahu xh.sh. e ka garantuar ruajtjen e Kur'anit e Sheriatit deri në Ditën e Kiametit. All-llahu xh.sh. thotë:

"Ne e kemi zbritur Kur'anin dhe ne do ta ruajmë atë". (el-Hixhr: 9)

Pavarësisht kalimit të katërmbëdhjetë shekujve që nga ardhja e Islamit dhe Kur'anit, dhe paraqitjes së shumë ateistëve, hipokritëve e batinijëve, ata nuk arritën të shtrembërojnë apo të ndryshojnë Kur'anin.

Sa kohë që Sheriati Islam është i ruajtur dhe Kur'ani është i ruajtur përgjithmonë, atëherë umeti mysliman nuk do të mbetet në kushte të tilla apo të dorëzohet faktit të kryer, pavarësisht se çfarë dobësie

apo ndarje i ndodh. Madje, do të pranojë Kur'anin dhe do t'i marrë në konsiderim parimet e Islamit që të rikthejë madhësitinë e Islamit dhe pozitën e lartë të umetit mysliman.

Historia e konfirmon këtë fakt. Pasi që myslimanët pësuan disfatë nga kryqtarët, mongolët e tatarët, ata arritën që të rikthejnë fuqinë, unitetin e nderin e tyre, pasi që pasuan parimet e pandryshueshme të Islamit dhe mësimet e Kur'anit.

Sot, i shohim shenjat e shpresës të një gjenerate të re myslimane që lufton për përtëritjen e nderit e Islamit dhe madhësitinë e myslimanëve nën flamurin e Kur'anit dhe udhëheqjes së Islamit. Kjo nuk është e vështirë për All-llahun xh.sh.

Hipokrizia e atyre me ambicie të ulëta

Prej llojeve më të njohura të hipokrizisë është hipokrizia e njerëzve me plane ambicioze dhe dëshira të ulëta. Njerëz të tillë përpiqen që të arrijnë dëshirat e tyre me të gjitha mjetet, madje edhe nëse nuk pajtohen me Islamin. Ata mund të klasifikohen në dy grupe:

1. Degjeneruesit
2. Pasuesit (Luajalistët).

Degjeneruesit janë ata njerëz, të cilët pretendojnë të jenë myslimanë, derisa nga brenda nuk janë. Qëllimi i tyre është arritja e dëshirave të tyre për fuqi e autoritet, apo i frikësohen fuqisë së myslimanëve, apo thurin intriga fshehurazi që të mbjellin farën e trazirës kur Islami është në madhësi dhe myslimanët janë të fortë e kanë autoritet. Abdullah ibn Ebi Seluli ishte model i njerëzve të tillë dhe ishte udhëheqës i hipokritëve gjatë jetës së Muhamedit a.s.

Degjeneruesit

Kur Muhamedi a.s. emigroi në Medine, Abdullah ibn Seluli ishte afër që të jetë udhëheqës i saj. Por, kur njerëzit e Medinës u konvertuan me vetëdëshirë në fenë e re të Islamit. Drejtimi i ngjarjeve ndryshoi dhe ibn Seluli u zhgënjye. Duke ndier se do të humbë fuqinë dhe autoritetin, ai mblodhi pasuesit e tij për të diskutuar çështjen dhe mbi-këqyr ngjarjet. Ata u pajtuan të konvertohen në Islam nga ana e jashtme, derisa nga brenda ishin jobesimtarë. Ata e bënë këtë që të mos e shfaqnin mosbesimin e tyre, përndryshe myslimanët do t'i vrisnin. Gjithashtu ata pasuan këtë rrugë për të kryer detyrën e shtyllës së fesë në favor të çifutëve dhe politeistëve arabë në Gadishullin Arabik. Nëse iu jepej rasti dhe koha e duhur të shfaqnin armiqësinë dhe urrejtjen e tyre, atëherë do të zbulonin fytyrën e tyre të vërtetë dhe do të luftonin kundër myslimanëve që t'i zhduknin.

Kështu, qëllimi prapa këtyre grupeve të hipokritëve ishte kërkimi i fuqisë dhe autoritetit. Në të vërtetë, ky është motiv i ulët dhe i lig.

Sa bukur e përshkruan Kur'ani ligësinë e tyre! Kur'ani e zbulon shtirjen e tyre si myslimanë dhe i përshkruan lakmitë e tyre të kësaj bote, qëllimet materiale dhe betimet e rreme. All-llahu xh.sh. thotë:

“Sikur të ishte fitim i afërt dhe udhëtim mesatar, ata (hipokritët) do të vinin pas teje, por për ta ishte largësi e vështirë. Ata do të betohen në All-llahun: “Sikur të kishim pasur mundësi, do të dinim me ju”. E shkatërrojnë veten e tyre; All-llahu e di se ata janë rrenacakë”. (et-Tevbe: 42)

Grupe të tilla që shtohen në çdo kohë dhe vend, konvertohen në fetë tjera, dhe iu bashkohen sekteve të devijuara në kërkim të udhëheqjes së përkohshme apo gjërave kalimtare të kësaj jete. Duke qenë të bindur dhe besnikë ndaj këtyre sekteve, ata iu bashkuan atyre dhe thurën intriga kundër Islamit e myslimanëve. Nuk ka forcë dhe fuqi përveç All-llahut.

Pasuesit (Luajalistët)

Me luajalistët kam për qëllim ata njerëz të cilët besojnë në madhësitinë dhe drejtësinë e Islamit, por besnikërinë e bindjen e tyre ia japin një grupi jobesimtar e të devijuar për hir të autoritetit të neveritshëm apo kërkimit të gjërave të përkohshme të kësaj bote. Nëse pyeten për arsyen e bashkimit të tyre këtij grupi, atëherë do të përgjigjen: “Ne nuk i pranojmë besimet e tyre dhe jemi të pakënaqur me devijimin e tyre. Ne u bashkuam dhe bëmë aleancë me ata që t’i ruajmë myslimanët nga dëmtimi apo fyerja, dhe që t’i ruajmë tokën islame nga degjeneruesit dhe jobesimtarët sa më shumë që të jetë e mundur”.

Pastaj pyetni se cilat dëmtime i zbrapsni apo nga cilët degjenerues e mbrojnë tokën islame?

Ata përhapin degjenerim dhe mosbesim gradualisht. Komplotet sekulare janë përgatitur dhe janë zbatuar brenda shoqërisë myslimane çdo ditë.

Ata i përlligjin këto pozita dhe përgjigjen, “Në fakt ne u bashkuam atyre për interesa personale dhe që të mbrojmë veten nga çdo dëmtim”.

Kështu motivi që qëndron prapa kësaj hipokrizie është kërkimi i parasë, superioritetit dhe zotërimit. Sigurisht, kjo është nxitje e ulët dhe e ligë.

Sa bukur i përshkruan Kur’ani llojet e tillë të njerëzve se si i kanë zemrat e sëmura dhe të frikësuara. Kur’ani thotë:

“O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar. E ata që në zemrat e tyre kanë sëmundje, i sheh se ngarendin te ta (për miqësi) duke thënë: “Po sillet frikësohemi se mos po na ndodh ndonjë e keqe”. Po All-llahu do të sjellë fitoren, ose diç tjetër nga ana e Tij, e atëherë do të pendohen për atë që e mbanin fshehtë në shpirtin e tyre”. (el-Maide: 51-52)

Intrigat e tyre në shoqërinë myslimane

Sipas mendimit tim, intrigat e hipokritëve përqendrohen në çështjet e pasuese:

a. Dobësimi i fuqisë së myslimanëve në luftëra: Në kohën e Muhamedit a.s., hipokritët ishin në gjendje të luajnë rolin e tyre kur rrejtshëm u konvertuan në Islam dhe arritën sukses që të paraqesin sinqeritetin e tyre ndaj Muhamedit a.s. Madje Omeri r.a. i njihte shumicën e tyre si të sinqertë e të devotshëm.

Prej veprimeve të tyre të ulta ishte shmangia nga xhihad duke mos kërkuar leje. Kur të tjerët i panë, ata i imituan dhe u bënë pasivë e të ngadaltë. Pastaj disa u larguan nga shkuarja në xhihad derisa besimtarët e vërtetë shkuan.

Disa nga hipokritët shkuan në xhihad, por u kthyen përsëri duke thënë: “Pse e vrasim vetveten tonë?” Kur u kthyen, shumë luftëtarë u kthyen përsëri, ashtu siç vepruan në Betejën e Uhudit.

Po të mos ktheheshin dhe të vazhdonin të luftonin, përkundrazi ata përhapën rebelim, grindje dhe dobësi në mesin e ushtarëve, ashtu siç vepruan në Betejën e Tebukut. Njëri nga ta deklaroi: “A mendon ai (duke pasur për qëllim Muhamedin a.s.) që do të pushtojë pallatet dhe fortesat e romakëve? E pamundshme! E pamundshme!”

Tjetri tha: “A mendoni që lufta kundër romakëve është si lufta kundër arabëve? Pasha All-llahun, nesër do të lidheni me litar!”

Kur’ani i demaskon qëllimet e tyre të ulëta. All-llahu xh.sh. thotë: *“Edhe sikur të dilnin me ju, ata nuk do t’ju shtonin tjetër pos ngatërresës dhe shumë shpejt do të përçanin mesin tuaj, duke kërkuar t’ju turbullojnë. E ndër ju ka të tillë që i dëgjojnë ata. All-llahu i di shumë mirë hipokritët”. (et-Tevbe: 47)*

b. Mbjellja e mosmarrëveshjeve e grindjeve mes myslimanëve: Gjatë jetës së Muhamedit a.s., hipokritët shfrytëzuan çdo rast të mundshëm për të përhapur trazirë e rrëmujë. Ajo që do të përmendim më poshtë është shembull i veprimeve të tyre.

Në ekspeditën ushtarake kundër Beni Mustalikëve⁴, ishin dy djelmosha, të cilët grindeshin për ujë. Njëri ishte nga ensarët dhe tjetri nga muhaxhirët. Ai i cili ishte nga muhaxhirët bërtiti, “O muhaxhir!” Ndërsa tjetri i cili ishte nga ensarët thirri, “O ensar!” Kur Abdullah ibn Seluli, udhëheqësi i hipokritëve, dëgjoi se kishte shpërthyer konflikti mes dy grupeve të myslimanëve, shfrytëzoi rastin dhe filloi të rrisë grindjen mes tyre. Ai deklaroi: “Ata (duke pasur për qëllim muhaxhirët) na luftuan! Pasha All-llahun, ata nuk janë si ne! Ata janë ashtu siç thotë proverbi popullor "Ushqeje qenin tënd dhe pastaj ai të ha ty". Pastaj iu drejtua ensarëve që ishin prezentë: “Ju jeni shkaktarë për këtë, pasi që i lejuat të jetojnë në vendin tuaj dhe u dhatë para. Po t’i kishit dëbuar, do të shkonin në ndonjë vend tjetër. Pasha All-llahun, nëse kthehemi në Medinë, vërtet më i ndershmi do të dëbojë të ligin!”

Ibn Seluli dëshironte të përhapte rrëmuje, por All-llahu xh.sh. i bëri intrigat e tij të pafrytshme dhe e nxiti djalin e tij, Abdullahun, që ishte besnik dhe i sinqertë ndaj tij. Kur i dëgjoi thëniet e babait të tij, i tha: “I Dërguari i All-llahut është shumë i ndershëm, ndërsa ti je i lig”. Ai i kërkoi leje Muhamedit a.s. që të vriste babanë e tij, por Muhamedi a.s. e ndaloi duke i thënë “Duhet të sillemi me të me mirësi sa kohë që është me ne”.

c. Sajimi i gënjeshtreve dhe akuzave kundër Islamit. Gjatë jetës së Muhamedit a.s., hipokritët sajuan gënjeshtër, duke përfshirë edhe ngjarjen e ifkut, kur akuzuan rrejshëm gruan e Muhamedit a.s., Aishen r.a. për shkelje kurore. Kjo ishte goditje kundër Islamit, pasi që njerëzit filluan të dyshojnë për ndershmërinë e saj, babait të saj dhe familjes. Ata dyshonin dhe nuk besonin se gruaja e Muhamedit a.s. kishte shkelur kurorën.

Pa dyshim, dyshimet e tilla dobësuan joshjen ndaj Muhamedit a.s. dhe pranimin të Islamit.

Gjithashtu ata e akuzuan atë a.s. për besimin e çdo gjëje pa e vërtetuar.

Qeshnin me besimtarët, të cilët e jepnin zekatin dhe lëmshën. Nëse ndokush jepte shumë lëmshë, ata e akuzonin për hipokrizi dhe nëse ndokush jepte pak lëmshë, e përqeshnin dhe e akuzonin për koprraci.

Gjithashtu qeshnin me besimtarët e vërtetë dhe të devotshëm. Një hipokrit foli me vrazhdësi për disa lexues të devotshëm të Kur’anit duke thënë “Lexuesit tanë të Kur’anit kanë më shumë dëshirë të hanë, janë gënjeshtar dhe rrenacakë”. Kur Muhamedi a.s. mësoi për këtë, u zemërua. Hipokriti erdhi te Muhamedi a.s. dhe u shfaqësua duke i thënë: “Ne ishim vetëm duke folur dhe duke u tallur”.

Kështu sajuan gënjeshtër që shpalljen ta mbushin me dyshime, të degradojnë nderin e Islamit dhe të turpërojnë besimtarët e devotshëm e të vërtetë. Kur u pyetën për bërjen e këtyre krimeve të tilla, u shfaqësuan, i mohuan dhe u betuan se nuk i kanë bërë apo nuk kanë thënë asgjë.

d. Mbajtja e kontakteve sekrete: Një numër i kontakteve të tilla janë përmendur në librat e tefsirit dhe librat e sires (biografisë) të Muhamedit a.s. Për shembull, hipokriti dhe murgu i quajtur Ebu Amir udhëtoi te mbreti romak duke kërkuar ndihmë kundër Muhamedit a.s. Mbreti romak iu përgjigj dhe e strehoi. Ebu Amiri i dërgoi te hipokritët e tij disa shokë duke u thënë që ushtarët romakë do të vinin të luftonin kundër Muhamedit a.s. dhe do ta mundnin. Ai i urdhëroi që të përgatisin një kështjellë të vetme, në të cilën do të pritnin të dërguarit e mbretit romak dhe i cili do të ishte vendi i tij për mbikëqyrje nëse do të vinte më vonë. Si përgjigje, ndërjuan xhaminë e quajtur Dirar, lidhur me të cilën është zbritur ajeti kur’anor i mëposhtëm:

Nga hipokritët më të shëmtuarit janë ata që ndërjuan xhami sherrri, mosbesimi e përçarjeje mes besimtarëve dhe ftuan në pritje (solemne) atë që më parë kishte luftuar kundër All-llahut dhe të dërguarit të Tij. Ata do të betohen: “Ne nuk kemi pasur tjetër qëllim, vetëm për të mirë!” Po All-llahu dëshmoi se ata vërtet janë rrenacakë”. (et-Tevbe: 107)

Pas demaskimit të komplotit të tyre, Muhamedi a.s. urdhëroi që xhamia të digjet dhe të shkatërrohet.

⁴ Benu Mustalik është një vend mes Mekës dhe Medinës.

Ajo që përmendëm më lart ishin intrigat më të rëndësishme të hipokritëve gjatë jetës së Muhamedit a.s. Intriga ka pas në çdo periudhë të historisë dhe në çdo ndryshim të natës e ditës.

Ata të cilët kanë mendje e intelekt e dinë mirë që hipokrizitë e çifutëve e batinjëve dhe hipokrizia për dobi personale ka ndez zjarrin e shqetësimit e trazirës, ka mbjell farën e devijimit, ateizmit, mosbesimit, partishmërisë, ndarjes dhe sektarizmit mes muslimanëve. Gjithashtu ata kanë sajuar gënjeshtër kundër Muhamedit a.s. dhe muslimanëve që të shkatërrojnë shtetin e tyre dhe të shkatërrojnë shtyllat e Islamit. Mjafton fakti që hipokritët janë përshkruar në Kur'an si të turpshëm, mashtrues dhe të pamend. All-llahu xh.sh. thotë:

“Vëni re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit, por nuk e kuptojnë”.
(el-Bekare: 12)

“Në të vërtetë ata, dhe mu ata janë mendjelehtit, por nuk e dinë”.
(el-Bekare: 13)

“Kërko falje për ta ose mos kërko (është njëjtë), e edhe nëse kërkon falje shtatëdhjetë herë, All-llahu nuk do t’ua falë, sepse ata mohuan All-llahun dhe të dërguarin e Tij, e All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë (të shpëtimit), ata që nuk respektojnë”. (et-Tevbe: 80)

“Dhe asnjërit prej tyre kur të vdesin, mos ia fal namazin (e xhenazës) kurrë, e as mos qëndro pranë varrit të tij (për lutje e vizitë), pse ata mohuan All-llahun dhe të dërguarin e Tij dhe vdiqën kryeneçë”. (et-Tevbe: 84)

Qëndrimi i Islamit ndaj hipokritëve

Më lartë kemi përmendur që hipokrizia është sëmundje që shkatërron ndjenjën e nderit e burrërisë, zhduk Islamin e muslimanët, dëmton vlerat e moralin, dhe shpie drejt armiqësisë e rebelimit. Prandaj, Islami i lufton grupe të tilla djallëzore dhe urdhëron dënim për çdo grup varësisht dëmit që kanë shkaktuar.

Tani do të sqarojmë qëndrimin e Islamit për çdo grup.

Qëndrimi ndaj hipokrizisë së çifutëve

Për të shpjeguar çdo grup qartasi, duhet t’i klasifikojmë hipokritët çifut në dy grupe:

1. Ata të cilët e marrin Islamit si mbulesë
2. Ata të cilët e marrin marrëveshjen e dhimmive si mbulesë.

Lloji i parë duhet të trajtohet siç trajtohen muslimanët të konvertuar në ndonjë fe tjetër nëse shfaqin mosbesimin e tyre. Apo trajtohen sikur ata që bëjnë dëm në tokë nëse janë grup kriminel.

Ata të cilët e marrin Islamit si mbulesë

Dihet mirë që dënimi për atë që ndërron fenë është vdekja. Buharriu transmeton që Muhamedi a.s. ka thënë, “Kush konvertohet në fe tjetër përveç Islamit, vrane atë”.

Gjithashtu dihet mirë që dënimi për ata që bëjnë shkatërrime në tokë është vdekja, prerja e duarve dhe këmbëve të anëve të kundërta, dëbimi nga vendi. Udhëheqësi musliman i dënon në bazë të krimin që kanë bërë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dënimi i atyre që luftojnë (kundërshtojnë) All-llahun dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, nuk është tjetër vetëm se të mbyten ose të gozhdohen, ose (të gjymtohen), t’u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Kjo (masë ndëshkuese) është poshtërim për ta në dynja, dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh”. (el-Maide: 33)

Ata të cilët e marrin marrëveshjen e dhimmive si mbulesë

Ndërsa hipokritët çifutë të cilët e marrin marrëveshjen e dhimmive si mbulesë, ata duhet të trajtohen si dhimij sa kohë që i përmbahen marrëveshjes. Nëse e thyjnë atë, shkaktajnë trazirë e rrëmujë në tokë, dhe nxitin rebelimin në shoqërinë muslimane, atëherë duhet të luftohen dhe të zhduken intrigat e agresioni i tyre. All-llahu xh.sh. thotë:

“E nëse ata thyejnë zotimet e tyre pas marrëveshjes, ofendojnë fenë tuaj, atëherë luftoni krerët e mohuesve. Ata vërtet nuk kanë besë, luftoni që të frenohen (nga krimi e fyerja)”. (et-Tevbe: 12)

Prandaj, qëndrimi islam ishte shumë i ashpër kur fisi çifut Benu Kurejdha prishi marrëveshjen dhe bëri aleancë të fshehtë me grupet tjera në Mekë kundër Muhamedit a.s. Sahabiu, Sa'd ibn Muadh r.a. urdhëroi që meshkujt e tyre të mbyten, gratë e fëmijët e tyre të merren rob, dhe pasuria e tyre të merret si plaçkë. Muhamedi a.s. për këtë thotë, “O Sa'd, ke urdhëruar ashtu siç ka urdhëruar All-llahu xh.sh.”.

Të gjithë u vranë njëri pas tjetrit. Kur udhëheqësi i tyre, Hujejb ibn Ahtabi u dënua dhe iu lidhën duart, e shikoi Muhamedin a.s. dhe i tha, “Pasha All-llahun, nuk e fajësoj veten kur isha armik i joti, por kushdo që nuk e beson All-llahun ai e dëmton veten e tij”. Pastaj u vra.

Nganjëherë dënimi ishte dëbimi nga vendi, ashtu siç bëri Muhamedi a.s. me fisin çifut Benu Nadir.

Nganjëherë dënimi ishte vdekja për individ të caktuar, të cilët thurën komplete kundër Islamit dhe pasuesve të tij. Muhamedi a.s. urdhëroi sahabët e tij të vrasin disa nga çifutët për lëndimin e Muhamedit a.s., intrigimin për vrasjen e tij, nxitjen e armiqve të tij që ta vrasin, dhe luftimin e Islamit e pasuesve të tij.

Shembuj të njerëzve të tillë

- Ka'b ibn Eshref, i cili u vra nga sahabiu Muhamed ibn Mesleme.
- Ebu Rafi, nga Hajberi, i cili u vra nga sahabiu Abdullah ibn Atik.
- Ebu Afak, i cili u vra nga sahabiu Salim ibn Umejr.
- Asir ibn Rizam nga Hajberi, i cili u vra nga sahabiu Abdullah ibn Enis.
- Esma bint Mervan, e cila u vra nga sahabiu Umejr ibn Adi el-Ama.

Kështu Islami urdhëron dënim të ashpër e të dhimbshëm për çdo hipokrit çifut dhe thyes të marrëveshjes, sepse butësia me hipokritë të tillë djallëzor është e padobishme, dhe toleranca për individ të ulët është e kotë. All-llahu e mëshiroftë poetin, i cili thotë:

*Nuk pranohet të jesh i dobët
në një situatë që kërkon të jesh i fortë.
Apo të jesh i fortë në një situatë
që kërkon të jesh falës.*

Çifutët kanë të njejtën natyrë në ditët tona, ashtu siç ishin në të kaluarën me të njejtën mëri, poshtërsi, dobësi dhe dinakëri. Po të mos ishin trajtuar ashpër dhe rreptë, do të kishin shkaktuar më shumë fatkeqësi, mjerim e dëme. Kushdo që dëshiron të çliroj Palestinën dhe Xhaminë Aksa, të rikthej tokat e pushtuara dhe të fitoj të drejtat, duhet të din faktin që karakteristikat e çifutëve (dinakëria, poshtërsia, urrejta dhe intrigat) nuk kanë ndryshuar. Natyra e tyre e ulët dhe djallëzore është e njejtë.

Zgjidhja e vërtetë për të arritur çlirimin dhe fitoren është sakrifikimi i jetëve tona dhe besimi në fjalët e poetit:

*Umeti ynë do të din
që kemi sakrifikuar e rrezikuar
veten tonë për hir të tij.
Nëse arrijmë fitore, do t'i
largojmë vështirësitë nga njerëzit.
Nëse biem martirë, do të sakrifikojmë
veten për ta.*

Qëndrimi ndaj hipokrizisë së batinijëve

Pa dyshim, hipokrizia e batinijëve është aq e rrezikshme sa edhe hipokrizia e çifutëve. Intrigat dhe mosbesimi i tyre nganjëherë madje ia kalon hipokrizisë së çifutëve. Pas demaskimit të çështjeve e planeve të tyre, duhet të thuhet se ata janë jobesimtarë e ateistë, dhe se duhet të trajtohen me ashpërsi e rreptësi. Gjithashtu myslimanët duhet t'i zhdukin ata dhe t'i trajtojnë me rregulla të veçanta.

Të shohim se çka kanë thënë dijetarët islamë për ta.

Ibn Abidin përmend në librin e tij mendimin e katër shkollave juridike:

Qëndrimi i tyre në vendet myslimane nuk është i lejuar, e as marta me ta, e as ngrënia nga ajo që therin. Ata duhet të konsiderohen si jobesimtarë, hipokritë dhe ateistë. Megjithëse shfaqin besnikëri ndaj Islamit, agjërojnë e falen, ata besojnë në emigrimin e shpirtave, lejojnë pijet alkoolike dhe shkeljen e kurorës. Gjithashtu besojnë që hyjnia është e mishëruar në njerëzimin dhe mosbesimi në ringjallje, agjërim, falje të namazit dhe haxh (pelegrinazh). Pretendojnë që kuptimi i jashtëm (i dukshëm) i Kur'anit ndryshon nga kuptimi i brendshëm (i fshehur), dhe e përshkruajnë Muhamedin a.s. me fjalë të vrazhda. Gjithashtu përvetësojnë besimet e Karamitëve dhe Batinijëve që Aliu është i shenjtë, dhe se el-Hakim bi emrilah është i shenjtë dhe Aga kani është i shenjtë.

Pa dyshim, me këtë rast dëshmia e tyre e besimit nuk i bën murted.⁵ Në të njëjtën kohë, konvertimi i tyre në Islam nuk është i lejuar, përveç me kusht që t'i mohojnë të gjitha besimet, sepse ata e pranojnë Islamin dhe e pranojnë besimin e tyre. Pas kësaj, iu lejohet të jetojnë në tokat myslimane, por pendimi i tyre nuk pranohet. Disa dijetarë thonë që pendimi i tyre nuk pranohet kurrësi.

Ibn Tejmije, në një fetva lidhur me sektet batinije në vendet islame, mban këtë mendim:

emërimi i njerëzve të tillë në kalatë dhe ushtritë e myslimanëve është mëkat i madh. Kjo i ngjan atij që e përdor ujkun t'i kullojë dhe të. Ata janë njerëzit më mashtrues për myslimanët e udhëheqësit e tyre. Gjithashtu ata do të përpiqen të përhapin rrëmujë e parregullsi në mbretëri e shtet. Ata mund t'i zbulojnë sekretet e kalave myslimane armiqve dhe t'i nxisin ushtarët myslimanë që të mos u binden udhëheqësve të tyre. Udhëheqësit myslimanë i lejohet që t'i largojë nga ushtria dhe kalaja, ndërsa nuk i lejohet që të aplikojë ligjet lidhur me ta.

Lidhur me pendimin e tyre, ibn Tejmija thotë:

Pasuria dhe gjaku i tyre janë të lejuar për myslimanët. Nëse pendohen, dijetarët islamë nuk pajtohen lidhur me pranimin e pendimit të

⁵ Ky besim nuk i bën murted, ngase ndërimi i fesë është jashtë ateizmit të shprehur me gjuhë. Por, dëshmia e tyre e besimit dhe besimi i tyre është mosbesim i pastër Batinij. Kjo është hipokrizi e vërtetë.

tyre. Atyre nuk iu lejohet që të mblidhen në bashkësi e as u lejohet të bartin armë apo t'i bashkohen ushtrisë. Ata janë të obliguar të kryejnë ritet islame siç është kryerja e pesë namazeve ditore dhe leximit i Kur'anit, dhe duhet t'u mësohen mësimet islame, dhe t'u ndalohet takimi me mësuesit e tyre fetarë. Nëse udhëheqësi i tyre pendohet, atëherë ai duhet të izolohet nga ata dhe të dëbohet në një vend tjetër mysliman, ku nuk do të ketë pasues. Atje ose do të njohë rrugën e drejtë ose do të vdesë në hipokrizi duke mos dëmtuar myslimanët.⁶

Sipas mendimit tim, fëmijët e këtyre batinijëve, të moshës dhjetëvjeçare dhe më lart, nëse gjejnë shoqëri të mirë e besimtare apo një grup myslimanësh të kujdesshëm që do t'u mësojë realitetin e Islamit, parimet e shariatit dhe do t'i ndalojnë nga takimi i njerëzve fetarë të tyre, atëherë ata do t'i përgjigjen rrugës së drejtë, do të besojnë në Islam dhe do të jenë anëtarë brenda shoqërisë myslimane.

Kemi dëgjuar për disa të rinj, të cilët pasuan sektin batinij. Kur dikush nga myslimanët ua mësoi Islamin si besim e sistem, Kur'anin e shpatën, fenë e shtetin, adhurimin e politikën, pastërtinë e xhihadin, ata braktisën idetë e devijuara, të cilat i trashëguan, refuzuan besimet e rreme, besuan në Islam si sistem politik dhe rrugë e jetës, u bënë thirrës të vërtetë të Islamit, dhe punuan me të rinjtë e tjerë, të cilët përhapën Mesazhin e All-llahut dhe nuk iu frikësuan askujt përveç All-llahut.

Prandaj, dijetarët myslimanë dhe grupet besimtare islame duhet të bartin përgjegjësinë e informimit të tyre me mesazhin Islam që të mbrojnë gjeneratat e sekteve batinije, të cilët u kthyen nga mosbesimi në Islam, nga ateizmi në besim, dhe nga devijimi në udhëzim. Kësaj gjenerate i është dhënë natyrë e pastër, arsye e shëndoshë dhe përgatitje e mirë. Këto karakteristika janë dritare për pranimin e së drejtës dhe t'i përgjigjen fesë së All-llahut.

O dijetarë dhe ju thirrës të Islamit, shtoni përprjekjen, punën e propagandën tuaj që të ndikoni që kjo gjeneratë të besojë All-llahun,

⁶ Kjo fetva është marrë nga një shkresë, në të cilën i shpjegon rregullat e Islamit në lidhje me sekte të caktuara në Siri.

të pasojë të drejtën, të pranojë udhëzimin e All-llahut dhe të njohë vërtetësinë e Islamit. Udhëzimi i njeriut në rrugën e drejtë dhe vërtetësia e Islami është më e mirë se bota dhe çka në të dhe All-llahu xh.sh. i mbron besimtarët.

Qëndrimi ndaj hipokrizisë për interes të dikujt

Më lart kemi klasifikuar hipokrizinë për interes të dikujt në dy lloje: hipokrizinë e degjeneruesve dhe hipokrizinë e luajalistëve. Tani do të prekim çdo lloj prej tyre.

Më lart përmendëm që hipokrizia e degjeneruesve është e lidhur me një grup njerëzish, të cilët pretendojnë të jenë myslimanë derisa nga brenda janë jobesimtarë. Qëllimi i tyre është arritja e fuqisë, autoritetit dhe prishja e unitetit të umetit dhe mbjellja e farës dhe përçarja mes myslimanëve.

Sa kohë që janë hipokritë, por nuk e dëmtojnë Islamin, do t'i trajtojmë si myslimanë dhe sekretet e tyre do t'ia lëmë All-llahut. Por, nëse intrigat e tyre kundër myslimanëve dhe përvetësojnë besimet e rrejshme, atëherë do të trajtohen si renegatë. Nëse bëjnë vepra të këqija, atëherë do të dënohen ashpër që të jenë shembull për të tjerët. Nëse janë prej grupeve që bëjnë shkatërrime në tokë, do të dënohen ashtu siç urdhëron Kur'ani, që ose të vriten, ose t'u priten duart e këmbët nga anët e kundërta ose të dëbohen.

Udhëheqësi mysliman nganjëherë përmbahet nga vrasja e këtyre hipokritëve, të cilët nuk besojnë për shkak të politikës legislative, për shembull nëse ajo shkakton çrregullime e trazira mes myslimanëve. Muhamedi a.s. është përmbajtur nga vrasja e Abdullah ibn Ebi Selulit, kur kishte fyer Muhamedin a.s. në ekspeditën Benu Mustalik. Fjalimi i tij ishte një justifikim legal për ekzekutimin e tij.

Qëndrimi ndaj hipokrizisë së luajalistëve

Më lart përmendëm që luajalistët janë një grup i njerëzve, të cilët pretendojnë se besojnë në Islam, por ata i janë besnikë një grupi të mosbesimtarëve apo një grupi të devijuar në kërkim të qëllimeve të ulëta, kënaqësisë së kësaj bote apo interesave personale.

Sipas mendimit tim, ky lloj i hipokritëve janë të shumtë në kohën tonë, ku ekzistojnë interesa të shumta dhe qëllime të ndryshme. Njerëzit e konsiderojnë paranë si zot që adhurohet, autoritetet si qëllim të tyre të shenjtë, dhe ata me interesa personale si shpresë të tyre në jetë, madje edhe nëse e paguajnë me besimin e tyre dhe Islamin.

Shtrohet pyetja: A konsiderohen këta hipokritë besimtarë apo jo?

Kësaj pyetje do t'i përgjigjemi në detaje. Imam Ahmedi transmeton që Muhamedi a.s. e qortoi Omerin r.a. kur e pa duke lexuar një libër të "Ihtarëve të Librit", duke i thënë: "A nuk po beson në fenë tënde, o ibn Hatab? Pasha All-llahun, në dorën e të Cilit është jeta ime, po të ishte gjallë Musa, do të pasonte fenë time".

Ebu Davudi dhe Xheriri transmetojnë që Muhamedi a.s. i qortoi gjithashtu disa myslimanë, të cilët dëgjuan disa nga mësimet e çifutëve dhe i shënuan ato. Muhamedi a.s. thotë: "Ata të cilët devijuan nga feja e profetëve të tyre në fenë e tjerëve janë mendjelehtë dhe të humbur". All-llahu xh.sh. lidhur me këtë ngjarje zbriti ajetin vijues:

"Po a nuk u mjaftoi atyre që Ne ta shpallëm ty librin, i cili u lexohet atyre, e s'ka dyshim se kjo është dhuratë e përkujtim për njerëz që duan të besojnë". (el-Ankebut: 51)

El-Baihaki transmeton që Muhamedi a.s. e ka qortuar Hafsen r.a., kur ai solli një libër që përmbante tregimin e Jusufit a.s. Ai a.s. u zemërua dhe tha, "Pasha All-llahun në Dorën e të Cilit është shpirti im, nëse Jusufi do të dërgohej te ju derisa unë jam në mesin tuaj, dhe ju do ta pasonit atë, ju do të devijonit nga rruga e drejtë. Unë jam caktimi juaj nga profetët dhe ju jeni caktimi im nga kombet".

Nga tekstet e lartpërmendura, na bëhet e qartë që Muhamedi a.s. i kritikoi sahabët e tij për leximin e librave të feve të mëparshme. Ai e

bëri këtë që të ruajtë madhështinë e shariatit dhe madhështinë e mësimave të tij dhe që të mos i përziejë ato me besime e ide të tjera.

Nëse ata të cilët i lexojnë Shkrimet e Shenjta të mëparshme (megjithëse disa prej tyre kanë mbetë të pandryshuara) u qortuan, atëherë si do të jetë çështja me ata të cilët pranojnë sistemet e parimet që All-llahu xh.sh. nuk i ka zbritur? Si është çështja me ata të cilët bëjnë aleancë me shtetet jobesimtare dhe organizatat e devijuara që thërresin për parime e ide, të cilat janë në kundërshtim me besimin islam? Si është çështja e atyre që u bashkohen njerëzve, të cilët nuk i respektojnë lidhjet familjare apo marrëveshjet, dhe të cilët nuk i frikësohen dënimit të All-llahut?

Padyshim, devijimi i tyre nga rruga e drejtë është më i madh.

Lidhur me këta hipokritë që kërkojnë nder nga jobesimtarët dhe tentojnë të arrijnë interesat e tyre personale me besnikërinë ndaj tyre, All-llahu xh.sh. thotë:

“Ti (Muhamed) lajmëro munafikët se me të vërtetë ata kanë një dënim të dhembshëm. Janë ata që, përkundër besimtarëve, i miqësojnë jobesimtarët. Vallë, a mos kërkojnë fuqi te ta? S’ka dyshim, e tërë fuqia i takon All-llahut”. (en-Nisa: 138-139)

Kur’ani përmend fatin e atyre, të cilët i dëgjojnë njerëzit duke besuar dhe duke u tallur me fjalët e All-llahut xh.sh., duke qenë të kënaqur dhe duke u përrulur. All-llahu xh.sh. thotë:

“Juve u është shpallur në librin (Kur’anin) që, kur të dëgjoni se po mohohet Kur’ani i All-llahut dhe po bëhet tallje me të, mos rriini me ata derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër. Përndryshe, ju do të jeni si ata. All-llahu do t’i tubojë tradhtarët dhe jobesimtarët që të gjithë në xhehenem”. (en-Nisa: 140)

A janë ata besimtarë apo jo?

All-llahu xh.sh. na ndalon që jobesimtarët t’i marrim si mbrojtës apo të jemi miq me ta, qofshin ata "Ithtarë të Librit", politeistë apo ateistë.

Ajetet e mëposhtme i ndalojnë myslimanët që t’i marrin jobesimtarët si miq:

“Nuk gjen popull që e beson All-llahun dhe ditën e gjykimit, e ta dojë atë që kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre...”. (el-Muxhadele: 22)

“O ju që besuat, nëse keni dalë (prej vendlindjes) për hir të luftës për rrugën Time, duke kërkuar kënaqësinë Time ndaj jush, mos e zini mik armikun Tim dhe armikun tuaj, duke shprehur ndaj tyre dashuri, kur dihet se ata mohuan të vërtetën që u erdhi juve...”. (el-Mumtehine: 1)

“O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqarë”. (el-Maide: 51)

“O ju që besuat, mos u ofroni miqësi (dashuri) prindërve tuaj, as vëllezërve tuaj, nëse ata vlerësojnë mosbesimin kundër besimit. E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizorë”. (et-Tevbe: 23)

Myslimanët duhet të kuptojnë nga fjalët e All-llahut xh.sh. të lartpërmendur që nuk lejohet të jemi besnikë ndaj jobesimtarëve me qëllim të mbrojtjes së vetes ndaj rrezikut të tyre.

“Besimtarët të mos i miqësojnë jobesimtarët, e t’i lënë anash besimtarët. E kush bën atë, ai nga feja e All-llahut nuk ka asgjë, përveç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre...”. (Ali Imran: 28)

Mendoj që ajeti i lartpërmendur do të thotë që nëse luftojmë kundër jobesimtarëve dhe ata na vijnë e na sulmojnë dhe na mundin, ne myslimanët, në atë rast, do t’u nënshtrohemi kushteve të tyre vetëm

me gjuhë. Këtë duhet ta bëjmë për të parandaluar dëmin e lëndimin dhe për të mbrojtur shpirtat, nderin e pasurinë e myslimanëve. Myslimanët nuk duhet t'i zënë miq apo t'i imitojnë në veprat e tyre të liga siç janë pirja e alkoolit, apo t'i njohin me të metat e myslimanëve, apo të bëjnë aleancë me ta kundër myslimanëve.

Në fund të përmbledhim këtë që thamë: Nuk lejohet, ashtu siç tregon ajeti, që t'i marrim jobesimtarët si miq apo përkrahës. Kur fuqia e jobesimtarëve ia kalon fuqisë së myslimanëve, lejohet t'i bindemi vetëm me gjuhë.

Ndërsa ata të cilët anojnë me dashje ndaj jobesimtarëve, ateistëve apo njerëzve që besojnë besime të rrejshme a ulen me ta pa justifikim, u bashkohen atyre për hir të interesave personale dhe bëjnë aleancë me ta në emër të përfitimit e dobisë, sigurisht se ata kontribuojnë shumë në thellimin e mosbesimit, ateizmit, dhe padrejtësisë në shoqërinë islame.

All-llahu xh.sh. na paralajmëron që të mos i përkrahim apo të bëjmë aleancë me jobesimtarët e kriminelët:

"...kursesi të mos jesh ndihmëtar i jobesimtarëve". (el-Kasas: 86)

"...kurrë nuk do të vihem në ndihmë të kriminelëve". (el-Kasas: 17)

Nuk ka tradhti më të madhe ndaj Islamit se pasimi i atyre njerëzve që nuk i frikësohen All-llahut, nuk i respektojnë lidhjet familjare apo marrëveshjet, bëjnë shkatërrime në tokë, ndajnë atë që All-llahu xh.sh. ka urdhëruar të bashkohet dhe luftojnë kundër Islamit sa më shumë që është e mundur.

All-llahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat, mos e tradhtoni All-llahun dhe të dërguarin, e ashtu të tradhtoni amanetet tuaja, derisa e dini sa e keqe është kjo". (el-Enfalë: 27)

"O ju që besuat! Mos i merrni për miq ata të cilëve u është dhënë libri para jush edhe as jobesimtarët që me fenë tuaj tallen e luajnë. Kini dro All-llahun po qe se jeni besimtarë". (el-Maide: 57)

Këta hipokritë, të cilët janë luajalistë dhe shikojnë interesin e tyre personal nuk mund të quhen besimtarë apo myslimanë, pasi që u janë bashkuar grupeve të devijuara, sekteve të rrejshme dhe u janë bërë besnikë udhëheqësve të mosbesimit dhe u janë nënshtruar udhëheqësve të ateizmit. All-llahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqarë". (el-Maide: 51)

"...E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizorë". (et-Tevbe: 23)

Mjer për ata të cilët besnikërinë dhe bindjen e tyre ia japin jobesimtarëve apo ateistëve apo atyre që kanë devijuar që të jenë të vendosur në shoqërinë islame. Ata do të ndëshkohen me mundim të ashpër në Ditën e Gjykimit. All-llahu xh.sh. thotë:

"Ti (Muhamed) lajmëro munafikët se me të vërtetë ata kanë një dënim të dhembshëm. Janë ata që, përkundër besimtarëve, i miqësojnë jobesimtarët. Vallë, a mos kërkojnë fuqi te ta? S'ka dyshim, e tërë fuqia i takon All-llahut". (en-Nisa: 138-139)

"O ju që besuat, mos i zini miq jobesimtarët e t'i lini anash besimtarët. A doni t'i sillni All-llahut argument të qartë kundër vetes!" (en-Nisa: 144)

"S'ka dyshim, munafikët do të jenë në shtresën më të ulët (në fund) të zjarrit dhe për ta nuk do të gjesh mbrojtës. Përveç atyre që u penduan, u përmirësuan, iu përmbajtën All-llahut (mësimëve të Tij) dhe praktikojnë sinqerisht fenë e tyre për All-llahun. Të tillët do të jenë bashkë me besimtarët, e All-llahu ka për t'iu dhënë besimtarëve shpërblim të madh". (en-Nisa: 145-146)

Pa dyshim, hipokritët (luajalistët dhe njerëzit të cilët shikojnë interesat e tyre personale), nëse pendohen nga hipokrizia, bëjnë vepra të mira, dhe besojnë në fenë e All-llahut, do të jenë besimtarë të vërtetë dhe do t'u jepet shpërblim i madh e do të arrijnë fitore.

Fjala përfundimtare

Ky është qëndrimi i Islamit për lirinë e besimit dhe feve tjera.

Kjo është feja, të cilën e kanë vulosur mesazhet qiellore dhe ligjet hyjnore.

Gjithashtu dallohet duke qenë me origjinë hyjnore, pasi që është shpallje nga i Gjithëdijshmi.

Gjithashtu dallohet me universalitetin e tij, pasi që është fe për gjithë njerëzimin.

Gjithashtu dallohet me kompletësi, pasi që u përgjigjet të gjitha nevojave të njerëzimit në çdo kohë e vend.

Gjithashtu dallohet me vazhdimësi, pasi që mbjell farën e rritjes e vazhdimësisë deri në Ditën e Gjykimit.

Gjithashtu është fe i Dërguari i së cilës është dalluar me vërtetësi, ashtu si njerëzit e drejtë mes murgjve e priftërinjve, për të cilën dëshmanuan Bibla e Tevratit. Dhe paimitueshmëria e Kur'anit që sfidon njerëzimin në të gjitha kohërat e dëshmon këtë të vërtetë.

Është feja që nuk e detyron askënd të pranojë atë, qoftë me shpatë apo me forcë.

Është feja që i trajton "Ithtarët e Librit", paganët, dhe minoritetet jomyslimane me drejtësi dhe u jep të drejtat që asnjë fe apo shtet nuk i ka dhënë më parë. Është feja që i trajton ashpër dhe rreptë ateistët, hipokritët dhe renegatët.

Para se të përfundoj, do të komentoj atë që Shejh Seid Hava ka shkruar në Librin e tij "Kultura dhe morali i ushtarëve të All-llahut" (xhundullah thekafetun ve ahlak) lidhur me këta hipokritë, ateistë dhe renegatë që luftojnë Islamin. Kjo për të përfunduar dhe që të kemi dobi prej saj. Do të parafrazoj atë që shkroi ai në faqen 438:

Vendi i Islamit duhet të banohet vetëm me myslimanët dhe dhimitë, të cilat kanë marrëveshje me myslimanët. Ajo duhet të çlirohet nga renegatët, ateistët dhe hipokritët. Nuk lejohet t'u nënshtrohemi atyre apo t'i lejojmë të jetojnë në vendin e shpalljes dhe profetëve.

Nuk do të kemi nderin dhe autoritetin ndaj jomyslimanëve në vendin e Islamit përveç se me zbatimin e ligjeve të All-llahut, veprimin në përputhje me marrëveshjen tonë me dhimitë, luftën kundër çdokujt që e thyen atë dhe liritë të vendit tonë nga degjeneruesit e gënjeshtarët.

Por, nëse në shoqërinë myslimane ka ateistë e të shturur të cilët bëjnë vepra të këqija, qofshin jobesimtarë, batinij dhe nga sektet tjera si Karamita, Kadijani, Ismailij e të tjerë në vendin islam, atëherë ne nuk përpiqemi t'i zhdukim ata.

Nëse në vendet myslimane ka grupe e thirrës të devijuara që thërrasin në ide destruktive, atëherë kjo tregon se ne nuk lëvizim për zhdukjen e tyre. Kjo tregon se myslimanët kanë humbur nderin e tyre para jobesimtarëve dhe kanë dështuar të zbatojnë ligjet e All-llahut xh.sh. lidhur me ta, qoftë në tokën islame apo në tokën joislame.

Kur myslimanët humbën nderin e tyre, atëherë u ndanë, u turpëruan dhe u shkatërruan. Veç kësaj, çifutët me ndihmën e masonëve që gjendeshin në vendin tonë, ishin të gjendje që plotësisht të shkatërrojnë hilafetin islam. Gjithashtu batinijët ishin në gjendje të marrin një pjesë territori nga vendet islame. Komunistët ishin në gjendje të nënshtrojnë shumë vende myslimane. Antifetarët arritën të kontrollojnë myslimanët. Krishterët arritën të dominojnë vendet më të bukura në vendet myslimane. Çifutët arritën të themelojnë një shtet në Palestinë dhe të pushtojnë el-Aksanë dhe kështu me radhë.

Gjenerata e re islame sot është duke vuajtur shumë në saje të neglizhencës së udhëheqësve myslimanë në zbatimin e ligjit të All-llahut. Po të bënin këtë gabim përsëri, do të poshtëroheshin e do të turpëroheshin.

Ne duhet të jemi të ashpër ndaj jobesimtarëve, pasi që shfaqja e mëshirës ndaj tyre është poshtërim për myslimanët. Shfaqja e mëshirës ndaj jobesimtarëve është lloj i mosbesimit. Si mund të shfaqim mëshirë ndaj atyre që janë armiq të All-llahut, të Dërguarit të Tij, dhe besimeve tona, dhe kush i thyen marrëveshjet? Si mund të shfaqim mëshirë ndaj atyre që All-llahu xh.sh. na urdhëron t'i luftojmë? All-llahu xh.sh. thotë:

“O ti pejgamber, luftoju jobesimtarët e hipokritët dhe qëndro ash-për kundër tyre...”. (el-Tahrimë: 9)

Prej shenjave të besimit është mosshfaqja e mëshirës ndaj burrave e grave, të cilët bëjnë marrëdhënie seksuale jashtëligjore, madje edhe nëse janë besimtarë. Ne jemi të urdhëruar t'i gjuajmë me gurë pa keqardhje nëse janë të martuar dhe t'i rrahim me kamxhik duke i goditur njëqind herë nëse janë të pamartuar. All-llahu xh.sh. thotë:

“Dispozitë obliguese është që laviren dhe lavirin t'i rrihni, secilin prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të All-llahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve, nëse jeni që besoni All-llahun dhe botës tjetër. E gjatë zbatimit të ndëshkimit ndaj tyre, le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh”. (en-Nurë: 2)

Atëherë, si mund të kemi mëshirë ndaj një jobesimtari që thur intriga kundër Islamit dhe bën shkatërrime në tokë?

Një mëshirë e tillë tregon frikën e dobësinë tonë. Ajo që kam për qëllim me mëshirë është heqja dorë nga zbatimi i urdhrave të All-llahut lidhur me ata të cilët thurin intriga kundër Islamit e myslimanëve. Problemet e myslimanëve nuk mund të zgjidhen vetëm se me atë gjeneratë që i dëbon ata, të cilët e meritojnë të dëbohen nga toka islame, ateistët, batinijët, njerëzit e shturur, komunistët, kryqtarët e ligë, të pafetë dhe të degjeneruarit. Ata do t'i zhdukin ata me kënaqësi, pasi të kuptojnë që e kryejnë një detyrë me të cilën do të shpërblehen dhe do të zbatojnë urdhrat e All-llahut për hir të Tij.

Prania e një gjenerate të tillë besimtare, informuese e luftuese do të zgjidhë problemet e myslimanëve, do të fitojë madhështi dhe sovranitet për Islamin në shoqëritë e tyre.

Sa kohë që myslimanët frikësohen të luftojnë kundër armiqve të vendeve dhe fesë së tyre, heqin dorë nga frikësimi i armiqve të All-llahut, largohen nga marrja e frerëve dhe lirimi nga adhurimi i të këqijave e intrigave të tyre, sigurisht se ata do të jetojnë në poshtërim, nënshtrim dhe skllavërim. Sipas Ligjit Islam, myslimanët janë përgjegjës për lirimin nga degjenerimi dhe lufta kundër ateizmit e armiqve të Islamit. Kjo përgjegjësi do të jetë madhështore para All-llahut, dhe

do të kenë llogari të ashpër në Ditën e Gjykimit. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ndalni ata, sepse do të merren në përgjegjësi”. (es-Safatë: 24)

“Ne patjetër do të marrim në përgjegjësi ata, të cilëve u është dërguar (pejgamber), e do t'i marrim në pyetje edhe të dërguarit”. (el-A'rafë: 6)

“Pasha Zotin tënd, ata të gjithë do t'i marrim në përgjegjësi. Për atë se ç'vepruan”. (el-Hixhr: 92-93)

O All-llah, pastroji zemrat tona nga hipokrizia, gjuhët tona nga gënjeshtria, pastroji sytë tonë nga tradhtia. Ti e di më së miri mashtruesin e syve dhe gjithë atë që fshih zemra.

O All-llah, kërkojmë shpëtim te Ti nga shqetësimi e mëkati. Kërkojmë shpëtim te Ti nga frika e koprracia. Kërkojmë shpëtim te Ti nga të qenit i kontrolluar nga borxhi dhe nga padrejtësia e njerëzve.

O All-llah, na jep vetëbesim dhe na i mbush zemrat me besim. Bëj që të jetojmë ashtu siç dëshiron Ti dhe bëj që të vdesim si martir. O All-llah, na bëj prej ushtarëve të sinqertë të Islamit, nga ata njerëz të vërtetë që janë të butë ndaj besimtarëve dhe të ashpër ndaj jobesimtarëve, që luftojnë në rrugën e All-llahut dhe kurrë nuk u frikësohen armiqve.

Lavdërimi i takon All-llahut, Zotit të të gjithë botëve.

*Përktheu nga anlishtja:
Fuad Morina*

Abdullah Nasih Ulvan

FREEDOM OF RELIGION IN ISLAMIC LAW - (3) THE POSITION OF ISLAM TOWARDS HYPOCRITES

(Summary)

The characteristics of a hypocrite

Hypocrisy (may Allah protect us from it) is the pretence (claim) of being a Muslim, while one does not believe. The Qur'an describes the characteristics of hypocrites in the following ayats:

Of the people there are some who say: "We believe in Allah and the Last Day;" but they do not (really) believe. Fain would they deceive Allah and those who believe, but they only deceive themselves, and realise (it) not! In their hearts is a disease; and Allah has increased their disease: And grievous is the penalty they (incur), because they are false (to themselves). When it is said to them: "Make not mischief on the earth", they say: "Why, we only Want to make peace!" Of a surety, they are the ones who make mischief, but they realise (it) not. When it is said to them: "Believe as the others believe:" They say: "Shall we believe as the fools believe?" Nay, of a surety they are the fools, but they do not know. (Al-Baqarah: 8-13)

عبدالله ناصح علوان

حرية القيدة في الاسلام

موقف الاسلام من المنافقين

(خلاصة البحث)

صفات المنافقين

النفاق حفظنا الله جل شأنه منه هو الظهور بالاسلام و أنت يختفى في قلبك غير ذلك لاسباب دنيوية. و القرآن الكريم يصف المنافقين في الايات التالية:

وَمِنَ النَّاسِ مَن يَقُولُ آمَنَّا بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ

يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَمَا يَخْدَعُونَ إِلَّا أَنفُسَهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ

فِي قُلُوبِهِمْ مَّرَضٌ فَزَادَهُمُ اللَّهُ مَرَضًا وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ بِمَا كَانُوا يَكْذِبُونَ

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ لَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ قَالُوا إِنَّمَا نَحْنُ مُصْلِحُونَ

أَلَا إِنَّهُمْ هُمُ الْمُفْسِدُونَ وَلَكِن لَّا يَشْعُرُونَ

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ آمِنُوا كَمَا آمَنَ النَّاسُ قَالُوا أَنُؤْمِنُ كَمَا آمَنَ السُّفَهَاءُ أَلَا إِنَّهُمْ هُمُ

السُّفَهَاءُ وَلَكِن لَّا يَعْلَمُونَ (البقرة: 8-13)

AKTUALITETE

Dr. Mustafa Ceriq

LËVIZJET BASHKËKOHORE SHPIRTËRORE NË BOTËN ISLAMIKE

Bota islamike në epokën moderne

Shekulli i gjashtëmbëdhjetë në historinë europiane shënon fundin e mesjetës dhe fillimin e epokës së re moderne. Me paraqitjen e renesancës në kulturë dhe të reformacionit në religjion, Europa përjeton transformimin e llojit të vet të jetës politike, shoqërore dhe ekonomike. Këtij transformimi me të madhe i ka kontribuar fryma shkencore që në Europë në mënyrë rapide është përhapur dhe ka krijuar kushte për revolucionin industrial (1785), me ç'rast definitivisht është vullsur epoka e re teknologjike e përmasave universale.

Pikërisht për shkak të atij universaliteti të transformimit europian historia islame në periudhën e re moderne është në lidhje të ngushta me Europën. Sepse, në linjën skajore, ky transformim poliformë europian indirekt ka përcaktuar pozicionin dhe rolin e Islamit brenda botës moderne islame, dhe direkt ka ndikuar në sjelljen e botës islamike në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kështu mund të thuhet që historia moderne e Islamit nuk është historia e përparimit por e ngecjes, nuk është historia e mirëqenies por e krizës, dhe nuk është historia e suksesit por e mossuksesit. Në realitet, atë që Europa e quan periudhë të errët me-

sjetare në historinë e frymës njerëzore, për historinë islame kjo ka qenë periudha e ndritshme, kurse atë që Europa e quan periudhë të krizës së zhvillimit njerëzor, në historinë njerëzore shënohet si epoka e artë e përparimit dhe lulëzimit.

E vërteta, ka pasur kriza të rënda në historinë e Islamit edhe para epokës moderne europiane. Mjafton të përmendim krizën *medinase* dhe *sifinase* në shekullin e shtatë, krizën *emevite* në shekullin e tetë dhe atë më të rëndën *bagdadase mongoliane* në shekullin e trembëdhjetë. Mirëpo, pas të gjitha atyre krizave myslimanët kanë arritur ta mbajnë kontinuitetin e historisë autentike të Islamit dhe t'i kthehen qëllimit burimor të projektit historik islam. Kriza *medinase* është tejkaluar me zgjidhjen e halifit të parë Ebu Bekrit, *kriza sifinase* është ngadhënjyer me vënien e qendrave kulturore religjioze në Damask, kriza *emevite* është rregulluar me transferimin e *locusit* kulturo-politik-historik islam në Bagdad, derisa kriza *bagdadase mongoliane* është zbutur me krijimin e tri perandorive dominante islame të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, asaj Osmane në Stamboll, Safavidase në Tabriz dhe Mogule në Delhi.

Këto tri qendra nga pak të ndryshme të jetës politike dhe kulturore islame kanë siguruar praninë e Islamit në historinë e epokës moderne dhe, në realitet, është bërë objekt kryesor i dominimit, së pari ekonomik e pastaj edhe politik europian, me ç'rast për botën islame fillon epoka e kolonializmit europian si krizës më të rëndë e më të gjatë në historinë e Islamit. Këtë periudhë koloniale e fillon Portugalia, detarët e së cilës qysh në shekullin e pesëmbëdhjetë dhe të gjashtëmbëdhjetë formojnë koloni në qytetet bregdetare myslimane të Afrikës Perëndimore dhe Lindore, në Gjirin Persik, në Indi dhe në shumë ujdhesa të Indonezisë së sotshme. Hapave të detarëve portugezë pastaj kanë shkuar detarët spanjollë, holandezë, danezë, anglezë dhe francezë në shekullin XVI dhe XVII. Për shkak të shikimit gjithëpërfshirës në gjendjen e botës islame në periudhën koloniale, sjellim tabelën që dëfton pozitën koloniale të vendeve me popullatën predominuese myslimane në periudhën prej shekullit të gjashtëmbëdhjetë deri te sendërtimi i pavarësisë.

| Emërtimi i vendit | | | | |
|----------------------------|---|--------------------|----------------------------------|--|
| I tanishmi | I dikurshmi | Popullata (në 000) | Përqindja e popullatës myslimane | Administrata |
| Afganistani | | 16.750.000 | 99 | Invadimi britanik më 1842, 1878-1879, 1919; okupimi nga BRSS më 1979 dhe tërheqja më 1988. |
| Algjeria | | 20.000.000 | 97 | Territor osman prej sh.. XVI deri më 1830; territor francez prej 1830 deri 1962 |
| Arabia Saudite | Hixhazi, Nexhdi, Asiri, El-Hasa dhe krahinat tjera në Arabi | 9.700.000 | 100 | Disa krahina, pjesë të Perandorisë Osmane prej 1517-1918. |
| Bahrejni | | 375.000 | 95 | I lidhur me kontratë me Britaninë nga 1820, 1880, 1892; pavarësia 1971. |
| Bangladeshi | Pakistani Lindor | 92.600.000 | 85 | Pjesë e Indisë britanike prej shek. 18 deri 1947; pjesë e Pakistanit prej 1947-1971. |
| Çadi | Afrika Franceze Perëndimore | 4.650.000 | 50 | Protectorati francez prej rreth 1900-1960. |
| Emiratet e Bashkuara Arabe | | 800.000 | 96 | Emiratet e ndara nën protektoratin britanik prej 1892 -1971. |
| Komori | | 375.000 | 80 | Koloni franceze prej 1886-1975. |
| Xhibuti | Somalia franceze | 335.000 | 94 | Koloni franceze prej 1881-1977 |
| Egjipti | Republika e Bashkuar Arabe | 44.750.000 | 90 | Pjesë e Perandorisë Osmane prej 1517 deri 1798; okupimi francez prej 1798 deri 1802; i është kthyer administrimit osman pas okupimit të shkurtër britanik; dinastia e Hidjevit prej 1841; okupimi britanik 1882 dhe protektorati prej 1914-1936. |

| | | | | |
|------------------|--------------------------------|-------------|-----|--|
| Gambia | | 640.000 | 90 | Liman portugez dhe britanik në shek. 15 dhe 16; kontrata britanike 1618; kontest rreth pjesëve me Francën prej 1677-1783; e trajtuar si pjesë e kolonisë britanike të Sierra Leones deri 1888; protektorat britanik prej 1935-1965; në aleancë federale me Somalinë prej 1982. |
| Indonezia | India holandeze lindore | 153.000.000 | 89 | Koloni holandeze prej shek. 17 deri 1949; okupimi japonez prej 1942 deri 1945. |
| Irani | Persia | 41.000.000 | 98 | Sfera e ndikimit Rus dhe britanik prej 1907 deri 1919 |
| Iraku | Mesopotamia | 14.000.000 | 95 | Pjesë e Perandorisë Osmane prej 1534 deri 1916; Okupimi ushtarak anglez 1914; protektorati prej 1918 dhe mandati prej 1922 deri 1932. |
| Jordania | Transjordania | 3.475.000 | 95 | Pjesë e Perandorisë Osmane prej 1516 deri 1918; okupimi britanik prej 1918 deri 1920; pjesë e mandatit palestinez britanik prej 1920 deri 1946. |
| Libani (Libanon) | | 2.700.000 | 50 | Pjesë e Perandorisë Osmane prej 1516-1918. (pjesë autonome prej 1861-1914); okupimi i aleancës prej 1918-1920; mandati francez prej 1920-1941. |
| Libia | Tripolitania, Sirenaika Fezani | 3.250.000 | 99 | Pjesë e Perandorisë Osmane prej shek. 16; okupimi italian i Tripolitanisë prej 1911 dhe i pjesëve tjera prej 1918; okupimi gjerman prej 1941; kontrata britanike prej 1943-1951. |
| Maldivi | Ujëdhosat E Maldivit | 160.000 | 100 | Pjesë e Cejlonit prej 1645-1887; koloni holandeze 1645-1798; protektorat britanik 1887-1965. |
| Mali | Afrika Perëndimore Franceze | 7.350.000 | 65 | Kontrolli francez prej 1880-1960. |
| Mauritania | Afrika Perëndimore Franceze | 1.725.000 | 96 | Liman portugez prej shek. 15; liman francez prej 1904-1960. |

| | | | | |
|---|--------------------------------|------------|-----|---|
| Maroko | | 21.275.000 | 95 | Protektorati francez dhe britanik prej 1912-1956. |
| Nigeria | Afrika Perëndimore Franceze | 5.650.000 | 85 | Kontrrolli francez 1880-1960. |
| Omani | | 950.000 | 100 | Koloni portugeze në Muskat 1508-1650; kontrata britanike 1891 (por joformalisht protektorat). |
| Pakistani | Pakistani Lindor | 85.500.000 | 97 | Pjesë e Indisë britanike prej fundit të shek. 18-1947. |
| Katari | | 260.000 | 99 | Kontrata britanike 1916 -1971. |
| Republika Arabe e Jemenit | | 8.575.000 | 100 | Pjesë e Perandorisë Osmane prej 1517 deri 1918. |
| Republika Popullore Demokratike e Jemenit | Adeni, Jemeni Jugor | 2.100.000 | 98 | Koloni britanike në Aden 1839-1967 dhe kontrata britanike me shejhë të ndryshëm nga Arabia; Adeni protektorat 1937-1959; Federata Arabe Jugore 1959-1967. |
| Senegali | Afrika Perëndimore Franceze | 5.960.000 | 86 | Koloni portugeze 1944; koloni franceze prej 1663-1960; në përbërje federale me Gambinë prej dhjetorit 1982. |
| Somalia | Somalia italiane dhe britanike | 5.150.000 | 99 | Pjesa italiane nën protektorat 1889, e bashkuar Etiopisë 1935; okupimi britanik 1941; nën kontratën britanike deri 1960. |
| Sudani | Sudani Anglo-egjiptian | 19.150.000 | 72 | Nën administratën osmane 1820-1885; kondiminimi britanik dhe egjiptian 1899-1956. |
| Shqipëria | | 2.870.000 | 70 | Territor Osman prej shekullit 14 deri 1912. |
| Tunizia | | 6.650.000 | 92 | Protektorat francez 1881-1956. |
| Turqia | Imperia Osmane | 47.500.000 | 98 | Pjesë e Perandorisë Osmane prej shek. 14 deri 1923; okupimi britanik, francez dhe pjesërisht grek ndërmjet 1918-1923. |

Vështirë është të shpjegohet saktë përse dhe si civilizimi islam aq i pasur dhe i fuqishëm në kohën relativisht të shkurtër u rrëzua para hovit të hegjemonisë ekonomike, politike dhe kulturore europiane. A mund të shpjegohet ngecja e procesit civilizues islam në epokën moderne me transformimin revolucionar në Europë ose ajo shfaqet si pasojë e çrregullimit historik brenda vetë botës islame, të cilën ndryshimet në Europë vetëm e kanë forcuar? A janë rrënjët e dekadencës islame në burimet themelore të Islamit apo ato janë shfaqur si pasojë e lëshimit të këtyre burimeve? A ka ndodhur diç e gabueshme në historinë e zhvillimit islam që e ka shkaktuar këtë rënie që do të ndodhte pavarësisht prej ndodhive tjetërkund në botë, ose është shkaktuar me ato ndodhi?

Pra, bota islame domosdoshmërisht është ballafaquar me pyetjen e kontinuitetit të civilizimit islam në epokën moderne. Përgjigja në këtë pyetje nuk ka qenë e thjeshtë sikur që nuk ka qenë e thjeshtë as situata në të cilën bota islame është gjetur. Dilemat kanë qenë të qarta: a të fillohet çdo gjë prej fillimit sipas modelit të përvojës zanafillore islame; disa të arritura të përvojës historike islame a bën të ruhen, disa të modifikohen, e disa plotësisht të lëshohen dhe a të largohemi krejtësisht nga modelet tradicionale dhe të miratojmë modele moderne të rregullimit të shoqërisë islame? Është e natyrshme të pritët që në pyetjet e ndryshme kanë ofruar edhe përgjigje të ndryshme që, sipas mendimit tonë, mund të rrëgjohen në disa shenja të përgjithshme dhe këtë: reformizmi, modernizmi, *fundamentalizmi*, dhe islamizimi.

Reformizmi

Me reformizmin islamik këtu mendojmë në metodën e revitalizimit të mendimit dhe praktikës islame, i cili më tepër bazohet në burimet fundamentale të islamit se sa në inspirimin e epokës moderne që e karakterizon modernizmi islam. Me fjalë tjera, arsyetimin e reformës (*islah*) apo të përtëritjes islame (*texhid*), ithtarët e reformizmit e kanë gjetur në vetë burimet e Islamit, në Kur'an dhe Sunnet, sepse vetëm me kthimin në këto burime do të sigurohej shërimi i gjendjes së

sëmure në botën islame e me këtë do të pengohet edhe dominimi i jashtëm. Ky kthim në burimet themelore të Islamit nënkupton domosdoshmërinë e ringjalljes të komentimit origjinal të mësimit islam (*ixhtihad*), përkundër imitimit të zgjidhjeve tradicionale (*taqlid*), të cilat me shtresën e historisë së gjatë e megjullojnë esencën e porosisë islame. Kjo, në realitet, do të thotë: riafirmimi i islamit autentik dhe ndërtimi i shoqërisë islame në themelet e provuara të vetëqenësisë islame. Pra, *islah*, do të thotë, reformë, thënë më mirë lëshimi i traditës ekzistuese historikisht të imponuar, kurse *texhdid*, do të thotë: përtëritja e botës islame në bazat autentike të Islamit që tradita i ka errësuar me verbërinë e dobësisë historike. Qëllimi themelor i reformizmit të hershëm islamik ka qenë përtëritja e frymës burimore islame kundërall islamit popullarizues që e ka asfiksuar këtë frymë që ka qenë edhe supozim për mbrojtjen e pikëpamjes joislame europiane në rritje. Shkaku i krizës, pra, është gjetur në të kuptuarit dhe aplikimin joadekuat të planit civilizues burimor islam, prandaj formula për tejkalimin e tij është zbuluar në leximin e sërishëm serioz e të drejtpërdrejtë të këtij plani burimor.

Ideja për nevojën e ringjalljes së mësimit origjinal islam, që u përket të gjitha sferave të jetës njerëzore mund të përcillet qysh nga koha e mësuesit të madh islam Ebu Hamid el-Gazaliut (1058-1111), të cilën më vonë në mënyrën e vet e elaboron po ashtu dijetari i madh islam Ibn Tejmijje (1262-1327). Mirëpo, kjo ide në botën islame përjeton jehonë të vërtetë në shekullin e tetëmbëdhjetë kur e merr Muhammed ibn Abdulwehhabi (1703-1792) dhe kur familja Saud pranon që ta zbatojë në siujdhesën Arabike. Insistimi “vehabit për nevojën e arsyeshme të *ixhtihadit* (të përsiaturit të pavarur) dhe gjykimi i tyre i *taklidit* ka vepruar si forcë çliruese dhe ka ndikuar ndoshta në rrjedhën e zhvillimit të mëtejshëm islam më tepër se çdo faktor tjetër individual”. Rëndësia e lëvizjes vehabite qëndron në kundërvënien të gjitha llojeve të risive në fe dhe angazhimin e fuqishëm në pastërtinë e besimit të cilin drejtpërdrejt duhet pranuar nga burimet e Kur'anit dhe Sunnetit. Karakteristika themelore e vehabizmit është dimensionin transcendentin i islamit për të cilën nuk është masë e kaluara islame, por

aktualizimi i tashëm moral islam. Përmbajtja e tërheqjes së vëmendjes së vehabizmit ka qenë në atë që ajo që është në pikarritjen e fundit është e drejtë, e mirë dhe korrekte nuk është aplikimi i tanishëm i islamit, por aplikimi i tij ideal. Në këtë mënyrë vehabizimi ka theksuar esencën e jo formën e Islamit, idealitetin e tij e jo realitetin, në aspektin moral Abdulwehhabi e ka orientuar vëmendjen e myslimanëve jo në atë që myslimanët e kanë bërë në histori, por në atë çka ata duhet të bëjnë. Edhe pse kjo ndërprerje vehabite me të kaluarën islame për shkak të ardhmërisë ideale islame nuk është pranuar, ajo ka pasur ndikim të fortë në kuptim të çlirimit të botës islame nga tradicionalizmi i rrënjosur dhe gjetja e zgjidhjeve të reja mbi principet e metodologjisë klasike islame të *ixhtihadit* që në mesin e sunitëve pothuaj qe harruar. Shembulli më i mirë për botëkuptimin e tillë të reformizmit islamik është Shah Welijullahu nga Delhi (1703-1762) i cili energjinë e tij intelektuale e ka harxhuar në përtëritjen (*texhdidin*) e jo në mohimin e përmbajtjeve dhe formave ekzistuese islame. Welijullahu ka tentuar të gjejë sintezën e sufizmit të vërtetë dhe Sunnetit të pastër. Ai ka mundur ta përfytyrojë përtëritjen islame në suazat e Imperisë Mogule në Indi, deri sa Abdulwehhabi ka refuzuar çfarëdo bashkëpunimi me Perandorinë Osmane. Ky reformizëm i brendshëm islam i Abdulwehhabit dhe Shah Welijullahut fiton edhe dimensionin e raportit kundrejt faktorit të jashtëm. Sejjid Ahmed Barelaviu (1782-1931) ka konsideruar se nuk mjafton vetëm përtëritja e brendshme por nevojitet edhe mbrojtja nga rreziqet e jashtme.

Reformizmi islamik i shekullit nëntëmbëdhjetë më së fuqishmi e ka shprehur këtë raport ndërmjet përtëritjes së brendshme dhe mbrojtjes së jashtme. Personaliteti i Xhemaluddin Afganiut (1839-1897) më shprehimisht e simbolizon reformën e brendshme të botës islame dhe luftën e tij për ruajtjen e integritetit ekonomik, politik dhe kulturor. Konform ideve të tij panislamiste, Afganiu aktivitetin e vet reformatorist islamik nuk e ka kufizuar gjeografikisht por barabartë i ka ftuar myslimanët e Iranit, të Indisë, botës arabe dhe Turqisë që të bashkohen në shkronjën dhe fjalët e Islamit dhe ashtu bashkërisht të çlirohen nga kolonializmi perëndimor. Sipas mendimit të tij, bota islame ka

rënë në krizë për shkak se është e dobët, e jo për shkak se gjendja e tij e përgjithshme ka qenë e keqe, si e kanë komentuar pararendësit e tij. Afganiu është reformisti i parë islamik që esencën e modernes islame e ka njohur në kolonializmin perëndimor, duke krijuar kështu një raport permanent rivivalist ndërmjet Islamit dhe Perëndimit. Nxënësi i tij, Muhammed Abduhu në Egjipt (1849-1905), që thellë e ka respektuar mësuësin e vet, ka konsideruar se reforma e shoqërisë islame është e mundur me anë të përtëritjes bazore dhe këmbëngulëse të arsimimit islam për çka mund të përdoren edhe disa përvoja të shoqërisë moderne perëndimore.

Pra, reformizmi islam i shekullit tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë shprehet në gjurmimin për lidhjen e humbur me Islamin burimor, pastaj me vënien e asaj lidhjeje me burimet pa përzjerje ose me ndihmën e traditës ekzistuese dhe në çlirimin prej kolonializmit perëndimor me anë të unitetit politik ose të përparimit intelektual të botës islame.

Modernizmi

Modernizmi islamik është lëvizje shpirtërore në Islam që po ashtu rekomandon reformën e institucioneve themelore shoqërore dhe politike islame në pajtim me mësimin themelor të Islamit, por i cili për dallim nga reformizmi islam, inspirimin për këtë e gjen edhe në mendimin dhe praktikën perëndimore. Derisa reformizmi i hershëm islam i tipit vehabit përfaqëson përtëritjen e mendimit dhe praktikës islame në principin e kthimit Kur'anit dhe Sunnetit, modernizmi islamik i tipit të Haxhi Agus Salimit (1844-1955) nga Indonezia, Sejjid Ahmed Kahit (1817-1898) dhe Emir Aliut (1849-1928) nga India, Sangulaxhit (1890-1943) nga Irani, Namik Kemalit (1840-1888) dhe Tevfik Fikretit (1870-1915) nga Turqia e theksojnë lojalitetin e vet islamit burimor jo në kuptim të kthimit, por në kuptim të interpretimit bashkëkohor të Kur'anit dhe Sunnetit që nënkupton edhe aplikimin e metodologjisë perëndimore. Por, dallimi nuk është vetëm në qasjen burimore islame. Ai manifestohet edhe në metodologjinë e këtyre dy

lëvizjeve shpirtërore. Nën ndikimin e filozofisë modernistët islamë e lëvizin intelektualizmin, e nën ndikimin e sufizmit humanizmin islam. Me fjalë të tjera, parimi esencial metodologjik i modernistëve është racionalizmi të cilën edhe Abdulwahhabi edhe Weljullahu si princip nuk e pranojnë.

Ky krahasim është i nevojshëm për shkak të kundërimit të raporteve ndërmjet përpjekjeve reformiste islame si në aspekt të përcaktimit intern të drejtimit të jetës së gjithmbarshme shoqërore islame ashtu edhe në aspekt të ndikimit të Perëndimit në botën islame, penetrimi gjithnjë e më shumë ndjehej, sidomos prej fundit të shekullit nëntëmbëdhjetë deri te Lufta e Parë Botërore, kur liberalizmi europian ka përjetuar ngritjen më të madhe të vet dhe kur shumë studentë myslimanë janë shkolluar në Perëndim. Pra, dyshimi fillestar ndaj Perëndimit si rrezik potencial për botën islamike është shndërruar në lëvizje të modernizmit islamik, i cili në botën islamike futi ide të reja, vlera dhe orientime dhe inkuadroi institucione moderne: juridike, politike, shoqërore dhe shumë të tjera në vend të atyre klasike islamike. Sipas modelit perëndimor, bota islame ngadalë po adaptohet me fenë dhe shtetin si dy entitete të veçanta e nganjëherë kundërshtuese shoqërore, në perceptimin e moralit publik dhe privat si dy kategori të ndryshme morale, në shekullarizmin si fakt i domosdoshëm historik që nuk mund të kapërcehet.

Duke parë se megjithatë ekziston dallimi ndërmjet rolit të Islamit në botën islame dhe rolit të religjionit në Perëndim, vendet islame, duke përjashtuar Turqinë, e cila tekstualisht ka zbatuar modelin perëndimor të shekullarizmit ose liberalizmit politik, i sigurojnë hapësirë Islamit në atë masë në të cilën bartësit e tyre është e mundur të mbahen nën kontrollin ekonomik dhe politik. Në këtë mënyrë Islami bëhet faktor i rëndësishëm shoqëror në vendet islame, por jo edhe ideja udhëheqëse morale, juridike dhe politike, e cila në pajtim me frymën e kohës më tej zhvillohej dhe konfirmohej në të gjitha aspektet e veprimtarisë njerëzore.

Prandaj, shkollat moderniste islame vëmendjen e vet e kanë koncentruar në interpretimin e Islamit në kontekst të humanizmit dhe

racionalizmit perëndimor me tendencë të fuqishme të liberalizmit, dhe në kontekst të marksizmit që e ka shkaktuar edhe shfaqjen e nacionalizmit arab, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore. Fazlur Rahmani dhe Muhammed Arkuni janë shembujt më të mirë të racionalizmit ose intelektualizmit modern islam, sepse konsiderojnë se rilindja islame në epokën moderne mund të sendërtohet me integrimin e racionalizmit klasik islam dhe të metodologjisë moderne perëndimore. I preokupuar në gjendjen e rëndë shoqërore në botën islame, Ali Sheriati mendimin e vet modern islam me të madhe e ka mbështetur në marksizëm si metodë të emancipimit ekonomik dhe politik të masave myslimane.

Dhe sikur që reformizmi klasik islam nuk ka mundur t'i zgjidhë problemet e botës moderne islame, por ka arritur t'i identifikojë dhe ta hapë procesin për zgjidhjen e tyre, ashtu as modernizmi islam, pasi që gjithnjë e më shumë është larguar nga disa supozime themelore islame, nuk ka mundur ta japë provimin para zgjimit gjithnjë e më të madh të etosit islam që po shfaqet në kohën më të re.

Fundamentalizmi

Zgjimi i etosit Islam është i ngjashëm me reformizmin islamik në kuptim të thirrjes në kthim principeve fundamentale të fesë dhe praktikës islame, por dallon sipas intensitetit, vendosmërisë dhe efekteve në skenën ndërkombëtare. Pikërisht për shkak të efekteve në rrafshin ndërkombëtar përpjekjet më të reja të rilindjes islame llojlojshëm komentohen si jashtë ashtu edhe në botën islame. Pasi që kjo valë e re e revivalizmit islamik i ka përfshirë të gjitha llojet e shoqërive islame, që do të thotë, që stili islam i sjelljes gjithnjë e më shumë depërton në kulturë, në marrëdhënie shoqërore, çështje ekonomike dhe në jetën politike të botës myslimane, në Perëndim dhe në disa mjedise islame ka fituar parashenjë negative të "fundamentalizmit" islamik. Revolucioni iranian në vitin 1979 më së qarti e pasqyron këtë valë islame, i cili, duke i shkaktuar disa ndodhi dramatike në skenën ndërkombëtare, në vokabularin perëndimor politik, shkencor dhe zhurnalist është

shënuar me këtë shprehje. Mirëpo, siç kemi parë, procesi i zgjimit islam ka qenë i hetueshëm edhe para shembullit eruptiv iranian. Problemi si duket është në atë që specialistët perëndimorë për Islam nuk kanë mundur të parashohin revivalizëm aq të fortë islamik, sepse qasjet e tyre të islamit i kanë bazuar në teorinë materialiste ose të tjera mbi kauzalitetin shoqëror, të cilat lëvizin prej liberalizmit deri te neomarksizmi dhe funksionalizmi struktural. Është interesant të hetohet që, ndonëse të vetëdijshëm për faktin se Islami nuk është vetëm religjion por "mënyrë komplete e jetës", shumica e specialistëve amerikanë për Lindjen e Afërme përsiatjet e veta për islamit i ka orientuar në drejtim të shekullarizimit të shoqërisë myslimane në shembujt e shoqërisë perëndimore. Në atë kuptim edhe shume intelektualë islamë nuk kanë pasur sens më të rreptë me të cilin kanë mundur korrektësisht ta masin seriozitetin dhe fuqinë e revivalizmit islamik në mjediset e tyre vetjake pasi që edhe vetë ata janë të ushtruar sipas mënyrave të diturisë perëndimore dhe marksiste shoqërore.

Bruce Lawrence thekson se në gjuhën arabe etimologjikisht nuk ekziston shprehja fundamentalizëm edhe pse ekzistojnë shprehjet për reformën - *Islah*, rilindjen - *nahda*, sikur edhe për përtëritjen - *texhdid* dhe modernizmin - *tahdith*. Më tej, asnjë grup mysliman veten nuk e quan fundamentalist.

Historikisht, sikur që kanë vërejtur F. Rahmani (1986), Voll (1989), Lapidus (1983) dhe Lawrence (1984), grupet myslimane dhe individët, veçanërisht prej shekullit tetëmbëdhjetë, e kanë ftuar botën islame në përtëritjen socio-morale në bazë të kthimit Kur'anit dhe Sunnetit të Pejgamberit të Zotit. Prandaj, F. Rahmani konstaton se qëllimi i fundamentalistëve është "që të zbulojnë domethënien origjinale të porosisë islame pa devijime dhe shtrembërime historike dhe pa pengim me intervenim të traditës..."

Prandaj, Richard Antouni vëren se, "duke folur përgjithësisht", ata që kanë vendosur që plotësisht ta aplikojnë Islamit, Kur'ani i quan *mu'minûn* (besimtarë të mirëfilltë), kurse ata myslimanë që u përmbahen kritereve formale të Islamit pa intensitet dhe fortësi morale Kur'anit i quan *myslimân*, derisa ata që e pranojnë identitetin islam por

veprojnë vepra të padëshirueshme morale nga aspekti islam, Kur'ani i quan *munafiqûn* (dyfytërësh).

Lidhur me fenomenin e "fundamentalizmit", Seyyid Hossein Nasr thotë:

"Përdorimi zhurnalist, dhe akademik i shprehjes "fundamentalizëm", me të cilin dëftohet në shfaqjet poliforme në botën islame dhe në mendimin bashkëkohor islam është shprehja më e pafalshme që shpie në rrugë të gabuar, sepse është nxjerrë nga konteksti kristian, ku ka konotacion krejtësisht tjetër fare. Në Amerikë me këtë shprehje përcaktohen disa forma konservative të protestantizmit, rëndom antimoderne, me interpretim mjaft të ngushtë dhe tekstual të Biblës dhe me theks të fuqishëm në etikën tradicionale kristiane. Këto karakteristika kanë shumë pak të përbashkët me atë që klasifikohet në shprehjen "fundamentalizmi në islam", edhe pse edhe disa tendenca të jashtëzakonshme ekzotike por tradicionale në mendimin islam janë quajtur "fundamentalizëm" dhe kanë disa karakteristika të përbashkëta me "fundamentalizmin", sikur që kjo përgjithësisht kuptohet në anglishte. Mirëpo, dallimet janë shumë më të mëdha krahasuar me ngjashmëritë..."

Më tej, Hossein Nasri i klasifikon "fundamentalistët" islamikë në ata që dëshirojnë ta islamizojnë shoqërinë islame me aplikimin e sheri'atit me anë të qetë siç është rasti me *Xhemaati Islami* të Ali Mevdudisë dhe me ata që shërbehen me retorikën "revolucionare" që përkujton me lëvizjet revolucionare europiane me parashenjë islame. Këta të fundit, shpjegon Hossein Nasri nga një anë e lëvizin idenë për sundimin e ulemasë (sikur në Iran) dhe, nga ana tjetër, përpiqen plotësisht ta përjashtojnë ulemanë nga pushteti politik (sikur në Libi).

Sipas, mendimit tonë, "fundamentalizmi" islamik paraqet tentimin më radikal të revivalizmit modern islam i cili prej reformizmit klasik islam dallon në konfrontimin më të theksuar më perëndimor politik, ekonomik, dhe kulturor. Kësaj lëvizjeje me të madhe i ka ndihmuar edhe modernizmi islamik, i cili duke inkorporuar në botën islamike trendet perëndimore të mendimit politik, ekonomik dhe filozofik ka mospërfillur lojalitetin e numrit më të madh të myslimanëve ndaj principeve tradicionale morale islame. Po t'i shtohet kësaj edhe absteni-

mi i llojit të vet nga paradigma perëndimore në vetë Perëndimin, qartë tregohet që kërkesa për një frymë më origjinale ka mundur të pritët.

Islamizimi

Për shkak të karakterit radikal të llojit të vet "fundamentalizmi" islamik në Perëndim, sidomos në Amerikë, shënohet edhe me shprehjet "islami militant", "neofundamentalizmi" apo "politika me instinkt fetar". Në formën diç më të butë, por me qëllimin skajor që të tërhiqet vërejtja në aspektin politik të "fundamentalizmit" islamik ndodhitë në botën islame në Perëndim shënohen edhe me shprehjet "rilindja islame", "ringjallja islame", "zgjimi islam" ose "kthimi islam". E gjithë kjo, do të thoshim, e rëndon një dialog, të qetë e largpamës intelektual si ndër vetë myslimanët që i shohin mundësinë e revivalizmit bashkëkohor islam në analizën e durueshme të supozimeve morale dhe kulturore islame, ashtu edhe me Perëndimin që, tash mund të thuhet, gjithnjë e më qartë e sheh rëndësinë e rolit të islamit në çfarëdo ndryshimesh në botën islame. Me fjalë të tjera, për kyçjen e botës islame në proceset civilizuese bashkëkohore nuk mjafton vetëm emancipimi politik që në kohët e fundit veçanërisht është manifestuar si në kuptimin pozitiv ashtu edhe në atë negativ, por një ndërmarrje serioze shkencore hulumtuese islame, e cila do të siguronte mirëqenien morale dhe materiale të gjithë atyre që jetojnë dhe punojnë në një shoqëri islame dhe që në mënyrë karakteristike të vetëm i ka kontribuar përparimit civilizues botëror.

Sot, për fat, për këtë çështje në botën islame mjaft seriozisht mendohet edhe disa rezultate të kësaj ndërmarrjeje tashmë janë të dukshme. Ismail Faruki është një prej shumë intelektualëve myslimanë që kujdesin e vet e ka orientuar drejt gjetjes së mënyrës për islamizimin e diturisë ose, thënë ndryshe, konstituimit autentik të sistemit arsimor islam në suaza të të cilit do të mundej në mënyrë islame të përgjigjet në provokimet e kohës së tashme e të ardhshme. Projekti i islamizimit të dijes të I. Farukut ka pesë caqe elementare dhe këtë:

1) Të mësohen (përvetësohen) disiplinat shkencore moderne;

- 2) Themelësisht të njihet trashëgimia intelektuale islame;
- 3) Të vihet domethënia specifike e Islamit lidhur me çdo fushë të diturisë moderne;
- 4) Të gjenden mënyrat për sintezë kreative të trashëgimisë islame dhe të diturisë moderne dhe;
- 5) Të prodhohet mendimi i këtillë që do të shënojë rrugën drejt kënaqësisë së All-llahut.

Duke e miratuar këtë dëshirë për islamizimin e diturisë, Ziauddin Sardari, ndërkaq, i ka bërë vërejtje serioze planit të Farukut, sepse me atë nuk garantohet autenticiteti i shikimit islam mbi botën pasi që ende në pjesën më të madhe mbështetet në epistemologjinë moderne perëndimore, ndërsa as sintagma "islamizimi i diturisë" nuk është krejt e qartë. Për këtë arsye, Sardari ofron planin e vet të "islamizimit" të sistemit arsimor islam me një ndërmarrje më komplete të ndërtimit të *Weltanhangut* islamik. Në librin e vet të shkëlqyeshëm *Islamic Futures: the Shapes of Ideas to Come*, (Ardhmëria islame: Format e ideve që po vijnë, 1988) Sardari ekspozon dy rrethe koncentrike që paraqesin manifestimet kryesore të botëkuptimit islam: epistemologjia dhe *Sheri'ati* ose e drejta. Katër petalet primare i paraqesin shprehjet eksterne primare të *Weltanhangut*: struktura politike dhe shoqërore; ndërmarrja ekonomike; dituria dhe teknologjia dhe; mjedisi (environment).

Shembujt e Farukit dhe të Sardarit na japin shpresa se energjia shpirtërore në rritje në botën islame do të shpenzohet në qëllime të drejta dhe ashtu të sendërtohen vlera universale shpirtërore, të cilat do t'i shërbejnë të gjithë njerëzve.

Së këndejmi, këtu është e rrugës të flitet për ndërrimin e shprehjes "fundamentalizëm" me shprehjen *islamizim*, i cili, si e vëren edhe Richard T. Antoun, më tepër i përgjigjet tendencave reale në botën bashkëkohore islame. Antouni këtë e arsyeton me faktin se me rastin e vizitës së tij Jordanit në vitin 1959 në fshatin Kufr El-Ma' rrallë ndonjë familje i është përmbajtur rregullave të sheriatit gjatë kurorëzimit, por kur është kthyer më 1965, ka vërejtur se çdo martesë në atë fshat është kryer strikt sipas rregullave islame. Pra, këtu nuk ka të bëjë me

kurfarë "islami militant" por për procesin e veçantë të freskimit aktiv islam pas një periudhe të marrëdhënieve pasive ndaj religjionit përgjithësisht, kurse ndaj islamit sidomos.

Në këtë punim kemi folur për lëvizjet shpirtërore në botën islamike ku është shumica myslimane. Për atë çka po ndodh në midiset ku është pakica myslimane nuk kemi folur, sepse kjo është fushë ende jo mjaft e hulumtuar. Dëshirojmë, ndërkaq, të theksojmë se në kohën e fundit edhe asaj pjese të botës islame i kushtohet pak më tepër kujdes. Për më tepër, mendojmë se çdo studim serioz për Islamit në të ardhmen do të duhet të preokupohet edhe me gjendjen e myslimanëve në Bashkimin Sovjetik, Kinë, Europë dhe Ballkan.

Përktheu:
Nexhat Ibrahimi

Mustafa Ceriq

CONTEMPORARY SPIRITUAL MOVEMENTS IN THE ISLAMIC WORLD

The Islamic world in the modern era

(Summary)

In European history, the 16th century marks the end of the middle ages and the beginning of the modern era. Thanks to the renaissance (in culture) and the reformation movements (in religion) Europe experienced a transformation of the political, social and economic life. This transformation was encouraged by a scientific spirit, which spread through Europe creating conditions for the industrial revolution (1785) and marking the beginning of a new technological era (of universal dimensions).

مصطفى تسريش

الحركات الاسلامية المعاصرة العالم الاسلامي في الوقت الحاضر (خلاصة البحث)

القرن السادس عشر يعتبر نهاية القرون الوسطى و بداية العصر الحديث. مع بروز النهضة الحديثة في الثقافة و الاصلاحات في الدين المسيحي حدثت في القارة الاوربية تغييرات في الحياة السياسية و الاقتصادية. و قد ساهمت الحركة التنويرية و الروح العلمية التي كانت سائدة في أوروبا في تلك الفترة و التي كانت عاملا فاعلا للثورة الضاعية التي حدثت سنة 1785.

AKTUALITETE

Mr. Almir Fatiq

UMMETI NË KUR'AN DHE UMMETI SOT OSE: DREJT UMMETIZIMIT TË UMMETIT MYSLIMAN

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا لِتَكُونُوا شُهَدَاءَ عَلَى النَّاسِ
وَيَكُونَ الرَّسُولُ عَلَيْكُمْ شَهِيدًا

[WE KEDHALIKE XHE'ALNAKUM 'UMMETEN WESATEN
LITEKUNU SHUHEDAE 'ALE'N-NASI
WE JEKUNE'R-RESULU 'ALEJKUM SHEHIDEN...]

“Dhe ashtu (siç ju udhëzuar në fenë islame) Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në ditën e gjykimit) ndaj njerëzve, dhe për të qenë i dërguari dëshmitar ndaj jush”. (El-Bekare, 134)

Kuptimi leksikor i fjalës *ummetun*

Fjala *ummetun* në Kur'an është përmendur në pesëdhjetë e një vende në formën e njëjësit dhe në trembëdhjetë vende në formën e shumës. ¹ Sipas semantikëve të Kur'anit (*ehlu'l-me'aanii*), kjo fjalë në

Kur'an ka nëntë kuptime të ndryshme kontekstuale. Para se të sjell shembujt e kuptimit kontekstual të fjalës *ummetun* në Kur'an, shkurtimisht do të bëj një vështrim mbi kuptimin themelor (leksik) të saj. Filologu Ibn Kutejbe (v. 276 h.) thotë që kuptimi themelor i kësaj fjale është “lloj/grup njerëzish” (*sinf mine'n-naasi*), ose “bashkësi” (*el-xhema'ah*). Gjithashtu, sipas këtij filologu, fjala *ummetun* ndonjëherë nënkupton “kohë”, “periudhë” (*hin*), ose mund të nënkuptojë “udhëheqësin-prijësin” (imam), respektivisht “njeriu e ditur në çështjet fetare” (rebbani). Fjala *ummetun*, vazhdon më tutje ibn Kutejbe, herëherë është sinonim i fjalës ed-din (fe).

Një filolog tjetër i njohur, Ibn Faris (208 h./ 823), shënon që fjala *ummetun* në bazë do të thotë “shtat njerëzor” (el-kaametu), duke e argumentuar me vargun “*we inne mu'awijete'l-ekremin, hisanu'l-wuxhuhi tiwaalu'l-umem*”. Sipas Ibn Farisiut, fjala *ummetun* mund të nënkuptojë edhe “mirësi të madhe, nimet” (el-kethiretu en-ni'ameh).²

Nuk është vështirë të vërehet lidhja leksiko-semantike mes fjalës *ummetun* dhe fjalës *ummun* (nënë). Me të vërtetë, ashtu siç na shpjegojnë filologët, fjala *imam, umm dhe ummetun* ndajnë rrënjën e përbashkët të foljes *emmeme*. Për bazë ose themel të cilësdo çështje (send, lëndë-M. A) thuhet që ajo është *ummetun* (*we aslu kuli shej'in: ummetun*). Kjo lidhje leksiko-semantike ndërmjet fjalës *ummetun* dhe *ummun* bart edhe lidhjen simbolike në të cilën dallojmë idenë që ndaj ummetit (bashkësi besimtarësh të tubuar në një besim në Allahun, xh. sh.), duhet të sillemi ashtu siç sillemi edhe ndaj nënës që na ka lindur. Më tutje, nga lidhja e këtyre fjalëve *ummetun* dhe *ummun* shfaqet mesazhi i fuqishëm: vetëm se në krahët e ummetit ndjehemi më të qetë dhe më të sigurt, ashtu njëjtë sikur që atë ndjenjë na e dhurojnë kraharorin e ngrohtë të nënës.

¹ Muhammad Fu'ad 'Abd al-Baqi, *Al-Muxham al-mufahris li alfaz al-Qur'an al-karim*, Dar al-hadith, Al-Qahira, 1996, 99.

² Cit. sipas: Ibn al-Xhawzi, *Nuzha al-'ayun al-nawazir fi 'ilm al-wuxhuh wa al-naza'ir*, Dar al-kutub al-'ilmiyyah, Bayrut, 2000, 44.

Kuptimi kontekstual i fjalës *ummetun* në Kur'an

Ashtu siç edhe u theksua, sipas semantikëve të Kur'anit, fjala *ummetun* në Kur'an ka nëntë kuptime të ndryshme kontekstuale. Semantiku i njohur i Kur'anit nga shekulli i pesë sipas hixhretit Ebu Abdullah el-Husejn b. Muhammed ed-Damegani në veprën e tij të jashtëzakonshme me titull *El-Vuxhuuh we'n-nadhaa'ir li elfaadh kita-abilahi'l-azaiz* shënon këto kuptime të fjalës *ummetun*:

1. *ummet*, si grumbuj njerëzish ('*usbeh*): p.sh. në ajetet:

وَمِنْ ذُرِّيَّتِنَا أُمَّةٌ مُّسْلِمَةٌ لَّكَ [WE MIN DHURRIJETINA 'UMMETEN MUSLIMETEN LEKE] (El-Baqare, 128), d.m.th. '*usbeten*, (... dhe bëre që pasardhësit tanë të jenë bashkësi e përlur ndaj Teje...);

تِلْكَ أُمَّةٌ قَدْ خَلَتْ [TILKE 'UMMETUN KAD HALET] (El-Baqare, 134), d.m.th. '*usbetun*, (Ajo bashkësi ishte dhe kaloi...);

لَيْسُوا سَوَاءٌ مِّنْ أَهْلِ الْكِتَابِ أُمَّةٌ قَائِمَةٌ يَتْلُونَ آيَاتِ اللَّهِ [LEJSU SEWA'ÉN MIN 'EHLIL-KITABI 'UMMETUN KA'IMETUN JETLUNE 'AJATI 'L-LAHI] (Alu 'Imran, 113), d.m.th. '*usbetun*, (Nuk janë të gjithë Ithtarët e Librit të njëjtë. Nga bashkësia e tyre ka që janë në rrugë të drejtë, të cilët lexojnë ajetet e Allahut...);

وَمِنْ قَوْمِ مُوسَى أُمَّةٌ يَهْدُونَ بِالْحَقِّ وَبِهِ يَعْدِلُونَ [WE MIN KAWMI MUSA 'UMMETUN JEHDUNE BIL-HEKKI WE BIHI JA'DILUNE] (El-E'araf, 159), d.m.th. '*usbetun*, (Edhe prej popullit të Musait qe një bashkësi që udhëzoi drejt dhe iu përmbajt asaj.)

2. *ummet*, si bashkësi njerëzish të tubuar në të njëjtën fe (*el-mileh*),

كَانَ النَّاسُ أُمَّةً وَاحِدَةً [KANE'N-NASU 'UMMETEN WAHIDETEN] (El-Baqare, 213), do të thotë, *miletun*, (Të gjithë njerëzit (më parë) kishin bërë një bashkësi fetare)

وَإِنَّ هَذِهِ أُمَّةٌ وَاحِدَةٌ [WE 'INNE HADHIHI 'UMMETUKUM 'UMMETEN WAHIDETEN] (El-Mu'minun, 52, El-Enbija', 92), d.m.th. *miletukum mileten wahideten*, (Kjo bashkësia juaj, është e vetmja bashkësi e besimtarëve...)

كَذَلِكَ زَيْنًا لِّكُلِّ أُمَّةٍ عَمَلُهُمْ [KEDHALIKE ZEJENNA LIKULLI 'UMMETIN 'AMELEHUM] (El-En'am, 108), do të thotë, *li kuli ehli miletin*, (Kështu Ne ia kemi zbukuruar çdo bashkësi veprimin e vet...)

وَلَوْلَا أَنْ يَكُونَ النَّاسُ أُمَّةً وَاحِدَةً [WE LEWLA 'EN JEKUNE EN-NASU 'UMMETEN WAHIDETEN] (Ez-Zukhruf, 33), do të thotë, *miletun wahideten*, (E sikur të mos ishte që njerëzit (do të lakmonin) të jenë të një bashkësi fetare...).

3. *ummet*, si numër vitesh të caktuara (*siniine ma'duudeh*):

وَلَكِنَّا أَخْرَجْنَا عَنْهُمْ الْعَذَابَ إِلَى أُمَّةٍ مَّعْدُودَةٍ [WE LE'IN 'EHHARNA 'AN-HUMUL-'ADHABE 'ILA 'UMMETIN MA'DUDETIN] (Hud, 8), d.m.th. *siniine ma'duudeh*, (Nëse Ne e vonojmë ndëshkimin për një kohë të shkurtër kundër tyre...);

وَإِذْ كَرَّرْنَا بَعْدَ أُمَّةٍ [WE EIDDEKERE BA'DE 'UMMETIN] (Jusuf, 45), d.m.th. *sinin*, (...e përkujtoi pas disa viteve...).

4. *ummet*, si popull (*qawmun*):

أَنْ تَكُونَ أُمَّةٌ هِيَ أَرْبَى مِنْ أُمَّةٍ [EN TEKUNE 'UMMETUN HIJE 'ERBA MIN 'UMMETIN] (En-Nahl, 92), d.m.th. *en jekuune qawmun ekthere min qawmin*, (...për shkak se një popull është më i madh se tjetri...);

لِكُلِّ أُمَّةٍ جَعَلْنَا مَنْسَكًا [LIKULLI 'UMMETIN XHE'ALNA MENSE-KAEN] (El-Haxh, 67), do të thotë, *we li kuli qawmin*, (Secilit popull Ne i dhamë ligj...).

5. ummet, si udhëheqës, imam i cili ndiqet (imaam):

إِنَّ إِبْرَاهِيمَ كَانَ أُمَّةً قَانِتًا [‘INNE ‘IBRAHIME KANE ‘UMMETEN] (Ēn-Nahl, 120) – (Ibrahimi ishte udhëheqës (imam), i udhëzuar).

6. ummet, si popuj të veçantë pabesimtarësh dhe të tjerë (el-umemu'l-khaalije mine'l-kuffaari we gajrihim):

وَلِكُلِّ أُمَّةٍ رَسُولٌ [WE LIKULLI ‘UMMETIN RESULUN] (Junus, 47), d.m.th. *el-umeme'l-khaalije*, (Secili popull në të kaluarën kishte të dërguar...);

وَأَنَّ مِنْ أُمَّةٍ إِلَّا خَلَا فِيهَا نَذِيرٌ [WE ‘IN MIN ‘UMMETIN ‘IL-LA HALA FÍHA NEDHIRÛN] (Fâtir, 24), d.m.th. *el-umeme'l-khaalije*, (...e nuk pati asnjë nga popujt në të kaluarën që nuk pati të dërguar).

7. ummet, si ummet i Muhammedit, a.s., do të thotë, myslimanët (ummetu muhammedin):

كُنْتُمْ خَيْرَ أُمَّةٍ أُخْرِجَتْ لِلنَّاسِ [KUNTUM HAJRE ‘UMMETIN ‘UHRI-XHET LILNÑASI] (Alu 'Imran, 110), d.m.th. *el-muslimin*, (Ju jeni ummeti më i mirë, të cilët ndonjëherë janë paraqitur...);

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا [WE KEDHELIKE XHE'ALNAKUM ‘UMMETEN WESETÆN] (El-Beqare, 143), do të thotë, *ummeten* ‘adlen bejne’n-nas, (Dhe kështu nga ju bëmë bashkësi të drejtë në mes njerëzve tjerë...).

8. ummet, si popuj të veçantë pabesimtarësh (el-kuffaar khaasah):

كَذَلِكَ أَرْسَلْنَاكَ فِي أُمَّةٍ قَدْ خَلَتْ مِنْ قَبْلِهَا أُمَمٌ [KEDHALIKE ‘ERSE-LNAKE FÍ ‘UMMETIN KÁD HALET´MIN KABLIHA ‘UMEM-UN] (Er-Ra’d, 30), do të thotë, *el-kuffaar*, (Dhe kështu të dërguam te një popull pabesimtarë, para të cilit ishin dhe kaluan popuj tjerë pabesimtarë..).

9. ummet, si krijesa:

وَلَا طَائِرٌ يَطِيرُ بِجَنَاحَيْهِ إِلَّا أُمَمٌ أَمْثَالُكُمْ [LA TA’IRIN JETIRU BIXHE-NAHEJHI ‘ILĀ ‘UMEMUŦ ‘EMTHALUKUM] (El-En'am, 38), do të thotë, *khalqan mithlukum*, (...dhe të gjithë shpendët të cilat me krahet e tyre fluturojnë, krijesa sikur ju janë...)³

Dijetari Er-Ragib Isfehani (vd. 503. H./1109.) në Fjalorin e tij leksikor të Kur'anit (*Mu'xhem mufredaat elfaadhi'l-Qur'an*) shënon që fjala *ummetun* në ajetin 22 të sures Ez-Zuhruf: إِنَّا وَجَدْنَا آبَاءَنَا عَلَىٰ أُمَّةٍ [‘INNA WEXHEDNA ‘ABA’ENA ‘ALA ‘UMMETIN] – do të thotë fe (*diin*) – (Ne i gjetëm të parët tanë në fe...)⁴

Ummeti si bashkësi e rrugës mesatare

Në suren El-Bekare (143) bashkësia myslimane është përshkruar si e drejtë, respektivisht bashkësi mesatare (*ummetun wesetun*). Çka do të thotë termi mesatar (*wesatun*) në këtë ajet dhe çka ai në kuptimin përmbajtësor nënkupton? Përgjigjen mund ta gjejmë në komentet e periudhës klasike dhe bashkëkohore. Këtu do t'i paraqesim disa komente të tilla të ajetit të lartshënuar.

Komentatori i shquar i Kur'anit El-Mawerdi (vd. 450. H./1058) në veprën e tij të çmuar të komentimit të Kur'anit pohon që fjala *wesetun* ka tre kuptime: a) të qenët i zgjedhur; b) qëndrim mesatar në të kuptuarit e çështjes (sendit, lëndës, -M. A), sepse myslimanët në pikëpamje të fesë kanë rrugën mesatare; nuk e teprojnë në fe, as që e reduktojnë rëndësinë e saj, ashtu siç bëjnë hebrenjtë, të cilët ndryshuan Librin e Allahut, mbytën të dërguarit dhe shpikën gënjeshtër ndaj Zotit të tyre. Andaj, Allahu i Lartësuar i ka përshkruar myslimanët si ata të cilët i përmbahen mesit, sepse Atij, të Lartësuarit, çështja mesatare i është më e dashur; c) të qenët të drejtë, sepse drejtësia është mesi ndërmjet

³ Al-Damagani, Abu 'Abdullah al-Husayn b. Muhammad al-Damagani, *Al-Wuxhuh wa al-naza'ir li alfaz kitabilah al-'aziz*, I-II, Iyha' al-turath, Al-Qahira, I, 1996, 120-22.

⁴ Isfahani, Al-Ragib, *Mu'xham mufradat al-alfaz al-Qur'an*, Dar al-kutub al-'ilmiyyah, Bayrut, 1997, 30.

shtimit dhe pakësimit – për këtë mundësi të tretë kuptimore El-Mawardi përcjell nga Ebu Se'id el-Hudri, që vetë i Dërguari i Allahut s. a. v. s., mbi Fjalët e Allahut: *وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا* [WE KEDHE-LIKE XHE'ALNAKUM 'UMMETEN WESETÆN], ka thënë që fjala *wesetan* këtu do të thotë 'adlen (drejtësi).⁵

فيه ثلاثة تأويلات: أحدها: يعني خياراً، ... والثاني: أن الوسط من التوسط في الأمور، لأن المسلمين تَوَسَّطُوا في الدين، فلا هم أهل غلو فيه، ولا هم أهل تقصير فيه، كاليهود الذين بدلوا كتاب الله وقتلوا أنبياءهم وكذبوا على ربه، فوصفهم الله تعالى هم وسط، لأن أحب الأمور إليه أوسطها . والثالث: يريد بالوسط: عدلاً، لأن العدل وسط بين الزيادة والنقصان، وقد روى أبو سعيد الخدري، عن النبي صلى الله عليه وسلم في قوله تعالى: *﴿وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا﴾* أي عدلاً

Mufessiri i famshëm, autori i komentit më të njohur dhe më të lexuar të Kur'anit ndër myslimanët sunnit, Ibn Kethiri (vd. 774. H./1372.) në tefsirin e tij *Tefsiru'l-Qur'ani'l-'adhim* shënon se si fjala *wesetan* këtu ka ardhur në kuptim “të shkëlqesisë, përsosurisë, përgjegjësisë”. Ibn Kethiri më tutje thotë që i Dërguari i Allahut, s.a.v.s., ishte *wesetan* ndër popullin e tij, do të thotë, “raca më bujare në mesin e tyre”. Nga ato fjalë, fjala *wesetan*, ashtu siç ky komentator shënon, nxjerr sintagmën *es-salatu'l-wusta*, të cilën Kur'ani e përdor për “namazin e mesëm” (do të thotë, namazi i iqindisë), i cili është “namazi më i çmuar”. Më pas Ibn Kethiri citon një transmetim autentik në të cilin thuhet se Allahu i Lartësuar këtë ummet e ka bërë më të zgjedhur, me atë që e ka dalluar: me dispozita më të përkryera, metoda më të mira dhe drejtim më të qartë

⁵ Al-Mawardi, Abu al-Husayn 'Ali b. Habib al-Basri, *Al-Nukat wa al-'uyun*, I, Al-Turath al-islamiyy, Al-Kuvayt, 1986, 164-65. Komentatori i njohur Al-Kutubi në tefsirin e tij thotë që Et-Tirmidhi mbanë qëndrimin se ky hadith është *hasenun sahih*. (Al-Qurtubi, *Al-Xhami' li ahkam al-Qur'an*, I, Mu'assasah manhil al-'irfan, Bayrut, pa vit botimi).

والوسط ههنا: الخيار، والأجود؛ وكان رسول الله صلى الله عليه وسلم وسطاً في قومه، أي: أشرفهم نسباً، ... ومنه الصلاة الوسطى التي هي أفضل الصلوات، وهي العصر، كما ثبت في الصحاح وغيرها. ولما جعل الله هذه الأمة وسطاً، خصها بأكمل الشرائع وأقوم المناهج وأوضح المذاهب.⁶

Komentatori i njohur i Kur'anit En-Nesefiu (vd. 701. H./1301.) në Tefsirin e tij, duke e komentuar fjalën *wesetan* kryesisht shërbehet me ajetin e sures El-Bekare, në të cilin gjithashtu flitet mbi ndërrimin e Kibles, po ashtu thotë që ky ummet është më i zgjedhuri nga gjithë ummetet tjera, mu ashtu siç edhe drejtimi i këtij ummeti është më i zgjedhur ndërmjet drejttimeve tjera. Gjithashtu, edhe En-Nesefiu, konfirmon që fjala *wesetan* do të thotë drejtësi, e cila nënkupton ekuilibrin midis ekstremiteteve, të cilave nuk u afrohet ummeti. Ashtu siç edhe kibleja e këtij ummeti është ndërmjet lindjes dhe Perëndimit, ashtu edhe ky ummet është në mes ndërmjet teprimit dhe pakësimit-poshtërimit.

Të krishterët janë ata të cilët e tepruan kur Mesihun e përshkruan si Qenie Hyjnore, ndërsa hebrenjtë poshtëruan Mejremen e ndershme duke e akuzuar për amoralitet, si Isaun, a. s., që ai është fëmijë i zinasë (amoralitetit), përfundon ky komentator.

أُمَّةً وَسَطًا خياراً. وقيل: للخيار وسط لأن الأطراف يتسارع إليها الخلل والأوساط محمية أي كما جعلت قبلتكم خير القبل جعلتكم خير الأمم، أو عدولاً لأن الوسط عدل بين الأطراف ليس إلى بعضها أقرب من بعض. أي كما جعلنا قبلتكم متوسطة بين المشرق والمغرب جعلناكم أمة وسطاً بين الغلو والتقصير فإنكم لم تغلوا غلو النصارى حيث وصفوا المسيح بالألوهية، ولم تقصروا تقصير اليهود حيث وصفوا مريم بالزنا وعيسى بأنه ولد الزنا⁷

⁶ Ibn Kathir, *Tafsir al-Qur'an al-'adhim*, I, Maktaba dar al-fihya' & Maktaba dar al-salam, Riyad, 1994, 260.

⁷ Al-Nasafi, 'Abdullah, *Tafsir al-Nasafi*, I, Dar ihya' al-kutub al-'arabiyya, pa vend dhe vit botimi., 79.

Mësuesi i madh i urtësive tradicionale dhe autor i njërës nga komentet më të mëdha të Kur'anit në shek. XX, 'Allameh Sejjid Muhammed Husejn Tabataba'i në *Mizanin* e tij, kur e komenton këtë ajet, thotë që fjala *wesetun* do të thotë “shmangie nga çdo lloj skajshmërie” فالوسط هو المتخلل بين الطرفين لا إلى هذا الطرف ولا إلى ذاك الطرف

Sipas Tabatabait, për dallim nga hebrenjtë, krishterët, politeistët dhe idhujtarët, prej të cilëve disa i janë kushtuar vetëm aspektit material apo trupor të jetës njerëzore (politeistët dhe idhujtarët), ashtu që mohojnë ringjalljen në botën tjetër dhe çdo kualitet të jetës shpirtërore, ndërsa të tjerët, duke refuzuar sferën materiale, ekskluzivisht iu përkushtuan shpirtërores dhe mënyrës monakiste të jetesës (të krishterët), ummetin mysliman Allahu i lartësuar e bëri ummet mesatar, ashtu që fesë ia dha fenë, e cila e rekomandon rrugën mesatare me të cilën i shmanget çdo lloj ekstremizmi. Vërtet, vë në dukje Tabataba'i, fe e cila favorizon edhe vlerat shpirtërore edhe materiale, sepse njeriu është “bashkim i shpirtit dhe trupit, e jo vetëm shpirt i pastër apo vetëm trup i pastër”. Nga kjo, për jetë të lumtur njeriut i “nevojitet që t'i bashkon të dyja vlerat dhe kënaqësitë: materialen dhe shpirtëroren”, pohon Tabataba'i

وهذا الأمة بالنسبة إلى الناس - وهم أهل الكتاب والمشركون - على هذا الوصف فإن بعضهم - وهم المشركون والوثنيون - إلى تقوية جانب الجسم محضاً لا يريدون إلا الحياة الدنيا والاستكمال بملاذها وزخارفها وزينتها، لا يرجون بعثاً ولا نشوراً، ولا يعبأون بشيء من الفضائل المعنوية والروحية، وبعضهم كالنصارى إلى تقوية جانب الروح لا يدعون إلا إلى الرهبانية ... لكن الله سبحانه جعل هذه الأمة وسطاً بأن جعل لهم ديناً يهدي منتحليه إلى سواء الطريق وسط الطرفين لا إلى هؤلاء ولا إلى هؤلاء بل يقوي كلا من الجانبين - جانب الجسم وجانب الروح - على ما يليق به ويندب إلى جمع الفضيلتين، فإن الإنسان مجموع الروح والجسم لا روح محضاً ولا جسم محضاً ومحتاج في حياته السعيدة إلى جمع كلا الكمالين والسعادتين المادية والمعنوية.⁸

⁸ Al-Tabataba'i, 'Allamah Sayyid Muhammad Husayn, *Al-Mizan fi tafsir al-Qur'an*, e marrë nga web-faqja: <http://www.al-tafsir.com>, 1. 11. 2006.

Komentatorët e tjerë të Kur'anit në shek. XX, siç janë p.sh., Sejjid Qutb, shejh Mahmud Sheltut, Ebu'l-'Ala el-Mewdudi e të tjerë, në tefsiret e tyre do të vënë në dukje veçanërisht pozicionin e mesëm të ummetit mysliman në çdo pikëpamje: në të kuptuarit, në të ndjerit, në të organizuarit, në marrëdhënie ...

Këtu duhet theksuar që në Kur'anin fisnik edhe në ajetet tjera theksohet pozicioni i mesëm i ummeti mysliman, siç janë:

وَالَّذِينَ إِذَا أَنْفَقُوا لَمْ يُسْرِفُوا وَلَمْ يَقْتُرُوا وَكَانَ بَيْنَ ذَلِكَ قَوَامًا; (El-Furqan, 67)

وَلَا تَجْعَلْ يَدَكَ مَغْلُولَةً إِلَىٰ عُنُقِكَ وَلَا تَبْسُطْهَا كُلَّ الْبَسْطِ فَتَقْعُدَ مَلُومًا مَّحْسُورًا (El-Isra', 29).

Nga njohuritë e lartshënuara të komentatorëve dhe ajeteve kur'anore përfundohet që pozicioni i mesëm ose rruga mesatare me të cilin është përshkruar ummeti mysliman nënkupton ekuilibrin e përkryer (*te'adul*) në të gjitha aspektet e mundshme të besimit, veprimit dhe mendimit mysliman. Detyra e dijetarëve dhe shkencëtarëve mysliman të kohës së sodit është që ta kthejnë atë ekuilibër të rrënuar të bashkësisë bashkëkohore myslimane në çdo pikëpamje: shkencore, kulturore, ekonomike, politike...

Ummeti si bashkësi politike e të gjithë myslimanëve

Është e udhës këtu të përmendet që neni i dytë i dokumentit të Medinës thotë: “Besimtarët e përbëjnë një bashkësi jashtë njerëzve tjerë” (*innehum ummetun wahidetun min duni'n-nas*).⁹ Kështu, pra, i Dërguari i Allahut, Muhammedi, s.a.v.s., e ka definuar bashkësinë myslimane të besimtarëve.

Nga historia islame na është e njohur që deri te rrënimi i Bagdadit në vitin 1258, si qytet kryesor dhe vendbanim i hilafetit mysliman prej

⁹ Dr. Muhammad Hamidullah al-Haydar Abadi (pergatit), *Maxhmu'a al-watha'iq al-siyasiya lil 'ahd al-nabawii wa al-khilafah al-rashidah*, Al-Qahira, 1956, 15. Shih tekstin e plotë të dokumentit të Medinës në origjinal dhe përkthim në: Enes Kariq (përgatiti), *Ljudska prava u kontekstu islamsko-zapadne debate*, Pravni centar, Fond otvoreno društvo BiH, Sarajevë, 1996, 285-297.

750.-1258., shoqëria myslimane ka qenë e vendosur në organizim qendror të konceptit të ummetit. Rënia e Bagdadit ka nënkuptuar fundin e pushtetit qendror mysliman. Në këtë organizim koncepti i ummetit, më shumë sesa shtet, ka rezervuar pozicionin primar. Faktorët bashkues të shoqërive myslimane ishin: besimi i përbashkët në një Zot dhe ibadetet e përbashkëta, siç janë namazi, agjërimi, haxhi etj. Natyrisht, edhe brenda këtij organizimi kanë ekzistuar dallime të rëndësishme. Pas rënies së Bagdadit, sistemet e mëdha imperiale dhe shoqërore, të cilat u themeluan në Mesjetë, tregojnë shenja të dobisë së brendshme, ndonëse akoma ato kanë formë të jashtme. Në përfundim të shekullit XVIII, Perandoria Osmane kontrollonte pjesën më të madhe të gadishullit ballkanik, një pjesë të madhe të bregdetit mesdhetar të Afrikës dhe të gjitha tokat arabe në basenin lindor mesdhetar. Perandoria Mongole vazhdon të jetë fuqia më e fortë politike në Azinë Veriore, ndërsa perandoria Safavidiane qeveris me Persinë. Jashtë këtij organizimi të qartë të sistemit shtetëror, ka ekzistuar periferia e gjerë e zonës myslimane. Në Azinë qendrore kanë ekzistuar gjatë *kanatët*, të cilët janë shtrirë nga Evropa lindore deri në Kinë. Në juglindje të Azisë paraqiten *sulltanatet* e reja si pasojë e ndikimit të dijetarëve dhe tregtarëve myslimanë. Në Afrikën Perëndimore paraqiten shtetet e reja si rezultat i ndryshimeve thelbësore në strukturën fisnore dhe të perandorive mesjetare.¹⁰

Gjatë periudhës koloniale, ky koncept transnacional i ummetit është ndërruar me sistem tjetër operativ i cili, sipas origjinës së tij, është karakteristik përëndimor. Ky koncept i ri ka qenë nacionalizëm i cili rritej deri te ideja e shtetit si themel i bashkimit politik, i ndarë në kufi konkret. Ky ndryshim ishte diç më shumë se formulim i thatë teorik i këtyre dy koncepteve; ai, në të vërtetë, ka pasur pasoja afatgjate për botën myslimane. Fryma e nacionalizmit bazohet në parimet lingvistike dhe kulturore. Në Perëndim, ky koncept ka sjellë deri te shtetet

¹⁰ Shih: Muzaffar Iqbal, "Islam and the West in the Emerging World Order", në: Zafar Ishaq Ansari & John L. Esposito (ed.), *Muslims and the West*, Islamic Research Institute, Islamabad, and Center for Muslim-Christian Understanding, Washington, 2001, 251-52.

e ndryshme politike, të cilat gjerë e gjatë janë definuar në bazë të gjuhës, kulturës dhe kufijve gjeografikë. Këto shtete, në emër të patriotizmit, nga qytetarët e tyre kanë kërkuar lojalitet. Për shembull, detyrim kryesor i një rusi ka qenë lojaliteti ndaj Ruisë, ndërsa për gjermanët, lojaliteti ndaj Gjermanisë. Nga ana tjetër, islami nuk pranon asnjë lloj fragmentarizmi të racës njerëzore në bazë të gjuhës dhe kulturës. Paraqitja e nacionalizmit në botën myslimane, gjatë periudhës koloniale, për herë të parë në historinë e botës myslimane shpiku idenë e cila e ndau ummetin në baza nacionale dhe rajonale – ndarje për shkak të së cilës ata edhe vuajnë sot. Ajo nxori një numër të madh shtetesh në botën myslimane dhe formoi kombe e shtete jashtë asaj që ka qenë bashkësia e besimtarëve, duke e ndarë atë, siç ka ndodhur edhe me luftërat e ndërmjetme.¹¹

Drejt *ummetizimit* të ummetit mysliman

Në bazë të kësaj që u paraqit, sipas mendimit tonë, mund të vijmë deri të disa përfundime të rëndësishme. Përcaktimi kur'anor-sunnetik i termit *ummet* dhe analiza semantike-leksikore e fjalëve kur'anore *ummet* dhe *wesetun* na tregojnë në karakteristikat vijuese të ummetit mysliman:

- A) Ummeti mysliman është bashkësi e besimtarëve pos bashkësive tjera;
- B) Ummeti mysliman është i bashkuar në një të vetmin Zot, xh. sh., dhe ibadetet e përbashkëta të islamit;
- C) Ummeti mysliman posedon dispozita më të përkryera, metoda më të mira dhe drejtim më të qartë;
- D) Ummeti mysliman është ummeti i zgjedhur mbi ummetet e tjera në botë;
- E) Ummeti mysliman është ummet i drejtë dhe drejtësisë në marrëdhëniet dhe punët midis tyre si edhe ndaj ummeteve tjera;
- F) Ummeti mysliman është ummet i ekuilibruar në të gjitha aspektet e besimit, veprimt dhe mendimit njerëzor;

¹¹ Ibid., 257-58.

- G) Ummeti mysliman është bashkësi e mesit në çdo pikëpamje;
 H) Ummeti mysliman iu shmanget skajshmërive në vlerat materiale dhe shpirtërore;
 I) Pjesëtarët e ummetit mysliman ndaj ummetit kanë ndjenjën e nënës;
 J) Ummet do të thotë siguri për çdo pjesëtar të ummetit.

Nga ana tjetër, pozicioni i sodit në botë i ummetit mysliman nuk përputhet me përcaktimet e theksuara kur'anore-sunnetike të termit dhe konceptit të ummetit. Gjithsesi, pasojat e një gjendje të tillë janë shkatërruese, çka edhe është konsekuencë natyrore braktisja e konceptit të ummetit në praktikën politike bashkëkohore të myslimanëve në botë. Sot ekzistojnë zëra, si nga ana e qarqeve orientalistike perëndimore njëashtu edhe nga ana e myslimanëve të sekularizuar, të cilët idenë e ummetit e shpallin “të vdekur politikisht”. Ne si myslimanë këtë ide nuk mund ta pranojmë, për më tepër, ajo për myslimanët si një ummet, ummet i Muhammedit, s.a.v.s., parimisht është e papranuar. Përkundër tendencës së tillë të gabuar, dijetarët dhe mendimtarët e ummetit mysliman duhet nga fillimi t'i paraqesin dhe artikulojnë çdo koncept fetar, politik apo tjetër të ummetit në periudhën bashkëkohore. Gjithsesi, duhet thënë qartë që ideja e ummetit nuk është e vdekur politikisht. Ajo është e gjallë dhe jeton në zemrat e miliona myslimanëve në pjesë të ndryshme të botës. Është për t'u habitur që sot mbi idenë e ummetit nuk flitet shumë, madje as midis qarqeve të ulemasë. Ndërsa pikërisht ulemaja myslimane është ajo që duhet e para të filloj *ummetizimin* e ummetit mysliman. Ideja e ummetit nuk i shlyen identitetet nacionale të myslimanëve, ato edhe më tutje mbeten ashtu siç janë, mirëpo koncepti mbinacional i ummetit ngadhënjën çdo identitet nacional dhe i lidh të gjithë myslimanët me dashurinë vëllazërore dhe barabartësinë përpara Krijuesit të Lartësuar, i Cili ka thënë:

إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ [‘INNE ‘EKREMEKUM ‘INDELL-LLAHI ‘ETKAKUM] El-Huxhurat, 13). Duke marrë parasysh situatën turbulente politike në botë, gjendjen dhe pozicionin global të shoqërive dhe shteteve myslimane, ideja e ummetit imponohet si çështje me rëndësi vendimtare fetare dhe politike e bashkëkohësisë dhe ardhmërisë mys-

limane. Për atë, mendoj, sot duhet fuqishëm të flitet mbi *ummetizimin* e ummetit mysliman në të gjithë nivelet.

Në fund, t'i rikujtojmë fjalët e të Dërguarit të Allahut, s.a.v.s., i cili në fjalimin e tij në “haxhin e lamtumirës”, ndërmjet tjerash, ka thënë:

O njerëz! Me të vërtetë keni vetëm një Zot dhe vetëm një pararendës: të gjithë ju jeni pasardhës të Ademit, ndërsa Ademi është prej dheut. Më i respektuari nga ju te Zoti është ai i cili më shumë i frikësohet. Nuk ka dallim Arabi nga jo-Arabi, përpos në devotshmërinë e tij. (Ejjuhe'n-naas, inne rabbekum wahidun we inne ebaakum waahidun. Kul-lukum li adem we ademu min turaab. Ekremekum 'indell-llahi etqaakum. We lejse li 'arebijjin 'alaa 'axhemijjin fadlun il-la bi't-taqwaa)¹²

Burimi:

<http://www.zerislam.com/gjuhe.te.huaja/UMMET-U-KUR.ANU-I-UMMET-DANAS.html>

Nga boshnjakishtja:
Mehas Alija

Almir Fatiq

¹² Dr. M. H. Abadi (përgatiti), *op. cit.* 283; sh. E. Kariq (përgatiti), *op. cit.*, 295-300.

THE UMMAH IN THE QUR'AN AND THE UMMAH NOWADAYS TOWARDS THE UMMAHIZATION OF THE MUSLIM UMMAH

(Summary)

“Thus, have we made of you a nation justly balanced. That ye might be witnesses over the nations, and the Messenger a witness over yourselves”. (Al-Baqarah 143)

The lexical meaning of the word Ummah

The word Ummah is mentioned 51 times in the Qur'an (in singular). It is mentioned 13 times (in plural). According to semanticists (ehlul-me'aanii) this word has 9 different meanings in the Qur'an (depending on the context). According to Ibn Kuteybe, a philologist who was born in 276, the main meaning of this word is a group of people (sinf mine'n-naasi) or community (el-jema'ah). The word Ummah can also have other meanings such as: “time”, “period” (hin), “leader” (imam), respectively, “a scholar in religious matters” (rebbani). Occasionally, the word Ummah is a synonym of the word ed-din (religion).

المير فاتييش

الامة في القرآن و الامة اليوم أو نحو أمة مسلمة

"وَكَذَلِكَ جَعَلْنَاكُمْ أُمَّةً وَسَطًا لِتَكُونُوا شُهَدَاءَ عَلَى النَّاسِ وَيَكُونَ الرَّسُولُ عَلَيْكُمْ شَهِيدًا"

معنى الامة في القاموس

ان كلمة أمة ذكرت في القرآن الكريم في واحد و خمسين آية كريمة على صيغة مفرد و في ثمانية و عشر آية على صيغة الجمع. و حسب علماء اللغة فان لهذه الكلمة في القرآن الكريم أكثر من تسعة معاني مختلفة.

KUMTESA

Prof. dr. Mehdi Polisi

QËNDRIMI I SAMI FRASHËRIT NDAJ ISLAMIT DHE QYTETËRIMIT TË TIJ

Për kontributin e Sami Frashërit në fushën e Islamistikës kemi shkruar punime edhe më parë.¹ Arsyet që më kanë shtyrë t’i rikthehem kësaj teme janë të shumta, nga të cilat do t’i përmend dy më kryesoret:

E para, sepse njohuritë e enciklopedistit Sami Frashëri, ashtu sikurse në fushat e tjera të dijes, edhe në fushën e Islamistikës janë aq të thella sa që për to gjithmonë ka mundësi të thuhet diçka e re;

E dyta, sepse ka zëra të cilët kur flasin për mendimet dhe pikëpamjet që ka shfaqur Samiu lidhur me Islamin dhe qytetërimin e tij, flasin në mënyrë joobjektive, flasin me paragjykime, sigurisht, përveç tjerash, nën ndikimin e rrethanave politike e ideologjike të kohës, që për shkencën janë të papranueshme.

¹ Mehdi Polisi, Sami Frashëri në fushën e Islamistikës, botuar në veprën Qytetërimi islam (shih shënimin 6); i njëjti: Interesimi i Sami Frashërit për shkencat natyrore, Filologji, nr. 12, Prishtinë, 2004; i njëjti: Sami Frashëri njohës i Kur’anit, Hëna e Re, nr. 192, Shkurt 2007, Shkup. Ky punim është lexuar në Sesionin Shkencor “Kur’ani te shqipëtarët” 26-37 dhjetor 2005 në Prishtinë, që e organizoi Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës. Kumtesat e këtij sesiioni shkencor priten të botohen në përmbledhje të veçantë.

Ndër zërat që kanë shkruar në mënyrë të veçantë për qëndrimin e Samiut ndaj fesë është dhe një nga studiuesit e veprës së Samiut, Shaban Çollaku. Ai, duke shkruar një vepër të rëndësishme për Sami Frashërin si iluminist², një kapitull të veçantë në këtë vepër³ ia kushton çështjes së botëkuptimit të Samiut ndaj fesë. Për të shkruar këtë kapitull, Çollaku është mbështetur kryesisht në disa vepra shkencore-popullore të Samiut, të botuara në kuadër të “Bibliotekës së Xhepit”, si: *Gök* (Qielli), *Yer* (Toka), *Insan* (Njeriu), *Yine Insan* (Përsëri njeriu), *Esatir* (Mitologjitë) etj., në të cilat trajtohen tema të ndjeshme, si, për shembull, zanafilla e krijimit të njeriut, përbërja e tij, zhvillimi dhe evoluimi i tij, dallimi i tij nga kafshët e tjera, qëllimi i krijimit të tij etj., pastaj, krijimi i qiellit dhe i tokës, përbërja e tyre, lëvizjet e tyre dhe e trupave të tjerë në gjithësi, shkatërrimi i tyre etj, tema këto, siç thotë Samiu në njëren nga këto vepra, “kanë lodhur më së shumti mendjet e dijetarëve”. Meqenëse veprën e tij Çollaku e ka shkruar në kohën kur në Shqipëri mbretëronte ideologjia marksiste-leniniste, natyrisht, ai nuk ka mundur të dalë nga kthetrat e asaj ideologjie, prandaj shpjegimet e tij për shumë çështje që i shtronte Samiu në mënyrë të drejtë, ai do t’i shtrembërojë dhe do t’i shpjegojë me paragjykime, duke sulmuar fenë në mënyrën më të ashpër, dhe sidomos Fenë islame, duke e quajtur atë reaksionare, antikombëtare, antishoqërore, si mjet që ka lënë në errësirë e në injorancë shoqërinë etj., vlerësime këto që, siç do të shihet në vazhdim të këtij punimi, aspak nuk përkojnë me realitetin, në asnjë mënyrë nuk përputhen me mendimet dhe pikëpamjet e Samiut. Shkurt, nga ky punim shihet qartë se Çollaku ka qenë i përqendruar në dy pika kryesore: 1. të sulmojë fenë, sidomos Fenë islame, 2. të bindë opinionin se Samiu fenë e ka përdorur si mjet për të arritur qëllime të tjera. Të merresh me arsyetimin e këtyre problemeve të shpjeguara sipas tekeve ideologjike të Çollakut, më duket se është humbje kohe. Në të vërtetë, shumë nga këto probleme i kam trajtuar në punimet e mia të zëna ngoje më lart (shih shënimin 1), para se ta

² Shaban Çollak, Mendimi iluminist i Sami Frashërit, 1986, Tiranë, botuar nga Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë.

³ Po aty, f. 173-230.

kisha në dorë veprën e Çollakut. Të gjitha ato çështje i kam shqyrtuar me gjakftohtësi, pa paragjykime, ashtu siç i kam gjetur në veprat e Samiut, prandaj, në këtë rast nuk dëshiroj të përsëriten. Në fakt, duke parë vlerën e veprave shkencore-popullore të Samiut, që u përmendën më lart, nga njëra anë, dhe për të shmangur mjegullimet e paraqitura, me dashje a pa dashje, nga ana tjetër, në vitin 2004, me rastin e 100-vjetorit të vdekjes së autorit të tyre, dijetarit të madh, Sami Frashërit, të gjitha këto vepra i përktheva në gjuhën shqipe të plota, ama pa hequr asnjë fjali a paragraf nga origjinali, duke menduar se vetëm kështu mund të kuptohen drejt konceptet e Samiut.⁴ Tani lexuesi shqiptar e ka më lehtë të gjykojë vetë.

Qëllimi i këtij punimi, megjithatë, nuk është për të polemizuar me askënd, por, duke u mbështetur në veprën e Samiut, të vihet në spikamë në mënyrë objektive mendimi që ka shfaqur Samiu ndaj Fesë islame dhe qytetërimit të saj; të vihet në dukje nëse Samiu në shkrimet e tij lidhur me Islamin dhe qytetërimin e tij ka përdorur taktikë për të arritur ndonjë qëllim tjetër apo këto mendime e qëndrime i ka shfaqur me bindje të thellë, duke u mbështetur në objektivitetin shkencor dhe në përvojën e provat e së kaluarës historike. Janë këto disa nga çështjet që duhet të shtrohen drejt, ashtu siç meriton dijetari ynë i madh, Sami Frashëri. Dhe ne, vërtet, lidhur me këto nuk dëshirojmë të themi asgjë më tepër, por vetëm atë që e gjejmë në veprat e tij.

Pohimi i Çollakut se “...nga gjithë krijimtaria e tij (e Samiut - M.P) që njohim deri më sot nuk ka asnjë punim apo ndonjë shkrim të veçantë kushtuar problemit të fesë”⁵ është fare i pambështetur, sepse Samiu, qëndrimin e tij ndaj Fesë islame dhe qytetërimit të saj, përveç që e shpreh në veprat e përmendura më lart: *Qielli, Toka, Njeriu, Përsëri njeriu, Mitologjitë*, pastaj në *Kamus al-a'lam* dhe në vepra të tjera, sa herë që e ka dashur puna, ai do të shkruajë dy vepra të veçanta:

⁴ Veprat e sipërpërmendura të përkthyer prej meje, të botuar në serinë e veprës së Samiut nga SHB Logos-A, Shkup, 2004 (gjithsej 20 vëllime) kanë këtë radhitje: Qielli (nr. 16), Toka (nr. 17), Njeriu (nr. 18), Përsëri njeriu (nr. 19), Mitologjitë (nr. 20).

⁵ Shaban Çollaku, vep. e cituar, f. 173.

*Medeniyyet-i Islamiyye*⁶ dhe *Himmetu-l Himam fi neshri-l Islam*⁷ në të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë trajton tema të ndryshme shumë të rëndësishme të kësaj fushe. Këto dy vepra mund të konsiderohen si një vepër e vetme sepse, pa dyshim, për nga tematika e tyre plotësojnë njëra-tjetrën. Veprat nuk janë aq të vëllimshme, por gjithsesi kanë vlerë të lartë, sepse Samiu, i pajisur me kulturën e gjerë të Islamit dhe qytetërimit të tij, nga njëra anë, dhe të qytetërimeve të tjera,⁸ nga ana tjetër, me mjeshtërinë e tij enciklopedike, diti t'i kapë problemet më të rëndësishme dhe më të ndjeshme, të vlefshme jo vetëm për kohën e tij por edhe për sot e për gjithmonë. Është e pamundur të përfshihen të gjitha temat e trajtuara nga Samiu lidhur me Islamin dhe qytetërimin e tij brenda këtij punimi, prandaj do të përpiqemi të bëjmë një përzgjedhje të tyre, me shpresë se edhe përmes tyre do të mund të nxjerrim përfundimin se në ç'masë e në ç'shikallë ka qenë qëndrimi i Samiut lidhur me Fenë islame dhe qytetërimin e saj. Pa u zgjatur, të shohim së pari për vlerat e Islamit, ku i shihet Samiu ato vlera.

Për këtë temë Samiu ishte shumë i qartë. Le t'i referohemi veprës së tij: “Me paraqitjen e Islamit njerëzimi përfitoi, sepse ndaloi gjëra të çuditshme të zakoneve pagane, për shembull, djegien e grave të veja pas vdekjes së bashkëshortit”⁹ – thotë Samiu, për të vazhduar: “Kudo që lind drita e Islamit, aty zhduket mosbesimi, pikërisht sikur bora nën nxehtësinë e Diellit në pranverë dhe me atë freski lulëzojnë lulet e diturisë, mirësisë e drejtësisë. Në këtë mënyrë, zbukurohet vendi dhe lartohet integriteti i njerëzve. Ata marrin pamjen e një njeriu të përsosur. Kjo edhe është njëra nga përbërëset e Islamit dhe fryteve të besimit, thotë Samiu. Kështu, vazhdon ai në veprën e tij *Përpjekjet e*

⁶ Sami Frashëri, Vepra 10, Qytetërimi islam, 1999, Prishtinë (bot. parë); Logos-A, 2002, Shkup (bot. i dytë); Logos-A, 2004, Shkup (në këtë seri mban numrin 13). E përktheu nga gjuha turke-osmane Mehdi Polisi.

⁷ Sami Frashëri, Përpjekjet e heronjve në përhapjen e Islamit, Logos-A, 2004 Shkup (mban numrin e serisë 12). E përktheu nga gjuha arabe Ismail Ahmedi.

⁸ Në revistën kulturore, shkencore dhe artizanale të tijën “Hafta”, Samiu shkruan një artikull të gjatë për historikun e qytetërimit, në tri numra të saj: nr. 9, f.128; nr. 10, f. 145-149; nr. 161-165.

⁹ Sami Frashëri, Përpjekjet..., f. 22.

hernjve në përhapjen e Islamit, një popull pagan, pjesëtarët e të cilit ishin të zhveshur nga vlerat njerëzore, hanin mishin e njeriut, jetonin në luftë nëpër male sikurse kafshët, vrisnin të huajin dhe udhëtarin për t'i ngrënë, bënë prostitucion, jepnin nderin e bashkëshorteve dhe bijave të tyre, nuk punonin e as fitonin, por vidhnin e grabitnin; ishin aq shumë të ndyrë sa që ai që i shihte, doemos i urrente dhe ikte prej tyre. Mirëpo, pasi pranuan Islamin, thotë Samiu, ndryshuan dhe kështu ndryshoi mendësia e tyre. Tashmë janë njerëz që bëjnë jetë të qytetëruar, të pajisur me vlera të mirësisë dhe edukatës, janë të zotët e nderit dhe bujarisë, kujdesen për të huajin dhe udhëtarin; e nderojnë mikun dhe e sigurojnë jetesën nga dora e tyre; bëjnë vepra të mira dhe ruhen nga të këqijat; vendoset mirëkuptimi ndërmjet tyre; fillojnë të mësojnë shkrimin e leximin; merren me punë dhe zeje; tash ndërpritet ndyrësira dhe ata janë njerëz të pastër; ai që i sheh në këtë gjendje, vazhdon Samiu, do t'u ketë lakmi. Ndërkaq, ata që i kanë parë përpara se ta pranonin Islamin, thotë Samiu, do të mohonin që këta janë po ata njerëz, të cilët i kishin parë dikur. Ata duken sikur të ishin errur kafshë, por janë gdhirë njerëz. Për Allahun, pohon Samiu, kjo s'është tjetër, përveç një mrekulli e madhe nga mrekullitë e Islamit.”¹⁰

Për t'i përforcuar këto ide të paraqitura këtu dhe për t'ia bërë me dije opinionit se kjo që po e thotë këtu është realitet, Samiu shprehet: *“Këtë gjendje nuk jemi duke e shtuar e as zmadhuar, në mënyrë që të dëshmojmë lartësinë e fesë sonë, por kjo është një e vërtetë e madhe, të cilën nuk mund ta mohojnë të pafetë.”*¹¹ Në vazhdim Samiu citon fjalët e një dijetari anglez, pjesëmarrës i një ekspedite në ato vise të largëta, i cili thotë: *“Vërtet Islami është fe që pastron tokën nga idhujt dhe idolet. Ndalon prerjen e njeriut dhe ngrënien e mishit të tij. Garanton të drejtat e grave. Kufizon poligaminë në caqe të përligjura dhe logjike...”*¹²

Temë tjetër shumë e rëndësishme të cilën e trajton Samiu në veprën e tij në mënyrë mjaft bindëse është mënyra e përhapjes së Fesë

islame dhe e qytetërimit të saj. Lidhur me përhapjen e Islamit Samiu thotë se ai është përhapur kryesisht vetvetiu, pa përdorimin e forcës dhe pa përdorur misionarë e misione të organizuara, e kjo është plotësisht në përputhje me parimet e tij. Këtë e argumentonte me faktin se shumë vende, si p.sh., në Afrikën e Ekuadorit, në Ujdhesat e Paqësorit etj., në të cilat, ndonëse nuk kanë qenë asnjëherë nën juridiksionin e shtetit islam, Feja islame është shtrirë dhe shtrihet gjithnjë e më tepër. Përhapja e Islamit në mënyrë vullnetare sipas Samiut është një argument i qartë dhe dëshmi e prerë, se mbrojtës i Islamit të vërtetë është Allahu i Lartmadhërishtëm dhe Pejgamberi i Tij. *“Allahu i Lartmadhërishtëm, thotë Samiu, për ta përhapur fenë në çdo kohë ndër besnikët e Tij, krijoi disa mënyra dhe mënyra më e suksesshme për këtë kohë është udhëzimi e informimi.”*¹³ E për sa i përket përhapjes së qytetërimit islam në mënyrë të menjëhershme dhe me lehtësi të madhe, pra duke mos kundërshtuar, duke mos sakrifikuar jetë dhe duke mos krijuar vështirësi e fatkeqësi Samiu e argumentonte me faktin se ai mbështetet pikërisht në Fenë islame, në mësimet e Kur'anit, i cili urdhëron kërkimin e diturisë, të shkencës e së vërtetës dhe është udhërrëfyes i qytetërimit, i drejtësisë dhe i zbatimit të saj; në shembullin e Pejgamberit a.s. i cili në mënyrë urdhëruese thotë: *“Kërkoni diturinë nga djepi deri në varr”* dhe *“Kërkoni diturinë qoftë dhe në Kinë.”*¹⁴ Jo vetëm kaq.

Sami Frashëri pikëpamjet e tij për Islamin dhe qytetërimin islam do t'i çojë edhe më tutje. Në kohën kur jetoi dhe veproi ai, qarkullonte teza e identifikimit të “qytetërimit islam” me “qytetërimin arab”. Kjo tezë që mbretëronte te një grup i dijetarëve evropianë për Samiun ishte e papranueshme. Ai këtë e argumentonte me faktin se qytetërimi islam është fryt i Fesë islame dhe është paraqitur bashkë me shfaqjen e Islamit dhe nuk është prodhim mendor dhe përpjekje e popullit arab, sepse po të ishte ashtu, arabët edhe para Islamit, thotë Samiu, do të duhej të kishin po atë qytetërim. Pastaj, vazhdon Samiu, në përparim-

¹⁰ Po aty, f. 32.

¹¹ Po aty, f. 33.

¹² Po aty, f. 33.

¹³ Po aty, f. 30.

¹⁴ Sami Frashëri, Qytetërimi..., f. 35.

in e qytetërimit islam marrin pjesë të gjithë popujt që e kanë përfaquar Islamin. Ata që dëshirojnë ta quajnë qytetërimin islam qytetërim arab, thotë Samiu, harrojnë se shumica e dijetarëve që i mbajnë për dijetarë arabë, janë joarabë, p.sh., Ibn Sinai është persian, Farabiu është turk, Salahudin Ejubi, kurd etj. Nuk ka dyshim se ata, vazhdon Samiu, do t'i bashkohen mendimit tonë se ai qytetërim është qytetërim islam dhe se të gjithë popujt myslimanë janë pjesëtarë të atij qytetërimi¹⁵ Dhe, vërtet, mendimi i Samiut më vonë pranohet nga pjesa dërrmuese e dijetarëve objektivë europianë. Kjo madje është e vërtetë e pamohueshme, sepse qytetërimi islam tash studiohet nëpër qendrat më të mëdha europiane e botërore.

Sami Frashëri, duke njohur fare mirë qytetërimin islam dhe qytetërimet e tjera, siç u tha edhe më sipër, nuk pajtohet edhe me një grup të dijetarëve europianë, të cilët mendonin se qytetërimi europian është pasues i drejtpërdrejtë i qytetërimit të lashtë grek. Sipas Samiut, edhe qytetërimi i lashtë grek, i cili është i fundit nga qytetërimet e lashta, ashtu si qytetërimet e tjera të lashta të haldeasve, asirasve, babilonasve, midiasve, fenikasve etj., është ndërprerë për një kohë, prandaj periudha kohore 8-10 shekujve, nga ndërprerja e qytetërimit grek e deri në zgjimin e ngritjen e qytetërimit europian, nuk mund të ishte pa qytetërim; nuk mund të besohet që çdo anë e rruzullit tokësor të ketë qenë e fundosur në errësi e injorancë. Po t'u qasemi me vëmendje rrethanave dhe historive të këtyre shekujve, si dhe shumë veprave në të cilat flitet për qytetërimin, do të kuptojmë se në këta shekuj kishte një qytetërim më të plotë dhe më të përsosur se të mëparshmit, që ishte qytetërimi islam¹⁶, do të thotë Samiu. Këtë të vërtetë, vazhdon Samiu, e pranuan dijetarët realistë europianë duke u mbështetur te veprat e përkthyer të qytetërimit islam në gjuhën latine, e cila asokohe ishte gjuhë shkencore e përgjithshme e europianëve. Europeanët pra, dëgjuan dhe mësuuan për herë të parë për dijetarët antikë grekë, për Platonin, Aristotelin, Ptolemeun, Euklidin etj., nga veprat e tyre të përkthyer

¹⁵ Po aty, f. 29.

¹⁶ Po aty, f. 26.

në gjuhën arabe nga dijetarë islamë. Kjo, pohon Samiu, është një e vërtetë që është dëshmuar sot me anë të historisë dhe për këtë nuk mund të ketë ndonjë kundërshtim, dyshim a luhataje.¹⁷

Për të nxjerrë në shesh shkallën dhe thelbin e qytetërimit islam në shekujt e parë nga paraqitja e Islamit, Samiu thotë se duhet sqaruar e shpjeguar se në çfarë gjendje ndodheshin secila nga llojet e diturive dhe shkencave të popujt islamë; duhen shpjeguar e sqaruar shkurtimisht veprat kryesore të dijetarëve të shquar që janë marrë me fusha e disiplina të ndryshme të dijes dhe të shkencës, si: në astronomi, në shkencat matematikore, në gjeografi, në shkencat natyrore, në mjekësi, në filozofi, në jurisprudencë, në letërsi, në histori, në mjeshhtëri dhe në zbulime të tjera.¹⁸ Këtu Samiu përmend me qindra zëra që kanë dhënë kontributin e tyre në përparimin e disiplinave shkencore, sa duke shkruar vetë libra, aq duke përkthyer librat e dijetarëve antikë grekë, persianë, indianë etj., duke shpikur vegla e mjete të ndryshme që u shërbenin në punën e tyre shkencore në praktikë. Për shumë shpikje e zbulime shkencore, Samiu thotë se dijetarët islamë janë të parët autorë, e për shumë të tjera thotë se i kanë përmirësuar ato të paraardhësve të tyre.¹⁹ Një gjë që na bie në sy dhe që është shumë e rëndësishme të theksohet, është fakti se këta dijetarë për punën e tyre janë ndihmuar dhe nxitur veçanërisht nga udhëheqësit e tyre: halifët, sulltanët, mbretërit islamë etj. Ata tubonin pranë vetes dijetarët më të shquar nga të gjitha anët e Botës Islame dhe të tjerë, u krijonin kushte të volitshme për punë, duke u ndihmuar në ngritjen e institucioneve të ndryshme, varësisht nga natyra e fushës shkencore, dhe për rezultatet e tyre i shpërblenin me çmimet më të larta. Mjafton të përmendet vetëm Memuni, një nga halifët e Dinastisë së Abasidëve, i cili, siç shkruan Sam-

¹⁷ Po aty, f. 28.

¹⁸ Po aty, f. 40-110.

¹⁹ Një mendim të tillë e gjen edhe në veprën enciklopedike me titullin *Kleine Enzyklopedie-Natur*, Leipzig, 1961. (Sipas H.Z. Bakiut, Sami Frashëri, Vepra 8, Prishtinë, 1984, f. 161/2.

iu, veprat e dijetarëve i vinte në peshojë dhe peshën e tyre e paguante me ar.²⁰

E këtyllë qe Bota Islame gjatë 8-9 shekujve të parë. Pra, ndërsa bënin gara në dituri, në shkencë, në zbulime e shpikje, ndërkohë udhëhiqeshin nga parimet e pastra islame, shkruan Samiu, - ajo përparonte në çdo anë të botës dhe në çdo fushë të jetës njerëzore. Duke u përhapur në anë të ndryshme të botës: në Azi, në Afrikë, në Europë, ajo shpëtoi shumë popuj nga terri dhe injoranca²¹, thotë Samiu.

Përfundim

Në bazë të mënyrës së të shprehurit dhe aq më tepër në bazë të argumenteve që paraqet Samiu lidhur me Islamin si fe tolerante, si fe që ngrii dhe përsosi dinjitetin njerëzor, si fe që shpëtoi nga terri e injoranca shumë popuj anekënd botës, si fe që ndriçoi mendjet e shumë popujve, si fe që përkrah pa rezervë shkencën dhe diturinë, si fe që kërkon nga ithtarët e vet mirësi dhe drejtësi, si fe që kërkon unitet e jo përçarje etj., i japim vetes të drejtë të themi pa luhatje se Sami Frashëri ka pasur bindje të tillë ndaj Islamit dhe qytetërimit të tij. Prandaj, nuk mund të pajtohemi në asnjë mënyrë me ata zëra që shtrembërojnë pikëpamjet e Samiut lidhur me Islamin dhe qytetërimin e tij.

²⁰ Sami Frashëri, Qytetërimi..., f. 38.

²¹ Po aty, f. 30.

Mehdi Polisi

THE POSITION OF SAMI FRASHËRI TOWARDS ISLAM AND ITS CIVILIZATION

(Summary)

Many works have been written on the contribution of Sami Frashëri in the field of Islam. The reasons that made me turn to this subject were manifold, of which I will mention the following two:

Firstly, the knowledge of Sami Frashëri in the field of Islam is very profound;

Secondly, there are voices which, when speaking about the views and opinions of Sami Frashëri regarding Islam, are prejudiced. This is probably due to the influence of the current political and ideological circumstances, which are unacceptable to science.

مهدي بوليسي

موقف سامي فراشيري من الاسلام و مدنيته

(خلاصة البحث)

عن مساهمة سامي فراشيري في مجال الاسلام لقد كتبنا من قبل و الاسباب التي جعلتني اعود إلى هذا الموضوع هي عديدة و من اهمها الاثنان.

أولاً: لان معلوماته الموسوعية في المجالات الاخرى و العلوم الاسلامية هي عميقة إلى ذلك الحد حتى يمكن أن يجد الانسان في كل مراجعة شيئاً جديداً.

ثانياً: هناك اصوات و افراد عندما يتكلمون عن آرائه يتحدثون باحكام مسبقة و يولونها تأويلات أخرى تحت تأثير الظروف السياسية و الايدلوجية و التي تعد

غير مقبولة من الناحية العلمية.

KUMTESA

Rrezehana Hysa

KONTRIBUTI I SAMI FRASHËRIT NË KULTURËN DHE QYTETËRIMIN ISLAM

Disa fjalë mbi jetën dhe veprën e Sami Frashërit

Sami Frashëri në literaturën e huaj është i njohur si Shemsedin Sami Frashëri,¹ ishte ideator i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Filozof, iluminist, shkencëtar, erudit me përmasa ndërkombëtare, personalitet i shquar i shkencës, njëri ndër intelektualët më përparimtar të Ballkanit në atë kohë. Është autor i projektit të parë të sistemit të arsimit kombëtar shqiptar.²

Sami Frashëri u lind më 1850. Mësimet e para i mori në vendlindje nga myderriz Mahmud efendi Tetova. Pas vdekjes së të atit, bashkë me anëtarët e familjes u vendos në Janinë, ku vazhdoi mësimet. Shtatë vjet i vijoi mësimet në gjimnazin “ZOSIMEA”³, ku i përfundoi në vitin 1871. Aty mori arsim dhe kulturë perëndimore (iluministe). Në

¹ Sami Frashëri, vepra 8, Prishtinë, 1978, faq.15.

² Hajrullah Koliqi: “Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar”, Prishtinë, 2002, faq.279.

³ Zosimea u themelua në vitin 1828 në Janinë (kryeqendër e Toskërisë), ishte shkollë treklasëshe pastaj katërklasëshe. Jëpnin mësim profesorë nga Franca, Italia, Gjermania dhe Austro-Hungaria. U arsimuan shumë personalitete të Rilindjes Kombëtare si Jani Vreto, Kostandin Kristoforidhi, Naim dhe Sami Frashëri etj. (Po aty faq.144-145).

vitin 1872 shkoi në Stamboll, ku filloi të punojë në Drejtorinë për Botimin e Librave. Aty i themeloi njohuritë e tij shkencore dhe u bë veprimtar i shquar i shkencës dhe kulturës turke dhe asaj shqiptare. Shkroi rreth 50 vepra letrare leksikografike, filologjike, didaktike, shkencore-natyrore, historike, politike etj. U mor edhe me përkthime. Shumicën e veprave e shkroi në gjuhën turke dhe në gjuhën shqipe.⁴

Sami Frashëri ishte pionier i gjuhës dhe i letërsisë turke në përgjithësi. Ishte i pari që e shkëputi gjuhën turke nga osmanishtja. Sipas tij, gjuha turke është më e vjetër se gjuha osmane. Shkroi romanin e parë në turqisht, me titull “Taasaku Tal’at ve Fitnat (Dashuria e Talatit me Fitneten 1872); pastaj “Emsal”(Fjalë të urta, 1879), me 2919 fjalë të urta. Hartoi Fjalorin turqisht (Kamus-i Turki, 1901), vepër e cila konsiderohet si vepra më e mirë e këtij lloji, deri sot në Turqi. Në vitin 1884 themeloi “Bibliotekën e Xhepit”(Cep Kutuphanesi) në Stamboll, ku botoi disa broshura. Shkroi disa abetare e tekste të tjera shkollore si: “Abetarja e vogël” (e turqishtes) “Konjugacioni i arabishtes”, “Abetarja turke sipas metodës së re”, “Rregullat e morfologjisë arabe”, “Rregullat e sintaksës arabe”. Ndërkaq, vepra më madhore e Samiut është “Kamusu l’A’lam” (Enciklopedia historike e gjeografike, 1889-1898) në gjashtë vëllime. Ishte bashkëpunëtor ose botues i shumë gazetave-revistave turke si: “Siraç” (Feneri), “Hadika” (Kopshti), “Sabah”(Mëngjesi) etj, por njëkohësisht përktheu edhe disa vepra si “Të mjerët”, e Viktor Hygos, “Historia e shkurtë e Francës”...⁵etj.

Shumë e rëndësishme është edhe veprimtaria e tij botuese në gjuhën shqipe me veprat: “Gjuha shqipe”, “Dheshkronja”, “Alfabetarja e gjuhës shqipe”, (Konstadinopojë 1879), pesë artikuj në revistën “Drita”-“Dituria”, “Abetare e gjuhës shqipe”, (Bukuresht, 1886 dhe tri botimet e tjera 1888, 1900, 1909. Pastaj vepra “Shkronjëto e gjuhës shqipe”, (Bukuresht, 1886), gramatika e parë e botuar në gjuhën shqipe, me të cilën Samiu i hodhi bazat e gramatologjisë shqiptare. Vepra “Shqipëria ç’ka qenë ç’është dhe ç’do të bëhet”, (Bukuresht 1899),

⁴ Hajrullah Koliqi, v.p. e cituar, faq.280.

⁵ Po aty. faq.281.

ribotuar edhe dymbëdhjetë herë të tjera në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja etj.

Sami Frashëri vdiq më 5 qershor 1904 në Stamboll. Me rastin e vdekjes së tij, gazeta “Drita”, shkruante:

“Sa dëm i madh, sa e keqe
Mynxyrë për kombin shqiptar”⁶

Sami Frashëri dhe roli i tij në “Shoqëria e të shtypurit të shkronjave shqip”, në Stamboll

“Shoqëria e shkronjzave”⁷ ishte një klub i vërtetë i dijetarëve e shkrimtarëve shqiptarë, njëri më talent se tjetri si: Hoxhë Tahsini⁸, Pashko Vasa⁹, Jani Vreto etj., qëllimi i së cilës ishte përhapja e arsimit dhe e diturisë në gjuhën shqipe me anë të librit, gazetës, shkollës etj. Në krye të kësaj shoqate u zgjodh Sami Frashëri, më i riu në moshë, por me siguri më i denji për nga zjarri i patriotizmit dhe gjerësia e diturisë, autor i shumë veprave të mëvonshme letrare, politike, filozofike, shkencore në gjuhën shqipe, turke dhe arabe.

Detyrë urgjente e kohës ishte krijimi i vlerës dhe i shkrimit të saj alfabetik, prandaj të gjithë patriotët dhe dijetarët e kësaj shoqërie u angazhuan për krijimin e një alfabeti dhe një abetareje në gjuhën shqipe, e njohur me emrin “*Alfabetarja e Stambollit*”, me anë të së cilës do të hartoheshin libra shqip, që do të ndikonin jo vetëm në përhapjen e arsimit dhe diturisë te populli shqiptar, por njëkohësisht do të boto-

⁶ Hajrullah Koliqi (Për këtë shih më gjerësisht në punimin e akademik Jashar Rexhepagiqit: Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes Kombëtare, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosoves, Prishtinë, 1995, faq.107-177).

⁷ Kjo shoqëri u themelua 2 vjet pas themelimit të “Komitetit Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare”, ku Samiu ishte një ndër organizatorët e saj.

⁸ Hoxhë Tahsini, dijetar i gjithanshëm në fusha të ndryshme të shkencave natyrore si: astronomi, matematikë, fizikë, kimi, gjeologji, rektor i parë i Universitetit të Stambollit, një ndër personalitetet që Samiu kishte respekt të veçantë, bile thuhet që për shumë probleme edhe e konsultonte atë. (Sami Frashëri: “vepra 9, Shkup, 1994, faq.76-77).

⁹ Pashko Vasa, diplomat, burrë shteti, shkrimtar, publicist, orator, historian jo i zakonshëm etj.

heshin shumë tekste që do t’i shërbenin hapjes së shkollave të para kombëtare shqipe.¹⁰

Abetarja e gjuhës shqipe apo e quajtur ndryshe “*Abetarja e Stambollit*” ishte e para abetare shqipe me një alfabet unik, e cila u prit me entuziazëm të madh nga të gjithë bashkëkohësit e tij.

Abetarja përmban lëndë të ndryshme për mësimin e gjuhës shqipe, për zgjimin, atdheadashurinë dhe disa mësim të aritmetikës së thjeshtë, për nevojat e atyre që nuk kishin mundësi të vazhdonin shkollimin. Dy pjesë janë të shkruara nga Samiu: “*Gjuha shqipe*”, ku përcakton dhe shpjegon ç’është kombësia dhe “*Dheshkronja*”, në të cilën i tregon kombit shqiptar kufijtë dhe bukuritë e vendit të tij.¹¹

Gazeta “Drita”-“Dituria” dhe kontributi i Sami Frashërit

Mjet i pazëvendësueshëm i luftës ideologjike në rrethanat e atëherëshme ishte gazeta. Me anë të saj mund të merrnin informacione një numër i madh atdhetarësh shqiptarë në një kohë sa më të shpejtë. Prandaj, Samiu dhe atdhetarët e tjerë bënë përpjekje për hapjen e gazetës “Drita” (1884), e cila pas disa numrash u mbyll dhe ridoli me emrin “Dituria” me gjithsej 12 numra.

Përvoja e Samiut këtu nuk ishte e rastit, ngase ai qysh më parë ishte marrë me botimin dhe drejtimin e disa gazetave dhe revistave në gjuhën turke. Kësisoj, kultura së bashku me atdhetarizmin e tij, luajtën një rol të madh në organizimin dhe mbarëvajtjen e këtyre gazetave. Në artikujt e gazetës, “Drita” dhe “Dituria” paraqitet si një propagandist i flaktë i iluminizmit, si një luftëtar i qytetërimit dhe progresit.¹²

Dituria për të është një tipar dallues që lartëson njeriun, e përcakton fizionominë e shoqërisë dhe shërben si kriter për të matur nivelin e arritur prej saj. Ai është i mendimit se dituria me nivelin më të lartë të zhvillimit nuk fitohet vetvetiu, por për t’u përvetësuar ajo ka

¹⁰ Mësonjtorja e Korçës u hap më 1887 me iniciativën dhe përpjekjen e Samiut, Naimit, Vretos, punoi me tekstet e tyre, mbeti gjallë dhe u konsolidua me përpjekjet dhe ndihmën e tyre.

¹¹ Sami Frashëri: vepra 8, Prishtinë, 1978, faq.14.

¹² Zija Xholi: “Mendimtarë të Rilindjes Kombëtare, Tiranë faq.319-325.

nevojë për libra, mësues dhe shkolla. Ndërsa në paditurinë sheh shumë të këqija dhe më të madhen prej tyre egërsinë.

Ndërkaq, sa i përket kulturës arabe, si njohës i mirë i saj, Samiu nxjerr në pah vlerat dhe tregon vendin e veçantë të saj në historinë e kulturës botërore, si një kulturë që ka dhënë kontribut në shumë degë të shkencës dhe teknikës së kohës, si një kulturë që shpëtoi nga harresa dhe ua transmetoi europianëve shumë monumente të kulturës së lashtë greke. Kësisoj, si përfaqësues më të denjë të kësaj kulture për atë janë: Ibn Sina (Avicena)¹³, Ibn Rushdi (Averroes)¹⁴ etj.¹⁵

Vepra “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”- traktat i Rilindjes Kombëtare Shqiptare

Ky libër u botua më 1899 në Bukuresht, pa emër. Traktati në fjalë u bë manifestim i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, vepra që sintetizoi programin e lëvizjes dhe krijimin e shtetit (jo në kufijtë aktualë), strategjinë dhe traktatin e saj, e cila për shkak të karakterit dhe përmbajtjes, në rrethana të ndryshme shoqërore, pati baticë dhe zbaticë, rënie e ngritje në ditët e sotme, pikërisht në fund të shekullit të XX bëhet akoma më aktuale, më e fuqishme¹⁶. Vepra u botua edhe dymbëdhjetë herë të tjera në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja. Në të u shprehën ideat demokratike të zhvillimit politik e shoqëror të vendit, të zhvillimit, të kulturës e të shkencës¹⁷.

Në kuadër të projektit “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet” projektoi **sistemin arsimor kombëtar shqiptar** me mësim në gjuhën shqipe, në të gjithë shkallët e shkollimit, unik, demokratik, shtetëror dhe pa pagesë. Këtu parashikonte *shkolla fillore* për djem dhe vajza (7-13-vjeç) të obliguara, prandaj ato duhet të hapen në çdo qytet dhe fshat.

¹³ Në Europë është i njohur me emrin Avicena.

¹⁴ Po ashtu edhe ky në Europë është i njohur me emrin Averroes.

¹⁵ Po aty...

¹⁶ Sami Frashëri: “Qytetërimi Islam” Shkup 2002.

¹⁷ AASH: “Fjalor enciklopedik shqiptar” Tiranë, 291.

Në krahinë (qark) parashikon të hapen edhe shkolla të mesme (shkolla të treta), si gjimnaze dhe shkolla profesionale si vazhdimësi e gjimnazit të ulët, për djem dhe vajza veç e veç. Në kryeqytetin e Shqipërisë planifikoi të ketë një shkollë ushtarake, një për metale, një për pyje, një për bujqësi etj. Planifikonte që në Shqipëri të themelohen 3 universitete dhe atë: një në kryeqytetin e Shqipërisë, një në Shqipërinë e sipërme dhe një në Shqipërinë e poshtme. Ai parashihte edhe hapjen e një shkolle të marinës detare në Durrës apo afër Vlorës, pastaj edhe dy shkolla të mëdha, (njëra për mësimin e gjuhëve të reja dhe tjetra për mësimin e gjuhëve të vjetra të Europës).

Samiu tregoi interesim edhe për arsimimin e pjesëtarëve të popujve joshqiptarë, që jetonin në vilajetet shqiptare.

Në këtë projekt parashikoi edhe themelimin e Këshillit të diturisë (akademisë), themelimin e një shtypshkronje, shoqata profesionale për gjeografi (dheshkronjë), për histori, për xehetari (dhëkërkonjë), themelimin e një muzeu, një biblioteke etj. Në krye të sistemit të arsimimit diturisë parashikonte ngritjen e **Ministritë së Diturisë**¹⁸

Vështrim rreth “Kamusu-l-A’lam” të Sami Frashërit

Është enciklopedi historike-gjeografi, që konsiderohet vepra më vëllimore dhe më e rëndësishme e Samiut, e shkruar në gjuhën turke të asaj kohe me alfabet arab, që përmban gjithsej 6 vëllime apo 4830 faqe. E botuar brenda viteve 1889-1898. Vëllimet e para u botuan brenda vitit, kurse vëllimet e tjera në çdo 2 vjet, përveç vëllimit të katërt që u botua 3 vjet pas të tretit. Titullin e saj e shkroi në gjuhën frënge “DICTIONARE UNIVERSEL D’HISTOIRE ED GEOGRAPHIE”, kurse emrin e vërtetë e shënon të plotë, Sami Bej Frashëri.

Ndër çështjet kryesore që i parashtrou Samiu në parathënien e vëllimit të parë, e cila ishte e përbërë prej 8 faqe e gjysmë, ishte rëndësia e dy disiplinave shkencore - historisë dhe gjeografisë, kontributi i ditëtarëve të parë islamë në këto shkenca dhe njëkohësisht këtu shkruan

¹⁸ Sami Frashëri: Vepër e cituar...

edhe për veprimtarinë e Sulltan Hamidit, edhe pse e urrente nga zemra.

Ai çmoi të gjitha shkencat dhe disiplinat shkencore, ndërsa historinë dhe gjeografinë, si shkenca mjaft tërheqëse, i konsideronte si të domosdoshme, për arsye se njeriu si qenie intelektuale, dëshiron të ketë njohuri mbi gjendjen e planeteve të largëta dhe të afërta, mbi rrethanat e rruzullit tokësor, mbi të kaluarën e gjyshërve dhe stërgjyshërve të tij dhe njëkohësisht mbi ngjarjet më të rëndësishme të popullit të tij.

Ndër dijetarët e parë islamë, që janë marrë me këto shkenca, sipas tij, janë: Hatib Bagdati, i cili shkroi për historinë e Bagdatit mbi 50 vëllime të mëdha, kurse Ibni Asakiri për historinë e Damaskut shkroi plot 57 vëllime (histori); Astrahiu, Makdisiu, Bekriu, Ibni Hukali etj., të cilët janë të parët, që do të thotë, se veprat e tyre historike dhe gjeografike i shkruan sipas rendit alfabetik.

Të metat e këtyre veprave ai i shihte në atë se janë shkruar shumë gjerësisht dhe me shumë vështirësi shfrytëzohen, ngase kur duhet të dijë dikush mbi biografinë e një personaliteti ose mbi aspektin gjeografik të ndonjë vendi, qyteti, kasabaje, lumi a mali duhet të shfrytëzojë dhe shfletojë tërë ato vëllime derisa të arrijë tek ajo që u intereson lexuesve. Për këtë arsye ai, me sy kritikë, theksonte se duhet hartuar një fjalor historik të mirëfilltë, duke marrë si shembull veprën e Ibni Halikanit.¹⁹

Ndër epërsitë e këtyre veprave të dijetarëve islamë përmendet vepra e Jakut Hameviut "Muxhem el buluan", që e konsideroi një fjalor të mirëfilltë gjeografik, ndërsa për veprën e Vustenfeldit, dijetar dhe orientalist gjerman, vepra e të cilit u botua në Lajpcig të Gjermanisë, thuhet se i bëri një shërbim të madh shkencës arabe.

Ideja dhe dëshira për ta shkruar këtë enciklopedi të famshme i kishte lindur qysh herët, ndërsa arsyeja kryesore e Samiut për botimin e kësaj vepre madhore ishte se në fjalorët gjeografikë dhe historikë të botës perëndimore flitej dhe shkruhej më shumë për personalitete,

¹⁹ Historian i njohur arab (1211-1272), mësimdhënës, krykadi, që veprat e tij u botuan në Gjermani dhe të përkthyer në shumë gjuhë të tjera të Europës.

ngjarje dhe probleme që u interesonin dhe ishin në favor të perëndimorëve, dhe shumë pak për të tjerët. Edhe pse gjatë hartimit të saj, atij i është dashur të shfrytëzojë qindra libra të lënë në pluhur nga bibliotekat të vendeve të ndryshme për të zbardhur dhe nxjerrë në dritë ngjarje dhe personalitete të kohërave dhe kategorive të ndryshme shoqërore si: sulltanë, mbretër, vezirë, imamë, historianë, gjeografë, mjekë, filozofë etj., pastaj perandori, dinasti, mbretër, anekënd botës, duke filluar që nga Ballkani, Europa, Azia, Afrika, Arabia, e deri në Zelandën e Re, gjë që për hartimin e saj i janë nevojitur plot 11-12 vjet.²⁰

Për Shqipërinë dhe shqiptarët, do të thotë, për vendin e tij, ai u ndal më gjerësisht, shkroi gjëra që në të vërtetë nuk mund t'i gjesh në enciklopeditë e tjera, dha shpjegime për territorin e Shqipërisë, për kufijtë e saj, për malet dhe fushat, për lashtësinë e popullit të tij, për virtytet pozitive morale që i posedonin shqiptarët; si nderi, drejtësia, sinqeriteti, zgjuarsia, besnikëria, trimëria, pastaj për doket dhe zakonet e stërgjyshërve të tyre, virtytet e të cilëve nuk i kanë ndryshuar edhe sot e kësaj dite, dha shënime biografike për shumë personalitete nga mbarë trojet shqiptare, shumica e të cilëve për fatkeqësinë më të madhe kishin mbetur të panjohur për opinionin më të gjerë si Skënderbeu, Hoxhë Hasan Tahsini, Ali Pashë Tepelena, Dora d'Istria (Elena Gjika), Abdyl Frashëri, mbi 25 kryeministrat shqiptarë në Perandorinë Osmane etj.

Për shqiptarët Samiu shkroi se janë një komb që banojnë në anën perëndimore të Rumelisë, do të thotë, në Gadishullin Ballkanik, ku shumë studiues europianë duke e parë dhe duke e studiuar historinë e kombit shqiptar, që për shumë shekuj kishte mbetur enigmë, kanë vërtetuar se kombi shqiptar është njëri nga degët më të lashta të kombeve të Azisë dhe Europës, të quajtur "ARIA", dhe se gjuha shqipe nuk është degë e gjuhëve latine, greke e sllave, por degë e drejtpërdrejtë e gjuhës së vjetër *ariane* dhe se ky komb ka ardhur kryesisht nga Azia Qendrore në Europë sikur kombet e tjera të lashta **arianë**. Emri i

²⁰ Sami Frashëri, vepra, IX, Rilindja, Prishtinë, 1994, faq.10-18.

shqiptarëve në atë kohë ka qenë *pellash* (*pellazg*), ku thuhet se është marrë nga fjala shqipe “plak”.²¹

Pellazgët, do të thotë, shqiptarët e lashtë, kanë qenë të ndarë në 4 degë kryesore:

1. Ilirët - ishin të përhapur që nga kufiri i Greqisë së vjetër deri në pikën më veriore të Adriatikut, do të thotë, në Shqipërinë e tanishme, Bosnjë e Hercegovinë dhe Dalmaci.
2. Maqedonasit e lashtë - banonin në pjesën e Maqedonisë që shtrihet nga mali Pidos dhe Sharr e deri në malin Rodop, lumin Karasu (Karasu në gjuhën shqipe “Uji i Zi”) dhe Detin Egje, do të thotë, në anën e Selanikut, Manastirit, Shkupit, Serezit.
3. Trakasit - banonin në anën e vilajetit të Erenesë, Bullgari, e mbase deri në anën e djathtë të lumit Danub.
4. Frigiasit - ishin të përhapur në pjesët nga bregdeti i Anadollit deri në Ankara dhe Sivas.

Për këta 4 popuj që i përmendëm është argumentuar bindshëm se janë degë të popullit pellazg, por më të afërt siç thuhet si në gjuhë po ashtu në zakone ishin ilirët me maqedonasit në një anë dhe trakasit dhe frigiasit në anën tjetër. Kësisoj historiani i famshëm grek Herodoti, babai i historisë shpjegon lidhjen midis gjuhës frigiase dhe gjuhës shqipe, ku ndër të tjera thuhet se në gjuhën frigiase bukës i thonë *buks* që po t’i hiqet s-ja korrespondon me fjalën shqipe bukë që i themi edhe sot e kësaj dite.²²

Disa nga fjalët e urta të Samiut

Një e arritur spektakulare në serinë e librave të tij ishte edhe libri me fjalë të urta dhe aforizma, i përbërë prej 3000 fjalësh (1879-1880), ku gati gjysma janë krijim i drejtpërdrejtë i tij, ndërsa të tjerat janë adaptim dhe përkthim i autorëve dhe mendimtarëve të Lindjes dhe të Perëndimit në periudha të ndryshme kohore.²³

Fjalët e urta të tij janë një përmbledhje porosish dhe mësimesh, të cilat ndikojnë pozitivisht në përsosjen e njeriut dhe progresin e shoqërisë nëpërmjet atdhedashurisë, punës, diturisë, virtytit etj.

Samiu i trajtoi teorikisht virtytet e larta etike si; besën, nderin, guximin, trimërinë, njerëzinë, të vërtetën, miqësinë, bamirësinë, atdhedashurinë etj., ngaqë vetë ishte shëmbëlltyrë e gjallë e njeriut me tipare të larta morale, me karakter të fortë, intelektual dhe atdhetar i shquar, i cili parimet dhe vlerat morale i zbatoi në praktikë.²⁴

Atdhedashurinë e shihte në disa aspekte, ajo për të ishte një ndjenjë e fuqishme që e ndihmon njeriun të jetojë, të luftojë, të mposhtë çdo pengesë në rrugën e tij, bile e konsideron si një fuqi të mrekullueshme, plot frymëzim që del mbi gjithçka, si ai topi “që shemb këshqjellat më të forta”²⁵, edhe pse sentencat e tij për atdheun mbeten në vlerësime të përgjithshme duke mos hyrë fare në hollësi konkrete se për cilin atdhe është fjala, por përsëri kuptohej se bëhej fjalë për atdheun shqiptar, për Shqipërinë.

Për ngritjen e njeriut dhe të personalitetit njerëzor në përgjithësi komponenta e edukatës intelektuale, (dituria, arsimit, edukata), zë një vend të konsiderueshëm në sentencat e tij. Thëniet si: “*Argëtimi m’i mirë për njeriun është studimi dhe shoku m’i mirë libri*”, “*Kujdesi i njeriut duhet të përqendrohet që në çdo moshë ta stolisë veten me dije*”, “*Fëmija do të mësoj, i riu do ta vërë në praktikë atë që ka mësuar, plaku do të mësojë të tjerë*”, apo “*Anijet lidhin kontinentet, librat*

²³ Sami Frashëri, vepra, IV, Prishtinë, 1978, faq.116.

²⁴ Hajrullah Koliqi: “vepër e cituar”, Prishtinë.

²⁵ Sami Frashëri: “ v.p.e cituar...

²¹ Sami Frashëri, vepra VIII, Rilindja, Prishtinë, 1994 faq.218-219.

²² Sami Frashëri, vepra.IX e cituar...

çojnë idetë nga një shekull në tjetrin”, dhe shumë të tjera paraqesin rolin vendimtar të diturisë, edukatës dhe arsimit në përparimin e gjithmbarshëm të kombit.²⁶

Samiu u bënte thirrje të gjithë shqiptarëve “i madh e i vogël”, të mësojnë, të lexojnë e të shkruajnë gjuhën e tyre shqipe, madje edhe “pa shkollë”. Postulati themelor i tij ishte “*se pa shkolla shqipe dhe pa edukatë solide, pa dijeni dhe kulturë të përgjithshme, kombi shqiptar nuk mund të përparojë*”. Kësisoj, shumica e shqiptarëve për të janë të prirë sidomos për studime dhe për edukatë, prandaj “*Ajo që qeveriste botën nuk është as forca, as ligji, por mirësjellja dhe edukata*”, mendonte ai.²⁷

Plot demokratizim dhe konstatime të drejta janë një varg fjalësh të urta për komponentën e edukatës së punës, ku dalin në pah shumë vlera të saj. Për punën thotë se ajo është domosdoshmëri jetësore e njeriut në çfarëdo rrethane qoftë ajo, është burim lumturie dhe kënaqësie, faktor me rëndësi si në zhvillimin trupor, ashtu edhe në atë mendor të njeriut dhe njëkohësisht i urrente njerëzit dembel dhe parazitë, për arsye se këta të fundit janë të dëmshëm për shoqërinë njerëzore.²⁸

Gruan ai nuk e shihte si një qenie të papërfillur dhe pa vlerë, por atë brenda familjes e shihte si shtyllën e saj, jashtë familjes në shoqëri - një mjet i rëndësishëm në edukimin e brezit të ri, si qytetar të denjë për shoqërinë. Fjala e urtë “*Një shtet i qytetëruar mbështetet në edukatën e gruas*”, dhe shumë të tjera flasin për emancipimin dhe arsimin permanent të gruas në përgjithësi dhe gruas shqiptare në veçanti.

²⁶ Po aty...

²⁷ Hajrullah Koliqi: “v.p e cituar” Prishtinë.

²⁸ Sami Frashëri “v.p.e cituar..

Islami në përgjithësi

Islami nuk është vetëm fe e përjetshme universale, por është ligj dhe sistem, i cili i rregullon të gjitha çështjet e shoqërisë “kushtetutë” e pjesëtarëve të një shteti dhe udhëzimet për ta. Misioni i tij është shpallja e fundit dhe vulë e të gjithë shpalljeve dhe misionëve të mëparshme, ndërsa i dërguari i tij është Muhammedi, lajmëtar dhe vula e fundit e Pejgamberisë.

Feja islame sikurse fetë e tjera, njerëzve u ofron një mundësi të caktuar jetese, mënyrën se si duhet gjetur lumturinë dhe mirësinë në këtë jetë. Për këtë si burim i parë është Kur’ani i madhërishtëm²⁹, ndërsa si burim i dytë hadithet, do të thotë, fjalët dhe porositë e Muhammedit.

Sami Frashëri për qytetërimin islam

Në fushën e Islamistikës Samiu shkroi disa vepra “Qytetërimi Islam”, dhe “Përpjekja e heronjve në përhapjen e Islamit”.

Vepra “Qytetërimi Islam”, është vepra e parë e plotë, e tërësishme, përmbajtësore, e përkthyer në gjuhën shqipe me një vlerë të lartë, sepse Samiu falë njohurive dhe mjeshtërive të tij enciklopedike, diti që një temë shumë të gjerë ta përfshinte e ta përmbledhte në një libër të vogël, duke mos lënë pa përmendur thuajse asgjë të rëndësishme. Me një kulturë të gjerë qytetërimi islam nga njëra anë, dhe qytetërimi i tjerë nga ana tjetër, ai shtroi shumë çështje interesante. Ai mendonte se për të arritur një shkallë të lartë qytetërimi, njeriu duhet të vërë në shërbim mendjen, të punojë vazhdimisht, të mësojë e të zbulojë të

²⁹ Qëllimi kryesor i saj ishte të luftuarit të besimit në shumë zotra, dukuri e çila ishte shumë e përhapur në fiset arabe dhe nëpërmjet tij u vunë themelet e forta të besimit në një Zot dhe njëkohësisht bëri të mundur rregullimin e moralit dhe marrëdhënieve ndërnjerëzore. (dr.Xhemaludin Llatiq: “Bazat e pedagogjisë kuranore”, Prizen faq.4.

vërtetën dhe gjëra të reja të dobishme, të cilat do t'i mundësojnë e t'i sigurojnë mirëqenien e tij dhe të njerëzimit në përgjithësi.³⁰

Sipas tij, qytetërimi Islam është fryt i fesë Islame, i cili është paraqitur bashkë me Islamin dhe nuk është prodhim mendor dhe përpjekje e popullit arab, sepse po të ishte ashtu, arabët edhe para Islamit do të duhet ta kishin po atë qytetërim dhe përparim dhe se në përparimin e tij nuk do të merrnin pjesë edhe popujt jomyslimanë si Ibn Sinai (Persian), Farabiu (turk), Salahuddin Ejupi (kurd).

Qytetërimi Islam, sipas Samiut, ndryshe nga qytetërimet e tjera, ka disa karakteristika të veçanta:

- Nuk është ndërprerë asnjëherë, ndonëse gjithmonë ka pasur tendencë dhe përpjekje të tilla nga misionarë të ndryshëm;
- Nuk është i kufizuar vetëm te një popull a bashkësi;
- U përhap menjëherë dhe me lehtësi të madhe, pra duke mos u kundërshtuar;
- Duke mos u kundërshtuar, sakrifikuar jetë, duke mos krijuar vësh-tirësi e fatkeqësi, sepse mbështetet pikërisht në fenë Islame, në mësimet e Kur'anit kërkimin e diturisë, shkencës e të vërtetës është udhërrëfyes i qytetërimit, i drejtësisë dhe i zbatimit të saj në shembullin e Muhammedit kur thotë: *“Kërkoje diturinë nga djepi e deri në varr”, dhe “Kërkoni diturinë qoftë edhe në Kinë”*.

Për shumë shpikje e zbulime shkencore, dijetarët islamë janë të parët autorë, të cilët të nxitur nga udhëheqësit e tyre: halifët, sulltanët, mbretërit islamë, ku këto të fundit u krijonin kushte të volitshme për punë, duke u ndihmuar në formimin e bibliotekave, laboratorëve, observatorëve, varësisht nga natyra e fushës shkencore dhe për rezultatet e tyre i shpërbenin me çmime më të larta.³¹

Vlerat dhe përhapjen e fesë Islame Samiu i përfaqësoi edhe në veprën *“Përpjekjet e heronjve në përhapjen e Islamit”*, e shkruar në

³⁰ Sami Frashëri: *“Qytetërimi Islam”*, Shkup, 2002, faq.11-19.

³¹ Thuhet se Memunin, një nga halifet e Dinastisë së Abasidëve, veprat e dijetarëve i vinte në peshojë dhe peshën e tyre e paguante me ar.

gjuhën arabe³², vepër, në të cilën ndër të tjera pohoi se paraqitja e Islamizmit bëri kthesë të madhe në shoqërinë njerëzore, zëvendësoi politizmin me monoteizmin, barbarinë me qytetërimin, paditurinë me diturinë, urrejtjen me respektin ndaj njëri-tjetrit, dembelinë me përpjekjet në punë, papastërtinë me pastërtinë, poligaminë me monogaminë, shthurjen familjare me harmoninë familjare, imoralitetin me moralitetin, egoizmin me zemërgjerësinë, nëpërkëmbjen e femrës me barazinë me mashkullin, padrejtësinë me drejtësinë etj.³³

Padyshim këto argumente të pathyeshme bënë që Sami Frashëri, ky dijetar i madh, të shkruajë vepra enciklopedike, gjegjësisht të shprehet aq hapur, qartë e fuqishëm për të gjitha çështjet që i përkasin fushës së Islamistikës.

Jetëshkrimi i Muhammedit a.s.

Muhammedi³⁴ u lind më 20 prill të vitit 570 e.s. në Mekë nga një familje e mesme financiarisht, por me tradita të të qenit lider dhe human. Deri në moshën 15-vjeçare ishte bari delesh. Në këtë periudhë mësoi urtësinë, durimin, aftësinë si të jetë faktor bashkimi, ndërsa prej moshës 15-35 u mor me tregti. Thuhet se ai nuk dinte shkrim-lexim, por kjo nuk ishte mangësi, por mrekulli, ngase ai në të ardhmen do të bëhet lider i njerëzimit.³⁵

Në moshën 25-vjeçare të gjithë do të mendonin se, me gjithë përvojat që kishte fituar, ishte gati për të filluar shpalljen e Kur'anit, por thuhet se akoma nuk i kishte plotësuar kriteret e një Profeti për nje-

³² Samiu këtë vepër e shkroi 6 vjet pas veprës *“Qytetërimi Islam”* që do të thotë se ai ka shkruar në vazhdimësi në fushën e Islamistikës.

³³ Po aty...

³⁴ Emri i plotë i të cilit ishte Muhammed ibn Abdullah ibn Abdul Mutalib, ibn Abdul Mutalib, ibn Hashim, ibn Abdul Menaf, ibn Kusaj ibn Kilab ibn Murre ibn Ka'b ibn Luej ibn Galib ibn Fihir. Me këtë emër e pagëzoi gjyshi i tij. U rit jetim pa prindër sa që shumë herë ishte i detyruar t'i ndërrojë venbanimet, njëherë në shtëpinë e nënës deri sa i mbushi 2 vjet, pastaj pas vdekjes së nënës kthehet në shtëpinë e gjyshit dhe qëndroi aty deri në moshën 8 vjeçare. Ndërsa deri në moshën 25-vjeçare jeton në shtëpinë e xhaxhait.

³⁵ Amër Halid: *“Gjurmëve të të dashurit tanë”* Shkup, 2006, faq. 47.

rëzimin, ngase deri në atë kohë kishte hyrë në kontakt me njerëz të ndryshëm, por të gjithë nga populli i tij. Mesazhi me të cilin do të ngarkohej është për mbarë botën.

Fillimi i shpalljes atij iu bë në moshën 40-vjeçare, ngase në atë kohë kishte fituar tanimë përvoja familjare, ushtarake, paqeje, nga çështjet e jetës sociale etj.³⁶

Mesazhi i tij ishte shumë i vështirë, ngase atij i duhej të takohej me një qenie tjetër, që vinte nga qielli, Xhibrilin, prandaj zemra e tij duhej të ishte e fortë që të përballonte madhështinë e mesazhit.³⁷

Dita në të cilën vdiq Profeti ishte dita e fundit që Xhibrili do të zbresë në tokë. Prandaj, në çastet para vdekjes ai thotë: *“Paqja qoftë mbi ty o i Dërguari i Allahut”*.

Xhibrili nuk do zbresë më në tokë për shpallje të mesazhit të ri, por do të zbresë njëherë në vit, natën e Kadrit.

Misioni më i rëndësishëm i Muhammedit dhe ndër cilësitë më të dalluara të tij ishte edhe ajo e përpjekjes në përsosjen e normave të moralit në zemrat e besimtarëve, ngase nga goja e tij, asnjëherë nuk u dëgjuan fjalë të pavërteta, por gjithherë fjalë të ndershme e të respektuara, të cilat lanë mbresa dhe gjurmë të mëdha në vetëdijen njerëzore, fjalë të cilat e ngritën popullin në shkallën më të lartë të moralit. Edhe pse ata ishin në një dekadencë të përgjithshme dhe jetonin në një errësirë, pa kurrfarë normash morale, shpallja e fundit i nxori ata nga një errësirë dhe i bëri shembull dhe sinonim për të mirë të të gjithë popujt e botës.³⁸

³⁶ Po aty...faq.63.

³⁷ Momenti vendimtar që iu shpall Xhibrili ishte shpella Hira, në majë të një mali në Mekke. Ishte ky vend ku u takua qielli me tokën. Mesazhin të cilin e transmetoi Profeti Muhammed për 23 vite, filloi nga kjo shpellë e vogël. (Po aty...)

³⁸ Naim Tërnavi: "Moraliteti Islam" Prishtinë, 1996, faq.37.

Historiku i Hadithit

Të gjithë atë që Muhammedi i ka thënë në formë të këshillave apo vërejtjeve që disa prej tyre me anë të shembujve i ka punuar dhe zbatuar në praktikë quhet Hadith.³⁹

Hadithet për një kohë të gjatë janë transmetuar gojarisht brez pas brezi. Kësisoj në Damask, kah shekulli VI, u formuan shkollat e para për nxënien e haditheve përmendësh, pastaj më vonë në Kairo dhe në shumë vende të tjera.

Një ndër shkaqet kryesore të transmetimit gojarisht të hadithit ishte se besimtarët në ndërkohë ishin të angazhuar rreth shkrimit të Kur'anit dhe se ekzistonte frika si të Muhammedi po ashtu edhe të tjerët mos ndoshta do të vijë deri aty sa të bëhet ngatërrimi i haditheve me Kur'anin.⁴⁰

Mirëpo, kah fundi i jetës së tij u lejoi disa as-habëve të shkruajnë hadithe, ndërsa pas vdekjes, e sidomos kur Islami u përhap jashtë Gadishullit Arabik, filluan të shkruhen së pari hadithe për vete, por më vonë u ndje nevoja që të bëhet tubimi dhe klasifikimi i tyre. Edhe Halifët që erdhën në krye të shtetit Islam pas Muhamedit si: Ebu Bekri dhe Omeri, në fillim tubuan disa hadithe, por më vonë i dogjën ato, ngaqë kishin drojë se mos do të veprojnë diçka që nuk ka vepruar Muhammedi.

Ndër të parët që morën guxim dhe iniciativë rreth tubimit të haditheve ishte Omer Ibën Adul Azizi, i cili formoi komisionin për verifikimin dhe transmetimin e haditheve, dhe kjo u bë ngase njerëzit filluan t'i ngatërrojnë thëniet e Muhammedit me të shokëve të tij, nga frika se mos vjen deri të humbja e haditheve. Në fund, u bë koleksionimi dhe seleksionimi i haditheve nga një grup dijetarësh të zgjedhur.

³⁹ Sipas kuptimit etimologjik Hadith d.m.th.thënie, vepër, vrytyt, gjë që edhe vetë ai fjalët e tij i quajti kështu.

⁴⁰ Naim Tërnavi: "v.p e cituar", Prishtinë, 1996, faq.11.

Ndërkaq në shekullin III, i cili konsiderohet si më i begatshëm për shkencën e hadithit, u shkruan 6 koleksione si i Buhariut, i Muslimit, Tirmidhiut, i Ebu Davudit, i Ibni Maxhes dhe i En-Nesaiut.⁴¹

Disa hadithe (thënie) të zgjedhura të Muhammedit⁴²

Hadithi i Pejgamberit “Mos i shkruani fjalët e mia...” (Buhariu), shpeshherë ka shkaktuar polemika të ashpra ndërmjet shkencëtarëve të Hadithit, mirëpo studimet më të reja na bëjnë me dije se kjo ndalesë nuk ka vazhduar për njerëzit më të afërt të tij, të cilët kanë ditur të lexojnë dhe të shkruajnë, megjithëse, nuk do të thotë se nuk ka pasur arsye objektive që angazhimi i njerëzve të tij të marrë hov paralelisht me çështjen e shkrimit, mësimin përmendësh dhe të kuptuarit të shpalljes, ngaqë ekziston një grup hadithesh, të cilat për shkak të natyrës së tyre duhet të shënohen... ashtu që shënimet e dokumenteve të tubuara të këtij lloji, që nga koha e tij janë me qindra e qindra faqesh”.⁴³

Nga mozaiku i haditheve madhështore të Muhammedit (a.s.), unë zgjedha disa prej tyre të cilat kanë të bëjnë me aspektin edukativo-arsimor, prej të cilave do të veçonim:

Familja - si qeliza elementare e shoqërisë, është grup mikrosocial, që ka shumë funksione si: edukative, biologjike etj. Për të qenë një familje e shëndoshë, sipas tij, duhet t’i posedojë këto cilësi: dashuri dhe mirëkuptim ndërmjet anëtarëve të saj, grua të mirë dhe të ndershme, për arsye se kjo e fundit është shtyllë e familjes dhe mjet i rëndësishëm për edukimin e brezit të ri, sjellje të mirë ndaj njerëzve dhe jetesa në vendin e saj (813), shumë etikë dhe njerëzorë i konsideron ata burra të cilët sillen mirë ndaj grave dhe femrave në përgjithësi, është ithtar i familjes fisnike dhe me tradita të larta familjare (1718), ndërsa është kundër ndërprerjes së marrëdhënieve familjare (1702) dhe fqinjësore (973). Konsideron se trashëgimia më e mirë për prindërit

⁴¹ Po aty...faq.12.

⁴² Kto hadithe të zgjedhura janë marrë nga libri “Hadithe të zgjedhura të Pejgamberit a.s.” Tiranë 2004.

⁴³ Po aty...

është të edukuarit permanent të fëmijës, dhe këtë e quan më efektive sesa dhënien e mëshirës së të varfërve për çdo ditë (1284). Është pro dhënies së pasurisë si për vajza ashtu edhe për djem (903).

Në kuadër të familjes jep shumë porosi të obligimeve të burrit ndaj gruas dhe e kundërta, si obligim kryesor të burrit ndaj gruas i parashihet: respektimin e gruas në familje dhe jashtë saj, (821), e jo maltretim, të përmbajturit kur ajo ka nevojë, financimin e saj (782). Ndërsa gruaja duhet t’i posedojë këto virtyte pozitive: entuziazmin, dëgjueshmërinë, moralin, mbajtjen e fjalës së dhënë, sjelljen me dashuri e dashamirësi ndaj urdhrave të tij (779), mosneglizhencën e pasurisë (840) etj. Në mënyrë mjaft figurative e paraqet se gruaja, sipas tij, është e krijuar prej brinjëve të shtrembër, maja e së cilës është e lakuar, do të thotë, natyra e saj është mjaft e ndjeshme dhe emotive që po të mundohesh ta drejtosh ajo thyhet dhe po nuk e drejtove ajo lakohet (386).

Muhammedi jep disa kritere që burri duhet t’u përmbahet gjatë zgjedhjes së gruas si: pasuria materiale, origjina, bukuria, besimi (699). Është pro martesës së gruas së ve, por nëse ajo vendos vetë (735), dhe gruan e arsimuar e vë në pedestal (1455), ndërsa është kundër marrëdhënieve intime mes 2 personave të së njëjtës gjini (912).

Edukimi në punë

Për edukimin në punë jepen porosi të shumta. Sipas tij, çdo njeri posedon potencial të mjaftueshëm për punën që është i obliguar ta bëjë, prandaj këtë gjë nuk duhet t’ia lërë stihisë (*çdo njeri është i përgatitur që me lehtësi të kryejë atë punë që i është përcaktuar* (396). Punë më efektive për të është puna me karakter të sinqertë, (126) e ndershme (*fitimi më i mirë është ai fitim që njeriu e fiton me duart e veta, si dhe tregtia në të cilën nuk ka mashtrim-94*) dhe sistematike. Këtë më së miri e shpreh kur thotë (*Puno për këtë jetë, sikur do të mbetesh gjithmonë në të; puno për atë jetë, sikur do të vdesësh nesër* (395) dhe njëkohësisht flet me konsideratë për mosnxitim në punë (701).

Nga ana tjetër, është kundër dembelëve që të mirat e veta i presin në mëshirë të fatit, i urren punëdhënësit që nuk i paguajnë punëtorët e tyre sa duhet, bile nuk u tregojnë paraprakisht për hakun e punës që duhet ta bëjnë, ngase në realitet shumë herë punëtorët mbeten të zhgënjyer për hakun e tyre (*Jepjani hakun punëtorit ende pa iu terur djersa dhe njoftojeni për hakun qysh para punës që do të kryejë* (619) dhe shumë e shumë të tjera.

Edukimi fizik dhe shpirtëror

Duke u bazuar në Kur'anin e madhërishtëm se Zoti e krijoi njeriun me formën, konstruktin dhe proporcionet më të bukura të tij, ai në mënyrë mjaft figurative në hadithet e tij jep mjaft shembuj mbi pastërtinë fizike e shpirtërore të njeriut, mbi mbajtjen e rregullt të higjienës trupore dhe personale etj.

Në mënyrë të veçantë i dënon devijimet trupore seksuale, homoseksualizmin dhe të gjithë llojet e perversionit seksual, ngase shkatërron shëndetin, karakterin, përhapjen e dyfytërsisë, mosruajtjen e traditave shoqërore duke shkatërruar individë, familje e popuj në përgjithësi.

Lidhur me këtë aspekt jepen disa porosi mbi mbajtjen e rregullt të higjienës personale (*secili mysliman e ka borxh, bile një herë në javë të lahet, ta lajë mirë kryet dhe tërë trupin*), mbi ushqimin e pastër dhe të freskët ngaqë në të kundërtën do të shfaqen sëmundje të ndryshme, bile edhe vdekjeprurëse (*ndalohet të përdoret për ushqim mishi i kafshëve të ngordhura-567; T'i shmangeni gjellës së nxehtë, sepse ajo e zhduk bereqetin dhe hani ushqim, pasi të ftohet, sepse si i tillë bëhet më i këndshëm dhe më i bereqetshëm*) etj.

Edukimi intelektual

Islami si fe e përgjeshme dhe universale, shkencën e konsideron si shtyllë të saj (hadithi nr.1096), prandaj të mësuarit dhe dituria janë obligim i çdo myslimani, këtë më së miri e tregon kur thotë kërkoje diturinë deri në skajin më të lartë të rruzullit tokësor.⁴⁴ Pra siç shihej qëllimi i këtij mesazhi është ngritja intelektuale e çdo myslimani, ngase njeriu i edukuar dhe i arsimuar është më i formuar si personalitet, ka më shumë vizione për vete dhe për të tjerët. Të nxënit, sipas tij, duhet të fillojë qysh në moshë të re, ngase shembulli i atij që mëson në fëmijëri është i ngjashëm me të të gdhendurit në gur dhe të nxënit duhet të vazhdojë gjatë gjithë jetës. Aty njëkohësisht jepen mjaft mesazhe të tjera mbi edukimin intelektual si: të vlerësuar të njeriut në bazë të vlerës individuale dhe jo në bazë të të arriturave të paraardhësve të tij (467), vënia në jetë e diturive të fituara, ngase në të kundërtën dituritë e fituara (688), do t'i ngjanin një mermeri të papërpunuar që sado i vlefshëm të jetë, nëse nuk skalitet dhe ekspozohet do ta humbë vlerën e tij. Flitet në pedestal mbi respektimin e njerëzve të ditur dhe atyre personave që japin dituri (624), konsultimin dhe respektimin e mendimit të të tjerëve, sepse njeriu sado i ditur, i arsimuar, largpamës ka nevojë të marrë ide nga të tjerët, sepse në shumë situata vendimtare për jetën e tij dhe të të tjerëve, nuk mund të marrë vendime të drejta dhe të menjëhershme (770). Jepen porosi mbi obligimin e prindërve për shkollimin e fëmijëve të tyre dhe sigurimin e kushteve sa më të mira për jetë (549).etj.

Është kundër njerëzve injorantë (1051), kundër atyre dijetarëve që me vetëdije dhe qëllim bëjnë vepra të këqija (939), egoistëve që dituritë e tyre nuk ua përcjellin të tjerëve (1159) etj.

Detyrë kryesore e Muhammedit është të përsosurit e **moralit**. Prandaj, në kuadër të haditheve të tij jepen këshilla të një niveli të lartë edukativ, që kultivon dashuri dhe mbjell frymë paqeje ndër njerëz,

⁴⁴ Në parim Muhammedi thotë "kërkoje diturinë po të jetë nevoja deri në Kinë" ngase Kinë në atë kohë ka shërbyer si nocion largësie.

përmbledh rregulla e dispozita të dobishme të rendit social, parashikon norma edukative për njerëz të çdo kohe dhe të çdo niveli si: paraqitje të matur në situata të caktuara dhe të falurit e gabimit (136), të përqendruarit e njeriut në rrugë të drejtë (374), të kërkuarit e mirësisë si një ndër virtytet fisnike të njeriut (196), nderi dhe respekti ndaj mysafirëve (236), dëgjueshmëria vetëm në atë që është e mirë dhe e drejtë (569). Të kërkuarit të të drejtave në mënyrë dinjitoze (613), të mbajturit diskret gjatë realizimit të dëshirave, interesave, synimeve, ngase përreth nesh ka njerëz të papërgjegjshëm, të paaftë, tendenciozë, xhelozë që duke u nisur nga paaftësitë dhe mossukseset e tyre i përdorin të gjithë mjetet për t'i shkatërruar begatitë e të tjerëve (370), kontakti me njerëz të mirë (410) marrja me ndonjë punë dhe aktivitet që sjell më tepër dobi për veten dhe për të tjerët (279). Ndërsa si parakusht të mirësisë paraqet të respektuarit e vëllait, largimin nga e keqja, të udhëzuarit të atij që ka humbur rrugën (664) të ndihmuarit e njeriut të varfër (627). E çmon jashtëzakonisht modestinë për arsye se i sjell njeriut dinjitet dhe fisnikëri, (700), adhurim të sinqertë ndaj të tjerëve.

Për ta përmbushur parimin e konsekuencës, sipas Muhammedit, ekzistojnë 6 detyrime si: gjithmonë duhet të flasë të vërtetën, të mbajë fjalën dhe besën e dhënë, t'i shmanget imoralitetit, shikimeve të palejueshme, vjedhjes etj. Jep udhëzime mbi të pasurit dhe si të kihet kujdes gjatë marrjes së borxhit, sepse borxhin e përshkruan si brengë nate e nënçmim dite (595). Është kundër gjakmarrjes (171), pesimizmit dhe njerëzve dështakë (313), shoqërisë me njerëz të këqij (586) që nuk janë besnikë dhe që lejojnë të shkelet dinjiteti dhe personaliteti i të tjerëve (1574), koprracisë (599), lakmisë, mendjemadhësisë, zilisë (603), gënjeshtres (605) udhëheqësve që dëshirojnë të tjerët t'i shpijnë në rrugë të shtrembët, ngase për të qenë udhëheqës i një grupi të caktuar, ai duhet t'i posedojë disa cilësitë morale si korrekt, i ndershëm, i saktë, i vyer, i rregullt, pedant, të respektojë personalitetin dhe dinjitetin e tjetrit dhe shumë virtyte pozitive morale, sepse në të kundërtën do t'i dezorientojë anëtarët e grupit dhe si rezultat i kësaj krijohen konflikte mes tyre që shpeshherë marrin përmasa të paparashikueshme

(416). Fatkeqësi të madhe e konsideron sunduesin, i cili kur punon mirë nuk të falënderon, e kur të gabosh nuk të falë, fqinji i cili kur të sheh mirë heshtën, ndërsa të keqen e përhap gjithandej, gruaja e cila, nëse je afër të shqetëson, e nëse largohesh nga ajo të tradhton. (724).etj.

Dashuria për atdheun dhe gatishmëria për t'i shërbyer atij zë një vend jashtëzakonisht në hadithet e tij. Virtytet si: trimëria, bujaria, atdhedashuria dhe shumë të tjera i konsideron si fuqi të mrekullueshme dhe plot frymëzim. Ndërsa ana tjetër e parasheh luftën për pushtet (913).

Krahasimi i fjalëve të urta të Sami Frashërit me hadithet e Muhammedit a.s.

Sentencat e Sami Frashërit pothuajse janë identike me hadithet e Muhammedit, bile lirisht mund të thuhet se ai u bazua në to. Arsyeja kryesore është se aty jepen këshilla dhe porosi për ngritjen e vetëdijes së njeriut në çdo aspekt të edukatës: fizike, intelektuale, morale, estetike, punuese, gjë që këtë Muhammedi e bëri shumë shekuj më parë se ai.

Për sa i përket edukatës intelektuale, populli arab ishte një popull që nuk merrej me shkrim-lexim. Por ishte një popull që ushtronte shprehitë e qëndrueshme të nxënies shumë shpejt të teksteve përmendësh. Ata ishin në gjendje të mbanin në kujtesë qindra e mijëra vargje të poezisë, dinin për origjinën e paraardhësve të vet shumë të lashtë. Prandaj, Islami për ta ishte i mirëseardhur ngase shkencën gje-gjësisht diturinë e konsideronte si shtyllë të saj. Këtë e dëshmon fakti që qysh në ajetin e parë të Kuranit thuhet IKRE, që do të thotë, "*Lexo në emër të Zotit tënd*". Kësisoj një pjesë e konsiderueshme e haditheve të Muhammedit, jepen mesazhe mjaft të qarta për edukimin dhe arsimimin e popullit mysliman në përgjithësi, bile këtë e konsideron si obligim të çdo myslimani. Gjithsesi i çmon ata njerëz që i respektojnë njerëzit e ditur dhe atyre që japin dituri.

Ndërkaq, nga ana tjetër, populli shqiptar në atë kohë ishte në një injorancë të paparë. Prandaj, Samiu duke e parë gjendjen e mjerueshme të tij, ishte i detyruar që revoltën ta shprehë në shkrimet e tij. Për këtë ai ngriti postulatit themelor: *"Pa shkollë shqipe, pa edukatë solide, dijeni dhe kulturë të përgjithshme, kombi shqiptar nuk mund të përparojë"*, dhe këtë e bëri duke u bazuar në thënien: *"Kërkoje diturinë, nga djepi deri në varr, kërkoje atë qoftë edhe në Kinë"*.

Duke e konsideruar punën si domosdoshmëri jetësore të njeriut, si burim kënaqësie dhe lumturie, ai u bazua në hadithin e Muhammedit, në të cilën jepen mjaft këshilla për respektimin e rregullave të punës dhe të mirave të saj si: *"Fitimi më i mirë është ai që njeriu e fiton me duart e veta"*, apo *"Puno për këtë jetë sikur të vdesësh nesër"*. Këtë e përvetësoi dhe e modifikoi në fjalën e urtë shqipe: *"Punë, punë, natë e ditë që të shohim pagës dritë"*.

Edukimi i cilësive pozitive të vullnetit dhe karakterit është detyrë me rëndësi e edukatës morale, për arsye se njeriu në shumë situata jetësore duhet të veprojë e të sillet në harmoni me qëndrimet morale. Sjelljet e këtilla kërkojnë nga individit që të ketë vullnet dhe karakter të fortë. Prandaj, te njeriu gjatë procesit të edukimit qysh herët duhet të zhvillohen cilësitë e vullnetit dhe karakterit si: vendosmëria, iniciativa, guximi, qëndrueshmëria, mirësia, matura, drejtësia, njerëzorja dhe të evitohen tiparet negative: hipokrizia, pasiguria, papërgjegjshmëria, gënjeshtria, kokëfortësia etj.

Populli mysliman në atë kohë ishte në një dekadencë të përgjithshme dhe jetonte në një errësirë, pa kurrfarë normash morale, shprehja e fundit i nxori nga një errësirë dhe i bëri shembull dhe sinonim për të mirë të gjithë popujt e botës.

Prandaj, në kuadër të haditheve janë të gërshetuara një varg rregullash dhe normash të caktuara, të cilat rregullojnë raportet në mes të njerëzve dhe shoqërisë në përgjithësi ndërsa refuzohen dhe qortohen cilësitë e këqija në natyrën e njeriut.

Kësisoj, Sami Frashëri, duke e parë pikërisht dhe duke u bazuar në gjendjen momentale të popullit të tij i thuri sentencat që teorikisht, i trajtoi virtytet e larta etike, shembullin e njeriut me tipare të larta mo-

rale, me karakter të fortë dhe dëbimin e cilësive negative të tij. Edhe këtu sikur shihet u bazua në thëniet e haditheve.

Ndërkaq, për familjen jepen mjaft dispozita universale, me qëllim që ajo të jetë e shëndoshë dhe e harmonishme. Flitet mbi të drejtat dhe obligimet e bashkëshortëve, respektimin e gruas, paraqiten norma dhe rregulla për mënyrën e kurorëzimit dhe shkurorëzimit, për vënien e raporteve fqinjësore e shoqërore etj.

Përfundimi

Në bazë të gjithë kësaj që u tha në mënyrë telegrafike, si dhe shumë mëçka që mbeti pa u thënë, arrijmë në përfundim se Sami Frashëri, si personalitet shkencor me përmasa ndërkombëtare në gjitha fushat e jetës, arriti të bëjë mishërimin mes elementit kombëtar dhe fetar në funksion të ngritjes së vlerave të gjithmbarshme njerëzore, kombëtare e fetare.

Nga krahasimi i shkurtër që u bë mes disa fjalëve të tij të urta si dhe disa thëniet të Muhammedit (a.s.) hetohet dukshëm ndikimi i fjalëve profetike si dhe kulturës e civilizimit Islam në përgjithësi në krijimtarinë e tij shkencore enciklopedike dhe në ngritjen e vetëdijes të popullit shqiptar në përgjithësi.

Thuhet se Samiu ka shkruar rreth 20.000 faqe, duke mos i llogaritur këtu disa vepra të pabotuara dhe artikuj të shumtë të botuara nëpër gazeta dhe revista të ndryshme të kohës.

Rrezehana Hysa

THE ROLE OF SAMI FRASHËRI IN ISLAMIC CULTURE AND CIVILIZATION

(Summary)

Sami Frashëri, who was also known as Shemsuddin Sami, was a prominent figure of the Albanian National Renaissance. He was a philosopher, a scientist, an erudite, one of the most distinguished intellectuals of the Balkans at that time. Sami Frashëri was born in 1850. Mahmud effendi Tetova was his first teacher. After the death of his father, his family moved to Ioannina. He attended the "Zosimea" Gymnasium, which he completed in 1871. There, he acquired western culture and education. In 1872, he moved to Istanbul. He worked in the governmental press bureau. There, he deepened his scientific knowledge and became a distinguished figure of Albanian and Turkish science and culture.

رزھانا ھوسا

مساهمة سامى فراشرى في الثقافة و التمدد الاسلامى

(كلمات عن حياة و اعمال سامى فراشرى)

(خلاصة البحث)

يعرف سامى فراشرى في الكتابة الاجنبية باسم شمس الدين سامى فراشرى و الذي يعتبر العقل المفكر للنهضة الالبانية الحديثة. و في نفس الوقت هوفيلسوف و عالم و كاتب و مفكر و صحفى واحد اهم المثقفي في البلقان في تلك الفترة و هو الذي وضع خطط التعليم القومى لدى الشعب الالبانى.

PËRVJETORE

Gazmend Shpuza

AKTUALITETI I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Kur bëjmë fjalë për rëndësinë historike dhe aktuale të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit duhen pasur parasysh në radhë të parë detyrat madhore që qëndronin para saj, të cilat ajo i perceptoi drejt qysh në hapat e parë të themelimit të vet. Ajo udhëhoqi luftën e mbarë popullit shqiptar në tre drejtime kryesore: për çlirim kombëtar, për mbrojtjen e tërësisë dhe njësisë së trojeve shqiptare, për bashkimin e tyre në kuadrin e një formacioni shtetëror të njësuar qoftë dhe autonom në përputhje me zhvillimin e Çështjes Lindore aso kohe. Janë pikërisht përmasat e objektivave, të cilat ajo i vuri vetes dhe për të cilat luftoi për afro tre vjet rresht ato që përcaktojnë, veç të tjerash, rëndësinë e saj historike dhe aktuale.

Përveç vetë domethënies historike të kësaj ngjarjeje, është kuadri i sotëm i zhvillimit të çështjes kombëtare, veçmas të çështjes së Kosovës, e cila qe djepi i Lidhjes dhe shtrati i fundit epik i saj, të cilat i diktojnë natyrshëm opinionit shkencor dhe më gjerë mbarëshqiptar në ditët tona detyrën që t'i drejtohen edhe në përvjetorë të zakonshëm jo-jubilarë dhe jashtë tyre kësaj ngjarjeje madhore të historisë sonë kombëtare. Se sa të vetëdijshëm jemi apo, më mirë të themi, se sa

tregohemi të vetëdijshëm për plotësimin e kësaj detyre ky është një problem tjetër.

Faktorë jashtëshkencorë, të lidhur pas politikave, të cilat nuk përputhen me interesat tona kombëtare për të mos thënë se janë në kundërshtim me to, kanë diktuar që përditësimi i kësaj ngjarjeje madhore të mos ecë në përpjestim të drejtë me përmasat historike të saj dhe aq më pak me momentet që kalon çështja kombëtare mbarëshqiptare. Këtë dëshmojnë dhe zhvillimet e fundit. Heshtja për Lidhjen e Prizrenit pikërisht në kohën kur u bë fjalë më shumë se kurrë për vendosjen e statusit të Kosovës përkoi me vendimin për shtyrjen e afatit të përcaktimit të saj.

Fjala është për një periudhë mbresëlënëse, mësimdhënëse dhe frymëzues tejet aktuale. Për më tepër ajo përkon me përvjetorin e largimit të forcave serbe nga Kosova. Dhe megjithatë edhe pse ishte një përvjetor jo-jubilar askush në Shqipëri dhe pakkush në Kosovë iu drejtua 129-vjetorit të saj. Edhe ndonjë veprimtari mbarëshqiptare si “Ditët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” e parashikuar të organizohej edhe në Tiranë me nismën e Komunës së Prizrenit nuk pati kurrfarë jehone për të mos thënë se dështoi. Gati një orë pas kohës së caktuar për fillimin e saj në Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës ndodheshin vetëm organizatorët dhe trupat artistike pjesëmarrëse të angazhuara në këtë veprimtari. Asnjë përfaqësues nga organet kulturore dhe shkencore, ato shtetërore e politike jo se jo, as lokale, e për ato në shkallë kombëtare nuk bëhej fjalë, nuk u ndodh aty.

Po kështu në mediet e Shqipërisë kaloi pa kurrfarë jehone edhe ndonjë veprimtari siç qe tryeza “Mesazhet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, e zhvilluar në Prizren nga Bashkësia Islame e Kosovës. Te ne askush nuk mori vesh se në një monument shumë të rëndësishëm jo vetëm në pikëpamje arkitektonike, në xhaminë historike “Mehmet Pashë Bajraklija” u vendos një pllakë përkujtimore në shenjë të Kuvendit të Prizrenit, të mbledhur aty 129 vjet më parë. Në këtë faltore të nacionalizmit shqiptar u morën më 15 qershor 1878 nga përfaqësues të Sanxhakut të Prizrenit, 43 myslimanë dhe 5 katolikë, vendime historike për fatet e mbarë kombit shqiptar.

Në vitet 1878-1881 populli shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes hyri, qysh në ditët e para të ekzistencës së saj, në rrugën e guximshme të luftës me armë me një përfytyrim të qartë për të ardhmen e tij. Në ato vite paraardhësit tanë u angazhuan në këtë luftë me besim se brezat e ardhshëm, cep më cep të trojeve të veta amtare, do të korrin frytet e luftës së tyre.

Këtë besim e ngjalli dhe e përforcoi Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e cila qëndroi në ballë të përpjekjeve si një organizatë me një platformë ideologjike kombëtare dhe një program politik të përcaktuar qartë qysh në ditët e para të ekzistencës së saj, me një konceptim shtetëror dhe ushtarak në shkallë kombëtare të ngritur edhe organizativisht mbi ndarjet krahinore, administrative dhe fetare të vendit.

Si përfaqësuese e të drejtave të kombit shqiptar dhe më vonë si qeveri e tij, Lidhja me veprimet e organizuara politike e ushtarake, e ka ruajtur dhe përforcuar në rrethanat që po kalon sot kombi shqiptar, domethënien e saj madhore edhe në rrafsh historik edhe në atë perspektiv, edhe për sot dhe për kohët që do të vijnë.

Objektivat e Lidhjes së Prizrenit mbeten aktuale dhe sot e kësaj dite. Ajo mbrojti tërësinë, paprekshmërinë dhe njësinë e trojeve etnike shqiptare, luftoi për njohjen dhe zbatimin e parimit të kombësisë e të së drejtës për vetëvendosje të shqiptarëve, për shtetin e vet të njësuar qoftë dhe autonom për atë kohë. Prandaj, pavarësisht nga qëndrimet taktike që kanë mbajtur dhe vijojnë t'u përmbahen forcat politike shqiptare sot, ky mbetet qëndrimi strategjik i plotë, i qartë dhe i panegociueshëm i objektivit final të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Përballë qëndrimit të egër armiqësor të shovinizmit shtetmadh ballkanik dhe Fuqive të Mëdha që qëndronin prapa tij, për interesa të caktuara, si dhe përballë autokracisë sulltanore, të cilës vendimet e Kongresit të Berlinit, paradoksalisht, ia zgjatën jetën dhe për afro dyzet vjet, Lidhja hodhi themelet e njësisë dhe të bashkimit të popullit shqiptar si komb modern.

Lidhja ishte rezultat i pjekurisë politike, ideologjike dhe diplomatike të Lëvizjes sonë Kombëtare në shek. XIX. Mendimtarët e atyre viteve kapërcyen pasojat e rënda që diktonte në këtë fushë prapa-

mbetja ekonomike, shoqërore dhe kulturore e vendit. Ata përballuan kundërshtimet e forta të qarqeve intelektuale vendase, kryesisht klerikale të formuar në shkolla të huaja dhe çka ishte më keq dhe të vëna në shërbim të politikave të vendeve të huaja.

Lidhja e Prizrenit qëndroi në një rrafsh më të përparuar nga politika e shteteve ballkanike, të cilat pretendimet e tyre i mbështesnin mbi parimin mesjetar të bashkësisë fetare dhe të së "drejtës historike" perandorake. Kemi të bëjmë me një qëndrim modern jo vetëm për atë kohë, por dhe në këto vite të para të mijëvjeçarit të tretë. Për t'u bindur për këtë mjafton të kujtojmë se fqinjët tanë sllavë, ortodoksë, katolikë dhe myslimanë po hyjnë në Evropë në kuadër të shteteve të veçanta dhe jo bashkërisht siç qenë në federatën jugosllave. Ndërsa shqiptarëve që janë shumicë mbizotëruese në Kosovë u kërkohet, në një mënyrë apo në një tjetër, të hyjnë në Evropë së bashku me Serbinë sllave.

Për diplomacinë europiane deri në fund të viteve '70 të shekullit XIX Shqipëria ishte veçse një shprehje gjeografike. Ndërsa një shekull më vonë, në fillim të viteve 80 të shekullit XX, kur çështja e Kosovës doli në arenën ndërkombëtare si një çështje madhore që kërkonte zgjidhje, për shkencën serbe të vënë në shërbim të politikës së Beogradit, Shqipëria nuk përfaqësonte as edhe aq. Tanimë ajo na ishte vetëm një "koncept i papërcaktuar gjeografik". Për më tepër, sipas përfaqësuesve të saj, kombi i njësuar shqiptar dhe historia e tij nuk na ishte tjetër veçse një "fiksion" nacionalist. Për këtë popull nuk paska për të pasur të ardhme të qytetëruar, veçse brenda "suazave federative, në vëllazërim me popuj me të cilët e lidhka një histori e tërë në kuadrin e "jugosllavizmit". Çdo mendim i ndryshëm na qenka "nacionalist dhe irredentist"! Pikëpamje të tilla ekzistojnë dhe sot, pavarësisht nga formulimet e ngatërruara me apo pa qëllim në suazat në të cilat kërkohet të vihet e ardhmja e Kosovës dhe e popullsisë shqiptare e dalë nga ish-Jugosllavia.

Në këtë vazhdë aso kohe u vërejtën përpjekjet për ta stolisur flamurin kombëtar të shqiptarëve në Kosovë në funksion të autonomisë që ajo kishte siguruar deri më atëherë në kuadër të federatës me tre-

ngjyrëshin jugosllav. Këto përpjekje qenë të ngjashme me tentativat e fashistëve për ta mbërthyer shqipen dykrenore me sëpatat e Liktorit.

Edhe nën Italinë fashiste edhe nën Jugosllavinë, gjegjësisht Serbinë socialiste askush nuk e çoi ndërmend që ta zhvishte simbolin e shqiptarëve qoftë dhe në Kosovë nga shenjat e tij karakteristike kombëtare. Nuk guxuan as fashistët dhe as shovinistët serbë që ta zhvishnin këtë flamur historik të shqiptarëve nga ngjyrat e tij kombëtare me gjithë “multietnicitetin” e Kosovës, i cili nuk ishte i panjohur për aq sa ekzistonte në realitetin jugosllav. Nuk patën fat më të mirë dhe orvatjet e deritanishme për ta mbingarkuar simbolin kombëtar të mbarë shqiptarëve me elemente mitologjike, të sajuar, të pretenduar si dardanë, duke eklipsuar shenjat dalluese bazë. Në këtë sajësë vështirë të spikasin çfarë ka ai të përbashkët me flamurin e të gjithë shqiptarëve. Është më e lehtë të hetohen elemente të përbashkëta me simbolet kombëtare të shteteve të tjera.

Dëgjojmë se është rekomanduar që flamuri i Kosovës duhet të sintetizojë simbolet kombëtare të përbërjes multietnike të shtetit të ri. Porse njihen shumë shtete multietnike madje me multietnicitet më të theksuar që nuk e plotësojnë këtë kusht. Edhe një shtet tipik federativ i hershëm si Zvicra, që ka mbijetuar që nga viti 1291, ka një flamur origjinal, i cili nuk i përngjan asnjërit prej flamujve të kombësive prej të cilave përbëhet ky shtet. Ka më se shtatë shekuj që asnjëra prej këtyre kombësive dhe shteteve përkatëse amë nuk është shqetësuar nga ky fakt, sepse ky simbol jo vetëm që nuk ka cenuar të drejtat e asnjëres prej tyre, por i ka siguruar ato më së miri që në kohët e Mesjetës. Nuk duhet harruar se shenjat kombëtare të shqiptarëve asnjëherë nuk i kanë prirë politikave aneksioniste, asgjësuese, shfarosëse të gjenocidit, etnocidit e të religjioncidit.

Në vitet e Lidhjes Shqiptare dhe në të gjitha momentet vendimtare për fatet e atdheut kosovarët qëndruan jo vetëm me pushkë, por dhe me vizione të qarta në ballë të përpjekjeve të popullit të vet për të afirmuar të drejtat e tyre, individualitetin dhe identitetin kombëtar në trojet etnike. Këtë dëshmojnë dhe vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që nga ditët e para të Kuvendit historik të Prizrenit.

Zhvillimi i Lëvizjes Kombëtare mbarëshqiptare dhe niveli në të cilin ka arritur diskutimi i problemeve që ajo ka shtruar për zgjidhje, çështja e statusit të Kosovës dhe dalja në skenë e çështjes çame, ka përditësuar në shkallë sipërore kumtin që sjell për shqiptarët tashti dhe në të ardhmen historia jonë kombëtare dhe momentet e saj kulmore si Besë-Lidhja e Lezhës, Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Shpallja e Pavarësisë. Çështja Kombëtare Shqiptare, e zhveshur nga çdo paragjykim shovinist, nuk mund të konsiderohet e vjetruar. Ajo mbetet në rend të ditës deri në zgjidhjen e saj të drejtë dhe të plotë. Përpjekjet për kinse modernizimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve, duke shpërfytyruar dhe gjymtuar përbërësit e tij historikë i bien ndesh realitetit të kaluar dhe atij të sotëm. Për më tepër, ato nuk i ndihmojnë zhvillimit të suksesshëm të këtij procesi.

Le të kujtojmë se në bashkëfjalimet për statusin e Kosovës marrin pjesë nga ana shqiptare përfaqësues që shumëkush, jo vetëm të huaj, por mjerisht dhe nga mesi i shqiptarëve, deri dje i pati quajtur, me të padrejtë, terroristë. Madje, i cilësuan dhe terroristë islamikë, megjithëse në radhët e tyre kishte, çka është e natyrshme, dhe shumë luftëtarë të krishterë katolikë. Ato përfaqësohen natyrshëm dhe në Grupin Negociator. Me sa kemi dëgjuar vëllai i njërit prej anëtarëve katolikë të këtij Grupi, është mysliman. Përballë fakteve të tilla kemi të bëjmë me përpjekje të ethshme që synojnë të mjegullojnë qëllimisht, realitetet shqiptare. Ato flasin qartë për ekzistencën edhe në Europën e sotme të mendësive mesjetare me ngjyresa të forta teokratike. Me to vijon të ushqehet ajo propagandë e shfrenuar, sipas së cilës shqiptarët në shekuj paskan luftuar për gjysmëhënën, kundër kryqit. (!) Kemi të bëjmë me një thjeshtëzim tejet banal të fronteve të luftës çlirimtare të zhvilluar në Kosovë për sa i takon dislokimit të forcave ndërluftuese në fund të mijëvjeçarit të dytë dhe në fillim të mijëvjeçarit të ri.

Pavarësisht nga debatet, jehona e luftës çlirimtare nën udhëheqjen e Skënderbeut, nën udhëheqjen e Lidhjes së Prizrenit si dhe ajo e zhvilluar gjatë viteve 1909-1912, kurorëzuar me shpalljen e pavarësisë të mbarë trevave shqiptare ndjehet e fuqishme në zhvillimet e sotme. Pjesë integrale e saj është dhe Lufta e Kosovës e vitit 1999 përkrah së

cilës u rreshtuan dhe forcat e shteteve përgjithësisht të krishtera të NATO-s

Në qershor të vitit 1878 shqiptarët u mbledhën në Prizren, i cili u bë në ato vite kryeqyteti i të gjithë shqiptarëve pa dallim krahine, gegë dhe toskë, pa dallim besimi, nëse ishin myslimanë suni, bektashi, apo të krishterë ortodoksë a katolikë. Bashkimi i tyre aty u bë në kundërshtim me propagandat e qendrave të tyre fetare dhe fuqive shtetërore, të cilat qëndronin pas tyre, Stambollit, Athinës, Vjenës dhe Vatikanit. Përpjekjet e autoriteteve osmane dhe të elementeve turkomane për t'u dhënë protestave të shqiptarëve kundër copëtimit të trojeve të tyre karakter islamik pak e ka shqetësuar Vjenën aso kohe. Trysnia e autoriteteve greke dhe e Patrikanës së Stambollit pamundësoi, fillimisht, pjesëmarrjen e përfaqësuesve të popullsisë shqiptare të besimit ortodoks, në radhë të parë të klerikëve, në organet e Lidhjes Shqiptare dhe në përfaqësitë e saj pranë Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha. Këtë fakt e vërejtën dhe drejtuesit e Kongresit të Berlinit. Siç shkruante Fan S. Noli në gazetën "Dielli" në vitin 1909, Bismarku u tërhoqte, jo pa të drejtë, vërejtjen Mehmet Ali Vrionit dhe Abdyl Frashërit për mungesën e përfaqësuesve të popullsisë ortodokse në përbërjen e delegacionit të tyre. Fjala ishte për misionin e tyre në mbrojtje të viseve të Jugut nga pretendimet e shovinistëve grekë.

Pavarësisht nga pasojat e rënda të zbatimit të sistemit, gjithsesi liberal, osman të popullsisë në mesin e shqiptarëve multikonfesionalë, plurifetarë, ata i bashkoi njësia etnike kombëtare e trashëguar nga epopeja skënderbegiane, e kalitur në përpjekjet e vijueshme për çlirim kombëtar. Midis tyre, në kohët e reja, dallon lufta për formësimin e autonomisë shqiptare nën udhëheqjen e krerëve myslimanë, Bushata-sve dhe të Ali Tepelenës.

Rezultati më i rëndësishëm i gjithë kësaj lufte gjatë këtyre dhjetëvjeçarëve ka qenë thjeshtëzimi i ndarjeve krahinore, etnokulturore të shqiptarëve në dy degëzime të mëdha: në gegë dhe në toskë. Përpjekjet për të ringjallur nëndarje më të hershme janë të destinuar të dështojnë. Të njëjtin fat duhet të kenë dhe do të kenë dhe nëndarjet e

imponuara nga copëtimi politiko-administrativ i diktuar nga Konferenca e Londrës dhe nga Konferenca e Parisit.

Bashkimi politik i shqiptarëve në Lidhjen e Prizrenit u arrit relativisht shumë shpejt nën peshën e rrezikut vdekjeprurës të krijuar nga pasojat katastrofike të Traktatit të Shën-Stefanit për ekzistencën kombëtare të njësuar të shqiptarëve. Vendimet e Kongresit të Berlinit dhe zhvillimi i mëtejshëm i ngjarjeve nxiti dhe përforcoi përpjekjet për fitimin e kohës së humbur.

Krerët shqiptarë të çdo kategorie shoqërore u pajtuan në idenë e krijimit të bashkimit politik ushtarak dhe shtetëror të shqiptarëve, duke kapërcyer mendësitë partikulariste, krahinore dhe fetare dhe në një shkallë jo të vogël dhe ato shoqërore, feudale e bajraktariste. Parardhësit të banorëve të Shqipërisë së sotme, të Kosovës së sotme, të Pollogut të sotëm në Maqedoninë Perëndimore, të Preshevës së sotme në Serbinë Jugore, të shqiptarëve që banojnë në Mal të Zi, të banorëve të Çamërisë martire e të tjerë në një mendje ecën përkrah njeri-tjetrit. Nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare ata u vunë në të gjitha rrafshet në krye të luftës për mbrojtjen e trojeve shqiptare dhe në ballë të përpjekjeve për sendërtimin e shtetit kombëtar të bashkuar qoftë dhe autonom, të përligjur plotësisht aso kohe.

Prandaj, mund të thuhet pa mëdyshje, se mesazhi që vjen në ditët tona nga Lidhja e Prizrenit e 129 vjetëve më parë është edhe sot e kësaj dite shumë i fuqishëm. Ky mesazh merr vlera jo vetëm nga rëndësia e atëhershme e vendimeve që u morën në atë kuvend nga burrat e shquar të trojeve shqiptare. Ata edhe pse jo të pangarkuar, me mendësi separatiste, u ngritën në lartësinë e detyrave historike. Në këto përpjekje ata u drejtuan nga mendime dhe veprime politike ndër më të përparuarat të kohës. Ky mesazh mori forcë, sidomos, nga përmasat e luftës trevjeçare të zhvilluar nga populli shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes së Prizrenit. Për vetë faktin që objektivat, të cilat asaj kohe qëndronin përpara Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nuk janë realizuar ende në të gjitha përmasat e tyre mesazhi Lidhjes së Prizrenit mbetet i përditësuar dhe i flet me zë të fuqishëm edhe kohës që jetojmë.

Aktualiteti i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit përforcohet dhe më tepër për faktin se edhe zhvillimet progresive të sotme të çështjes kombëtare shqiptare janë vijim dhe pjesë përbërëse organike, e natyrshme e atij procesi dhe e atyre dukurive, të cilat kanë zënë fill në trevat shqiptare që me epokën skënderbegiane dhe u mishëruan në vendimet e Kuvendit të Prizrenit. Ato u jetësuan në veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare që lindi aty. Prandaj, mund të themi pa e tepruar, që mesazhi i Lidhjes së Prizrenit është mesazhi që sjell programi dhe platforma për sendërtimin e së cilës punuan shqiptarët qysh para afro 130 vjetësh. Kumti i Lidhjes së Prizrenit mbetet aktual dhe sot e kësaj dite dhe bën thirrje fuqishëm për t'u bashkuar rreth programit dhe platformës së saj për t'i vënë ato në jetë plotësisht.

Kuvendi i Prizrenit u zhvillua në një moment tepër kritik për fatin e Shqipërisë dhe për zhvillimin europian të Ballkanit. Koha që kalojmë mbetet vendimtare dhe përcaktuese për të ardhmen e Shqipërisë së bashkuar, të projektuar që nga Skënderbeu në Lezhë dhe të riformuluar në Prizren para 129 vjetësh. Koha që kalojmë është provë për brezat e rinj të shqiptarëve për të ditur dhe për të mundur të orientohen në kushtet e reja për shpалosjen dhe afirmimin e identitetit të tyre kombëtar. Ajo është njëkohësisht dhe koha e sprovës për një Europë, e cila mëton të integrohet në rrugë demokratike, e çliruar nga mbeturinat e hipotekimeve të traktateve që i zgjatën jetën sundimit osman në Ballkan, të traktateve që kërkojnë ta mbajnë edhe sot e kësaj dite çështjen shqiptare peng të pansllavizmit dhe të panhelenizmit anakronik dhe të ndonjë izme tjetër.

Në të ardhmen e afërt shqiptarët në përpjekjet e tyre për sendërtimin e bashkimit kombëtar, shpirtëror dhe politik, këtej dhe andej kufirit nuk do të ndodhen më përballë sundimeve të huaja. Të gjendur tashmë, për ditë e më tepër, përballë me vetveten, problemet që kanë me njeri-tjetrin do të dinë t'i zgjidhin në rrugë demokratike e vëllazërore. Keqkuptimi dhe keqpërdorimi i pluralizmit politik, kuptimi mesjetar separatist e bajraktarist i politikave partiake, duhet pranuar, me keqardhje të thellë, nuk lejoi në këto vitet e fundit dhe nuk po lejon

dhe sot e kësaj dite që Tirana, Prishtina, Shkupi e të tjera qendra shqiptare edhe në diasporë të luajnë siç duhet rolin që u takon.

Në rrethanat e reja para shqiptarëve del detyra që kufijtë politikë të imponuar para 95 vjetësh nga të huajt të mos shndërrohen në të ardhmen në kuadër të Europës së bashkuar në kufij kantonesh apo federatash, të karakterizuar nga identitete kulturore dhe çka është më keq dhe nga identitete fetare, siç dëgjohej të flitet jo rrallë here jo vetëm në mjedise parashkencore.

Në gjirin e Kuvendit të Prizrenit u zhvillua një proces i menjëherëshëm reflektimi lidhur me detyrat që shtronte momenti historik, bashkimin politik dhe shtetëror të të gjitha forcave të popullit shqiptar në mbrojtje të atdheut. Pjesëmarrësit e tij u ngritën menjëherë pa kurrfarë hezitimi në nivelin e detyrave që kishin përpara. Kemi të bëjmë me një shembull, i cili pavarësisht nga evoluimi i situatave dhe vështirësitë, mbetet në rend të ditës dhe na imponohet.

Sot fjala është për të çuar deri në fund atë proces shtetformues të shqiptarëve të nisur në Lezhë para 560 vjetësh dhe të sendërtuar në Prizren 130 vjet më parë. Krijimi i shtetit të bashkuar shqiptar u pengua dhe u cungua rëndë, pikërisht atëherë kur u zhduk edhe në saje të luftës së pandërprerë të popullit shqiptar, sundimi osman, ajo pengesë madhore që e ndërpreu atë proces dhe nuk lejoi për pesë shekuj zhvillimin e tij normal. Ndërsa vendimet e padrejta të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, më 1913, nuk lejuan sendërtimin e shtetit kombëtar shqiptar të njësuar. Sepse, vijonte të ishte në veprim në thelb po ajo diplomaci, e cila kishte mbajtur në këmbë Perandorinë Osmane edhe për afro dy shekuj pasi ajo kishte marrë rrokullimën e saj.

Platforma politike e Besëlidhjes Shqiptare, të themeluar nga Skënderbeu dhe të konkretizuar dhe materializuar në Prizren para 130 vjetësh qëndron në fillet dhe në bazë të strategjisë së zgjidhjes së çështjes kombëtare mbarëshqiptare, të shtruar në ditët tona për zgjidhje përfundimtare në skenën diplomatike europiane. Shi për këtë arsye, kulti i Skënderbeut dhe platforma e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit janë shndërruar ndër elementet më të qenësishme të ndërëgjegjes kombëtare të shqiptarëve. Çdo përjasje tjetër e simbolikës së 10 qershorit të vitit

1878 me 10 qershorin e vitit 1999, me zhvillimet më të fundit në viset shqiptare është jashtë realitetit historik dhe larg detyrave që shtron e sotmja dhe e ardhmja para mbarë shqiptarëve.

Rruga e nisur me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe e ndjekur me vendosmëri deri në prag të Shpalljes së Pavarësisë simbolizon jo vetëm unitetin kombëtar kundrejt përçarjes feudale, krahinore e fetare, por shënonte edhe rrugën e luftës së armatosur me armikun, kundrejt rrugës së kompromisit apo të kapitullimit që ndiqte një pjesë e mirë e klasës çifligare shqiptare dhe e parisë bajraktare të atëhershme. Edhe në këtë kuptim Lidhja e Prizrenit na sjell një mesazh kuptimplotë, që duhet pasur vëmendje parasysh.

Mbetemi plotësisht të vetëdijshëm për detyrat që vijnë të qëndrojnë para nesh, jo thjesht si pasardhës të ligjshëm të epokës që u bë e lavdishme nën udhëheqjen e Skënderbeut, të epopesë që shkroi Lidhja e Prizrenit, por si zbatues konsekuent të testamentit politik të Kuvendit të Lezhës dhe të Prizrenit që na lanë amanet organizatorët e tyre në përputhje me kushtet kur u hodhën themelet e bashkimit shtetëror të shqiptarëve. Këto detyra do t'i përballojmë, gjithashtu, dhe si bartës të ndërgjegjshëm të amanetit të Kuvendit të Vlorës që shpalli pavarësinë e të gjithë Shqipërisë dhe jo vetëm të asaj pjese që mbeti brenda shtetit shqiptar pas cungimit të pamëshirshëm që iu bë trupit të saj në Londër. Ky faktor i imponuar politik i detyroi shqiptarët që testamentin e Besëlidhjes së Lezhës dhe të Lidhjes së Prizrenit si dhe amanetin e Kuvendit të Vlorës t'i shprehnin këto 95 vjet në rrugë paralele: në vitet '20 të shekullit të kaluar, me platformën e Kongresit të Lushnjës dhe me platformën e Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe, më pas, në vitet e Luftës së Dytë Botërore, me platformën e Konferencës së Pezës dhe me platformën e Konferencës së Bujanit. Pavarësisht nga ky dyzim i diktuar nga zhvillimet politike dhe diplomatike ndërkombëtare, këto platforma të veçanta, që pikënisjen e kanë në epokën e Skënderbeut dhe në vitet e Lidhjes së Prizrenit, kanë një synim të përbashkët dhe presin të shkrihen në një platformë të njësuar.

Çdo injorim apo cenim i platformës kombëtare të Rilindjes, e cila e ka zanafillën në Kuvendin e Lezhës dhe që mori trajta moderne në

Prizren, nuk besojmë se do të arrijë ta dëmtojë bashkimin kombëtar të shqiptarëve; ta bëjë copëtimin politik shtetëror të tyre dhe t'u zgjasë edhe më shumë jetën mbeturinave të një politike, të cilës mendohet se i ka ikur koha.

Sot, më shumë se çdoherë tjetër vijon të qëndrojë në rend të ditës mesazhi i epokës epirote të Krujës dhe epopesë mbarëshqiptare të Prizrenit, për t'u angazhuar me forca të bashkuara në realizimin e platformës shtetërore kombëtare mbarëshqiptare të shprehur në Vlorë, më 28 nëntor 1912.

Porse epokës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nuk mund t'i drejtohesh me mendime gjoja "të reja", "moderne" për organizimin politik të shqiptarëve, kinse, mbi baza europianiste, në të vërtetë mbi bazën e koncepteve mesjetare kantoniste. Së kaluarës së shqiptarëve nuk mund t'i drejtohem gjithashtu mbi bazën e një ndjenje separatiste fetare, e cila mohon jo vetëm rrugën e ngjizjes mbifetare të ndërgjegjes së shqiptarëve, por dhe kërkon ta sakatojë atë nga një komponent i gjallë për hir të një ideje tejet fluide. Debatimi mbi identitetin kombëtar të shqiptarëve në masën më të madhe iu kundërvu platformës së Besëlidhjes së Lezhës dhe asaj të Lidhjes së Prizrenit si dhe vendimit historik të Kuvendit të Vlorës. Pavarësisht nga përpjekjet për modernizimin e këtyre pikëpamjeve, kinse, me përvojën europiane, kemi të bëjmë me mendime të kapërcyera nga të parët tanë, qysh në shek. XV nga mendimi politik më i përparuar mesjetar i shqiptarëve të kohës së Skënderbeut dhe më pas, por dhe para tij. Në mënyrë të veçantë mendësi të tilla janë tejkaluar nga mendimi politik rilindës i sanksionuar në platformën e Lidhjes së Prizrenit. Nga ana tjetër, mesazhi që na vjen nga Besëlidhja shqiptare në Lezhë dhe në Prizren nuk i përlligj kursesi përpjekjet për të hedhur poshtë gjuhën letrare shqipe. Asnjë argument sado shkencor që të duket apo të pretendojë të jetë i tillë, në të vërtetë, nuk e fsheh dot rrezikshmërinë që paraqet.

Lufta e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nuk ishte një luftë për mbrojtjen e Perandorisë Osmane, luftë për t'i zgjatur jetën sundimit të saj në Ballkan. Atyre viteve nuk mund t'i drejtohesh duke e reduktuar rëndësinë dhe karakterin e luftës së

shqiptarëve të udhëhequr nga kjo organizatë, në një luftë kundër “gjysmëmehënës” për një Europë të krishterë. Në të vërtetë politika e madhe e Europës së krishterë ishte ajo që mbrojti Perandorinë Osmane nga shqiptarët dhe popujt e tjerë të ndodhur nën sundim të saj, ia zgjati jetën këtij sundimi edhe për afro dy shekuj deri në çerekun e parë të shekullit XX.

Prandaj, ta shtrosh çështjen që shqiptarët ndodhen sot ashtu sikurse afro gjashtë shekuj më parë, “midis kryqit dhe gjysmëmehënës”, do të thotë ta shtrembërosh dhe ta cungosh si të vërtetën historike, ashtu dhe realitetin e sotshëm. Nuk mund të vihet kurrsesi shenja e barazimit midis besimit fetar të shumicës së popullsisë shqiptare në Kosovë, nga njëra anë, dhe politikës kolonialiste gjenocidiale të Serbisë së krishterë, nga ana tjetër.

Shqiptarët në Kosovë sikurse mbarë shqiptarët në kohën e Besëlidhjes së Lezhës ndodhen në fund të udhëkryqit që ndan lirinë nga robëria. Gjithë shqiptarët ndodhen midis luftës për bashkim kombëtar dhe përpjekjeve kundër copëtimit të trojeve shqiptare, qoftë dhe në suazën e bashkimeve si ato federative e tjerë. Ndodhemi sot midis përpelitjeve për t’u futur sa më shpejt në rrugën e përparimit në përballje me pengesat objektive dhe subjektive me prejardhje të ndryshme, të cilat synojnë zgjatjen e mëtejshme të destabilizimit të gjysmështetit shqiptar dhe çorientimit të forcave politike brenda dhe jashtë tij.

T’i drejtohesh Lidhjes Shqiptare të Prizrenit kërkon nga ne që të merremi seriozisht me studimin e pasojave të copëtimit politik të shqiptarëve për afro një shekull; kërkon të merren masat për përbalimin e dallimeve që kanë lindur në mesin e shqiptarëve gjatë këtyre 95 vjetëve, kryesisht, në nivelin ekonomik, në rrafshin kulturor, në shkallën e emancipimit, në preferencat ideologjike, në qëndrimin ndaj fesë, deri edhe në çështjen e gjuhës etj. Kjo nuk do të thotë kurrsesi se janë krijuar, siç dëgjohet, të çara në cilësitë thelbësore që na bashkojnë si komb, të cilat na dallojnë të gjithëve bashkë, jo vetëm nga ballkanasit, por edhe nga europianët.

T’i drejtohesh sot historisë së kaluar dhe të afërt do të thotë të angazhohesh me të gjitha forcat e bashkuara të shqiptarëve për të he-

dhur poshtë çfarëdo hije dyshimi që ka lindur dhe është përhapur me qëllim rreth aftësive të shqiptarëve për t’u vetëqeverisur, për t’u veta-administruar të njësuar, tashmë, në rrugë demokratike. Shqiptarët i kanë të gjitha mundësitë të mënjanojnë faktorët politikë, shoqërorë dhe ata ekonomikë që destabilizojnë gjendjen në viset e tyre dhe që pengojnë përpjekjet për realizimin e synimeve kombëtare.

Nëse duam që e djeshmja t’i shërbejë sa më mirë të sotmes dhe të ardhmes, ta marrim atë pa e idealizuar, por dhe pa e minimizuar dhe ca më shumë pa hedhur baltë mbi të, nën pretekstin e mbajtjes së qëndrimeve vetëkritike. Nuk lejohet që e kaluara të shtrembërohet në funksion të një politike të ashtuquajtur - të ditës. As politikanëve dhe diplomatëve shqiptarë nuk u lejohet ta injorojnë atë kurrsesi.

Lufta e popullit shqiptar në ditët tona nuk mund të ketë sukses po të zhvillohet mbi bazën e interesave të pjesshme, ndërkrainore, apo ajo çka është edhe më keq mbi bazën e politikave ngushtësisht partiake. Kjo vlen të theksohet aq më tepër sot kur fryma krainore dhe partiake, mund të thuhet, në garë me separatizmin feudal të kohës mesjetare, të kohës së principatave, dhe bajraktarist të kohëve të mëvonshme, po sjell jo pak dëm në rrafshin kombëtar.

Kemi disa vite që përdorim krejtësisht vend e pa vend një slogan jo të saktë, me të cilin kërkohet që Shqipëria, shqiptarët të hyjnë në Europë, e vijojmë të kërkojmë që Shqipërinë ta bëjmë europiane. Shqipëria ka qenë dhe është në Europë. Shqipëria, edhe në kohët më të errëta të historisë së saj ka qenë në Europë, ka qenë, shpeshherë, shumë më tepër europiane se shumë vende të tjera, të cilat mëtojnë se janë, porse në mjaft momente nuk kanë qenë apo edhe nuk janë të tilla. Në të vërtetë, shumë prej tyre dhe vetë fuqitë e mëdha kanë punuar për t’i zgjatur jetën sundimit osman në Ballkan. Me politikën e tyre të ruajtjes së status kuos në Turqinë europiane ata mbajtën një qëndrim kundëreuropian të theksuar. Sot me përpjekjet për t’i zgjatur jetën mbeturinave të asaj politike, në të vërtetë, po mbahet një qëndrim i theksuar antieuroatlantik.

Shqiptarët, duke ecur në rrugën e Besëlidhjes Shqiptare si skënderbegas, si shqiptarë të pandarë dhe jo si “shiftari” dhe “allbanci”, do të

zënë, përmes shqiptarisë, vendin që, historikisht, e kanë dhe u takon ta kenë në Europë.

Mesazhi historik i Lidhjes së Prizrenit shtron para nesh kërkesën objektive për një qëndrim aktiv ndaj tij, në përputhje me ecurinë e zhvillimeve të çështjes kombëtare mbarëshqiptare në rrafsh ndërkombehtar në rrugën e zgjidhjes së saj përfundimtare, hap pas hapi, në një të ardhme të afërt.

Gazmend Shpuza

THE ACTUALITY OF THE ALBANIAN LEAGUE OF PRIZREN

(Summary)

When speaking about the historical and current importance of the Albanian League of Prizren we must bear in mind the major objectives, which stood in front of it (these objectives were properly understood since the first days of the establishment of the League). The League led the struggle of the Albanian nation for national liberation, for the defence of the wholeness of the Albanian territories and their unification within a state formation (be it an autonomous formation within the Ottoman Empire). The setting of very high objectives, which were to be pursued by the League (it fought for their accomplishment for almost 3 years), determine the historical and current importance of the Albanian League of Prizren.

غزمند شپوزا

أهمية رابطة بريزن في الوقت الحالى

(خلاصة البحث)

عندنا نتحدث عن الأهمية التاريخية و كذلك أهمية رابطة بريزن الالبانية في الوقت الحاضر يجب علينا مراعاة الواجبات الرئيسية التي أخذتها على عاتقها في مرحلتها الأولى. هي قامت بخوض الحرب في ثلاثة اتجاهات رئيسية: التحرير القومى و الدفاع عن وحدة الاراضى الالبانية و اتحادها في وحدة سياسية ذات سيادة اقليمية في اطار تطوير المسألة الشرقية في ذلك الوقت. هذه كانت المهام الرئيسية التي وضعتها امامها و التي حاربت لمدة ثلاث سنوات لتحقيقها.

HISTORI ISLAME

Amr Halid

KATËR KALIFËT E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT alejhi selam

Falënderimi qoftë për Allahun e Madhëruar, Zotin e gjithësisë. Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë, falje dhe udhëzim kërkojmë. Atë që Allahu e udhëzon, nuk ka kush që mund ta humbë e atë që Ai nuk e udhëzon, nuk ka kush që mund ta udhëzojë.

Prezantimi i Ebu Bekrit dhe i cilësive të tij

Para se të flasim për Ebu Bekrin, Allahu qoftë i kënaqur me të, dua të parashtoj një pyetje: Cila është mrekullia e Islamit?

Çdo Pejgamber pati mrekullinë e vet, çdonjëra prej tyre e jashtëzakonshme, jashtë normave të ligjeve të fizikës që dominojnë në natyrë. Këto mrekulli kanë impresionuar bashkëkohësit e çdo Pejgamberi. Mrekullia e Isait alejhi selam ishte shërimi i të sëmurëve dhe ringjallja e të vdekurve, shërimi i njerëzve të sëmurë me sëmundje sysh dhe shërimi i të verbërve, kurse mrekullia e Musait alejhi selam ishte shkopi me të cilin ai çau detin në dysh. Ky shkop madje shndërrohej edhe në gjarpër.

Cila është mrekullia e Islamit?

Besoj se të gjithë e dimë që nga vegjëlia se mrekullia e Islamit është Kur'anit. Por, ku është mrekullia në Kur'an? Mrekullia e Kur'anit është në retorikën e tij. Kjo është e vërtetë, por ka edhe mrekulli të tjera. Ai që e merr këtë libër si libër jete arrin të bëhet njeri prej njerëzve më madhështore në këtë botë. Kur sheh se njerëz të rëndomtë, pasi morën Kuranin si kushtetutë jete, u shndërruan nga skllëvër në zotërinj që dominuan në botë dhe shndërrohen në zotërinj të kësaj bote edhe sot, kjo është mrekullia më e rëndësishme. Atëherë, mrekullia është te vetë njerëzit, të cilët e marrin Kur'anin si kushtetutë jete. Në këtë rast ne shndërrohemi pa dyshim në zotërinj të botës. Ja, fjala vjen, Sad bin Ebi Vekasi, një njeri i rëndomtë, kur e mori Kur'anin si kushtetutë jete u shndërrua në një komandant brilant në histori. Ai i priu ushtrisë myslimane në luftën e Kadisisë, pas së cilës e tërë Persia, vendi i idhujtarisë dhe i adhurimit të zjarrit, u shndërrua në një vend ku Islami dominon prej shekujsh. Mrekullia e Kur'anit është kur një njeri si Omer bin Hatabi, i cili varros bijën e tij të gjallë në dhe (traditë e arabëve para Islamit), e shndërron në një njeri që zë vend të madh e të padiskutueshëm në faqet e historisë kur flitet për politikë, sociologji, ekonomi, art luftarak dhe oratori. Një ditë prej ditësh, ky njeri arrin të bëhet komandant suprem i mbarë Gadishullit Arab, i Egjiptit, i Shamit, i Irakut dhe i vendeve të tjera islame.

Kur një tregtar i thjeshtë si Ebu Bekri, falë mrekullisë së Kur'anit, shndërrohet në simbol të burrërisë, të sakrificës dhe të bujarisë, kjo është mrekullia e Kur'anit. Kur'anit e shndërron njeriun e thjeshtë e të pavlerë në një njeri që i prin mbarë botës dhe që e mbush tërë botën me drejtësi, mëshirë dhe humanizëm, pasi më parë ishte plot tirani, shtypje dhe padrejtësi.

Është shumë vështirë të flitet për Ebu Bekrin, Allahu qoftë i kënaqur me të. Cila fjalë do t'ia jepte hakun këtij njeriu madhështor?

Ebu Bekri është fjalor i moralit, i trimërisë dhe i madhështisë. Cila fjalë mund ta vlerësojë dhe ta definojë këtë njeri?

Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të

Emri i tij është Abdullah, nofka e tij është Ebu Bekër, babai i tij është Kuhafa. Është thirrur edhe me nofkën “El-Atik”, të cilin thuhet se ia ka dhënë Pejgamberi alejhi salam. Thuhet se Pejgamberi alejhi salam e pa Ebu Bekrin dhe u tha shokëve të tij: “Kush dëshiron të shohë të falurin e Allahut nga zjarri (atik ki-lahi), le të shikojë Ebu Bekrin.”

Thuhet gjithashtu se kjo nofkë i është dhënë Ebu Bekrit para Islamit, në kohën e xhahilietit, për shkak të pamjes së tij simpatike dhe për moralin e tij të lartë. Lidhja e bukurisë me moralin qëndron në faktin se një send shumë i vlefshëm tek arabët quhej “muatak”, ndërsa ai send që ishte i vlefshëm dhe i vjetër quhej “atik”. Ebu Bekri kishte moral të mirë edhe para Islamit, prandaj është quajtur “atik”. Ai është quajtur edhe Es-Sidik sepse i ka besuar Pejgamberit alejhi salam kur i treguan lajmin se Pejgamberi alejhi salam kishte shkuar në Isra dhe në Miraxh. Ndërkohë që banorët e Mekës e përgënjeshtrojnë Muhamedin alejhi salam, Ebu Bekri e besoi atë menjëherë. Nëna e tij, Umulhair Selma bint Sahr, ishte prej të parëve që pranoi Islamit në Darul Erkam, ndërsa babai i tij, Ebu Kuhafa, e pranoi Islamit vonë, në ditën e çlirimit të Mekës. Nga fundi i jetës së tij ai humbi edhe dritën e syve. Ai vdiq gjashtë muaj pas Ebu Bekrit, në moshën 97-vjeçare.

Fisi i Ebu Bekrit

Ebu Bekri është nga fisi Beni Temim. Beni Temimët janë nga familjet e kurejshëve. Ai pra është kurejsh dhe me Pejgamberin alejhi salam takohet te gjyshi i gjashtë, Bin Keabi. Familja Beni Temim ishte përgjegjëse për pagimin e gjobave, për borxhet dhe për gjakun e ndokujt, nëse personat përgjegjës nuk arrinin t’i paguanin ato. Para Islamit, Ebu Bekri ishte ndër dhjetë personat më të rëndësishëm në Mekë dhe ishte përgjegjës për përgjegjësitë e fisit të vet.

Mosha e tij

Ebu Bekri u lind dy vjet e disa muaj pas vitit të elefantit. Ai ishte dy vjet e disa muaj më i ri se Pejgamberi alejhi salam. Kjo do të thotë se në kohën e shpalljes së parë të Islamit ai ishte 38-vjeç. Këtu dua të theksoj një çështje. Ebu Bekri e filloi jetën e rëndësishme në moshën 38-vjeçare, prandaj ti djalë i ri fetar mos i humb shpresat që ta mësosh fenë tënde, Kur’anin dhe shkencat fetare, edhe pse ke shkuar në këtë moshë.

Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të, emigroi nga Meka në Medinë me Pejgamberin alejhi salam 13 vjet pas shpalljes së Kur’anit. Në këtë kohë ai ishte 53-vjeç, ndërsa kur ishte 61-vjeç u zgjodh kalif i myslimanëve. Në detyrën e kalifit ai qëndroi për dy vjet e disa muaj dhe ndërroi jetë kur mbushi 63-vjeç. Ai kishte të njëjtën moshë si Pejgamberi alejhi salam, madje vdiq edhe në të njëjtën ditë, në ditën e hënë, si Pejgamberi alejhi salam. Duke qenë se ai kishte një dëshirë të madhe që ta pasonte Pejgamberin alejhi salam në çdo hap të jetës, Allahu i Lartësuar ia mundësoi që edhe në vdekje të jetë si ai.

Bashkëshortet dhe fëmijët e tij

Ebu Bekri kishte dy gra në xhahiliet e dy gra në kohën e Islamit. Gruaja e parë e tij në xhahiliet ishte Kutejle bint Abdul Uza. Nuk është e sigurt se a e pranoi ajo Islamit apo jo. Disa thonë po, ndërsa disa e mohojnë. Thuhet se Ebu Bekri u nda prej saj, sepse ajo nuk dëshoi të pranonte Islamit. Ajo i lindi Abdullah bin Ebu Bekrin. Ai ishte djali i tij i madh, ai që i transmetonte lajmet e kurejshëve Pejgamberit alejhi salam kur ishte në shpellën Thevr. Ai e pranoi Islamit në fillim të thirrjes islame, mori pjesë në luftërat e Pejgamberit alejhi salam dhe vdiq në kohën e kalifatit të babait të tij. Ebu Bekri e varrosi me duart e veta. Kur vdiq Abdullahu, biri i kalifit, në ditën që vdiq ai kishte gjashtë dërrhemë.

Esma ishte bija e Ebu Bekrit dhe e Kutejles dhe motër e Aishes nga babai.

Gruaja e dytë e Ebu Bekrit quhej Umu Ruman. Ajo e pranoi Islamin herët, emigroi, dha besën për Islam dhe ishte prej besimtareve të dalluara. Ajo i lindi Ebu Bekrit dy fëmijë: Abdurrahmanin dhe Aishen. Abdurrahmani e pranoi Islamin vonë. Ai mori pjesë në luftën e Bedrit dhe të Uhudit kundër myslimanëve, duke luftuar kundër të atit në këto dy beteja, por pas luftës së Uhudit e pranoi Islamin dhe u bë prej myslimanëve të devotshëm. Ai mori pjesë në luftëra të shumta nën flamurin islam. Nën udhëheqjen e Halid bin Velidit ai mori pjesë në çlirimin e Irakut, në luftën e Jemames dhe të Shamit.

Gruaja e tretë

Me Esmā bint Umejsën ai u martua pasi ajo pranoi Islamin. Ajo i lindi Muhamed bin Ebi Bekrin. Esmā bint Umejsa u martua më shumë se me një sahab. Ajo ishte grua e Xhafer bin Ebi Talibit, Allahu qoftë i kënaqur me të, dhe i lindi tre fëmijë atij. Pas rënies dëshmor të Xhaferit, ajo u martua me Ebu Bekrin. Kur vdiq Ebu Bekri, kufomën e tij e pastroi dhe e veshi me qefin gruaja e tij, Esmā bint Umejsa, sipas porosisë së tij. Kjo ishte grua e parë në Islam që pastroi dhe përgatiti burrin e vet me qefin. Pas vdekjes së Ebu Bekrit, ajo u martua me Ali bin Ebi Talibin, Allahu qoftë i kënaqur me të.

Gruaja e katërt

Ajo quhej Habibe bint Zejd El-Hazrexhi dhe ishte nga Hazrexhi. Kur vdiq Ebu Bekri, ajo ishte shtatzënë dhe i lindi një vajzë, Umu Kulthum bint Ebi Bekrin. Me këtë fëmijë Ebu Bekrit i bëhen gjashtë fëmijë, tre djem dhe tri vajza.

Pamja fizike i tij

Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të, kishte trup të thatë dhe këmbë të holla, pak mish në kofshë dhe sy të thelluar në gropën e fytyrës. Ai nuk ishte as i gjatë e as i shkurtër dhe kishte një kërrusje të lehtë. Ebu Bekri ishte i bardhë, mjekrën e lyente me këna, kishte ballë

të gjerë e të qartë dhe hundë të ngrehur e të mprehtë, që në të njëjtën kohë ishte edhe cilësi e Ebu Bekrit. Karakteristikat e trupit të tij reflektoheshin edhe në personalitetin e tij.

Cilësitë e tij

Ndër cilësitë kryesore të Ebu Bekrit para Islamit ishte se ai asnjëherë nuk i bëri sexhde ndonjë idhulli. Tregohet se një herë babai i tij e mori me vete që të madhëronte një idhull dhe t'i binte në sexhde. Ai e la aty e shkoi, ndërsa Ebu Bekri nisi t'i shikonte me vëmendje idhujt një nga një. Më vonë nisi t'u thoshte: "Më ushqeni, më jepni të pi, më jepni të vishem", por idhujt nuk përgjigjeshin. Atëherë, ai mori një gur dhe filloi t'i godasë, derisa e rrëzoi idhullin dhe e theu. Që nga ajo ditë ai asnjëherë nuk iu afrua ndonjë idhulli në jetën e tij. Njëherë mekasit i thanë: "O Ebu Bekër, a nuk i bie në sexhde Latit dhe Uzasë (dy idhujve më të mëdhenj në Mekë)?" Ebu Bekri u tha: "Kush janë Lati dhe Uzaja?" Kurejshët i thanë: "Dy bijat e Zotit!" Atëherë ai u tha: "E kush është nëna e tyre?" Kurejshët heshtën e s'bënë zë.

Nuk piu kurrë alkool

Ebu Bekri ishte 38-vjeç kur u shpall Islami dhe megjithatë asnjëherë nuk kishte pirë asnjë pikë alkool. Kur e pyetën për këtë, ai u përgjigj se ruante nderin e vet. Thuhet se një ditë ai pa një njeri duke pirë alkool e në të njëjtën kohë merrte ndyrësi nga toka dhe i fuste në gojën e tij. Që nga ai çast, Ebu Bekri u betua se asnjëherë nuk do ta përbuzte veten në këtë shkallë.

I dashur për të gjithë njerëzit

Ebu Bekri para Islamit ishte shumë i dashur për njerëzit dhe gëzonte një respekt e pozitë të veçantë në mesin e mekasve. Ebu Bekri ishte njeriu më i ditur i kurejshëve për nga origjina e familjeve kurejshë dhe kjo ndikoi pozitivisht në rrjedhën e thirrjes islame më vonë. Kur shoqëronte Pejgamberin alejhi selam në ndonjë vizitë fiseve ose

familjeve të ndryshme, ai i tregonte Pejgamberit alejhi selam për detajet e atyre familjeve, duke ia lehtësuar Pejgamberit alejhi selam hyrjen në mesin e shumë familjeve për të paraqitur thirrjen e tij.

Një ditë, Pejgamberi alejhi selam shkoi te një fis, pjesëtar i të cilit ishte edhe një poet që quhej Zahir. Ebu Bekri i tregoi për të Pejgamberit alejhi selam dhe në momentin e përshëndetjes së Pejgamberit alejhi selam me anëtarët e këtij fisi, kur i erdhi radha Zahir, Pejgamberi alejhi selam tha: “Poeti, apo jo?” Zahir tregon e thotë se nuk qe gëzuar ndonjëherë në jetën e tij më shumë se atë ditë kur erdhi Pejgamberi alejhi selam te fisi i tij dhe e njohu.

Tregtar që shëtiste mbarë Gadishullin Arabik

Kjo karakteristikë është shumë e rëndësishme, ngase ky profesion e ndihmoi atë të njohë personalitetet e njerëzve. Ebu Bekri ishte i pasur. Pasuria e tij në kohën e paraqitjes së Islamit ishte dyzet mijë derhemë, në kohën e emigrimit pasuria e tij ishte pesë mijë derhemë, kur u bë kalif i besimtarëve nuk kishte asgjë, ndërsa kur vdiq kishte gjashtë mijë derhemë, që do të thotë se tërë pasurinë e tij ai e shpenzoi në rrugë të Allahut xh.xh. për të ndihmuar dhe përkrahur fenë e Tij.

Shok i Pejgamberit alejhi selam

Ndër karakteristikat kryesore të tij është se ai ishte shoku më i ngushtë i Pejgamberit alejhi selam. Thuhet se Ebu Bekri e shoqëroi Pejgamberin alejhi selam në udhëtimin e tij për në Sham, bashkë me xhaxhain e tij, Ebu Talibin. Gjatë këtij udhëtimi ai u takua me murgun Behira.

Çelësi i personalitetit të Ebu Bekrit

Pejgamberi alejhi selam ka thënë: “Imani më i sinqertë është imani i Ebu Bekrit.” Në një hadith tjetër ka thënë: “Imani më i qëndrueshëm është imani i Ebu Bekrit.”

Pejgamberi alejhi selam gjithashtu ka thënë: “Nëse vendoset imani i Ebu Bekrit dhe imani i umetit në anën tjetër, imani i Ebu Bekrit rëndon më shumë”, si dhe: “Ebu Bekri nuk ju ka paraprirë me ndonjë send tjetër vetëm se me atë që ia ka përshkuar zemrën.”

Çelësi i personalitetit të Ebu Bekrit është dashuria për të vërtetën. Kur e gjeti të vërtetën, ai shkriu jetën dhe pasurinë për të. Kur e vërteta u mishërua në personalitetin e Pejgamberit alejhi selam, Ebu Bekri shkriu tërë pasurinë dhe jetën e tij për hir të Pejgamberit alejhi selam. E kur Pejgamberi alejhi selam ndërroi jetë, Ebu Bekri ishte personi i vetëm që kishte vizion të qartë, pasi sjelljet e tij i drejtonte e vërteta. Ebu Bekri i ndoqi hapat e Pejgamberit alejhi selam në çdo aspekt të jetës. Dijetarët janë të një mendimi se i pari që bëri sexhde pas Pejgamberit alejhi selam dhe Hatixhes, Allahu qoftë i kënaqur me të, dhe i pari prej burrave që pranoi Islamit ishte Ebu Bekri, ndërsa i pari prej fëmijëve ishte Aliu, biri i Ebu Talibit, ndërkohë që i pari skllav që pranoi Islamit ishte Zejd bin Harithi, Allahu qoftë i kënaqur me të.

Pas shpalljes, Pejgamberi alejhi selam ia shfaqti Islamit Ebu Bekrit dhe ai e pranoi pa asnjë hezitim. Pejgamberi alejhi selam thotë: “Nuk i kam folur ndokujt për Islamit vetëm se më ka thënë më lejo të mendoj paksa, me përjashtim të Ebu Bekrit. Kur ia shfaqta Islamit, ai pa kurrfarë hezitimi tha “la ilahe il-la Allah, Muhamedu Resulullah”.

Përgjigja e Ebu Bekrit ndaj thirrjes së Pejgamberit alejhi selam nuk ishte përgjigje naive, përshpejtim ose hutim, por shpejtësi drejt së vërtetës, iman i shpejtë. Që nga ajo ditë e vërteta mbushi zemrën e tij.

Ky tip njerëzish, kur sheh të vërtetën, bindet se kjo fe është e vërtetë. Këta njerëz që duan ta jetojnë Islamit duhet të marrin për shebull Ebu Bekrin. Ai nuk na e ka kaluar me më shumë namaz e agjërim, ai na e ka kaluar me atë se kur njohu të vërtetën, jetoi për të

vërtetën me tërë trupin dhe qenien e tij, jetoi për të vërtetën me gjakun e tij, me pasurinë e tij dhe me shpirtin e tij. Ai jetoi për të vërtetën me kohën e tij dhe me mundin e tij, me postin e tij dhe me fëmijët e tij. Ne duhet të marrim mësim nga Ebu Bekri. Kur ta njohim të vërtetën, duhet të jetojmë për të!

Ebu Bekri dëgjoi prej Pejgamberit alejhi selam vetëm disa fjalë dhe menjëherë filloi t'i përhapë ato, që në javën e parë të Islamit. Prej thirrjes së Ebu Bekrit e pranuan Islamin gjashtë prej dhjetë të përgëzuarve me xhenet: Sad bin Ebi Vekasi, Zubejr bin Avami, Talha bin Ubejdullahu, Ebu Ubejde bin Xherrahu, Abdurrahman bin Oufi dhe Uthman bin Afani.

Ishte java e parë e Islamit, kur ai ende nuk kishte mësuar shumë për Islamin. Po halli ynë si është sot, po ne a dimë shumë sot për Islamin?

Dallimi mes nesh dhe Ebu Bekrit është se kur ai e njohu të vërtetën, menjëherë jetoi për të. Kush prej nesh e njeh të vërtetën dhe nuk jeton për të bën gabim të madh.

Ebu Bekri e njohu të vërtetën, e ndjeu dhe punoi për të. Gjashtë të përgëzuarit me xhenet e pranuan Islamin prej thirrjes së Ebu Bekrit dhe shpërblimet e punëve të mira të tyre do të regjistroheshin në llogarinë e Ebu Bekrit, Allahu qoftë i kënaqur me të, si: xhahadi i Ebu Ubejde bin Xherrahut, çliruesit të Shamit, xhahadi i Sad bin Ebi Vekasit, çliruesit të Irakut, i cili i dha fund perandorisë së Persisë etj.

Thirrjes së Ebu Bekrit iu përgjigjën shumë prej atyre që shkonin në Darul Erkam dhe Uthman bin Madhun.

Jo vetëm kaq, por Ebu Bekri menjëherë filloi të lironte dhe të blinte lirinë e myslimanëve të robëruar. Shtatë nga robërit e liruar e pranuan Islamin, e në mesin e tyre ishte edhe Bilal bin Rabahu, skllav i Umeje bin Kalefit, i cili e ndëshkonte dhe e torturonte. Kur një ditë Ebu Bekri kaloi pranë tij, i tha: "O Umeje, mëshiro të mjerin!" Umeja i tha: "Mëshiro ti." Ebu Bekri i tha: "Po! Sa dëshiron për të?" Umeja i tha se e shiste për nëntë vakin (copa ari) dhe Ebu Bekri i tha: "Unë e blej atë." Në atë rast, Umeje bin Kalefi qeshi dhe tha: "A e di o Ebu Bekër, se sikur të thoshe për një të katërtën e vakijes së arit, do të ta

shisja." Kurse Ebu Bekri i tha: "Vallahi o Umeje, sikur të kërkoje prej meje njëqind vakije ari, do të ta blija."

Ebu Bekri e liroi Bilalin dhe vazhdoi të blinte edhe robërit e tjerë, fëmijë e gra robëresha, e ua falte lirinë. Babai i tij e qortoi duke i thënë: "Ti blen vetëm të dobët e gra dhe fëmijë. Bli robër të fortë!", por Ebu Bekri ia ktheu se e bënte këtë për hir të Allahut xh.xh..

Kurejshët kishin përhapur thashetheme se Bilali i kishte kryer një punë të mirë Ebu Bekrit para Islamit dhe për atë arsye Ebu Bekri e bleu që t'ia kthejë mirësinë që i kishte bërë më herët, por Allahu xh.xh. thotë në Kuran: "***E jo për ta shpërblyer dikë që i ka bërë mirë më parë, por vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit të vet, më të Lartit. Për Zotin, ai do ta gëzojë atë kënaqësi!***" (El-Lejl, 19-21)

Shohim se të gjitha ajetet e sures El-Lejl flasin për Ebu Bekrin dhe cilësitë e tij. Lexo:

"Pasha natën që me errësirë mbulon gjithësinë! Pasha ditën kur ajo shkreptin! Pasha Atë që krijoi mashkullin e femrën! Vërtet, veprimi juaj është i llojllojtë. E sa i përket atij që jep dhe ruhet dhe vërteton bindshëm për më të mirën, Ne do ta përgatisim atë për më të lehtë. E sa i përket atij që bën koprraci dhe ndien veten të pavarur (nga Zoti), dhe që mohon atë më të mirën, Ne do ta përgatisim për më të vështirën. E pasuria e tij nuk do t'i bëjë dobi, kur ai të zhduket. Detyrë e Jona është vetëm të udhëzojmë. Dhe vetëm e Jona është bota tjetër si dhe kjo. Unë ua kam tërhequr vërejtjen për zjarrin e ndezur fort. Që aty nuk hyn tjetërkush, pos atij që është më i prishuri, i cili përgënjeshtroi dhe u zmbrops. Ndërsa ai që është më i devotshëm do të jetë larg tij. Ai që e jep pasurinë e vet e pastrohet, por vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit të vet, më të Lartit. Për Zotin, ai do ta gëzojë atë kënaqësi!" (El-Lejl)

Më trimi

Me gjithë trupin e tij të dobët, ai ishte shumë i fortë në të vërtetën dhe nuk i trembej askujt për hir të Allahut. Kur e pyetën Ali bin Ebi Talibin: “Kush është më trimi? A je ti?”, ai tha: “Jo. Ebu Bekri. Pasha Allahun xh.xh., e kam parë Muhamedin alejhi selam se si ishte në mesin e qafirëve, se si e tërhiqnin dhe e shtynin andej e këndej dhe ne e shikonim nga larg. Kur erdhi Ebu Bekri, i vetëm shkoi dhe i largoi ata prej tij dhe e mbronte Pejgamberin alejhi selam dhe u thoshte: “A do ta vrisni njeriun pse thotë Allahu është Zoti im?”

Atëherë e lanë Pejgamberin alejhi selam dhe kapën Ebu Bekrin. Erdhi Ukbe bin Ebi Muiti dhe e hodhi Ebu Bekrin me shpinë për tokë, hoqi nallanet e tij dhe filloi të godiste fytyrën e Ebu Bekrit, derisa iu ënjt fytyra, saqë nuk i dihej se ku ishte hunda. Gjaku i rridhte nga fytyra dhe ai u alivanos nga goditjet e rënda dhe të shumta. Më vonë familja Beni Temim erdhi dhe e mori dhe e dërgoi në shtëpinë e tij. Ata mendonin se me siguri do të vdiste, prandaj i thanë nënës së tij se nëse jeton, jepi të hajë dhe të pijë. Pastaj shkuan te Ukbeja dhe e kërcënuan se në rast se Ebu Bekri do të vdiste, ata do të merrnin hak.

Sapo hapi sytë, Ebu Bekri menjëherë pyeti se çfarë kishte ndodhur me Pejgamberin alejhi selam. Nëna e tij, e cila ende nuk e kishte pranuar Islamin, i tha: “Ende e mban mend atë?!” Ai i tha: “Pasha Allahun, as nuk ha e as nuk pi derisa të më qetësohet zemra për Pejgamberin alejhi selam. Shko tek Umu Xhemil, Fatma bint El-Hatabi, merr ndonjë lajm dhe më qetëso në lidhje me Pejgamberin alejhi selam.”

Ajo shkoi te Fatma bint El-Hatabi, e cila ende e mbante Islamin fshehtazi, por ajo i tha se nuk dinte gjë për Muhamedin e as për djalin e saj, por nëse dëshironte që të shkonte e të shihte e të qetësohej për Ebu Bekrin, mund të shkonte. Ajo shkoi me nënën e Ebu Bekrit dhe Ebu Bekri e pyeti se si ishte Muhamedi alejhi selam. Ajo i tha se nuk e dinte se si ishte Pejgamberi alejhi selam. Ebu Bekri i tregoi se ajo ishte nëna e tij dhe atëherë ajo i tha se Pejgamberi alejhi selam ishte

mirë. Ebu Bekri tha: “Pasha Allahun, as nuk ha bukë e as nuk pi ujë derisa ta shoh Pejgamberin alejhi selam me sytë e mi dhe të qetësohem.” Ajo i tha: “Prit derisa të ndalen këmbët (të mos ketë njerëz në rrugë).” Ebu Bekri u ngrit duke u mbajtur tek ato të dyja, ngase nuk mund të qëndronte vetë në këmbët e tij, derisa shkoi në Darul Erkam. Trokiti në derë dhe dera u hap. Ebu Bekri e pa Pejgamberin alejhi selam, ndërsa Pejgamberi alejhi selam e mori në gjoksin e tij duke e përkëdhelur. Kur Ebu Bekri pa se si Muhamedi alejhi selam e përkëdhelte dhe si i dhimbsej atij, i tha: “O i Dërguari i Allahut, nuk më ka ndodhur ndonjë gjë, vetëm se fytyra paksa është lënduar.” Atë çast, Pejgamberi alejhi selam ia përkëdheli fytyrën dhe u lut për Ebu Bekrin, Allahu qoftë i kënaqur me të.

Ebu Bekri atëherë i tha Pejgamberit alejhi selam: “O i Dërguari i Allahut, lutu për nënën time që ta pranojë Islamin!” Atëherë, Pejgamberi alejhi selam tha: “O Zot, udhëzoje nënën e Ebu Bekrit!” Në atë çast, nëna e Ebu Bekrit tha: “La ilahe il-la Allah, Muhamedu Resulullah!”

Qëndrimi i Ebu Bekrit në Islam

Biseda rreth qëndrimit të Ebu Bekrit në Islam njëkohësisht paraqet në mënyrë të kristalizuar se sa e deshi ky burrë Islamin dhe sa shumë bëri dhe flijoi për këtë fe. Nga kjo vërehet qartë se ky burrë ia ka dedikuar veten tërësisht Islamit, vetëm e vetëm që të lartësohet fjala e kësaj feje. Biseda rreth qëndrimit të Ebu Bekrit ka për qëllim të motivojë çdo mysliman që të kryejë detyrat e veta ndaj fesë islame, që Ebu Bekri të jetë shembull praktik i asaj se çfarë duhet të bëjë një besimtar për Islamin.

Në ditën e Israsë dhe të Miraxhit

Në kohën kur nuk kishte mjete transporti të shpejta, si sot, ishte e pamundshme të besohet se ndonjë njeri ka shkuar në Jerusalemin nga Meka brenda natës dhe ishte kthyer nga atje, ndërsa shtrati i tij ishte ende i ngrohtë, siç e kishte lënë. Kështu, disa prej atyre që nuk kishin

shumë kohë që e kishin pranuar Islamin, sa dëgjuan për këtë rast, u larguan nga Islami. Kurejshët morën të gjitha masat që ta shfrytëzonin këtë ngjarje në maksimum për të bërë kurthe e komplete kundër Pejgamberit alejhi selam, me qëllim që të largonin sa më shumë njerëz nga Pejgamberi alejhi selam. Ata shkuan dhe i thanë Ebu Bekrit: “A e di se çfarë po thotë shoku yt? Ai thotë kështu e kështu, se brenda natës i paska ndodhur Israja dhe Miraxhi.” Ebu Bekri ia ktheu: “A e ka thënë ai një gjë të tillë?” Thanë: “Po!”

“Nëse ai e ka thënë një gjë të tillë, atëherë ai thotë të vërtetën.” I thanë: “A po e beson për këtë?” Tha: “Unë i besoj atij edhe më shumë se kjo! Ejani të shkojmë së bashku tek ai.” Pejgamberi alejhi selam tregonte se çka i kishte ndodhur atij në Isra dhe Miraxh, kurse Ebu Bekri thoshte: “E vërtetë është, ti thua të vërtetën, unë dëshmoj se ti je i Dërguari i Allahut xh.xh..” Pejgamberi alejhi selam në këtë rast i tha: “O Ebu Bekër, ti vërtet je besimtar i besueshëm, Sidik, në fqinjësinë e Atij që është më i ndershëm dhe më bujar.”

Kur mushrikët e shtuan zullumin dhe dhunën kundër myslimanëve në Mekë, Muhamedi alejhi selam i dha leje Ebu Bekrit për të emigruar në Etiopi. Kur Ibn Dugne, i cili ishte njëri prej parisë së Mekës, dëgjoi për këtë gjë, ai i ofroi Ebu Bekrit mbrojtjen e vet, që ai të mos shkonte në Etiopi. Ebu Bekri e pranoi mbrojtjen e tij. Ai vazhdoi të lexonte Kur’an dhe të qante gjatë leximit të tij dhe në këtë mënyrë rreth tij afroheshin fëmijë, gra e të tjerë, pasi Kur’ani ndikonte tek ata. Kurejshët kërkuan nga Ibn Dugneja që ta hiqte nga mbrojtja e tij, ose ta ndalonte nga leximi i Kuranit. Ibn Dugneja i tha Ebu Bekrit se do të ishte mirë që të lexonte Kuran në shtëpinë e tij. Ebu Bekri atëherë lexonte Kuran pranë dritares së shtëpisë së tij dhe ata që kalonin atypari e dëgjonin leximin e tij. Edhe në këtë rast kurejshët e Mekës iu ankuan Ibn Dugnes se Ebu Bekri po i shqetësonte me leximin e tij. Ibn Dugneja kërkoi nga Ebu Bekri që të mos lexonte Kuran, por ai refuzoi dhe tha: “Pasha Allahun, do t’ua lexoj Kur’anin njerëzve që ta dëgjojnë. Nuk jam më nën mbrojtjen tënde, por nën mbrojtjen e Atij që është më i Fuqishmi dhe më Bujari.”

Dënesët e tij

Ebu Bekri qante me dënesë kur dëgjonte Kur’an. Kur dëgjonte suren Zelzele, ai qante shumë. Në ditën që po vdiste, Pejgamberi alejhi selam tha: “Thojini Ebu Bekrit t’u prijë njerëzve në namaz.” Aishja i tha: “O i Dërguari i Allahut, Ebu Bekri është i dobët dhe ndikohet nga Kur’ani. Kur ai lexon Kur’an, qan dhe njerëzit nuk mund ta dëgjojnë leximin e tij. Urdhëro Omerin që t’ua falë namazin.”

Anëtarët e delegacionit të Jemenit, të cilët kishin ardhur te Pejgamberi alejhi selam për t’ia dhanë besën për Islam, kur dëgjuan Kur’anin filluan të qanin. Ebu Bekri u tha: “Edhe ne në fillim kur dëgjonim Kur’anin qanim, para se të na shtangoheshin zemrat!” Kur e tha këtë, atëherë filloi vajin. Kjo ishte gjendja e Ebu Bekrit, po a thua cila është gjendja jonë? Kur është hera e fundit që kemi qarë nga frika e Allahut? Përse zemrat u shtanguan kështu? Përse u shterën lotët? Allahu xh.xh., i Cili krijoi shtatë oqeane dhe nga qielli lëshoi ujin e pashtershëm, Ai do të shohë lotin tënd, prandaj mos u trego koprrac me lotët e tu!

Besim absolut në premtimin e Allahut

Kur persët mundën bizantinët në një betejë, atëherë zbriti Allahu xh.xh. ajetet e sures Er-Rum 1-5.

Kur zbritën këto ajete, Ebu Bekri shkonte në mesin e kurejshëve dhe u thoshte se bizantinët do të fitojnë në luftën e ardhshme kundër persëve. Umeje bin Kalefi e pyeti: “Nga e di këtë dhe a do të vësh bast për këtë? Ebu Bekri tha po. Kur Umeje e pyeti për kohën, ai ia ktheu: “Tre vjet.”

Ebu Bekri shkoi te Pejgamberi alejhi selam e ai i tha se koha është nga tre në nëntë vjet. Ebu Bekri shkoi tek Umeja sërish. Umeja i tha: “A u pendove?” Ebu Bekri ia ktheu: “Jo, vetëm kam ardhur ta rris bastin dhe ta shtoj kohën nga tre në nëntë vjet”

Kaluan vitet dhe erdhi viti i shtatë, në atë vit fituan bizantinët kundër Persisë dhe Ebu Bekri e fitoi bastin. Pejgamberi alejhi selam i tha që fitimin ta shpërndante mes nevojtarëve.

Ky tregim është një portret për çdo mysliman, për çdo të ri, për ata që turpërohen ta paraqesin fenë e tyre dhe të flasin me të vërtetën dhe për të, për ata që turpërohen ta mbajnë Kuranin në fakultetet e tyre dhe për ato që turpërohen të mbajnë hixhabin (shaminë) në kokat e tyre.

Në ditën e hixhretit për në Medinë

Kur myslimanët filluan të emigrojnë drejt Medinës, Ebu Bekri shkoi te Pejgamberi alejhi selam dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, a më jep leje për hixhret?” I Dërguari alejhi selam thotë: “O Ebu Bekër, prit, ndoshta Allahu ka për të të zgjedhur ndonjë shok.” Ai kishte shpresë që të ishte shoku i Pejgamberit alejhi selam në hixhret. Ebu Bekri shkoi dhe bleu dy deve për rrugë dhe i ruante gati për udhëtim, derisa erdhi dita kur Muhamedi alejhi selam shkoi tek Ebu Bekri dhe i tha: “O Ebu Bekër, Allahu më dha leje për hixhret.” Ebu Bekri i tha: “A do të jemi së bashku, o i Dërguari i Allahut?” Ai i tha: “Po, së bashku, o Ebu Bekër.” Aishja tregon se nuk ka parë ndonjë njeri të qante aq shumë nga gëzimi si Ebu Bekri. Ai ishte udhëtim i vdekjes, nuk dihej se a do mbërrinte i gjallë në Medinë, e megjithatë ai gëzohej aq shumë, sepse do të shoqëronte Pejgamberin alejhi selam në këtë udhëtim. Çfarë dashurie është kjo e Ebu Bekrit për Pejgamberin alejhi selam?!

Ebu Bekri mori në këtë udhëtim tërë pasurinë e tij, edhe pse mbrapa la familjen e tij, por atyre nuk u la asgjë, vetëm Allahun xh.xh. dhe Pejgamberin e Tij. Dashuria e tij për fenë e bëri atë të sillet në këtë mënyrë.

Këtë pamje e shohim sot në Palestinë, kur shohim dëshmorët një pas një dhe palestinezët nuk i përshkon pesimizmi, përkundrazi, mburren me dëshmorët e tyre. Madje shtëpia që nuk ka ndonjë dëshmorë ndihet e turpëruar se në mesin e saj nuk ka dëshmor.

Doli Ebu Bekri me Pejgamberin alejhi selam dhe arritën në shpellën Thevr. Kur Pejgamberi alejhi selam deshi të hynte në shpellë, Ebu Bekri i tha: “O i Dërguari i Allahut, më lejo të sigurohem se nuk ka ndonjë gjë në shpellë që të lëndon.”

Hyri Ebu Bekri dhe u sigurua se nuk kishte ndonjë gjë që mund ta lëndonte Pejgamberin alejhi selam. Ebu Bekri griste rrobat e veta që të mbyllte vrimat e shpellës, pastaj hyri Pejgamberi alejhi selam e i tha Ebu Bekrit: “Si i grise rrobat e tua ashtu?” Ebu Bekri i tha: “Frikësohem se mos po të ndodh ndonjë gjë, o i Dërguari i Allahut xh.xh..” Muhamedi alejhi selam vendosi kokën e tij në prehrin e Ebu Bekrit dhe e zuri gjumi. Ndërkohë, Ebu Bekri pa një vrimë dhe e mbylli me këmbën e tij, që të mos e cenonte diçka të Dërguarin e Allahut xh.xh.. Në atë vrimë kishte qenë një akrep, i cili e kafshoi Ebu Bekrin, por ai s’bëri zë fare, që mos t’ia nxirrte gjumin Pejgamberit alejhi selam, por nga dhimbja sytë filluan t’i lotojnë. Atëherë, Pejgamberi alejhi selam u zgjua dhe e pyeti Ebu Bekrin se ç’ndodhi dhe ai i tha: “Të bëhen kurban babai dhe nëna ime, o i Dërguari i Allahut, një akrep më kafshoi.” I Dërguari i Allahut ia përkëdheli këmbën dhe me ndihmën e Allahut këmba u shërua menjëherë.

I dyti në shpellë

Shumë njerëz e kanë lëvdur Ebu Bekrin, por askush nuk e ka lëvdur më shumë e më mirë sesa Allahu xh.xh., kur tha në suren Tevbe 40: “Thani ithnein”, i dyti i të dyve. Lum ti, o Ebu Bekër! Allahu xh.xh. e ka dëshmuar shoqërinë tënde ndaj Pejgamberit alejhi selam. Lum ti, o Ebu Bekër! Allahu xh.xh. të ka lëshuar prehjen në zemrën tënde, nderim për ty. Qetësoje zemrën tënde të shqetësuar për thirrjen e fesë islame dhe për Pejgamberin alejhi selam.

Prandaj thoshte Omer bin Hatabi, Allahu qoftë i kënaqur me të: “Një natë nga netët e Ebu Bekrit- ka për qëllim natën e hixhretit- është më e mirë se netët e familjes së Hatabëve, që mbulojnë tërë tokën.” Pastaj thotë: “Ah, sikur të isha qime në gjoksin e Ebu Bekrit!”

A nuk i merr malli myslimanët gra e burra që t'i takojnë këta njerëz madhorë, që ndërtuan këtë botë me këtë fe? Ebu Bekri nuk është madhështor vetëm për myslimanët, por ai është madhështor ndër më madhështorët e njerëzimit. Pasha Allahun xh.xh., nuk ka ndonjë njeri më madhështor mbi rruzullin tokësor pas Pejgamberëve sesa Ebu Bekri.

Këtë fjalë ua themi të rinjve që lexojnë kujtimet e Madonës e të Pelesë, ose librin “Lufta ime” të Hitlerit. Le ta lexojnë historinë e Ebu Bekrit dhe të mishërohen me Ebu Bekrin.

Piu derisa u ngopa

Ebu Bekri qëndroi me Pejgamberin alejhi selam në shpellë. I kishte kapur uria dhe etja, kur atypari kaloi një bari. Ebu Bekri i kërkoi pak qumësht, ndërsa ai u përgjigj se kishte vetëm pak. Ebu Bekri e mori dhe shkoi e ia dha Pejgamberit alejhi selam dhe ai e piu. Thotë Ebu Bekri duke treguar këtë rast: “Piu Pejgamberi alejhi selam derisa u ngopa.”

Çfarë dashurie është kjo? Pejgamberi alejhi selam pi qumështin, kurse Ebu Bekri ngopet!?

Pastaj vazhduan rrugën e tyre së bashku për në Medinë. Ebu Bekri ishte tregtar i njohur. Kush e takonte, e pyeste se kush ishte ai njeri bashkë me të. Ai u përgjigjej se ishte një udhëzues i tij, se i mësonte rrugën. Kjo ishte përgjigje disi diplomatike, për të mos treguar se ai ishte Pejgamberi alejhi selam. Në të vërtetë, Muhamedi alejhi selam ishte udhëzues i tij në jetë, udhëzues në rrugën e vërtetë, në rrugën e xhenetit.

Thoshte Omeri: “Ebu Bekrit i vinte era e miskut në kohën kur unë isha më i humbur se kafshët e babait tim.”

Unë jam një njeri, kurse ti je kjo fe

Gjatë rrugës, tërë kohën Ebu Bekri rrinte duke ecur rreth Pejgamberit alejhi selam, herë djathtas e herë majtas, herë para e herë mbrapa, ndërsa Pejgamberi alejhi selam ishte i thelluar në recitim e Kur’anit. Në një moment ai i thotë: “Ç’ke, o Ebu Bekër?”

Dhe Ebu Bekri i përgjigjet: “Më shkon mendja se ndoshta kemi ndonjë pritë para dhe dal para, pastaj më shkon mendja se ndoshta ke ndonjë gjë mbrapa, e kthehem mbrapa. Pastaj frikësohem se do gjuajë dikush nga e djathta e dal andej, ose dikush nga e majta e dal andej dhe kthehem.” Pejgamberi alejhi selam i thotë: “A më do, o Ebu Bekër?” Tha: “Po.” Tha Pejgamberi alejhi selam: “A vdes në udhën time?” Tha: “Po. Nëse vdes unë, jam vetëm një njeri, e nëse ti vdes, ti je kjo fe.”

Edukatë e pashoqe

Ebu Bekri e shoqëroi Pejgamberin alejhi selam derisa mbërritën në Medinë. Ensarët kishin dalë ta prisnin Pejgamberin alejhi selam, por nuk e njihnin atë. Ensarët në fillim menduan se Ebu Bekri, i cili kishte dalë dhe i printe Muhamedit alejhi selam dhe ia hapte rrugën, ishte i Dërguari alejhi selam, prandaj filluan ta merrnin për litari devenë e Ebu Bekrit. Ai e kuptoi situatën, prandaj mori mbulesën e tij dhe ia vendosi Pejgamberit alejhi selam që t’i bënte hije dhe atëherë ensarët e kuptuan dhe morën devenë e Pejgamberit alejhi selam.

Në ditën e takimit të të dy grupeve

Kaluan ditët dhe erdhi dita e betejës së Bedrit. Abdurrahman bin Ebi Bekri ende nuk kishte pranuar Islamin. Ai mprehu shpatën dhe tha: “Kush më del në dyluftim?” Ebu Bekri u ngrit dhe tha: “O i Dërguari i Allahut, unë do t’i dal.” Pejgamberi alejhi selam i tha: “Jo, o Ebu Bekër, më argëto me shoqërinë tënde (më kënaq me jetën tënde duke jetuar pranë meje).” Atëherë ai tha: “Si të thuash, o i Dërguari i

Allahut xh.xh.” Kur kaloi ajo kohë dhe Abdurrahmani e pranoi Islam, ai i tha babait të tij: “A e di o baba, në ditën e luftës së Bedrit, kur të shihja, fshihesha që mos të të dilja përpara e mos të të luftoja.” Kurse Ebu Bekri i tha: “Pasha Allahun, nëse do të të shihja para meje, do të të vrisja.”

Ebu Bekri me trup të dobët kishte zemër gjigante. Urtësia e Allahut xh.xh. deshi që ky trup i dobët të mbante brenda një zemër të fortë, që të turpërohen të gjithë ata që kanë trup të madh ose të dobët, të gjithë ata që kanë pasuri e poste, që edhe këta të luftojnë e të përpiqen për rrugën e Allahut dhe ta lartësojnë Fjalën e Tij.

Në ditën e Bedrit, Ebu Bekri tregoi trimëri të rrallë. Sahabët menduan t’i ndërtonin një strehimore Pejgamberit alejhi selam që ta mbronin nga kurejshitet. Kur e ndërtuan atë, diskutuan se kush do ta mbronin Pejgamberin alejhi selam. Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon: “Ne u tërhoqëm, kurse Ebu Bekri tha: “Unë e ruaj dhe e mbroj Pejgamberin alejhi selam.” E në të vërtetë, gjatë tërë betejës së Bedrit ai e mbrojti Pejgamberin alejhi selam.

Aspiratat e Ebu Bekrit ishin të jashtëzakonshme. Ai e dëshironte shumë xhenetin, bile xhenetin Firdeus.

Një ditë, Pejgamberi alejhi selam ishte ulur në mesin e sahabëve të tij dhe u tregonte se çdo banor i xhenetit do të thirret në njërin nga dyert e xhenetit; kush ka qenë prej falësve të namazit, do të thirret në derën e namazit, e kush ka qenë prej agjëruesve, do të thirret në derën e agjërimit, që quhet Rejan. Kush ka qenë prej atyre që ka bërë xhihad, do të thirret në derën e xhihadit, ndërsa kush ka qenë prej atyre që kanë dhënë sadaka, do të thirret në derën e sadakasë. Ebu Bekri i tha: “O i Dërguari i Allahut, a ka mundësi që dikush nga njerëzit të thirret nga të gjitha këto dyer?” Pejgamberi alejhi selam tha: “Po, o Ebu Bekër, shpresoj se ti do të jesh prej tyre.”

I përgëzuar me xhenet

Një ditë, Pejgamberi alejhi selam fali namazin e sabahut dhe nisi t’i shikonte sahabët e tij. Ai e kishte për traditë ta sprovonte imanin e sahabëve të tij, prandaj i pyeti: “Kush agjëron sot?” Heshtën. Omeri tha: “Unë, o i Dërguari i Allahut xh.xh., nuk e kam bërë nijet mbrëmë agjërimin”, ndërsa Ebu Bekri tha: “Unë jam agjërueshëm sot, o i Dërguari i Allahut.” Pastaj Pejgamberi alejhi selam i pyeti: “Kush prej jush ka vizituar ndonjë të sëmurë sot?” Omeri tha: “O i Dërguari i Allahut, dolëm nga shtëpitë tona për në namaz në xhami, ku të bëjmë vizitë në këtë kohë?!” kurse Ebu Bekri tha: “Unë, o i Dërguari i Allahut xh.xh., dola nga shtëpia për në xhami. Dëgjova se Abdurrahman bin Oufi ishte i sëmurë dhe e dija se ai zgjohet për namazin e sabahut dhe e vizitova dhe erdha për namaz.” Tha Pejgamberi alejhi selam: “Kush prej jush ka dhanë sadaka sot?” Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, sërish tha: “O i Dërguari i Allahut xh.xh., dolëm nga shtëpitë tona për namaz, kujt t’i japim sadaka, kur ende nuk jemi larguar nga xhamia?”, ndërsa Ebu Bekri sërish tha: “Unë, o i Dërguari i Allahut, kur hyra në xhami, pasi u ktheva nga vizita e Abdurrahmanit, pashë në xhami një të varfër. Nipi im kishte një copë bukë, ia mora dhe ia dhashë të varfërit.” Pejgamberi alejhi selam tha: “Sihariq xhenetin, o Ebu Bekër! Nuk i bashkohen këto cilësi dikujt e të mos përgëzohet me xhenet.” Atëherë, Omeri ofshau dhe tha: “Kurrsesi nuk mund të ta kaloj ty, o Ebu Bekër!”

Lufta e Tebukut

Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon: “Pejgamberi alejhi selam nisi të na inkurajonte të jepnim sadaka për luftën e Tebukut. Atë ditë unë kisha pasuri. Thashë me vete se sot do t’ia kaloj Ebu Bekrit.”

Shkoi Omeri në shtëpi dhe mori gjysmën e pasurisë së tij dhe ia vendosi Pejgamberit alejhi selam përpara. Ai i tha: “Çfarë i le familjes sate, o Omer?” Omeri u përgjigj: “Lashë gjysmën e pasurisë për fami-

ljen.” Pastaj erdhi Ebu Bekri dhe kishte sjellë më pak pasuri se Omeri dhe e vendosi para Pejgamberit alejhi selam, i cili e pyeti: “Çfarë i le familjes, o Ebu Bekër?” Tha: “Ua lashë Allahun xh.xh. dhe të Dërguarin e Allahut xh.xh..” Omeri tha: “Pasha Allahun, pas kësaj dite kur më nuk do të vihem në garë me Ebu Bekrin.”

Ebu Bekri është i vetmi që tri herë e dha tërë pasurinë e tij për hir të Allahut xh.xh.. Kush prej nesh është në gjendje të shpenzojë tërë pasurinë e tij në rrugën e Allahut xh.xh. për të ndihmuar e përkratur vëllezërit palestinezë?

Mirësia ende gjendet dhe qëndron në këtë umet, elhamdulillah! Unë kam parë vetë një burrë të vjetër, i cili nuk kishte diçka tjetër për të dhënë për vëllezërit e tij në Bosnjë dhe dha karrocën me të cilën lëvizte. Kam parë shumë gra duke dhënë sadaka, duke dhuruar arin dhe stolitë e tyre për të ndihmuar vëllezërit myslimanë kudo në botë. Është e vërtetë se në gjirin e umetit tonë kemi shembuj të Ebu Bekrit, Allahu qoftë i kënaqur me të, por kemi dëshirë që këta shembuj të shtohen.

Ebu Bekri tri herë e dha tërë pasurinë e tij në rrugën e Allahut:
*kur shpëtoi dhe liroi një robëreshë besimtare të dobët,
kur bëri hixhretin me Pejgamberin alejhi selam,
në ditën e luftës së Tebukut.*

Përvuajtja dhe devocioni i tij

Një ditë, shërbëtori i tij i sjell Ebu Bekrit një ushqim dhe ai fut në gojë një kafshatë. Ebu Bekri e kishte zakon të pyeste për burimin e ushqimit, prandaj e pyeti shërbëtorin e tij se nga vinte ky ushqim. Shërbëtori i tha: “Përse po pyet për këtë?” Ebu Bekri sërish i tha: “Nga është ky ushqim?” Shërbëtori i tha: “Para Islamit kam punuar si murg, kam krijuar pasuri dhe ende e kam në dorë.” Ebu Bekri i tha: “A dëshiron të më marrësh në qafë?!” Pastaj u mundua ta nxirrte atë që kishte ngrënë. I treguan se nuk mund ta nxirrte atë kafshatë pa pirë ujë, prandaj urdhëroi t’i sillnin ujë. Pastaj futi gishtin në fyt dhe e nxori atë që kishte ngrënë. Njerëzit i thanë: “Të mëshiroftë Allahu, o

Ebu Bekër, ajo ishte vetëm një kafshatë!” Ebu Bekri ua ktheu: “Pasha Allahun, nëse do të dilte vetëm nëse më dilte edhe shpirti, do ta nxirrja!”

Modestia e tij

Ebu Bekri shkonte në shtëpinë e një plake në Medinë dhe e fshinte shtëpinë e saj çdo javë. Kur Omeri dëgjoji për këtë plakë, ai deshi të shkonte t’i shërbente. Kur shkoi atje, pa se shtëpia e saj ishte e pastër dhe e rregulluar. Omeri e pyeti plakën se kush e pastronte shtëpinë dhe ajo i tha se vinte një burrë, por ajo asnjëherë nuk e pyeste për emrin. Omeri deshi ta dinte se kush ishte ai njeri, prandaj u fsheh në një vend dhe priste të shihte se kush ishte ai që vinte dhe pastronte shtëpinë e kësaj plake. Pas pak erdhi Ebu Bekri, trokiti në derë, hyri brenda, e pastroi shtëpinë, mori mbeturinat dhe iku. A thua, kush prej nesh u shërben prindërve të tij kështu? Ata janë njerëzit që e meritojnë kujdesin dhe shërbimin tonë më shumë.

Dashuria e tij për Pejgamberin alejhi selam

Doli Pejgamberi alejhi selam një ditë para sahabëve në xhami dhe pyeti se ku ishte Ebu Bekri. Ai u ngrit. Pejgamberi alejhi selam i tha të shkonte pranë tij. Pastaj pyeti se ku është Omeri. Edhe ai u ngrit. Edhe atij i tha të shkonte pranë tij. Pastaj i mori të dy për dore, i ngriti lart dhe tha: “Kështu do të ringjallemi në Ditën e Kiametit.”

E pyetën Pejgamberin alejhi selam se kush ishte njeriu më i dashur tek ai dhe ai u përgjigj: “Aishja.” I thanë: “Kush prej burrave?” Tha: “Babai i saj.” Pejgamberi alejhi selam tha një ditë: “O Ebu Bekër, ti je shoku im në shpellë dhe shoku im në varrezë (në vendin ku janë të varrosur).”

Një ditë, Omeri u hidhërua me Ebu Bekrin për një fjalë që tha Ebu Bekri dhe u largua prej tij i hidhëruar. Ebu Bekri vrapoi pas tij duke i thënë: “Mos u hidhëro o Omer”, por ai nuk e dëgjonte. Ebu Bekri vazhdoi duke i thënë vazhdimisht të mos hidhërohej, por Omeri nuk i përgjigjet. Shkon Ebu Bekri te Muhamedi alejhi selam dhe ankohet:

“O i Dërguari i Allahut, unë mundohem të pajtohem me të, por ai nuk pranon. Unë mundohem prapë të pajtohem, por ai nuk pranon.” Pas pak erdhi Omeri në xhami dhe pa se Pejgamberit alejhi selam i ishte skuqur fytyra, ndërkohë që pranë tij ishte edhe Ebu Bekri. Kur Ebu Bekri vuri re skuqjen e fytyrës së Pejgamberit alejhi selam, mundohej t’i fliste Pejgamberit alejhi selam që mos të hidhërohej me Omerin, duke i thënë: “O i Dërguari i Allahut, unë isha i padrejtë, unë isha i padrejtë.” Atëherë, Pejgamberi alejhi selam tha: “Mjerë ti, o Omer! Çfarë ke me Ebu Bekrin? O ju njerëz, kam ardhur me këtë fe e njerëzit më përgënjeshtuan, ndërsa Ebu Bekri më tha se them të vërtetën dhe jam i drejtë. Më ngushëlloi e më përkrahu me trupin e tij, me pasurinë dhe me familjen e tij. A ma lini mua shokun tim?”

Pas asaj dite askush nuk e ngacmoi në asnjë mënyrë Ebu Bekrin, Allahu qoftë i kënaqur me të.

Qëndrime të bukura dashurie

Prej rasteve interesante ku tregohet dashuria e thellë e Ebu Bekrit ndaj Pejgamberit alejhi selam është edhe ngjarja që ndodhi gjatë mos-pajtitimit të Pejgamberit alejhi selam dhe Aishes, Allahu qoftë i kënaqur me të. Pejgamberi alejhi selam i tha Aishes: “Kë dëshiron të marrim për gjykatës, a marrim Eba Ubejden?” Aishja tha: “Eba Ubejda është njeri i mirë, kur të vijë ai do të marrë parasysh fjalën tënde!” Atëherë i tha: “Marrim babanë tënd.” Dhe ajo pranoi.

Pejgamberi alejhi selam e thirri Ebu Bekrin dhe kur ai hyri në shtëpi, Aishja i tha Pejgamberit alejhi selam: “Tregoja ngjarjen ashtu siç ka ndodhur saktësisht e mos thuaj asgjë përveç së vërtetës.” Menjëherë u ngrit Ebu Bekri që ta godiste bijën e tij dhe i tha: “A thua se Pejgamberi alejhi selam thotë diçka tjetër përveç së vërtetës?!” Pejgamberi alejhi selam hyri në mes dhe i tha: “O Ebu Bekër, nuk të kemi thirrur për këtë. O Ebu Bekër, na lë ne...” Pasi doli Ebu Bekri, Pejgamberi alejhi selam i tha Aishes: “E sheh se si të shpëtova nga babai yt?” Pas pak erdhi Ebu Bekri dhe gjeti Pejgamberin alejhi selam dhe Aishen duke qeshur, prandaj u tha: “Më bëni pjesëtar në paqen

tuaj (në qeshjen), ashtu si më bëtë pjesëtar në ngatërresën tuaj (kur e morën për gjykatës).” Atëherë Pejgamberi alejhi selam i tha: “Po, o Ebu Bekër, të bëjmë pjesëtar.” Dashuria për Pejgamberin alejhi selam është risk e mirësi nga Allahu, me të cilën Ai bekon robërit e Tij. Ta duash Pejgamberin alejhi selam është thjesht begati e risk nga Allahu xh.xh.. A thua a mund të arrijmë shkallën e dashurisë së Ebu Bekrit ndaj Pejgamberit alejhi selam? A e ndjekim traditën e Pejgamberit alejhi selam? A do t’i mbrojmë të dashurit e Pejgamberit alejhi selam, të cilët vriten në Palestinë? A do ta mbrojmë Kudsën, ku ndodhi Israja e Pejgamberit alejhi selam? Ebu Bekri nuk deshi të bërtiste në rastin kur e kafshoi akrepi në shpellë, që të mos e zgjonte atë nga gjumi, ndërsa ne flemë në një kohë që shenjtëria dhe sovraniteti i Islamit cenohet çdo ditë!

Një ditë, gjatë një bisede mes Ebu Bekrit dhe një sahabi që quhej Rabiah bin Kab el-Ensari pati një ngritje tonesh. Ebu Bekri i tha një fjalë që nuk i pëlqeu Rabias dhe menjëherë Ebu Bekri i tha: “Ma kthe fjalën, o Rabia!” Rabia i tha: “Jo, pasha Allahun, nuk ta kthej fjalën.” Ebu Bekri i tha: “O Rabia, a dëshiron që ta takoj Allahun kështu?” Rabia refuzoi t’ia kthente fjalën. Sërish Ebu Bekri i tha: “A dëshiron që ta takoj Allahun kështu?” Atëherë, Ebu Bekri u hidhërua dhe i tha: “Pasha Allahun, do të ankojem te Pejgamberi alejhi selam!” Në atë çast, një nga fisi i Rabias tha: “Ta ka thënë një fjalë që nuk të ka pëlqyer dhe shkon të ankohet te Pejgamberi alejhi selam?” Rabia u tha: “A e dini kush është ky? Ky është es-Sidiku? Kam frikë se mos po e kthen kokën pas e ju sheh se si po më nxitni kundër tij dhe hidhërohet e shkon te Pejgamberi alejhi selam dhe ankohet. Atëherë hidhërohet Pejgamberi alejhi selam për hidhërimin e Ebu Bekrit, e pastaj hidhërohet Allahu xh.xh. për hidhërimin e Pejgamberit alejhi selam dhe të Ebu Bekrit, e kështu mbaron Rabia. Më lini të qetë!”

Rabia shkoi te Pejgamberi alejhi selam pas Ebu Bekrit. Pejgamberi alejhi selam buzëqeshi dhe tha: “Çfarë keni ti dhe Ebu Bekri?” Rabia tha: “Ma tha një fjalë e nuk më pëlqeu, pastaj më tha kthema atë fjalë, e unë nuk desha t’ia ktheja.” Pejgamberi alejhi selam tha:

“Ashtu, mos ia kthe Ebu Bekrit fjalën, por thuaj: “Allahu të faltë, o Ebu Bekër!”

Çastet e lamtumirës

Pejgamberi alejhi selam mbushi gjashtëdhjetë e tre vjet dhe filluan t’i paraqiten shenjat e lodhjes dhe të sëmundjes. Erdhi një grua ta pyesë Pejgamberin alejhi selam dhe kërkoi nga ai diçka, e Pejgamberi alejhi selam e urdhëroi të vinte vitin e ardhshëm. Ajo i tha: “Nëse vij vitin e ardhshëm e nuk të gjej?”, duke aluduar për vdekjen e tij, ngase shihte shenjat e lodhjes dhe të sëmundjes. Ai i tha: “Nëse nuk më gjen, atëherë shko tek Ebu Bekri.” Kjo ishte një shenjë e Pejgamberit alejhi selam se Ebu Bekri duhej të ishte kalif i myslimanëve pas tij.

Pas këtij rasti, Pejgamberi alejhi selam shkoi në haxhin lamtumirës, ku zbriti ajeti 3 i sures El-Maide. Të gjithë sahabët u gëzuan për këtë ajet, vetëm Ebu Bekri qau, ngase në këtë ajet kishte edhe lajm për shkuarjen e Pejgamberit alejhi selam (nga kjo jetë).

Sëmundja filloi t’i shtohet Pejgamberit alejhi selam dhe ai kërkoi nga bashkëshortet e tij që t’i jepnin leje të mjekohej në shtëpinë e Aishes dhe ato i dhanë leje. Në momentet e fundit, sahabët u tubuan në xhami dhe zërat e tyre filluan të jenë më të lartë nga dhimbja që ndienin për Pejgamberin alejhi selam. Ai i dëgjoi zërat e tyre dhe tha: “Ç’është kjo? I thanë: “Kanë frikë për ty, o i Dërguari i Allahut.” Tha: “Më dërgoni tek ata.” Pejgamberi alejhi selam pastaj nisi t’u flasë fjalët e fundit: “O ju njerëz, e shoh se keni frikë për mua.” I thanë: “Po, o i Dërguari i Allahut.”

“O ju njerëz, takimi im me ju nuk është në këtë botë, takimi juaj me mua është te burimi në ahiret... Pasha Allahun, sikur po e shoh vendin tim me sy. O ju njerëz, sa i mirë është namazi! Frikësojuni Zotit për gratë tuaja. O ju njerëz, pasha Allahun, nuk ua kam frikën nga varfëria, por frikësohem për ju nga dynjaja, të viheni në gara për të ashtu sikur u vunë në gara ata që ishin para jush dhe u shkatërruan. Kam frikë se edhe ju do të shkatërroheni si ata. O ju njerëz, një njeriu Allahu xh.xh. i tha: “Zgjidh ku do të jesh, në dynja apo te Zoti?”, e ai

zgjodhi takimin me Zotin.” Sahabët ishin në heshtje të plotë, sikur t’u kishin fluturuar kokat. I vetmi që e kuptoi qëllimin e Pejgamberit alejhi selam ishte Ebu Bekri, i cili qau me dënësë dhe me zë shumë të lartë. Ai thoshte: “Të bëhem unë, babai, nëna, fëmijët dhe pasuria ime kurban, o i Dërguari i Allahut!” Sahabët filluan t’ia hapnin sytë Ebu Bekrit në shenjë qortimi, pasi kishte ndërprerë fjalën e Pejgamberit alejhi selam. Ai tha: “Lëreni Ebu Bekrin. Pasha Allahun xh.xh., nuk ka kush prej jush që ka dhënë dorë (ndihmë) dhe nuk e kemi shpërblyer për të. Vetëm Ebu Bekrin nuk kam mundur ta shpërblej, shpërblyerimin e tij ia kam lënë Allahut xh.xh.. Të gjitha dyert mbyllen, me përjashtim të derës së Ebu Bekrit.”

Pastaj Pejgamberi alejhi selam filloi të lutej duke thënë: “Allahu ju strehoftë! Allahu ju ndihmoftë! Allahu ju përkrahtë! Allahu ju ruajtë! Allahu ju lartësoftë! O ju njerëz, bëjuni selam të gjithë atyre që kanë ndjekur rrugën time deri në Ditën e Kiametit.”

Alejkum selam, ja Resulullah!

Pastaj e çuan Pejgamberin alejhi selam në shtëpinë e tij e ai thoshte: “Vetëm tek Allahu xh.xh.” Aishja thotë: “E kuptova se po zgjidhte ku dëshironte të shkonte.” Pastaj, Pejgamberi alejhi selam tha: “Thojini Ebu Bekrit t’u prijë njerëzve në namaz.” I thashë: “O i Dërguari i Allahut, Ebu Bekri është njeri i dobët dhe ndikohet nga Kurani. Nëse ua fal njerëzve namazin, nuk do ta dëgjojnë duke e lexuar Kuranimin. Urdhëro dikë tjetër, le të dalë Omer bin Hatabi”, por Pejgamberi alejhi selam tha: “A nuk ju thashë që Ebu Bekri t’u prijë njerëzve në namaz?”

Atëherë, Ebu Bekri u priu myslimanëve në namaz, ndërsa Pejgamberi alejhi selam i shikonte teksa faleshin në rreshta pas Ebu Bekrit dhe buzëqeshi. Ishte buzëqeshja e fundit e tij dhe ishte për namazin, prandaj medito o ti që nuk e fal namazin e sabahut.

Pejgamberi alejhi selam u qetësua kur pa myslimanët se si po faleshin pas Ebu Bekrit dhe u kthye në shtëpinë e tij duke thënë: “Te Shoqëruesi im, më i Larti (tek Allahu xh.xh.), jo tjetërkund, vetëm se te Shoqëruesi im, më i Larti!” Pastaj vendosi kokën e tij në krahun e Aishes. Thotë Aishja: “Pejgamberi alejhi selam vazhdoi të thotë të

njëjtën fjalë: “Te Shoqëruesi im, më i Larti”, pastaj i ra dora Pejgamberit alejhi selam, iu rëndua koka në gjoksin tim dhe atëherë e kuptova se Pejgamberi alejhi selam ndërroi jetë.”

Qëndrimi më i ndjeshëm

Kur Aishja ndjeu se Pejgamberi alejhi selam ndërroi jetë, nuk dinte se çka të bënte. Pastaj u ngrit dhe hyri në xhaminë e Pejgamberit alejhi selam dhe tha me sa zë kishte: “Vdiq Pejgamberi i Allahut xh.xh.!”

Atëherë e tërë xhamia u derdh në vaj. Ali bin Ebi Talibi nuk mundi të qëndronte në këmbë, kurse Uthman bin Afani u bë si fëmijë, e merrnin nga e djathta në të majtë dhe anasjelltas. Fatimja (bija e Pejgamberit alejhi selam) thoshte: “O babai im, iu përgjigje Zotit që të thirri! O babai im, në xhenetin Firdeus e ke vendstrehimin! O babai im, Xhibrilin e ngushëllojmë!”

Kurse Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, nxori shpatën dhe i heshti njerëzit në xhami duke u thënë: “Kush thotë se Muhamedi alejhi selam ka vdekur, do t’ia pres kokën. Ai ka shkuar te Zoti i tij, siç shkoi më parë Musai për të takuar Zotin, dhe do të kthehet. Do t’ia pres kokën atij që thotë se Pejgamberi alejhi selam ka vdekur!”

Ndërsa sahabi më i qëndrueshëm në këtë rast ishte ai që e deshi më së fortë, Ebu Bekri. Ai hyri në dhomën e Pejgamberit alejhi selam, u sigurua se vërtet Pejgamberi alejhi selam kishte ndërëruar jetë, e mori në gjoksin e tij, e puthi në mes dy syve dhe tha: “Sa i bukur ishe i gjallë e sa i bukur je i vdekur, o i Dërguari i Allahut!” Dhe thoshte: “O i dashur, o i zgjedhur, o shok, o i Dërguari i Allahut...”

Pastaj, Ebu Bekri u fut në xhami dhe tha: “Hesht, o Omer!” Omeri nuk ndalej duke folur, ndërsa Ebu Bekri me sa zë që pati tha: “O ju njerëz, kush prej jush ka adhëruar Muhamedin alejhi selam, le ta dijë se Muhamedi ka vdekur. E kush ka adhëruar Allahun xh.xh., le ta dijë se Allahu është i gjallë e nuk vdes.” Pastaj lexoi thënien e Allahut xh.xh.: **“Muhamedi nuk është tjetër vetëm se i Dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose**

mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm Allahut aspak, kurse Allahu do t’i shpërblejë mirënjohësit.” (Ali Imran, 144)

Omeri thotë: “Sikur po e dëgjoja këtë ajet për herë të parë, më ra shpata nga dora e nuk dija ç’të bëja. Vrapova drejt një vendi që të isha vetëm dhe të qaja.”

Imagjino se çfarë do të ndodhte sikur të mos ishte Ebu Bekri në këtë moment kritik. Shiko se ku i çonte hutimi i tyre. A e shikoni se çfarë u bëri dhimbja për Pejgamberin alejhi selam?

Kur ranë në kundërshtim rreth vendit se ku do ta varrosnin Pejgamberin alejhi selam, Ebu Bekri u tha: “Kam dëgjuar Pejgamberin alejhi selam duke thënë se ne Pejgamberët varrosemi aty ku vdesim.” Atëherë, sahabët e varrosën Pejgamberin alejhi selam në vendin ku ishte shtrati i Aishes, aty ku ai vdiq.

Betimi për kalifat

Menjëherë pas vdekjes së Pejgamberit alejhi selam u vunë re shënja mosmarrëveshjeje mes sahabëve, se kush duhet ta zëvendësonte Pejgamberin alejhi selam. Ensarët u tubuan në Sekife beni Sade që të zgjedhin një prej tyre. Sad bin Ubade, i cili ishte zotëria i Eusit, ishte një njeri që i dëgjohej fjala, por atë ditë Sadi ishte i sëmurë. Omeri dëgjoji për takimin e ensarëve në Sakife beni Sade dhe pyeti se ku është Ebu Bekri. Kur e gjeti, e mori atë për dore së bashku me Eba Ubejde El-Xherrahun dhe shkuan në Sakife. Në mes tyre filloi dialogu. Ensarët thanë: “Ne jemi njerëzit që meritojmë më shumë për këtë çështje, ngase ne e kemi strehuar, e kemi ndihmuar dhe nga ne është Sad bin Ubade, zotëria i Eusit.” Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, u tha ensarëve: “O paria e ensarëve, ju ishit të parët që e strehuat dhe e ndihmuat, prandaj mos u bëni të parët që ndryshojnë dhe ndërrojnë. O paria e ensarëve, duhet ta dini se këtë çështje arabët nuk do ta pranojnë nga dikush tjetër përveçse nga kurejshët.” Ensarët thanë: “Një emir nga ne e një nga ju.” Ebu Bekri tha se kjo punë nuk është e drejtë dhe e qëndrueshme. Në atë rast njëri nga ensarët, i cili quhej Beshir

bin Sad El-Hazrexhi, tha: “O paria e ensarëve, pasha Allahun, ata kanë më meritë për këtë post se çdokush tjetër. Unë ta jap besën.” Omeri në atë çast tha: “Shtriye dorën, o Ebu Bekër, të ta jap besën!” Kështu, Ebu Bekrit ia dha besën Omer bin Hatabi e pastaj pas tij edhe sahabët e tjerë dhe me këtë përfundoi edhe ky rast i ndjeshëm qetësisht e pa probleme, ngase zemrat e tyre ishin të lidhura me Allahun xh.xh..

Koncepti i kalifit të parë

Ebu Bekri u bë kalifi i myslimanëve dhe konceptin e tij e paraqiti në hytben e parë që mbajti, ku në mes të tjerash tha: “Jam zgjedhur të jem udhëheqës juaj e nuk jam më i mirë se ju. Nëse me shihni se jam në të vërtetë, atëherë më ndihmoni. E nëse më shihni se jam në gabim, atëherë më përmirësoni. Respektojeni urdhrin tim derisa i bindem dhe respektoj Allahun në hakun tuaj. Nëse mëkatoj, atëherë nuk kam respekt te ju (mos iu bindni urdhrin tim). I forti në mesin tuaj është i dobët, derisa ta marr hakun e të dobët. I dobëti në mesin tuaj është i fortë tek unë, derisa t’ia jap hakun. O ju njerëz, nuk ka ndonjë popull që e ka lanë anash xhihadin vetëm se e ka poshtëruar Zoti.”

Kështu, Ebu Bekri shpjegoi pesë rregulla kryesore, të cilat do të ishin hapat që do të ndiqte ai në politikën e tij gjatë kohës që do të ishte udhëheqës i shtetit islam:

Të jetë modest;

Të ndihmojë këdo që ka të drejtë;

Të përmirësohet, nëse është në gabim;

Të ndihmojë atë që ka të drejtë, edhe nëse është i dobët dhe të nënshtrorë të fortin derisa t’ia marrë hakun atij që i është bërë e padrejta nga i forti;

Xhihadi në rrugën e Allahut është rruga e krenarisë së myslimanëve.

Pasi Ebu Bekri u bë kalif i myslimanëve, të gjithë u gëzuan; burra e gra, pleq, të rinj dhe fëmijë e donin dhe e njihnin si njeri të butë dhe shumë të sinqertë. Fëmijët në rrugë e thërrisnin o baba, o baba, i ngji-

teshin për trupi dhe i kapnin rrobat, kurse Ebu Bekri i mbante në rrugët e Medinës.

Ebu Bekri e kishte zakon të milte delet e familjeve të jetimëve, të dëshmorëve dhe të të vejave, duke u shërbyer personalisht. Kur u zgjodh kalif, të vejat dhe jetimët thanë: “Kush do të na i mjelë delet, kush do të na sjellë qumështin?”

Ebu Bekri shkoi në shtëpitë e tyre dhe u tha se kishte dëgjuar se kishin thënë kështu e kështu... “Pasha Allahun xh.xh., Ebu Bekri do të mjelë qumështin e deleve për ju derisa të vdesë.”

Një ditë erdhën dy burra tek Ebu Bekri që t’ua jepte një copë tokë si dhuratë që ua ndante Islami për t’ua zbutur zemrat për Islamin. Ai ua dha tokën, me kusht që Omeri t’ua vërtetonte atë. Kur shkuan tek Omeri, ai refuzoi t’ua jepte tokën, ngase e vërejti se Islami nuk forcohej me ata që mendohej se po u zbutej zemra për Islamin, por e vërteta është se ata forcoheshin me mirësitë e Islamit pasi Islami tashmë ishte forcuar. Atëherë shkuan të hidhëruar tek Ebu Bekri dhe i thanë: “Pasha Allahun, nuk po e dimë se kush është kalif këtu, ti apo ai?” Ebu Bekri tha: “Ai, nëse do.”

Ebu Bekri ishte një njeri i veçantë. Kur mori kalifatin, shumica e kabileve arabe ishin larguar nga Islami. Islam kishte vetëm në Mekë dhe në Medinë, ndërsa brenda dy vjetëve dhe disa muajve, sa ishte kalif Ebu Bekri, ai i riktheu të gjithë nën flamurin e Islamit dhe i dha fund krizës së largimit nga feja. Pastaj çliroi Persinë, mposhti bizantinët dhe mblodhi Kuranin në një libër. Në luftën e të larguarve nga feja, Omeri shkoi tek ai që të konsultohet me të që t’i linte ata që nuk e paguanin zekatin. Ebu Bekri i tha: “O Omer, erdhe që të më ndihmosh e jo të më turpërosh. Trim i tmerrshëm në xhahiliet e frikacak në Islam? A do të pakësohet e cungohet kjo fe duke qenë gjallë unë?” Pastaj tha: “Pasha Allahun, nëse nuk më japin edhe litarin e devesë që duhet ta japin zekat, do t’i luftoj. Pasha Allahun xh.xh., nëse nuk mbetet kush tjetër vetëm Ebu Bekrit, do të luftoj në rrugën e Allahut derisa të kthehet feja si deshi Pejgamberi alejhi selam ose të shuhet fisi im.”

A e shihni se kush është Ebu Bekri? Ky burrë i dobët e thananik, kur Islami ka nevojë për të, shndërrohet në njeriun më të fortë, që e

mbron Islamin si luan. Vërtet, njeriu më i fuqishëm e solid në botë pas Pejgamberëve ishte Ebu Bekri. Pas Pejgamberëve, historia nuk ka njohur ndonjë njeri madhështor në mesin e madhështorëve, ndonjë njeri të fuqishëm në mesin e të fuqishmëve që të ketë marrë qëndrime e hapa madhështorë për të ndihmuar fenë, për të përkrahur umetin, për të ngritur e lartësuar popullin, për ta mbrojtur atë në ndonjë kohë nga kohët ose vendet si Ebu Bekri. Rinia e magjepsur pas civilizimit perëndimor, ose ata që admirojnë këngëtarët e këngëtares, artistët ose personalitetet perëndimore, duhet ta dinë se nuk ka ndonjë njeri në histori si Ebu Bekri, përveç Pejgamberëve, i cili është mirë të merret si shebull për rininë tonë. Duhet t'i kthehem kësaj feje, të mësohemi me shebullin e Pejgamberit alejhi selam dhe të sahabëve të tij.

Ditët e para të kalifatit të tij

Pak kohë para se Pejgamberi alejhi selam të ndërronte jetë, pas hapjes së Mekës, Islamin e pranojnë shumë fise arabe. Te këto fise arabe imani nuk ishte rrënjësor si duhet, prandaj shumica e tyre u larguan nga Islami kur vdiq Pejgamberi alejhi selam. Largimi i tyre nga Islami kishte forma të ndryshme: dikush nuk jepte më zekatin; dikush kishte lënë zekatin edhe namazin; dikush ishte vetëshpallur rrejshëm pejgamber, si Musejleme Kedhdhabi dhe Talha El-Esved El-Ansij, kurse dikush e kishte mohuar Islamin në përgjithësi dhe nuk pasonte asnjë prej Profetëve.

Kur Ebu Bekri mori kalifatin, Gadishulli Arabik pothuajse i tëri ishte larguar nga Islami, përveç Mekës dhe Medinës. Edhe banorët e Mekës për pak u larguan nga Islami po të mos ishte Suhejl bin Amri, një ligjërues i rangut të lartë. Ai u ngrit në Mekë duke ligjëruar në mesin e mekasve duke u thënë: “O paria e kurejshitëve, ishit të parët që e pranuat Islamin, mos u bëni të parët që e lënë atë. Qëndroni, pasha Allahun, nëse Islami forcohet, do të forcoheni edhe ju.”

Allahu e mbrojti Mekën nga largimi nga feja. Suhejl bin Amri ishte ai person i cili, kur ishte mushrik, thoshte vargje dhe nxiste njerëzit kundër Pejgamberit alejhi selam dhe kur u zu rob në ditën e Bed-

rit, Omer bin Hatabi i tha Pejgamberit alejhi selam: “O i Dërguari i Allahut, më jep leje t’ia prej gjuhën këtij mushriku, që të mos ketë mundësi asnjëherë të flasë”, por Pejgamberi alejhi selam refuzoi duke thënë: “Ndoshta një ditë ai do të mbajë ndonjë qëndrim që ti do ta falënderosh o Omer.” Pra, ishte ky ai qëndrim për të cilin fliste Pejgamberi alejhi selam, kur Allahu xh.xh. e mbrojti Mekën.

Para vdekjes, Pejgamberi alejhi selam kishte përgatitur një ushtri për të luftuar kundër Bizantit. Kjo ushtri ishte nën komandën e Usame bin Zejdit. Në këtë ushtri ishin sahabët e mëdhenj, si Omer bin Hatabi etj. Por, Pejgamberi alejhi selam vdiq para se ushtria të nisej për në luftë. Kështu, ushtria u vonua derisa të varrosej Pejgamberi alejhi selam dhe derisa të zgjidhej kalifi. Kur u zgjodh Ebu Bekri, shumica e fiseve arabe u larguan nga Islami. Në këtë rast kishte shumë sahabë që thoshin se është e udhës që së pari të merremi me ata që ishin larguar nga feja e pastaj të dërgohej ushtria me në krye Usamen në luftë kundër Bizantit. Por, Ebu Bekri ishte i mendimit se Usame bin Zejdi duhet të shkonte në rrugën e vet dhe t’i kundërvihej Bizantit, prandaj dha urdhër për këtë. Në të njëjtën kohë, brenda ushtrisë së Usames filloi debati, se sa e udhës do të ishte që kjo ushtri të shkonte në luftë kundër Bizantit, ndërkohë që rreziku i të larguarve ishte aktual dhe se ata mund të sulmonin Medinën. Kështu, ata shkuan tek Ebu Bekri për t’i thënë që ta rishqyrtonte këtë çështje. Një delegacion tjetër nga ensarët sërish shkoi tek Omeri, që edhe ai t’i fliste kalifit, që ushtria të mos shkonte në luftë kundër Bizantit në atë kohë. Omeri shkoi tek Ebu Bekri dhe ia paraqiti çështjen siç e mendonte, pastaj Ebu Bekri tha: “Pasha Allahun, atë që ka vendosur i Dërguari i Allahut, atë do të vendos edhe unë, edhe sikur shpendët të na marrin me kthetra dhe sikur egërsirat të sillen rreth Medinës dhe qentë të vrapojnë nëpër këmbët e nënave të besimtarëve. Pasha Allahun, do ta çoj në vend atë që Pejgamberi alejhi selam pati vendosur.”

Qëndrimi solid dhe i pathyeshëm i Ebu Bekrit mbështetet në atë se urdhri i Pejgamberit alejhi selam ishte i qartë, se ushtria e Usames duhet të shkonte në luftë kundër Bizantit. Atëherë, Omeri i tha: “Mirë, nëse ke vendosur që ushtria të shkojë në luftë, atëherë cakto dikë tje-

tër në krye të ushtrisë në vend të Usames, ngase ai është djaloshi i ri.” Në atë çast, Ebu Bekri u ngrit dhe e kapi Omerin për mjekre duke i thënë: “Të vajtoftë nëna, o Omer bin Hatabi! Pejgamberi alejhi selam e ka vendosur komandant e ti më thua ta largoj nga ai post? Pasha Allahun, do të shkojë ushtria dhe në krye do të këtë Usamen, ashtu siç deshi Pejgamberi alejhi selam.”

“O ju që keni besuar, binduni Allahut e Pejgamberit të Tij si dhe parisë (udhëheqësve) tuaj.” (En-Nisa, 59) Thotë Imam bin Hanbeli: “E kam shikuar ajetin: “...binduni Allahut dhe Pejgamberit të Tij” dhe kam parë se është në më shumë se tridhjetë vende.” Pastaj lexoi: **“Le të kenë kujdes ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, se mund t’u ndodhë ndonjë fitne, ose do t’u ndodhë ndonjë ndëshkim i dhimbshëm.”** (Nur, 63)

Ata që nuk e përfillin urdhrin e Pejgamberit alejhi selam do të ballafaqohen me fitne të mëdha. Këto fitne mund të jenë problemet bashkëshortore, gjendja e rëndë sociale, djegia e shtëpisë etj..

Kur Omeri doli nga takimi me Ebu Bekrin, e pyetën se çka ndodhi. Atëherë ai u tha: “Ju vajtoftshin nënat tuaja! Pasha Allahun, nuk bëtë gjë tjetër vetëm se bëtë që me mua të hidhërohet zëvendësi i Pejgamberit alejhi selam.”

Fryti i përfilljes së urdhrin të Pejgamberit alejhi selam

Ebu Bekri e urdhëroi tellallin të thërriste në mesin e njerëzve: “Kush është në ushtrinë e Usames, le të përgatitet dhe le t’i bashkëngjitet ushtrisë në rresht!” Ushtria e Usames u nis drejt Palestinës. Kur fiset arabe e vërejtën ushtrinë e Usames duke marshuar për luftë, menduan se myslimanët paskan fuqi të madhe përderisa paskan përgatitur një ushtri kaq të madhe. Disa fise, të cilat ende nuk e kishin ndërruar mendimin e tyre, qëndruan në Islam dhe nuk u larguan, ndërsa fiset e tjera që ishin larguar nuk mendonin të bënin ndonjë sulm kundër Medinës, pasi mendonin se myslimanët mund të kenë fuqi të tjera ushtarake. Më vonë, ushtria e Usames u kthye nga fusha e betejës triumfalisht, duke e lartësuar shumë shpirtin luftarak të myslimanëve.

Sikur të mos ishte ti, do të merrnim fund

Pasi Ebu Bekri e nisi për luftë ushtrinë e Usames, të larguarit nga Islami (murtedët) filluan të shkojnë në Medinë për negociata me Ebu Bekrin lidhur me zekatin, ndërsa Ebu Bekri ua ktheu: “Pasha Allahun, do t’i luftoj të gjithë ata që bëjnë dallim mes namazit dhe zekatit.”

Pas kësaj, Ebu Bekri i mblodhi myslimanët në xhami dhe u mbajti një ligjëratë të shkurtër: “Dijeni se ata kanë ardhur në Medinë dhe kanë parë se ne jemi të paktë në numër. E shoh se ata do të mblidhen së bashku dhe do të na sulmojnë pas tri ditësh, që të hyjnë në Medinë, prandaj mblidhuni në xhami dhe merrni armët tuaja.”

Vetë Ebu Bekri ruante hyrjen e Medinës. Imagjinoji këto çaste tjetër të rënda që përjetuan myslimanët në Medinë. Islami nuk ka arritur te ne lehtë e pa vështirësi. Sahabët kanë flijuar çdo gjë të shtrenjtë dhe fisnike për të.

Pas tre ditësh erdhën lajme në Medinë se të larguarit nga Islami ishin drejtuar drejt Medinës për ta sulmuar dhe kishin arritur në Dhul-Kisa. Ebu Bekri u doli vetë përballë në krye të një ushtrie për të mos i lënë të hyjnë në Medinë. Ushtritë u takuan ballë për ballë dhe myslimanët ishin duke fituar, por kundërshtarët filluan t’i fryjnë çantat e ujit dhe ato pengonin këmbët e deveve të myslimanëve, prandaj deve-të filluan të tërhiqen dhe të shkojnë drejt Medinës. Armiqtë u grumbulluan prapë në Dhul-Kisa që të sulmonin Medinën, por Ebu Bekri e mblodhi ushtrinë e tij dhe natën u nis drejt Dhul-Kisas, ku ishin mblodhur murtedët. Në agun e mëngjesit myslimanët iu vërsulën murtedëve, të cilët nuk e prisnin këtë sulm, dhe i mundën shumë rëndë. Fitorja e myslimanëve kundër murtedëve qëllloi në të njëjtën kohë kur edhe ushtria e Usames po kthehej në mënyrë triumfale nga lufta kundër Bizantit. Ajo ditë ishte vërtet dita e fitores madhështore.

Ebu Bekri filloi të caktojë komandantët e ushtrive që do të niste kundër fiseve arabe që ishin larguar nga Islami në Gadishullin Arabik. Ai nisi njëmbëdhjetë ushtri:

1. Ushtrinë e Halid bin Velidit e nisi kundër Talha bin Huveilid El-Esedijut, pastaj kundër Malik bin Nuveires dhe pastaj kundër Musejleme bin Kedhabit.
2. Ushtrinë e Ikreme bin Ebi Xhehlit e nisi në Jemame që të luftonte kundër Musejlemes.
3. Ushtrinë e Amr bin El-Asit e nisi në Tebuk dhe në Dumetu El-Xhendel.
4. Ushtrinë e Sherhabil bin Hasenes e nisi për në Jemame kundër Musejlemes.
5. Ushtrinë e Halid bin Sad bin El-Asit e nisi në periferi të Shamit.
6. Ushtrinë e Tarife bin Harithit e nisi kundër fisit Huvazin dhe Beni Selim.
7. Ushtrinë e El-Ala El-Hadremit e nisi për në Bahrej.
8. Ushtrinë e Hudhejfe bin Muhsinit e nisi për në Oman dhe te banorët e Debas.
9. Ushtrinë e Arxhefetusit e nisi për në Hadrameut dhe në Jemen.
10. Ushtrinë e Muhaxhir bin Umejes e nisi për të luftuar përkrahësit e El-Esved bin El-Ansit.
11. Ushtrinë e Suvid bin Mukrinit e nisi për në brigjet e Detit të Kuq nga ana e Mekës, deri në portën e Mendebit.

Të gjitha ushtritë dolën triumfuese dhe vetëm brenda dy vjetësh i tërë Gadishulli Arabik u rikthye sërish në Islam. Ushtritë pastaj nisën të shkonin në drejtim të Irakut dhe të Shamit. Në kohën e Ebu Bekrit u çlirua shumica e Irakut dhe një pjesë e Shamit si dhe u mblodh Kurani në një libër.

Një tabiin tregon: “Hyra një ditë në xhami dhe pashë një burrë që po puthte kokën e një burri tjetër dhe i thoshte: “Pasha Allahun, sikur të mos ishte ti, do të merrnim fund.” Thashë: “Kush është ai që po puth kokën e atij dhe kush është ai tjetri?” Më thanë se ai që po e puth kokën është Omeri, kurse ai të cilit po i puthet koka është Ebu Bekri.

*Përktheu nga arabishtja:
Tahir Kukaj*

Amr Halid

THE FOUR CALIPHS OF THE MESSENGER OF ALLAH ALAYHI SALAM The presentation of Abu Bakr and his qualities

Prior to speaking about Abu Bakr (may Allah be pleased with him), I would like to set forth a question: “What is the miracle of Islam?”

Every Messenger had performed a miracle, each of them extraordinary, defying the laws of physics. These miracles had impressed the contemporaries of the Messengers. The miracle of Jesus alayhi salam was to cure the ill and revive the dead. On the other hand, Moses alayhi salam could divide the sea into two (by holding out his stick over it).

عمرو خالد

الخلفاء الراشدون الأربعة

(خلاصة البحث)

الحمد لله رب العالمين و الصلاة و السلام على أشرف المرسلين و على آله و صحبه أجمعين. من يهده الله فلا مضل له و من يضله لا هادي له.

تقديم أبي بكر رضي الله عنه و صفاته:

قبل ان نتحدث عن أبي بكر رضي الله عنه أريد ان اطرح سؤالاً و هو: ما هي معجزة الاسلام؟

لكل رسول كانت له معجزة فوق العادة نفوق القوانين الطبيعية لهذا الكون. و كانت لهذه المعجزات آثاراً لدى معاصري أي رسول من الرسل. و كانت معجزة عيسى عليه السلام شفاء المرضى من الامراض المستعصية و شفاء الاعمى و كانت معجزة موسى عليه الاسلام العصا الذي شق به البحر و كان هذا العصا يتحول إلى حية تسعى كذلك.

TRASHËGIMI

Hasan Kaleshi - Ismail Rexhepi

KUKLI BEGU DHE VAKËFNIMET E TIJ

Për këtë legator osman, përshpirtënimet e të cilit mund të maten me ato të Husrev begut dhe Isa begut, është shkruar aq pak, sa që ka mbetur fare i panjohur. Madje as *Vakëfnameja* e tij, e cila paraqet padyshim dokumentin osman më të rëndësishëm për Prizrenin nga gjysma e parë e shek. XVI, - deri me sot nuk është botuar.

A thua, vallë, kush ka qenë Mehmed Kukli begu, i cili përveç kopshteve, pyjeve dhe pasurive të tjera të tundshme, ka vakëfnuar edhe 117 dyqane në Prizren, 50 dyqane dhe shumë mullinj në Lezhë në Shqipëri, kishte ngritur një urë në lumin Vardar afër Tetovës si dhe 14 karavansaraje në rrugën e Dukagjinit dhe të Stambollit?

Jastrebovi konsideron se Kukli begu ka qenë njëri nga pushtuesit e Prizrenit, se është dalluar në luftërat për këtë qytet dhe se për këtë arsye kishte fituar shumë pasuri¹, kurse Lutovaci e konsideron atë vetëm si “një feudal të madh” dhe “pushtues osman”.²

Menjëherë duhet hedhur tej mendimin se Kukli begu ka mundur të merrte pjesë në pushtimin e Prizrenit, sepse Prizreni është pushtuar

¹ Jastrebovi, *Sinan pasha dhe Kukliu*, Glasnik Srpskog u enog društva, XXXIII, Beograd, 1876, 22.

² Dr. M. Lutovac, *Gora i Opolje, antropografska istrazivanja*, “Srpsko etnografski zbornik”, 1/69, Beograd, 1955, 31, 48.

përfundimisht në vitin 1455, ndërsa Kukli begu kishte vdekur më 963 (fillon më 16 nëntor të vitit 1555)³. Po të llogarisim se Kukli begu kishte jetuar 100 vjet, prapëseprapë, ai nuk ka qenë i lindur atëherë kur osmanët pushtuan Prizrenin. Përveç kësaj, nga *Vakëfnameja* e tij, të cilën e legalizoi në vitin 1539, shohim se ai për mytevelevi të vakëfeve të tij kishte caktuar të atin, Hajrudinin, i cili atëherë patjetër duhej të ishte gjallë. *Vakëfnameja* hedh poshtë njëkohësisht edhe pohimin e Jastrebovit se Kukli begu gjithë pasurinë e vakëfnuar e ka plaçkitur dhe e ka përvetësuar si pushtues. Nga *Vakëfnameja* shihet se Kukli begu pjesën më të madhe të pasurisë së vet e kishte blerë nga persona të ndryshëm, emrat e të cilëve përmenden në *Vakëfname*, kurse pjesën më të madhe të përshpirtënimëve i kishte ndërtuar vetë. S’ka dyshim se deri te një pasuri e tillë ka mundur të arrinte vetëm personi që kishte zënë pozitë të lartë në hierarkinë osmane, p.sh., sanxhakbeu, që Kukli begu gjithsesi kishte qenë. Në këtë gjykim na shtyn “*Kronika*” e përmendur e Mehmed Tahirit. Në kreun për Kukli begun, Mehmed Tahiri thotë se Kukli begu ka qenë mëkëmbës që nga Shkodra në përrëndim e deri në Bosnjë në veri⁴, kurse në tekstin e atij kreu thuhet se Kukli begu ka qenë vali nga Selaniku deri në Bosnjë⁵. Nuk ka kurrfarë dyshimi se Kukli begu ka qenë sanxhakbej i sanxhakut të Prizrenit, edhe pse për këtë nuk kemi të dhëna të prera. Për këtë qartë flasin vetë përshpirtënimet e tij në Prizren dhe Zinovë. Se ka qenë sanxhakbej i Shkodrës, për këtë dëshmojnë edhe përshpirtënimet e tij të shumta në Shkodër dhe në Lezhë. Kukli begu në *Vakëfname* titullohet: “*Shembull i gazinjve dhe i luftëtarëve për fe, kundërshtar i tiranëve dhe rebe-*

³ E dhënë për vdekjen e Kukli begut që gjendet në një “Kronik” të verifikuar në gjuhën arabe, të cilën e ka shkruar myftiu i Prizrenit, Mehmedi, rreth viteve të shtatëdhjeta të shek. XIX. “Kronika” është shkruar në *tavil* dhe ka 227 bejete. Autografi i “Kronikës” gjendet në Zyrën e Vakëfit në Prizren, kurse një përshkrim i saj gjendet në duart tona. “Kronika” nuk ka tituj as datë. Është e ndarë në disa pjesë, në të cilat veçanërisht flitet për disa bamirës prizrenas. Secila pjesë ka titullin e vet, p.sh.:

مناقب صدر الاعظم الغازي و فاتح اليمن سنان پاشا
مناقب محمد بك والي من بلدة الاسكندرية غربا الى بوسنه شمالا
و قد صار واليا من سلانيك الى بوسنه⁵

*lëve, rilindës i fesë dhe ligjit, Mehmed begu...*⁶ “Kronika” po ashtu përmend se Kukli begu ka qenë në lidhje familjare me sulltanin.

Sipas mendimit të myteveliut të Vakëfit të Kukli begut, të cilin e thekson Jastrebovi, Kukli begu ka pasur shtatë vëllezër, prej të cilëve më i vjetri ka qenë babai i valiut të Selanikut, Jusuf pasha.⁷

Si të dhëna të sigurta për Kukli begun, mund të theksojmë se emri i vërtetë ishte Mehmed beg, kurse Kukli beg i është epitet. Babai i tij është quajtur Hajrudin, kurse gjyshi, Kasim⁸. Jastrebovi mendon se Kukli begu rrjedhë nga Azia e Vogël.⁹ Një pasardhës i mytevelive të Kukli begut, që jeton në Shkup, thotë se Kukli begu ka qenë me prejar dhje nga Vana, gjë që përputhet me mendimin e Jastrebovit. Në qoftë se përjashtohet mundësia se Kukli begu ka marrë pjesë në luftërat për pushtimin e Prizrenit, nuk duhet përjashtuar mundësinë se ai ka marrë pjesë në luftërat kundër Hungarisë dhe Kroacisë ku edhe ka mundur të vinte deri te plaçka.

Kukli begu me siguri një kohë të gjatë ka jetuar në Prizren dhe Opojë, ku në kasabanë e atëhershme, në Zinovë (në Bresanën e sotme) kishte ndërtuar sarajin e vetë, xhaminë, teqenë, tyrben dhe ujësjellësin. Saraji i tij gjendej në Beglere (Kuklibeg), një gjysmë kilometër nga Bresana. Edhe sot mund të shihen themelet e atij saraji, si dhe ujësjellësi dhe çezma, të cilën populli edhe sot e quan “Çeshmja e Sarajit” ose “Kroi i Sarajit”.¹⁰ Aty (në Bresanën e sotme - shën. i për-kth.) ekziston edhe tyrbja, në të cilën gjenden varret e gruas dhe fëmijëve të tij, që kishin vdekur derisa Kukli begu kishte qenë gjallë.¹¹ Pranë tyrbes gjendet edhe një varr, në të cilin është varrosur një mik i tij nga Shkupi, por që kishte vdekur aty (në Bresanë).¹² Pranë fshatit Bresanë, është një lagje që mban emrin e Kukli begut, banorët e të cilës i kanë pohuar M. Lutovacit se të parët e tyre paskëshin ardhur nga

⁶ قدوة الغزاة والمجاهدين قاتل البغاة والمعاندين محي الملة و الدين محمد بك

⁷ Vepër e cit., 20

⁸ Vakëfnameja e Kukli begut.

⁹ Jastrebov, *Stara Srbija i Albanija*, Spomenik SKA, Beograd, 1904, 83.

¹⁰ M. Lutovac, vep. cit., f. 75.

¹¹ “Kronika” لفقد مات اولاده حين هو حي

¹² M. Lutovac, vep. cit., f. 75.

Horasani në kufij të Rusisë dhe se rrjedhin nga Kukli begu.¹³ Sipas “Kronikës” së sipërpërmendur, Kukli begu ka vdekur në vitin 963 (fillon më 16. XI. 1555).

Sarajin e Kukli begut e kishte rrënuar *Mehmed pashë Bushatliu* në vitin 1795, duke u lëshuar nga malet e Sharrit, atëherë kur e mori Prizrenin. Asokohe pjesa më e madhe e trashëgimtarëve të Kukli begut kishin kaluar (shpërngulur) në Prizren.

Përveç përshpirtëtimeve të ndryshme publike të cilat hollësisht i përshkruan në Vakëfname, Kukli begu ka ndërtuar edhe *dy xhami* dhe një *mesxhid*; ato i ndërtoi në Prizren dhe Zinovë.

Xhaminë e parë në Prizren e ndërtoi në vitin 941 (fillon më 13.VII.1534).¹⁴ Ajo gjendet në qendër të Prizrenit. Xhamia është e ndërtuar me gurë. Pjesët e përparme janë riparuar. Në të sot nuk ekziston kurrfarë mbishkrimi, mirëpo, mbi derë ekziston thellimi në të cilin më herët kishte qenë pllaka me mbishkrim. Xhamia është e thjeshtë dhe ka kubënë katërkëndëshe. Para xhamisë gjendet tregu, i cili quhet “*Tereke pazari*” (*Tregu i Drithit*). Këtë xhami e quajnë edhe *Saraçhane*, sepse afër saj kanë qenë punëtoritë e saraçëve. Madje, e gjithë mëhalla quhet *Saraçhane*.

Derisa për këtë xhami mund të pohohet me siguri se e ka ndërtuar Kukli begu, çështja e xhamisë tjetër, deri diku, është kontestuese. Xhamia e dytë në Prizren njihet rëndom me emrin *Xhamia e Iljaz Kukës*. Kështu quhet edhe lagja në të cilën gjendet kjo xhami. Ajo (xhamia) gjendet në rrugën e quajtur sot me të njëjtin emër. Një pjesë e xhamisë është ndërtuar nga materiali i fortë, kurse pjesa tjetër nga tullat. Për ndërtuesin e kësaj xhamie, në Prizren mendimet janë të ndara. Disa ia përshkruajnë Kukli begut, kurse të tjerët, *Iljaz Kukës*. Autori i “Kronikës” së sipërpërmendur, Mehmet Tahiri, shkruan se Kukli begu në Prizren ka ndërtuar vetëm një xhami, kurse xhaminë e dytë, ky autor, ia përshkruan Iljaz Kukës.

¹³ Ibid, 86.

¹⁴ “Kronika”, në margjinat e artikullit për Kukli begun shkruan: تاريخ بناء جامع ٤١



Mbishkrimi në xhaminë Iljaz Kuka në Prizren

Mbishkrimi original, i cili këtë çështje do ta zgjidhte menjëherë, nuk është ruajtur, por është ruajtur vetëm mbishkrimi për renovimin e saj. Ky mbishkrim gjendet në pjesën e brendshme të hyrjes dhe daton nga viti 1317 (fillon më 12 maj 1899). Mbishkrimi është shkruar në gjuhën arabe dhe thotë:

لقد بنا لله هذا البيت قوقلى بك بناء جيدا
 بعده قد يلزم التعمير تجديدا منيرا نيرا
 ص ا د ف تعميرها في توبة التوليت¹⁵ النجل النسيب
 و هو مدعو باحمد بك سعي سعي بليغا حامدا
 ارتفع اذا انت معمور بان ترفع جدارا راغبا
 صار معمورا طريا كان نورا لامعا
 سنة ١٣١٧

¹⁵ Duhet: التولية

Përkthimi:

“Këtë faltore, - për hir të Allahut, - si ndërtesë të dalluar, e ka ndërtuar Kukli begu.

Më vonë është treguar i nevojshëm meremetimi i saj, ndaj dhe ajo e tëra ndrit.

Restaurimi i saj është bërë gjatë kohës kur drejtor i Vakëfit ka qenë trashëgimtari i tij me nam.

Ai quhet Ahmed beg dhe ai me sinqeritet është përpjekur.

Ngrihu, sepse je meremetuar që krenare të ngrihesh!

Është meremetuar nga themeli dhe është bërë dritë që shkëlqen.

Në vitin 1317”

Edhe ky mbishkrim thotë qartë se këtë xhami e ka ndërtuar Kukli begu. Të njëjtën gjë e pohon edhe trashëgimtari i përmendur i Kukli begut, që ishte myteveli. Kështu mendojnë edhe shumë prizrenas. Sa kohë që edhe në *Vakëfnamenë* e Kukli begut thuhet se ai ka ndërtuar në Zinovë dhe Prizren një mesxhid dhe dy xhami. Meqenëse në Zinovë ka ndërtuar një xhami, atëherë mbetet që xhaminë tjetër dhe mesxhidin t’i ketë ndërtuar në Prizren. Xhamia e tij e parë është e njohur tërësisht në Prizren, kurse tjetra mbetet të jetë mesxhidi, i cili më vonë u shndërrua në xhami, (që më pastaj i përshkruhet Iljaz Kukës), sipas së cilës (xhami) quhet e gjithë mëhalla në të cilën gjendej ai mesxhid. E dimë se disa mëhallë rëndom quhen sipas xhamive dhe mesxhideve, por në këtë pikëpamje ka edhe përjashtime. Një rast të tillë paraqet gjithsesi mëhalla e Iljaz Kukës, e cila kështu është quajtur që nga fillimi i shek. XVI e deri më sot.

Në një “*Sixxhil*” të vogël prizrenas ekziston një përshkrim i një vakëfnameje nga viti 1337 (1918, dok. nr. 52), në të cilën shihet se njëfarë Beqir Dedezade Hasan efendiu, i biri Abdullahut, spahi nga mëhalla Iljaz Kuka, ka vakëfnuar një shtëpi në atë mëhallë.

Dokumentin më të vjetër të kësaj mëhalle e kemi në *Vakëfnamenë* e poetit të njohur Suzi Çelebiu nga Prizreni nga viti 1513. Ajo na qartëson tërë këtë problem. Në të thuhet se Suzi Çelebiu “ka ndërtuar

një mesxhid dhe një shkollë fillore” në lagjen Iljaz Kuka¹⁶ pranë lumit Lumbardhë. Ajo vakëfname është legalizuar në vitin 918 (fillon më 19 mars 1513), që do të thotë se kjo lagje është quajtur Iljaz Kuka që në vitin 1513. Në këtë lagje deri atëherë nuk ka ekzistuar mesxhidi, andaj mesxhidin e parë në atë lagje e kishte ndërtuar Suzi Çelebiu. Prandaj, kjo mëhallë ka mundur të quhet Iljaz Kuka edhe pa mesxhidin e saj. Ajo është quajtur kështu edhe më vonë, madje edhe atëherë kur Suzi Çelebiu ndërtoi mesxhidin e vet, e kështu ka mundur të quhet akoma edhe më vonë, do të thotë, edhe atëherë kur Kukli begu në të kishte ndërtuar mesxhidin.

Nga *Vakëfnameja* e Kukli begut shohim se gjyshi i Kukli begut është quajtur Iljaz, (nuk përjashtohet mundësia që ai të jetë i njëjti me Iljaz Kukën), se ka marrë pjesë në pushtimin e Prizrenit, se lagjja e ka marrë emrin sipas tij, dhe se Kukli begu në emër të tij (të Iljaz Kukës – shën. përkth.) ka ndërtuar mesxhidin.

Në një mbishkrim të vitit 1213 (fillon më 15 qershor 1798) shohim se minarja e kësaj xhamie ishte riparuar, por kur është ndërtuar, këtë nuk e dimë. Ai mbishkrim thotë:

حسبة لله تعالى بو جامع شريفك مناره سنى تعمير ايدن محمد بن عثمان

سنه ١٢١٣

“Për hir të Zotit Hirmadh, minaren e kësaj xhamie e riparoj Muhamedi i biri i Osmanit. Viti 1213”.

Nga *Vakëfnameja* e Kukli begut shohim se ai ka ndërtuar xhami edhe në qytetin e Zinovës në kadillëkun Hasllar dhe se myteveliu i kishte caktuar për detyrë që për çdo vit në Bajramin e Ramazanit dhe Kurban Bajramit të harxhonte nga 500 akçe që të gostiste myslimanët e pasur dhe të varfër pas faljes së namazit të bajramit. Vakëfnameja përcakton që hatibit dhe imamit të xhamisë së Kuklibegut në kasabanë

e Zinovës t’u jepen katër akçe për çdo ditë. Si duket, pranë kësaj xhamie, Kuklibegu kishte ndërtuar edhe *medresenë*, sepse mësuesit në Zinovë i caktoheshin nga dy akçe në ditë. Nga këto përshpirtënime (vakëfe) në Zinovë nuk ka mbetur asgjë.

Kukli begu kishte ndërtuar një teqe afër *musallës* (ar. musal-la. – vend i hapur në natyrë për faljen e namazit. - shën. përkth.) në Prizren dhe atë e kishte caktuar për mysafirë, udhëtarë dhe të tjerë. As ajo nuk është ruajtur.

Kukli begu Vakëfnamenë e vet e hartoi dhe e verifikoi para gjyqit në dekadën e parë të muajit shevval të vitit 944. Origjinali i Vakëfnamesë nuk është ruajtur; së paku ne nuk kemi mundur ta gjejmë askund dhe as të dimë se a ekziston ai. E dimë se sërish është përshkruar dhe verifikuar (në fillim të qershorit të vitit 1669) në Prizren, me rastin e një kontesti mes trashëgimtarëve të Kukli begut, myteveliu të vakëfit të tij dhe të disa personave të cilët në atë kohë kishin filluar ta grabisnin këtë vakëf. Grabitja e vakëfeve të Kukli begut bëhej prej viti në vit, e sidomos në periudhat më të vonshme kur mori përmasa të tilla sa që në fund, nga i gjithë ai vakëf i madh, nuk mbeti asgjë. Ismail pasha, mytesarif i Prizrenit (1785-1794), grabiti mullirin mbi lumin Toplusi në fshatin Krushe. Mahmud Pashë Rrotlla, mytesarif i Prizrenit (1808-1836), përvetësoi nga myteveliu i Kukli begut karavansarajin në fshatin Mamushë afër Prizrenit. Për vakëfet e Kukli begut në Shkup, Tetovë, Shkodër e Lezhë, nuk ka kurrfarë gjurmësh. Dyqanet që kishte pasur në Prizren në anën e djathtë të Lumëbardhit (në Tregun e Vjetër dhe në Çarshinë e Popit), i kishin përvetësuar kryesisht të krishterët qysh në kohën e Jastrebovit, do të thotë, në gjysmën e dytë të shek XIX, kurse disa dyqane ishin në duar të myslimanëve si pasuri e tyre. Rasti është i njëjtë edhe me karavansarajet, të cilët që moti kishin kaluar në pronësinë shtetërore, disa në pronësinë e disa personave privatë, e disa të tjerë ishin rrënuar tërësisht. Në kohën kur Jastrebovi kishte qenë në Prizren, prej vakëfeve të Kukli begut kishin ngelur vetëm disa dyqane në afërsi të xhamisë së Kukli begut në *Tregun e drithit* dhe ndonjë tjetër tek-tuk në ndonjë lagje. Në duar të Maliq begut, myteveli i vakëfeve të Kukli begut, asokohe gjendej edhe

¹⁶ Olesnicki në Vakëfnamenë e Suziut gabimisht e ka lexuar emrin e kësaj lagjeje - Iljaz Koxha. (Suzi Çelebiu nga Prizreni, poet turk nga shek. XV-XVI, Glasnik skopskog nau-nog društva, XIII, Skoplje, 1934, 69-82).

karavansaraji në Shkup, pak tokë dhe dy livadhe të vogla në fshatin Brrut (Opojë).¹⁷

Sot ekzistojnë dy përshkrime të Vakëfnamesë së Kukli begut. Njëri përshkrim, mjaft i dëmtuar, gjendet në “*Sixhilin*” e përmendur të Prizrenit, kurse tjetri në Drejtorinë e Vakëfeve në Ankara (Defter 590, f. 198 dhe më tutje).

Teksti i kësaj *Vakëfnameje* deri më sot nuk është botuar. Vetëm Jastrebovi e ka botuar të përkthyer (në gjuhën serbe – shën. përkth.) dhe atë në mënyrë mjaft të lirë dhe pa ndonjë kritikë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka kjo Vakëfname për historinë e Prizrenit, ne po e botojmë në tërësi. Teksti i Vakëfnamesë është botuar në bazë të përshkrimit që gjendet në Drejtorinë e Vakëfeve në Ankara, mirëpo, me këtë rast është marrë parasysh edhe përshkrimi në “*Sixhilin*” e Prizrenit, kështu që plotësimet që mungojnë në përshkrimin e Vakëfnamesë që gjendet në Ankara, në tekst janë futur në kllapa, ndërsa dallimet tjera janë theksuar në fusnota.

Përkthimi i përshkrimit të verifikuar të Vakëfnamesë, thotë:

“Gjithë atë që është shkruar këtu për vakëfnamenë e bukur dhe përshpirtënimin madhështor, e konsideroj të drejtë, andaj kam gjuvuar se vakëfnimi është i vlefshëm dhe i pa revokueshëm. Unë jam lutësi i Zotit, Haxhi Mustafë Avniu, kadi që përfaqësoj kazanë e Prizrenit së bashku me Suharekën.¹⁸ Lë të mëshirohen!”

¹⁷ Jastrebovi, të dhënat në f. 118-119

¹⁸ Në mesin e kadijëve të cilat i përkasin sanxhakut të Prizrenit, Haxhi Kallfa përmend edhe Suharekën (Stojan Novakovi, *Haxhi Kallfa*, Spomenik SAN XVIII, 1892, 56-58). Mirëpo, ne askund nuk kemi gjetur konfirmimin se Suhareka ka qenë kadijëk i veçantë dhe si e tillë të përmendet. Këtë nuk e gjejmë as në “Muhimme Defterin” e shek. XVI. Ka të ngjarë që kadiu i Prizrenit të ketë kryer edhe detyrën e kadiut për Suharekën. Të njëjtin formulim që e hasim këtu (kadiu i kazasë së Prizrenit me Suharekën) e gjejmë edhe në Vakëfnamenë e Suziut, të vërtetuar në vitin 1513, si dhe në Vakëfnamenë e Mehmed pashës të vërtetuar në vitin 1831, që do të thotë se kjo gjendje nuk është ndryshuar as në gjysmën e parë të shek. XIX. Në Kanunnamenë e Prizrenit të vitit 1570, një përshkrim i secilës gjendet në duart tona, e në të cilën përmendet nahija e Tergovishtës, Bihorit, Sersernës dhe Hoçës, nuk përmendet Suhareka.

Përkthimi i vetë Vakëfnamesë, thotë:

“Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, Që i ka zbukuruar robërit e Tij me mëshirën fisnike, kurse me ndihmën e Tij dhe me mirësi ka udhëzuar në rrugën e drejtë atë që i lutet. Ia fal mëkatet atij që do, kurse ndëshkon atë që do. Ai është i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm. Pranoj se vetëm Allahu është Zot, se Ai është i Vetëm dhe nuk ka shok, me Dëshminë e cila shpirtit të njeriut i jep kthjelltësi dhe e shpëton nga zjarri dhe Xhehenemi.

Lë ta shpërblejë Zoti me Xhenet të parin tonë, Muhammedin a.s., familjen e tij dhe shokët e ndershëm të tij. Zoti ynë, pranoje lutjen tonë. Vërtet, vetëm Ti të gjitha i dëgjon dhe të gjitha i di. Pranoje kërkimfaljen tonë, sepse vetëm Ti pranon kërkimfalje dhe vetëm Ti je i Gjithëmëshirshëm. Qofsh lartësuar, i Lartëmadhërishti Zot, Që qëndron mbi gjithë që mund të përshkruhet. Paqe pejgamberëve, kurse çdo falënderim Ty, o Zot i të gjitha botëve.

E më pastaj: Kur trimi i trimave për fe, ripërtëritësi i fesë dhe i Sheriatit, Mehmed begu, i biri Hajrudinit, - lë të ia shtojë i madhi Zot përshpirtënimet e tij dhe lë t’ia dyfishojë bamirësinë deri në Ditën e Kiametit, - ka vërejtur se gjithë penjtë e qenies së tij trupore të lidhur për këtë botë janë të kufizuar në këtë jetë, dhe duke vërejtur në ëndërr pakujdesinë, atij papritmas i erdhi ideja nga i Madhi dhe i Gjithëmëshirshmi, kështu që vakëfnuesi i theksuar, Mehmedi, me ndihmën e Zotit Që falë shumë, u zgjua nga bota imagjinare. Duke kuptuar se ato ishin këshilla të mira, ai i dëgjoi dhe i mbajti shumë në mend, hapi syrin dhe arriti ta kuptonte mirë vlerën e kësaj bote të kalueshme, rrjedhën e ngjarjeve dhe zhvillimin e ngjarjeve të mëdha: se si kjo botë është mizërie, vend i vuajtjeve dhe stacion fillestar për botën tjetër, kështu secili atom që del nga errësira e asgjëje në botën e ekzistencës, patjetër do të kalojë nga kjo botë kalimtare në atë të përhershmen. Gjithsesi nga shtëpia e kalueshmërisë do të shpërngulet në botën e përhershme, ashtu siç ka thënë Allahu xh.sh.: “Secila gjallesë do ta shijojë vdekjen”.

Prandaj, i mençur është ai që ecën rrugës së bamirësisë dhe i cili kupton se me siguri do të jetë në mesin e njerëzve që do të futen nën

hijen e bamirësive të veta, andaj ai (Mehmed Kukli begu- vër. përkth.) është bindur se rruga më e mirë është që t'ua ndërtojë myslimanëve dhe besimtarëve një mesxhid lagjeje dhe dy xhami të respektuara. Duke vepruar mbi bazë të hadithit të Pejgamberit a.s., - Allahu e mëshiroftë!, - i cili thotë: "Kush ndërton faltore për Zotin, Ai do t'ia ndërtojë një shtëpi në Xhenet",¹⁹ - ka ndërtuar nga pasuria më e mirë e tij një mesxhid dhe dy xhami, kufijtë e të cilave është e tepërt të përkufizohen. (Ato i ka ndërtuar) Në Prizrenin e ruajtur nga Zoti dhe në kasabanë Zinovë në nahijen e Opojës në kadillëkun Haslar²⁰ dhe i ka vakëfnuar me emër të Zotit xh.sh., duke kërkuar kënaqësinë e Tij në ditën kur njeriu do të futet nën hijen e veprave të Tij të mira.

Pasi mirëbërësi ka përcaktuar si kusht që në to të falen pesë kohët e namazit dhe, me lejen e sulltanit, edhe xhumaja, - një gjë e tillë edhe është mundësuar.

Bamirësi i theksuar, - lë t'ia dyfishojë Zoti xh. sh. veprat e mira të tij deri në Ditën e Kiametit! - ka dëshiruar që ky mesxhid dhe xhamitë që ka ndërtuar, të jenë në gjendje të rregullt dhe të qëndrojnë deri në Ditën e Kiametit.

Për këtë qëllim, ai vakëfnoi në Prizren njëzet e pesë lokale, të cilët kufizohen me lokalet e Ahmedit, djali i Evrenos begut²¹ dhe me rru-

¹⁹ Hadith i Pejgamberit-Muhammed a.s.

²⁰ Për këtë kadillëk që është quajtur Havasi Prizren dhe Hasler, Haxhi Kallfa thotë se ky është "kadillëk i veçantë dhe i takon këtij sanxhaku". Novaković mendon se ato janë të mira të zotnive të Prizrenit që kanë pasur privilegje të veçanta. Të dhënat që i ofron kjo Vakëfname qartë udhëzojnë se kadillëku Haslar ka përfshirë nahinë e Opojës dhe Gorës me seli në Zinovë, në fshatin e sotëm Bresanë. Ai është quajtur Havasi Humayun (Muhimme, XVIII, nr. 266), Gora ve Havasi Prizren (*Muhimme*, 58, nr. 856) ose vetëm Hasler ose edhe Havasi Prizren (*Muhimme XVIII*, nr. 60).

²¹ Ahmed begu i biri i Evrenos begut ka qenë një nga prijësit më të njohur të akinxhinjve në gjysmën e dytë të shek. XV. Jastrebovi mendon se ky ka pushtuar Prizrenin (*Stara Srbija i Albanija*, 50) dhe atëherë fitoi atributin *Gazi*. Në këtë e marrim me rezervë, sepse nuk kemi kurrfarë fakti për të, e Jastrebovi asnjëherë nuk e ka cekur burimin. Ahmed begu aktivisht kishte marrë pjesë në luftërat për pushtimin e Shqipërisë. Kur në prill të vitit 1478 sulltan Mehmed i II u nis për të pushtuar Shkodrën, si pararojë dërgoi Ahmed beg Evrenosin dhe Omer beg Turhan begun për të riparuar urat dhe rrugët. Ahmed begu ishte në krye të ushtrisë, e cila gjashtë muaj e kishte mbajtur të rrethuar Shkodrën dhe e pushtoi atë. (*Tacut Tevarih*, 562-566; *Tarihi Solak-ade*, 256). Nga kjo Vakëfname shohim se ai ka pasur në Prizren dyqane dhe se Kukli begu nga biri i tij, Mehmed Çelebiu, kishte blerë një kopsht.

gën publike; tri lokale, që i kishte blerë nga hoxhë Sylejmani; katër lokale që i kishte blerë nga Dervishi, djali i Shir Merdovit; pesë lokale, që i kishte blerë nga haxhi Shabani dhe karavansarajin²², i cili kufizohet me mesxhidin e Jakub beut²³ dhe me rrugën publike si dhe lokalet që gjenden nga ana e jashtme e karavansarajit.

Ka vakëfnuar dhe përshtipëtnuar po ashtu dhjetë lokale, të cilët gjenden para karavansarajit të theksuar dhe midis dy lumenjve; dhjetë lokale të cilët gjenden në hyrje të Çarshisë afër lokaleve të hekraxhinjve²⁴ në lagjen Xhami Atik (Xhamia e Vjetër)²⁵, afër urës të të ndjerit,

²² Në tekst është përdorur shumësi karbansaraylar, mirëpo ne e kemi përkthyer në njëjës, sepse më poshtë shihet se ka të bëjë me një karavansaraj. Ky karavansaraj është quajtur Mirhan. Këtu tani është tregu i ri i gjelbër. Në kohën e Jastrebovit (në vitet shtatëdhjeta të shek XIX), ai han i ka shërbyer destinimit të vet dhe ka qenë në duar të pushtetit që e kishin marrë nga Mahmud pashë Rrotlla. Mahmud pashë Rrotlla me dhunë e kishte marrë nga myteveliu i vakëfit të Kukli begut. (Të dhëna 114, vërejtja 3).

²³ Ky mesxhid, i cili gjatë kohëve është restauruar shumë herë është shndërruar në xhami dhe quhet Xhamia e Arastës, sipas Çarshisë së Arastës në Prizren, e cila ishte djegur në qershor të vitit 1853. Në Prizren xhaminë e quajnë edhe xhamia e Jakub beut, ndërsa Jastrebovi (*Stara Srbija*, 50) atë e quan xhamia e Evrenos beut, duke pohuar se atë e ka ndërtuar Evrenos beu, trashëgimtar i Gazi Evrenos beut. Në "Kronikën" e Tahir efendiut shkruan se atë e ka ndërtuar Jakub dede Evrenosi. Jastrebovi thekson se kjo xhami është ndërtuar në vitin 1585, duke u mbështetur në mbishkrimin e një kroi që e kishte ndërtuar Evrenos beg Evrenosi. Mirëpo, ndërtuesi i xhamisë është Jakub pasha ose Jakub dede Evrenosi, e siç shihet nga kjo Vakëfname, ajo është ndërtuar para vitit 1526. Por, nuk kemi mundur ta konfirmojmë raportin në mes Jakub pashës dhe Ahmed beg Evrenosit, dhe të një trashëgimtari me emrin Evrenos beg, i cili në Prizren, në vitin 1583 kishte ndërtuar kroin. Ky Evrenos beg përmendet edhe në dy ferma osman. Në njërin ferman nga viti 1564 i urdhërohet begut të Prizrenit që t'i kontrolloj librat dhe llogaritë të të ndjerit Evrenos beut dhe t'i dërgoj në Stamboll, ndërsa në tjetrin ferman të të njëjtut vit urdhërohet beu i Prizrenit që t'i kontrolloj llogaritë e mytevelisë së vakëfit të të ndjerit Evrenos beg (G. Elezovi, nga arkivat e Stambollit, *Muhimme Defteri*, Beograd, 1950, 169-170).

²⁴ Në tekst: *Timurqiler dukanlari kurbunda*.

²⁵ Cami'i atik (Xhamia e Vjetër), në të vërtetë është kisha e Levishës. Jastrebovi në "Stara Srbija i Albanija", 40, të dhëna, 70; R. Gruji (Enciklopedia S. Stanojevi, Prizren; P. Kostić, Crkveni život pravoslavnih srba u Prizrenu i njegovoj okolini u XIX veku, Beograd, 1928, 72) dhe historianët tjerë pohojnë se ajo kishë është shndërruar në xhami në gjysmën e dytë të shek. XVIII. Mirëpo, nga kjo Vakëfname shohim se ajo ka ndodhur para vitit 1538. Për këtë ka një varg faktesh. Ajo xhami është quajtur *Fet'hiya*. Në një mbishkrim dhe në një dokument të një *Sixhili të Prizrenit*, xhamia quhet *Fet'hiye cami'i sherif*. Përveç kësaj, disa burime qartë tregojnë se vet Fatihu kishën e kishte shndërruar në xhami. Në "Kronikën" e përmendur të Tahir efendiut, qëndron:

Suxhudi²⁶, ndërmjet dy lumenjve dhe pesëdhjetë lokaleve të cilët i ka muruar në Tregun e Vjetër.²⁷

Po ashtu ka vakëfnuar dhe përshpirtënuar tri ndërtesa, të cilat i ka ndërtuar prapa lokalëve në Tregun e Vjetër si dhe çardakët të ndërtuar në ato. Po ashtu ka vakëfnuar edhe ujin e mullirit me dy gurë, të cilin e kishte blerë nga Husref Çelebiu, deri te At-mejdani, musa-lanë²⁸ dhe kopshtet e poshtme. Ka vakëfnuar dhe përshpirtënuar karavansarajin me katin përdhes dhe katin e parë, të cilin e kishte ndërtuar afër Tre-

و فاتح خان بذاته بدل أكبر الكنائس و صلى بجمعتي (!) ... يسمى له العتيق و جامع جمعه...
D.m.th.: "Fatih Mehmed han vet e ka shndërruar kishën më të madhe dhe ka falur namazin me të gjithë ne.

Ajo është quajtur "E Vjetër" (Atik) dhe "Xhuma Xhamia".

Në një mbishkrim tjetër që është shënuar edhe në transkriptimin rus të Jastrebovit i gjejmë këto fjalë:

بودر فتحيه درلر جامع عتيق بحمد الله كه فاتح بوني المش

D.m.th.: "Kjo është Xhamia e Vjetër dhe e quajnë Fet'hije.

Lavdi Zotit që Fatihu e ka çliruar".

Të gjitha këto dhe një varg dokumentesh, që do t'i ekspozojmë hollësisht në një punim të veçantë, flasin qartë se kisha është shndërruar në xhami që në kohën e Fatihut.

²⁶ Suxhudi (Sucudi) është poet turk nga periudha e sulltan Selimit dhe periudhës së parë të sulltan Sylejmanit. Sipas Latifit ("Tezkire", 183-4), Suxhudi ka qenë notar i silahdarit, ndërsa sipas Surejasë ("Sicili- osmani", III, 9) dhe Shemsuddin Samiut ("Qamus ul a-lam" IV, 2538) ka qenë shkrimtar i divanit në ndikimin e Piri-pashës. Ka shkruar në prozë të rimuar dhe strofa pushtimet e sulltan Selimit në vepër të veçantë që mban titullin "Selim-name", e gjendet në bibliotekën e Topkapu Sarajit, Revan Ktp, nr. 1284. (Shih: Aga Sirri Levand, *Gazavatnameler ve Mihalloulu Ali beyin Gazavat-namesi* Ankara 1956, 25), në Bibliotekën Nacionale në Vjenë dhe Bibliotekën Nacionale në Paris. Levendi e quan Kalkandelenli Sucudi-Suxhudi i Tetovës.

Kronistët turq nuk pajtohen për prejardhjen e Suxhudiut. Ndërsa Latifi thotë se është me prejardhje nga Prizreni, Surejai dhe Sh. Sami Frashëri mendojnë se është nga Tetova. Është vështirë të japësh vendim për atë se kush ka të drejtë, por ne anojmë dhe besojmë se është nga Prizreni dhe këtë e themi jo pse Latifi ka qenë bashkëkohanik i tij, por kryesisht për faktin se në Prizren ka ndërtuar një urë, siç po shihet nga kjo Vakëfname. Suxhudi ka vdekur para vitit 1538, pasi në vakëfname përmendet si i ndërjet.

²⁷ *Pazari i Vjetër (Eski Pazar)* ka qenë në Merxhan, pranë lumit Lumbardhë, në mes Urës së Drurit, e cila është quajtur "Nalet kyprysi" (Ura e dreqit) dhe Urës së Gurit, nëpër të cilën ka kaluar rruga e postës për në Shkup (Podaci, 115, vërejtja 21).

²⁸ *Musal-la ose namazxhahu* gjoja është ndërtuar me shpejtësi me rastin e pushtimit të Prizrenit. Ka ekzistuar (edhe sot ekziston) në dalje të Prizrenit në rrugën për në Gjakovë. Disa *musal-la*, si ajo në Prishtinë, janë ruajtur deri me sot, por gjatë kohës kanë përjetuar riparime.

gut të Vjetër, në tokën e Ballaban Çelebiut, i cili karvansaraj në të katër anët kufizohet me rrugën publike dhe me Lumbardhin.²⁹

Po ashtu ka vakëfnuar dhe përshpirtënuar karavansarajin, të cilin e ka ndërtuar në tokën të cilën e kishte blerë nga Ferhad begu dhe Daud Vojvoda, i cili kufizohet me pasurinë e rrobaqepësve Abdi dhe Hasan të bijtë e Abdullahit dhe me kishën, si dhe në dy anë me rrugën publike.³⁰

Po ashtu ka vakëfnuar dhe përshpirtënuar hamamin të cilin e kishte ndërtuar në kasabanë Zinovë në kadillëkun Haslar.³¹

Në vet Prizrenin vakëfnoi dhe përshpirtënoi kopshtin, të cilin e kishte blerë nga Mehmed Çelebiu i bir i Ahmed begu, që kufizohet me Lagjen e Tabakëve³², me jazin, me rrugën publike dhe me kopshtin e vakëfit. Të gjitha këto, janë fshat i tij, në të cilin gjendet kopshti që në dy anë kufizohet me rrugën publike, nga një anë me lagjen e Tabakëve, e në njërin anë me livadhet e qytetarëve.

Po ashtu ka vakëfnuar kopshtin e bukur me pemë, me rrush dhe hardhi dhe gjithë atë që i përket këtij kopshti i cili gjendet në rrethinën(?) e Prizrenit, nën At-mejdanin dhe kufizohet në të katër anët me rrugën publike dhe jazin.³³

Ka vakëfnuar pesë mullinj në një ndërtesë në Prizren, afër Tregut të Vjetër, të cilët janë të njohur me emrin "Mullinjët e Pashtrajve"³⁴, një mulli me një gur në Prizren, afër Çarshisë se saraçëve³⁵, të blerë nga Radosavi dhe Anka, i cili gjendet nën të njëjtin kulm me mullirin e Mustafë Popajt.³⁶

²⁹ Ky karavansaraj që ka ekzistuar afër Tregut të Vjetër, sot nuk ekziston.

³⁰ Edhe ky karavansaraj sot nuk ekziston. Nuk e dimë se ku ka ekzistuar.

³¹ Nga ai hamam ekzistojnë vetëm gërmadhat.

³² *Mëhalla e Tabakëve (Dabaqlar mahallesi)* ka ekzistuar dhe ekziston edhe sot pranë Xhamisë Suzi. Përmendet edhe në Vakëfnamenë e Suziut nga viti 1513.

³³ Jazi për pirjen e ujit nga kafshët (sigir su) më vonë është quajtur Suzi-su (?) Ka ekzistuar jashtë Prizrenit, afër musal-lës në rrugën për në Gjakovë. (Jastrebovi, Podaci, 115).

³⁴ Në origjinal: *Pashtro-oglu degirmenleri*. Sot këtë mulli e quajnë Mulliri i Et'hem agës (*Etëm aganin degirmeni*).

³⁵ Në origjinal: *Saraqqlar qarshusu kurbunda*.

³⁶ Në origjinal: *Papas-oglu Mustafanin degirmenile*.

Po ashtu ka vakëfnuar katër mullinj në një ndërtesë, të cilët punojnë në lumin Toplusi.

Po ashtu ka vakëfnuar katër mullinj në dy ndërtesa, të cilat gjenden në fshatin Rapçe³⁷ në kadillëkun Hasllar.

Më tutje ka vakëfnuar dhe përshpirtënuar karavansarajin me katin përdhes dhe katin, i cili gjendet në Lagjen e Bojaxhinjve në Shkup, i cili kufizohet nga katër anë me lumin Serav, e nga tri anë me rrugën publike.³⁸

Po ashtu ka vakëfnuar edhe dy karavansaraje, të cilat i kishte ndërtuar në Lezhë si dhe pesëdhjetë dyqane, një çardakë me katet përdhese dhe me katet, ndërtesën që kishte ndërtuar për ruajtjen e sanës dhe kashtës dhe hamamin e vet.

Po ashtu ka vakëfnuar edhe karavansarajin me katin përdhes dhe me katin, të cilin e kishte ndërtuar në Shkodër; karavansarajin me katin përdhes dhe me katin në fshatin Makosh, në nahijen e Dukagjinit³⁹; karavansarajin me katin përdhes dhe me katin, të cilin e kishte ndërtuar afër kalasë së Dukagjinit⁴⁰, karavansarajin, të cilin e kishte ndërtuar në fshatin Klumin⁴¹; karavansarajin të cilin e kishte ndërtuar në limanin Vaspas⁴²; karavansarajin, të cilin e kishte ndërtuar në fshatin Goden⁴³; karavansarajin të cilin e kishte ndërtuar në fshatin Mamushë⁴⁴

³⁷ Fshati Rapçe, Vrapça (në tekste Raqa) gjendet në nahinë e Opojës. Përmendet edhe në krisobulën e Dushanit (GSUD XV,280).

³⁸ Ky është ai han në Shkup që ka ekzistuar deri para pak kohësh dhe është quajtur Zhivahan.

³⁹ Ky fshat edhe sot ashtu quhet. Gjendet në nahinë e Dukagjinit.

⁴⁰ Kalaja e Dukagjinit më vonë është quajtur Doda kalasi dhe gjendej afër fshatit Kalis. Fshati Kalis, me fshatrat për rreth, në shek. XIX ka paraqitur nahi të veçantë që i ka takuar sanxhakut të Prizrenit.

⁴¹ Fshati Kluminë (Klomje) gjendet në mes Kalisit dhe Shën Shpëtimit përgjatë Drinit të Zi.

⁴² Vaspasi (Vau i Pasit) - fshat në rrugën e Dukagjinit në mes Shkodrës dhe Prizrenit, afër urës ku kalohet Drini. Këtë karavansaraj më herët e kanë quajtur Hani Vaspasit. Aty rregullisht kanë kaluar natën kirixhinjtë, kur udhëtonin nga Shkodra në Prizren.

⁴³ Fshati Goden gjendet jo larg Vaspasit.

⁴⁴ Mamusha është fshat afër Prizrenit. Banorët e Mamushës flasin turqisht dhe thonë se janë sjellë nga Anadoli. Ky karavansaraj tani është i rrënuar. Jastrebovi mendon se ka qenë në fshatin Mamza në rrethin e Lumës (Stara Srbija i Albanija, 212). Mirëpo, në të dy përshkrimet tona është shkruar qartë Mamusha dhe theksohet se fshati i takon kadillëkut të Prizrenit, ndërsa fshati Mamza nuk i ka takuar atij kadillëku.

në kadillëkun e Prizrenit; karavansarajin të cilin e kishte ndërtuar në fshatin Sopotnicë, i cili i takonte kadillëkut të Shkupit⁴⁵.

Të gjithë hambarët dhe koshat që ishin ndërtuar në afërsi të të gjithë karavansarajeve i vakëfnoi me kushtin që karavansarajexhinjtë dhe personat e tjerë që në to banojnë, t'i mirëmbajnë hambarët dhe koshat dhe t'i japin me qira, kurse paratë që grumbullohen nga ato qira, të harxhohen në mirëmbajtjen e karavansarajeve. Në qoftë se kjo nuk do të mjaftonte dhe duhej harxhime më të mëdha, lë të marrin nga të ardhurat e vakëfeve, kështu që karavansarajet të funksionojnë dhe të jenë në gjendje të mirë.

Të gjithë karavansarajet e mi të cilët gjenden në çdo vend në rrugët e Shkupit dhe Stambollit, le t'i ruajnë dhe t'i pastrojnë, kurse personave që kryejnë këto detyra, le t'u paguhen nga dy akçe për çdo ditë.

Po ashtu ka paraparë që të hollat që do të fitohen në emër të qirasë nga karavansarajet, nga çardakët dhe nga katet përdhese dhe nga katet e tyre, si dhe hamamet që kishte ndërtuar në Shkodër dhe në Lezhë, të harxhohen për mirëmbajtjen e karavansarajeve, të cilët, për hir të Zotit, i kishte ndërtuar në rrugët e Dukagjinit⁴⁶ dhe Stambollit. Për rro-

⁴⁵ Ky fshat gjendet afër Shkupit. Edhe sot ashtu quhet.

⁴⁶ Rruga e Dukagjinit ka lidhur Prizrenin me Shkodrën dhe me detin Adriatik. Sipas Hanit, kjo në të vërtetë është rruga e vjetër romake që është nisur nga Lezha për në Nish dhe ka kaluar përmes Danjit, ka kaluar Drinin, përmes maleve të Mirditës dhe ka dalë te Hani i Dukagjinit përmes maleve të Pukës. Ka arritur te brigjet e Drinit dhe ka kaluar përmes Shën Shpëtimit (Vau i Spasit). Këtu rruga ndahej në dy degë, njëra kalonte Drinin dhe në drejtim të veriut shkonte për në Gjakovë, ndërsa tjetra përgjatë grykës së Drinit të qonte në Prizren. Kjo degë e dytë - përmes Hanit të Vezirit dhe Urës së Vezirit - dilte në Kukës, Kullë të Lumes, Shalqi dhe fshatin Vermicë dhe pas tri orë udhëtimit nga ky fshat në Prizren. Duke parë rëndësinë e kësaj rruge, Kukli beu përgjatë asaj rruge ndërtoi disa karavansaraje. Konsiderojmë se është i paqëndrueshëm pohimi i Jiriçekut se rrugët nëpër Shqipëri nëpër të cilat është zhvilluar komunikacioni për tregti ishin të dëmtuara dhe stacionet tregtare të shkatërruara, sidomos rrugët që shkonin nga ngushtica e Bunës për gjatë lumit Drin nga Shkodra deri në Prizren dhe Fushë të Kosovës (Die Handelstrasse und Bergwerke vonSerbien und Bosnien Wahrend des Mittelalters, 1879, 62-68). Kjo do të kishte të bënte me periudhën e mëvonshme, kur në masë më të madhe u paraqitën plaçkitësit, të cilët vepronin nëpër të gjitha rrugët. Mbase edhe në gjysmën e shek. XIX kur në këto anë sundonte anarkia, tregtia e Prizrenit ishte e drejtuar kah Shkodra. Përmes Shkodrës malli kalonte në Austrohungari dhe importohej nga ajo (Emile Weit, consul de Fra e Scutari, Memoire sur la pachu de Prizren, Bulletin de la societe geographie, octobre 1866. Bile edhe në kohën kur Nushiç kishte qenë në Prizren për Shkodër, pandërprerë kishin udhëtuar karavanet e mallrave (Nga Kosova, në disa vende).

gën e atyre që kujdesen për ruajtjen dhe pastërtinë, - me dijen e kadiut lokal, - lë të harxhohen nga dy akçe në ditë. Mirëpo, nëse vjen dikush dhe deklaron “unë dëshiroj të kujdesem për vakëfin” dhe nëse pranon (detyrat) e ruajtjes, pastrimit etj., me një shpërblim prej një akçe në ditë, lë t’i jepet, kurse teprica e të hollave lë t’i mbetet vakëfit.

Për ruajtjen dhe riparimin e urës, të cilën ai e kishte ndërtuar mbi lumin Vardar në kadillëkun e Tetovës⁴⁷, ka caktuar treqind e gjashtëdhjetë akçe për një vit. Për ruajtjen e zabelit, i cili ishte i nevojshëm për urën dhe i cili gjendet prapa urës, ka caktuar treqind e gjashtëdhjetë akçe në vit, por me këtë kusht: Cilido qoftë nga fshatarët e fshatit Zhelinë, i cili është afër urës, që dëshiron ta ruajë, lë t’i jepen si shpërblim treqind e gjashtëdhjetë akçe në vit”.

Po ashtu kadiut të Tetovës ia ka caktuar shpërblimin për detyrën mbikëqyrëse 60 akçe në vit, me kusht që askujt të mos ia lejojë që zabelin e theksuar ta presin, meqë do të dëmtohej ura.

Mirëbërësi i theksuar ka vakëfnuar nga pasuria më e pastër dhe thesari më i bukur 50 mijë akçe të reja argjendi, të cilat janë në qarkullim dhe të cilat janë farkuar me urdhër të sulltanit, dhe këtë e ka bërë pasi i ka ndarë (nga pjesa tjetër e pasurisë).

Ai nga ana e vetë e ka caktuar babanë e vetë, Hajrudinin të birin e Iljazit, drejtues (myteveli)⁴⁸ të vakëfit të vet. Ai sasinë e përmendur dhe të gjitha këto vakëfe i ka ndarë nga pasuria e vet dhe të gjitha ato atij ia ka dorëzuar. Pasi Gjyqi i Sheriatit ia ka lejuar ta kryejë detyrën (detyrën e mytevelisë), ai në tërësi e ka pranuar dhe ka marrë detyrën e mytevelisë mbi vakëfin e theksuar dhe shumë e theksuar të të hollave po ashtu.

Vakëfnuesi i theksuar përcaktoi drejtuesit mbi të gjitha vakëfet, disponimin me ta, ndryshimin, tjetërsimin dhe ndërrimin, largimin dhe zëvendësimin e imamëve, mualimëve dhe zyrtarëve të tjerë derisa

⁴⁷ Kjo urë e Kukli begut mbi lumin Vardar edhe sot ekziston afër fshatit Zhelinë.

⁴⁸ Sipas Jastrebovit (Podaci, 114, vërejtja 1) pas babait të Kukli begut myteveli ishin këta: Vëllai më i vogël i Kukli begut, Sylejman begu, biri i këtij Et’hem begu, Ali begu, Muhamed begu, Hajrudin begu, Sylejman begu, Ismail begu, Et’hem begu, Hajrudin begu, Et’hem begu, Sejfidin begu dhe Maliq begu i cili ka qenë myteveli gjatë kohës së Jastrebovit.

të jenë gjallë këta drejtues. E kur bamirësi të ndërroje jetë, atëherë e drejta e realizimit të ndryshimeve dhe zëvendësimeve lë të jetë në duar të mytevelive.

E kur babai i tij do të kalojë në botën tjetër, atëherë myteveli lë të bëhet njëri nga shërbyesit e bamirësit të theksuar që është më solidar dhe më i dobishëm për interes të vakëfit. Trashëgimtarët më të mirë meshkuj që janë më të dobishëm për vakëfin, lë të bëhen myteveli, brez pas brezi, nga gjenerata në gjeneratë. Mbikëqyrësi të jetë njëri nga farefisi i bamirësit brez pas brezi dhe lë të jetë ai që është më i miri dhe më i dobishmi për vakëfin.

Vetëm atëherë kur myteveliu dhe mbikëqyrësi i bëjnë dëm dhe i shkaktojnë humbje vakëfit, atëherë kadiu aktiv, në pajtueshmëri me xhematin, hatibin dhe myezinin, lë t’i caktojnë në detyrë të mytevelisë dhe mbikëqyrësit myslimanët më të mirë, të cilët janë të përshtatshëm, të aftë dhe të dobishëm për vakëfin.

Mirëpo, nëse dëmi i tyre ndaj vakëfit nuk është i theksuar, atëherë myteveliu të mos jetë nga farefisi, po ashtu edhe mbikëqyrësi. E më vonë kur ata të vdesin, atëherë kadiu aktiv, në mënyrë transparente me dijen e hatibit, myezinit dhe xhematit, t’i caktojë si myteveli dhe mbikëqyrës ata persona që janë myslimanë më të mirë e që janë të përshtatshëm dhe të pa përtesë në punë. Po ashtu kadiu aktiv të mos i bëjë shërbyesit e vakëfit pa dijen e xhematit.

Bamirësi i theksuar, - lë ta ndihmojë Sunduesi i Mëshirshëm në të gjitha përpjekjet, - po ashtu ka paraparë që dyqanet e theksuara dhe mullinjët, si dhe banesat e theksuara, të jepen me qira sipas rregullave të Sheriatit, kurse shuma e përmendur të jepet me interesat e lejuar me Sheriat, në mënyrë që nga paratë e fituara nga qiraja ligjore t’i jepen mytevelisë nga dhjetë akçe në ditë, notesit nga pesë, kurse mbikëqyrësit të vakëfit t’i jepen po ashtu pesë akçe - e që janë në shërbim të vakëfit në vet Prizrenin dhe në kadillëkun Hasllar (Haset).

Myteveliu i theksuar me mbikëqyrjen e vet dhe me noterin lë t’i vizitojë dhe lë t’i shikojë një herë në vit të gjitha vakëfet që gjenden në të gjitha viset, dhe të meremetojnë ato që janë për meremetim në karavansarje, në kilere, të riparohen urat etj. Nga një fletëllogari, me

dijen e kadiut, lë ta marrë myteveliu, kurse një tjetër lë ta marrë mbikëqyrësi.

Në vazhdim (Mehmed Kukli begu – vër. përkth.) ka paraparë që hatibit dhe imamit të xhamisë në kasabanë Zinovë t'u jepen për çdo ditë nga katër akçe: mualimit dy akçe në ditë, zëvendësit të tij një akçe, dy myezinëve nga dy akçe, kurse kajimit (pastruesit) të xhamisë një gjysmë akçe në ditë.

Po ashtu ka përcaktuar që për çdo ditë të lexohen nga dy xhuza, dhe kjo njëri për shpirt të nënës së tij, e tjetri për Pejgamberin, të zgjedhurin Muhamedin a.s.. Ka paraparë që xhuzët e theksuar t'i lexojnë myezinët (me pagesë) nga një akçe në ditë, kështu që rroga e tyre të jetë tri akçe në ditë.

Pastaj ka përcaktuar që hatibit të xhamisë së ndershme në Prizren t'i jepen katër akçe në ditë, mualimit dy akçe, zëvendësit të tij një akçe në ditë, dy myezinëve nga dy akçe në ditë dhe secilit kajim nga gjysmë akçe në ditë.

Që për çdo xhuma të lexohen nga gjashtë ashere, ka caktuar tri akçe e gjysmë. Një akçe prej këtyre t'i jepet sermahfilit, ndërsa dy akçe e gjysmë t'u ndahen pesë lexuesve të ashereve. Sevapi i ashereve të lexuara t'i dhurohet të zgjedhurit nga mesi i pejgamberëve, Muhamedit, ndërsa dy ashere, myezini lë t'i lexojë për shpirt të nënës së vakëfnuesit. Muarifi i xhamisë të lexojë një ashere që t'i paguhet në ditë nga një akçe, dhe kjo një gjysmë akçe për leximin e asherës dhe gjysma tjetër për punën e muariffit. Dy ashere lë t'i lexojë imami dhe myezini i mesxhidit i lagjes haxhi Kasim⁴⁹. Imamit të mesxhidit të theksuar ia ka caktuar nga dy akçe e gjysmë për çdo ditë, kurse myezinit të saj së bashku me punën e kajimit i ka caktuar nga një akçe e gjysmë

⁴⁹ Ky mesxhid më vonë është shndërruar në xhami dhe si e tillë ekziston edhe sot. Gjendet në mëhallën me të njëjtin emër, në rrugën Mustafë Bakiu nr. 10. Sipas Kostiqit (Crkveni život, 93) në atë vend ka ekzistuar kisha kushtuar paraqitjes së Zotit. Mirëpo, ne nuk kemi gjetur kurrfarë konfirmimi për atë, dhe as që ekziston ndonjë shenjë për atë në tregimet popullore. Për ndërtuesin e xhamisë nuk kemi kurrfarë të dhënash. Autori i "Kronikës" thotë se është nga Anadulli dhe me profesion veterinar në shërbim të Kukli begut. Kjo mund të jetë e saktë, sepse shohim se Kukli begu i cakton disa detyra dhe shpërblime për imamin dhe myezinin e këtij mesxhidi.

në ditë, kështu që me gjysmë akçe për leximin e asherës në xhami t'i këtë dy akçe në ditë, e imami i saj me gjysmë akçe për leximin e asherës, t'i këtë tri akçe në ditë. Mualimit ia ka caktuar nga dy akçe në ditë, e zëvendësit të tij një akçe në ditë.

Në vazhdim ka paraparë: "Në qoftë se me caktimin e Allahut xh.sh. shpërngulem në botën tjetër në Prizren dhe aty varrosem, për çdo ditë pas faljes së namazit të drekës dy lexues të lexojnë nga një ashere të Kuranit dhe lë t'ia kushtojnë shpirtit tim dhe të luten për mua". Secilit ia ka caktuar nga një akçe në ditë.

Pastaj për qirinj dhe hasra të mesxhidit, ka caktuar nga një akçe.

Si shpërblim për mbikëqyrësin-kadiun e Prizrenit, ka caktuar 150 akçe në vit, ndërsa kadiut në hase nga 100 akçe. Pastaj ka caktuar për secilin kopshtar nga dy akçe në ditë, nën kushtin që t'i rregullojnë gardhet e kopshteve, t'i ujitin dhe t'i ruajnë pemët e tyre dhe frutat tjera. Kurse, harxhimet për vreshtat, hardhitë dhe të tjerat, myteveliu lë t'i japë nga arka e vakëfit. Ato (kopshtet) i ka vakëfnuar për teqenë, e cila gjendet afër musalës⁵⁰, për mysafirët të saj, udhëtarët dhe të tjerët.

Mbikëqyrësit të teqesë ia ka caktuar nga tri akçe në ditë. Një lë të jetë për pastrimin e pusit, për kovë dhe litar, ndërsa dy akçe lë të jenë për mirëmbajtjen e oborrit të namazxhahit dhe për nevoja të tjera të tij. Të ardhurat nga sana lë t'i jepen mbikëqyrësit të teqesë. Në vazhdim, ka përcaktuar nga dy akçe në ditë për mihjen e kopshtit të vakëfit, që gjendet afër teqesë. Në qoftë se dervishi i teqesë është i aftë, ai i merr edhe ato akçe dhe ai lë ta punojë kopshtin. Në qoftë se ai nuk është në gjendje, atëherë lë të merret një kopshtar dhe atij t'i jepen ato dy akçe.

Po ashtu ka caktuar nga një akçe në ditë për pastrimin dhe ruajtjen e karavansarajit, i cili gjendet afër xhamisë në qytezën e Zinovës. Ai ka përcaktuar kushte të këtilla: Në qoftë se dikush nga shërbëtorët, qoftë ai imam, myezin ose kushdo qoftë, që merren me bujqësi, detyra e tyre lë t'u jepen të tjerëve. Në fillim të çdo viti të dy kadinjtë e theksu-

⁵⁰ Nuk e dimë saktësisht se ku ka ekzistuar kjo teqe. Siç duket, ajo ka qenë teqe bektashiane. Kështu kemi dëgjuar në Prizren.

ar, duke njoftuar hatibin, myezinin dhe xhematin, t'i mbikëqyrin të ardhurat dhe të dalat dhe harxhimet e vakëfit në bazë të defterëve të mytevelisë, kontrolluesit dhe notarit, lë ta bëjnë llogarinë dhe atë lë ta regjistrojnë në sixhilet e tyre. Një kopje të llogarisë të vulosur dhe të nënshkruar lë t'ia japë mytevelisë, kurse tjetrën mbikëqyrësit.

Vakëfnuesi i theksuar po ashtu ka paraparë: Myteveliu i vakëfit për çdo vjet lë të harxhoje në xhaminë e qytezës së Zinovës 500 akçe në kohën e Bajramit të Madh dhe Bajramit të Vogël, lë të ziejë ushqim në ditët e atyre bajrameve dhe t'i qerasë myslimanët e varfër dhe të pasur pas faljes së namazit të Bajramit. Lë të hanë me kënaqësi dhe lë të luten për shpirtin e Pejgamberit dhe për shpirtin e bamirësit. Për zierjen e ushqimit në të dy bajramet ka vakëfnuar dy kazanë dhe pesëdhjetë sinia.

Po ashtu ka paraparë që të gjitha të ardhurat e të gjitha këtyre vakëfeve të tij të harxhohen për nevojat e riparimit të urave, lokaleve dhe vakëfeve të tjera. Në qoftë se këto të ardhura nuk janë të mjaftueshme, lë të merret nga harxhimet dhe lë të bëhen riparimet.

Kur mirëbërësi përfundoi paraqitjen e rregullave të vakëfeve dhe i ndau nga pasuria e vet, të gjitha, një nga një, ia dorëzoi babait të vet, Hajrudinit. Ai këto i mori dhe filloi të drejtojë me vakëfet e theksuara. Edhe pse myteveliu dispononte me vakëfin e theksuar, mirëbërësi tha: "Pasi sipas Sheriatit nuk ekziston pajtueshmëri për vlefshmërinë e vakëfit dhe duke pasur parasysh ndasitë për përvokimin, sipas fjalëve të imamit të madh Ebu Hanife Numan ibni Thabitit nga Kufja⁵¹, lë të jetë i kënaqur Zoti xh.sh. me të - kur vakëfi vakëfnohet ai është i revokueshëm. Për këtë arsye, vakëfnimin e pasurisë së theksuar unë e revokoj dhe kjo pasuri ende është e imja" dhe nga myteveliu i theksuar e kërkoi vakëfin e sipërcituar. Kur desh i ta merrte, për këtë Hajrudini tha: "Sipas fjalëve të dy imamëve të respektuar, Muhamed ibn Abu Hasan esh-Shejbaniut⁵² dhe Ebu Jusuf ibn Jakub al-Ansariut⁵³ - lë të

⁵¹ Imam Azami është Numan b. Thabit Ebu Hanife el-Kufi, jurist i madh islam, themelues i njërës nga shkollat-drejtimet islame, pra i drejtimit Hanefij.

⁵² Muhamed ibn Abi el-Hasan ash-Shejbani (725-805) është jurist i njohur islam, nxënës i Ebu-Hanifës.

jetë i kënaqur Zoti xh.sh. me ata!, -vakëfi është pasuri e Zotit xh.sh. e jo e bamirësit. Bamirësi i cituar, vakëfin e theksuar me vullnet dhe vetëdëshirë e ka ndarë nga pasuria e vet dhe mua më ka caktuar për myteveli dhe ma ka dorëzuar tërë vakëfin, andaj nga tash unë jam drejtues i vakëfit. Sipas mendimit juridik të dy imamëve, për gjërat që vakëfnohen për hir të Zotit xh.sh., nuk është e lejueshme kthimi i tyre". Atëherë ishte zhvilluar një kontest i gjatë në mes tyre, andaj qe i nevojshëm vendimi i kadiut. Pasi kishin ardhur në kontest para kadiut, i cili kishte gjykuar sipas Sheriatit dhe kishte firmosur dokumentin për vlefshmërinë e vakëfnimit dhe mostjetërsimin e vakëfit të theksuar, si dhe për vlefshmërinë e vakëfnimit dhe përvokueshmërinë e të hollave të theksuara sipas Sheriatit që këtë e lejon, andaj ka gjykuar për vlefshmërinë dhe zbatimin e kushteve të cituara më lart. Këtë e kishte thënë para vakëfnuesit të cituar, duke e konsideruar (këtë vakëf) të vlefshëm dhe të bazuar në Sheriat. Kështu, të gjitha dyqanet, mullinj-të, banesat, toka dhe të gjitha shtëpitë e theksuara janë bërë me vlerë juridike, të bazuara në Sheriat si vakëfe të patjetërsueshme, për të cilën edhe pajtohen të gjithë, andaj është regjistruar dhe është bërë i përhershëm, i pastër nga gjithë ata që do të mund ta ndryshonte natyrën e tyre juridike dhe i përvokueshëm sipas të gjithë dijetarëve të Sheriatit (myxhtehidëve), - lë të jetë Zoti xh.sh. i kënaqur me ta. Dhe askujt nuk ia ka lejuar që diçka të ndryshojë në këtë vakëf të sipërcituar dhe të kushteve të caktuara. Dhe kush e ndryshon pasi këtë ta ketë dëgjuar, atëherë mëkati do të bjerë mbi ata që e ndryshojnë. Vërtet Allahu i dëgjon të gjitha dhe të gjitha i di. Kush të përpiqet që një kusht të tij ta prishë ose ta ndryshojë ose zëvendësojë një nga rregullat e tij, ose të zvogëlojë diçka, përveç bamirësit të theksuar, lë ta arrijë mallkimi i Zotit xh. sh. i engjëjve dhe gjithë njerëzve. E shpërblimin bamirësit do t'ia japë Zoti xh.sh.

Hartimi dhe dëshmimi i dokumentit ndodhi në dekadën e parë të muajit shevval të vitit 944.⁵⁴

⁵³ Imam Jusuf (731-798) është jurist i njohur islam i shkollës hanefite. Gjatë kohës së Harun er-Rashidit ishte kadi suprem.

⁵⁴ Në mes 3-12 mars të vitit 1538.

Dëshmitarët:

Mevlana Haxhi Shabani, hatib në xhaminë Atik,

Mevlana Mehmed bir i Mustafës, hatib në xhaminë Xhedid (xhaminë e Re)⁵⁵.

Shkruesi i dokumentit Turguti, bir i Abdurrahmanit, hatib dhe të tjerët.

Në përshkrimin e dokumentit që gjendet në Sixhilin e Prizrenit gjenden edhe këta dëshmitarë:

Sinan Dede, i biri Aliut, myezin

Mevlana Abdi Hoxha, i bir i Husamës, mualim

Hyseni, i bir i Nesuhit, imam

Mustafë Oruçi, mualim

Sejdi Hoxha, i bir i Shir-Merdas, mualim

Muharrem Hoxha, i bir i Xhenanit

Davudi, i bir i Haxhi Aliut, myezin

Ejnebeg, i bir i Aliut, spahi

Hysen Dede, i bir i Jusufit.

Hartuesi Ramadan, i bir i Mustafait

Haxhi Aliu, i bir i Mustafait

Hyseni, i bir i Kasimit, ushtar.

Marrë nga: Hasan Kaleši i Ismail Redžep, *Prizrenac Kukli beg i njegove zaduzbine*, "Prilozi za orijentalnu filologiju", VIII-IX/1958-9, Sarajevë, 1960, 143 – 167.

Përgatiti:
Ismail Rexhepi
Sadik Mehmeti

⁵⁵ Të vetmet të dhëna për këtë xhami, e cila gjendej në Çarshi, na jep "Kronika" e Tahir efendiut. Ai thotë se xhaminë e ka ndërtuar njëfarë mevlana Xhafer efendiut, i cili ishte vrasë gjatë pushtimit të Prizrenit dhe aty është varrosur.

Edhe pse kjo xhami quhet Cami-i Cedid (Xhamia e Re), ajo është ndërtuar shumë herët, sikur se shihet edhe këtu, mbase menjëherë pas pushtimit të Prizrenit. D.m.th. pas shndërrimit të kishës në xhami ajo u quajt Cami-i Atik (Xhamia e Vjetër), që në të vërtetë është ajo xhami që ishte quajtur Cami-i Cedid (Xhamia e Re).

Hasan Kaleshi – Ismail Rexhepi

KUKLI BEG AND HIS WAQF (ENDOWMENT)

(Summary)

Little has been written about this Ottoman legator, whose waqf can be compared to that of Husrev Beg and Isa Beg. Furthermore, his waqfname, which represents doubtlessly the most important document about Prizren from the first half of the 16th century has not been published until now. Kukli Beg has endowed 117 shops in Prizren, 50 shops and a large number of mills in Lezha, he has built a bridge over the Vardar River in the vicinity of Tetova as well as 14 karavansarays (throughout the empire). According to Jatsrebov, Kukli Beg was one of those who conquered the town Prizren, who distinguished himself in the battle for this town (the latter is the source of his wealth). On the other hand, according to Lutovac, Kukli Beg was a "wealthy feudalist" and "Ottoman conqueror".

حسن كاليشى و اسماعيل رجبي

كوكلى بك و اوقافه

(خلاصة البحث)

عندما نذكر هذا الواقف العثماني الذي يمكن ان تقارن اوقافه بخصرو بك و عيسى بك الا ان مع الاسف الشديد فان ما كتب عنه يعد قليلا جدا حتى انه بات غير معروف. يمكن القول حتى ان وقفه الذي يمثل و بلا شك اهم وثيقة عثمانية بمدينة بريزن في النصف الاول من القرن السادس عشر – لم يتم نشره حتى اليوم.

السؤال الذي يطرح امامنا من هو كوكلي بك و الذي ترك اوقافا كثيرة اذا استثنينا الحدائق و الغابات و المزارع هو اوقف 117 دكانا بمدينة بريزن و 50 دكانا بمدينة ليجا في البانيا و بنى جسرا على نهر فاردار بقرب من مدينة تيتوفا و أربعة عشر قاراوان سراى على الطريق بين دوكاجين و استانبول.

PERSONALITETE

Qemajl Morina

Kontributi i shqiptarëve në poezinë arabe të Egjiptit

AHMET RAMI – SHQIPTARI QË MORI OFIQIN POET I KAJROS (1892-1981) Me rastin e 115-vjetorit të lindjes

Kontributi që dhanë shqiptarët në kulturën orientale në përgjithësi është një temë e gjerë, që kërkon një trajtim të veçantë dhe shumëdimensional, që deri më tani nuk ka pasur një trajtim të duhur në historinë e kulturës sonë.

Me përqafimin e fesë islame, shqiptarët gradualisht u integruan në rrjedhat e përgjithshme të jetës shoqërore, politike dhe kulturore islame. Ata morën nga popujt e ndryshëm myslimanë, por edhe u dhanë atyre. Këtë, ata e bënë, qoftë në trojet shqiptare, apo edhe në qendrat e ndryshme të vendeve islame, ku ata jetuan dhe vepruan.

Numri i personaliteteve me origjinë shqiptare, të cilët u shquan në aspekte të ndryshme të shkencës, letërsisë, artit, arkitekturës dhe fushave tjera të kulturës është jashtëzakonisht i madh, nëse krahasohet me numrin e popullit shqiptar. Personalitete të këtilla hasim në qendra të ndryshme të vendeve myslimane, si në Stamboll, kryeqendrën e Perandorisë Osmane, por edhe në qendrat tjera të kësaj Perandorie të madhe, e cila për më shumë se pesë shekuj e shtriu sundimin e saj në tri kontinente.

Kësaj radhe për objekt studimi kemi një personalitet tejet të rëndësishëm, i cili jetoi dhe veproi në Kajro, kryeqytetin e Egjiptit, në shekullin njëzet, ku shqiptarët lanë gjurmët e tyre të thella, në veçanti pas ardhjes në pushtet të Mehmet Ali Pashës, vali i Egjiptit në vitin 1805. Ndërkohë, që dinastia e tij qeverisi me këtë vend për afro njëqind e pesëdhjetë vjet, deri më 23 korrik 1952. Ky personalitet është poeti i njohur Ahmet Rami, i cili në qarqet letrare të Egjiptit njihet me emrin “poeti Kajros”.

Kush është Ahmet Rami?



Ahmet Rami është njëri ndër poetët më të mëdhenj egjiptian të shekullit njëzet, mu për këtë egjiptianët nuk do ta kenë lehtë të pranojnë se është me origjinë shqiptare¹.

Dr. Nimat Ahmed Fuad, biografe e njohur e Ahmet Ramit dhe autore monografisë “Ahmed Rami, tregim për poetin dhe këngën”² thotë se Ahmet Rami u lind në Kajro në gusht të vitit 1892. Gjyshi i tij, admirali Hasan Osmani, një shqiptar prej Kretës, u shpërngul në Egjipt në vitin 1870. Ai u vra në krye të një ekspedite ushtarake të ushtrisë egjiptiane në betejën Kesab në Sudan në vitin 1885³.

Edhe babai i tij, Muhamed Rami punoi mjek në ushtrinë egjiptiane. Ai vdiq i ri në moshën 47-vjeçare.

¹ Muhamed Mufaku, Shqiptarët e Egjiptit (fejton), Rilindja, Prishtinë, 03.09.1979.

² Botim i dytë, Dar el-Mearif, Biblioteka “Ikre”, Kajro, 1979.

³ Naum Shukajr, Tarih es-Sudan, 1957, Kajro.

Meqenëse, babai i Ahmet Ramit punonte në ushtrinë egjiptiane dhe transferohej prej një vendi në vendin tjetër, sipas nevojave të ushtrisë, derisa i biri i tij ishte si fëmijë e merrte me vete. Kështu, shohim se Ahmeti i vogël, vitet e para të fëmijërisë i kaloi në ujdhesën Thasos, njëra nga ujdhesat e detit Egje, e cila ishte vetëm gjashtë orë udhëtim me barkë nga qyteti i Kavalles, vendlindjes së Mehmet Ali Pashës. Në këtë moshë të re Ahmet Rami, gjatë qëndrimit të tij në Thasos kishte mësuar greqishten dhe turqishten.

Kur arriti në moshën që duhej të regjistrohej në klasën e parë të shkollës fillore, babai i tij e ktheu në Kajro, duke e lënë Ramin nën kujdesin e motrës së vet. Rami i vogël në fillim vijoi mësimet në mejtepin e lagjes, pastaj u regjistrua në shkollën e zonjës” Aishe “ dhe më vonë në shkollën “Muhamedie” në vitin 1903.

Në shtëpinë e hallës së vet, Ahmet Rami kishte në dispozicion një bibliotekë shumë të pasur. Andaj, libri i parë që ai kishte lexuar në poezi ishte “Argëtimi me të dashurin në dashuri”, që ishte pjesë e një vepre të dashurisë në shekujt e artë të poezisë arabe.

Ahmet Rami, pasi që kreu me sukses shkollën fillore u regjistrua në shkollën e mesme Mbretërore. Pastaj, vazhdoi mësimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike të brezit të parë të letrarëve. Në mesin e shokëve të tij ishin emra të njohur të mëvonshëm të letërsisë arabe të Egjiptit si: Ferid Ebu Hadid, Abdul Hamit el-Abbadi, Ahmet Zeki, Muhamed Bedran etj.

Në vitin 1914, Ahmet Rami mbaroi Shkollën e Lartë Pedagogjike dhe u inkuadrua në procesin mësimor. Në fillim punoi në shkollën e mesme në lagjen “Sejjde Zejnepe” të Kajros, pastaj në shkollën e mesme “Sant Mari”, si dhe në shkolla tjera deri në vitin 1916. Ndërsa prej vitit 1920-1922 punon si drejtor në Bibliotekën e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Kajros. Kurse në vitin 1922, Qeveria egjiptiane e dërgoi në Francë për të studiuar artin e bibliotekarisë për dy vjet me radhë, 1923-24. Pasi që në Francë me sukses mbaroi studimet e bibliotekarisë, në vitin 1924 u inkuadrua në Bibliotekën Kombëtare të Egjiptit, një institucion shumë prestigjioz, që jepte mundësi për zgjerimin e njohurive të tij. Ahmet Rami tërë jetën e tij punoi në Bibliotekën

Kombëtare të Egjiptit në Kajro, ku ishte në pozita të larta, derisa u pensionua në vitin 1954, kur ai ishte në pozitën e zëvendës drejtorit.

Ahmet Rami u kthye nga Parisi dhe me vete kishte tri diploma të larta, fliste disa gjuhë të huaja: anglisht, frëngjisht, persisht dhe turqisht.

Angazhimi i tij në ngritjen e nivelit të Bibliotekës Kombëtare të Egjiptit

Natyrisht se ai u kthye në vendin e tij të punës në Bibliotekën Kombëtare të Egjiptit, prej nga kishte shkuar për specializim në Paris. Në atë kohë, sistemi i katalogëve në Bibliotekën Kombëtare të Egjiptit, bazohej në emrin e autorit apo titullin e librit dhe në të shumtën e rasteve, titulli i librit nuk përputhej me përmbajtjen e tij.

Kështu shohim se Ahmet Rami shpiku esencën e librit apo çelësin e tij “tatch word”, duke përshkruar përmbajtjen e librit në çdo kartotekë. Për ta realizuar këtë projekt të madh, kërkohej që të gjithë librat të nxirren prej depove dhe të bëhej një përshkrim i përgjithshëm i të gjitha librave të Bibliotekës Kombëtare. Kjo punë kishte zgjatur për vite të tëra. Kurse nëpunësit dhe punëtorët tërë këtë punë e kishin emërtuar “katalogizimi i Ahmet Ramit”.

Por, shërbimin më të madh, që Ahmet Rami kishte bërë Bibliotekës Kombëtare të Egjiptit, si dhe tërë Egjiptit në përgjithësi, ishte redaktimi dhe përgatitja e “Enciklopedisë së Egjiptit”, të përgatitur nga autori Muhamed Remzi, i cili kishte qenë inspektor në Ministrinë e Financave për caktimin e tatimeve, gjë që për këtë punë ai kishte shëtitur hipur në një gomar plot njëzet e pesë vjet në të gjitha anët e Egjiptit. Pas këtij hulumtimi në terren, ai kishte lënë njëzet mijë zarfe si dhe dyzet fletore me të dhëna shumë të dobishme për Egjiptin. Në redaktimin e kësaj enciklopedie, Ahmet Rami, më një numër bashkëpunëtorësh punoi panda prej vitit 1950 deri në vitin 1956, dy vjet pasi që ishte pensionuar. Në fund doli libri me titull: “Leksikoni i Egjiptit prej kohës së Faraonëve e deri më sot”. Me redaktimin dhe botimin e kësaj enciklopedie, Ahmet Rami i bëri një shërbim të mirë jo vetëm Bibliotekës Kombëtare, por edhe vetë Egjiptit.

Lidhjet e tij me Teqenë shqiptare të Kajros

Poeti, Ahmet Rami përkatësinë e tij shqiptare e kishte manifestuar në mënyra të ndryshme. Por, ashtu siç pohonte i ndjeri Qerim Haxhiu, hallka e fundit kolonisë shqiptare në Egjipt, këtë e kishte manifestuar me lidhjet e që ai mbante me baba Sirriun, babai i fundit i teqesë shqiptare bektashiane të Kajros, të cilin e vizitonte rregullisht. Bile i magjepsur me bukuritë e shumta të kopshteve të teqesë ai aty shkruante edhe poezitë e tij më të bukura. Kjo lidhje e aq e fuqishme kishte arritur deri në atë shkallë sa që baba Sirriu i kishte ofruar poetit, që ta zëvendësonte atë në përkujdesjen e teqesë, meqenëse ai ishte në moshë të shtyer. Por, me gjithë respektin, poeti Rami nuk kishte pranuar të marrë një barrë të tillë. Vizitat e tij të shpeshta në teqenë shqiptare kishin bërë atë që të jetë më afër ambientit shqiptar dhe të jetë në kontakt me njerëzit e atdheut të parëve të tij. Ajo që e bashkonte poetin me Baba Sirriun ishte edhe poezia. Që të dy ishin poetë dhe të dy shkruanin poezi. Për poezitë e Ramit dimë shumë, sepse ato u botuan,



Një fotografi e rrallë, ku shihet poeti A.Rami (i pari nga e majta) në tryezën e Baba Sirriut në teqenë e tij

por për fat të keq nuk dimë asgjë për krijimtarinë poetike të Baba Sirriut?! Nga kontaktet e shpeshta të poetit me koloninë shqiptare dhe teqenë shqiptare të Kajros kemi një fotografi të rrallë, të cilën në sirtarët e bibliotekës së vet e ruante i ndjeri z. Qerim Haxhiu e që është e viteve tridhjeta të shekullit të kaluar, në të cilën shihet poeti, Ahmet Rami në mesin e të ftuarve në tryezën e Baba Sirriut në teqenë e tij në Kajro.

Poezia e Ahmet Ramit

Ashtu siç u përmend më lart, Ahmet Rami, divanin e parë të tij e botoi në vitin 1917, divanin e dytë më 1920 dhe divanin e tretë më 1925. Këto tri divane dhe poezitë tjera, të cilat i shkroi në periudha të mëvonshme, Ahmet Rami i përmbloodhi në një divan, të cilin e botoi në Kajro, në vitin 1947 me titull: “Divani i Ramit”.

Ajo që e dallon Ahmet Ramin nga poetët të tjerë të brezit të tij është muzikaliteti që ai futi në poezinë arabe të Egjiptit. Kjo bëri që ai të njihet më shumë në botën e këngëve si autor kënge. Në veçanti prej viteve njëzeta të shekullit të kaluar pas kthimit të tij nga Parisi, kur ai ra në kontakt me këngëtaren e njohur të Egjiptit, Um Kulthumin, e cila njihej në botën arabe si “ylli i Lindjes”, për reportarin e këngëve të së cilës ai shkroi mbi pesëdhjetë tekste poezish me tematikë të ndryshme. Me këtë, ashtu siç pohojnë disa kritikë të poezisë, Ahmet Rami themeloi një shkollë të re, të cilën e ndoqën më vonë poeti Bajrem Tunisi si dhe nipat e tij: Salah Xhahin, Fuad Hadad, Sejdi Hixhab, Abdurrahman el-Ebnudi, Mexhdi Nexhib etj. Mirëpo, kjo kthesë në poezinë e Ahmet Ramit, ashtu siç pohon poeti dhe kritiku i njohur egjiptian Faruk Shusha, kishte shkuar në dëm të poezisë, sepse nga talenti i tij kishte përfituar muzika por, kishte pësuar poezia⁴.

Në poezitë e tij të para, Ahmet Rami përshkruan jetën e tij si dhe ngjarjet më të rëndësishme, që kishin ndikuar në fëmijërinë e tij. Ne nga biografia e tij mësuam se vogëlushit i mungonte babai i tij, për shkak udhëtimeve të tij të shumta. Kjo kishte bërë që ta ndiente mu-

⁴ Maxhaletu al-Arabi, al-Adad 553, December 2004, s.154-157, al-Kuvajt.

ngesën e dashurisë prindërore të tij. Këto ndjenja të tij ai i shpreh në poezinë e tij me titull “O babai im”, e cila ka disa vargje, ku përveç tjerash thotë:

*“Kaloi fëmijëria pa të thirrur ty me emrin baba dhe erdhi rinia,
Sa festa kaluan në të cilat do të kisha dashur të më veshësh rrobat e reja,
Asnjëherë nuk pata rastin të kënaqem me babin tim,
qoftë edhe në një mexhli të vetëm.
Të dëgjoj edhe për një çast tregimet e tij të bukura.
Jam rritur jetim edhe pse isha me baba”.*

Poezi të këtij lloji Rami ia kushton edhe vëllait të tij, që kishte vdekur i ri si dhe motrës së vet, që mban titullin “Motra ime”.

Pothuajse të gjitha poezitë e Ahmet Ramit përshkruhen nga emociione dhe në to mbizotëron tema e melankolisë dhe dhembjes, të cilat përbënin një tematikë me interes për këngët e Um Kulthumit, këngëtares së njohur me përmasa në tërë botën arabe, siç janë: “Gdhin netët e hënës”, “I pa gjumë në vetmi”, “Mendoj”, “Si të harroj?!”, “Sa dënim i gjatë”, “Kohë të vjetra”, “Kujtime”, “Bukuria e perënduar”, “Thirrja e zemrës” etj. Kështu shohim se kritikë letrar, Mustafa Debbag, me të drejtë thotë: “Ahmet Rami është poet i dashurisë dhe lotëve,” apo “Alfred de Myse arab”.

Personalitetet të cilët ndikuan në veprimtarinë krijuese të Ahmet Ramit janë: prej arabëve: Sherifi dhe Shavki, prej anglezëve: Bajroni, prej francezëve: Alfred de Myse dhe Lamartini, kurse prej persianëve: Omer el-Hajami dhe Hafiz Shirazi. Të gjithë këta kanë lënë gjurmë në krijimtarinë e tij.

Përveç divaneve të tij, Ahmet Rami botoi në vitin 1934 një dramë poetike me titull; “Dashuria e poetëve”, që ishte një risi në letërsinë arabe të saj kohe.

Ahmet Rami është i njohur edhe si përkthyes i parë i “Rubairave” të Omer Hajamit nga persishtja. Nga dashuria për to, ai mësoi persishten në Paris që t’i përkthente ato nga origjinali. Përkthimi i “Rubairave” doli për herë të parë në Kajro, në vitin 1924 dhe më vonë u ribotua disa herë.

Përveç “Rubairave”, ai kishte përkthyer edhe nga anglishtja disa vepra të Shekspirit, si dhe nga frëngjishtja disa vepra të shkrimtarëve francezë.

Çka thonë kritikët për poezinë e tij?

Shumica dërmuese e kritikëve letrarë janë të mendimit se Ahmet Rami solli një frymë të re në poezinë arabe, e cila mund të quhet shkollë e re. Kështu shohim se Mustafa Abdurrazik thotë se “divani i Ramit është dashuri dhe dhembje, gjë që nuk është për t’u habitur, sepse ai është melodi e rilindjes sonë.”

Ndërkohë që poeti i Nilit, Hafiz Ibrahim i përshkruan me këto fjalë: “Poet origjinal që mbështet në vetvete e jo në poezitë e të tjerëve. Kjo më së miri shihet në poezinë erotike të tij, sepse ai mori një drejtim bashkëkohor duke u larguar nga shabllonet e njohura tradicionale të poezisë arabe.”

Kurse kritikë letrar, Muhamed Tahir Rashid, është i mendimit se “ajo që e dallon poezinë e Ahmet Ramit, është origjinaliteti i saj dhe mosndikimi i saj përmbajtësor nga ndikimet e poetëve të Perëndimit edhe pse ai ishte në kontakt të vazhdueshëm me ta.”

Ndërkohë që Othman Hilmi thotë: “Poezia e Ahmet Ramit është poezia e parë e kohës së sotme që na përkujton poezinë e Andaluzisë. Poezi e rimuar, melodike, por jo e thellë në mendime. Ramin me lehtësi mund ta kuptojë çdo lexues se çfarë do të thotë.”

Mustfa Debbag për të shkruan: “Ahmet Rami është poet i dashurisë dhe i lotëve”, apo “Alfred de Myse arab”.

Poezia e Ahmet Ramit zgjoi një interesim të madh edhe te kritikët perëndimorë, të cilët i përkthyen poezitë e tij në disa gjuhë europiane. Këtu po përmendim disa nga mendimet e tyre rreth krijimtarisë poetike të tij.

Exhbishjan Meli, shkruan: “Stili i tij është lakonik. Secili varg ka kuptim të plotë. Poezia e tij është art i vërtetë.”

Kurse kritiku belg Gaston Brthey, i cili përktheu poezinë e ti “Ushtari i panjohur”, lavdëroi dramën e tij, përkthimin e “Rubiajat-ve”, si dhe e quajti atë Afred de Myse të Egjiptit.”

Vlen të përmendim me këtë rast, se Ahmet Rami vetë kishte përkthyer disa nga poezitë të tij në gjuhën anglishte në vitin 1936.

Ky është një vështrim i shkurtër për Ahmet Ramin, i cili në letërsinë arabe të Egjiptit njihet me ofiqin “poet i Kajros”. Ai është hartues i më shumë se pesëdhjetë teksteve të këngëve të Um Kulthumit, këngëtares më të popullarizuar në botën arabe të shekullit njëzet, të njohur si “ylli i Lindjes.”

Por, ajo që vlen të përmendim për ne, është përkatësia e tij shqiptare, të cilën ai me krenari e manifestonte, kudo që i jepej rasti. Por, për fat të keq, Ahmet Rami nuk është i vetmi poet me rrënjë shqiptare në Egjipt dhe në botën arabe. Poetë dhe shkrimtarë të këtyre janë të shumtë. Është obligim yni që të hulumtojmë biografitë e tyre. Të përkthejmë së paku diçka nga krijimtaria e tyre për t'ua prezantuar brezave të tashëm dhe atyre që do të vijnë pas nesh. Sepse edhe ata janë pjesë e kombit dhe historisë sonë.

Qemajl Morina

**THE CONTRIBUTION OF ALBANIANS
IN ARABIC POETRY
On the 115 anniversary of the birth of Ahmed Rami
(1892-1981)**

(Summary)

Albanians played a very important role in the culture of the East. This is a very broad theme, which needs special consideration. Up to now, it has not been treated properly (in Albanian culture and history). Upon embracing Islam, the Albanians gradually integrated in the social, political and cultural life of Islam.

The number of Albanians, who distinguished themselves in science, arts, architecture as well as culture, is very large, bearing in mind the fact that the Albanian nation is a very small one.

On this occasion we will present a very important personality, who lived and worked in Cairo, the capital of Egypt, in the twentieth century. Albanians have played a very important role in this country, especially during the rule of Mehmet Ali Pasha, the vali of Egypt, who came to power in 1805. His dynasty ruled this country for a period of almost 150 years, up until 1952. This person is the well-known poet Ahmed Rami, who is better known in literary circles as “the poet of Cairo”.

كمال مورينا

مساهمة الالبانيين في الشعر العربي بمصر

أحمد رامى - ألبانى حصل على لقب شاعر القاهرة

(بمناسبة مرور 115 عاما على مولده)

(خلاصة البحث)

ان المساهمة الكبيرة التي اداها الالبانيون في الثقافة الشرقية هو موضوع مترامى الالطراف و الذي يحتاج إلى بحث خاص مع الاسف الشديد لم يتم بحثه حتى الآن.

اعتناق الدين الاسلامي الحنيف من قبل الالبانيين هم تأقلموا مع المجتمع الاسلامى من الناحية السياسية و الثقافية. هم اخذوا اشياء كثيرة من الشعوب المسلمة و لكنهم اعطوا من عندهم الشئ الكثير. و قد فعلوا ذلك سواء في الاراضى الالبانية أو في المراكز المختلفة للعالم الاسلامي.

PERSONALITETE

Shevki Sh. Voca

TË DHËNA BIOGRAFIKE PËR UDHËPËRSHKRUESIN E NJOHUR TURK ME EMRIN HAXHI KALFA (1609-1657)

Autori më i vjetër turk në lëmin e gjeografisë së pastër, të cilin e njohin shkrimet turke është Haxhi Kalfa, i cili kështu quhet edhe në literaturën europiane. Kurse ndër autorë turq ai më tepër njihet me pseudonimin Katib Çelebi. Në të vërtetë, dhe sikurse që dihet se Kalfa nuk mund të jetë emër identifikues për njeriun, sepse kështu në të kaluarën, por na bie të dëgjojmë shpesh edhe tani, titullohej eprori apo edhe ndihmës eprori i punëtorëve nëpunë zanate të ndryshme, që do të thotë më tepër ishte një titull zyrtar sesa emër personal. Ndonëse për Katib Çelebiun dihej se në fillim të karrierës së tij, kishte punuar në zyrën shtetërore në detyrën e punëdhënësit dhe, meqë kishte aftësi të rralla ai binte në sy për punët e kryera me sukses dhe përpikëri, për të cilat ishte shpërblyer disa herë. Me një jetë relativisht jo të gjatë, Katib Çelebiu shkroi mjaft vepra nga fusha e gjeografisë dhe historisë, por edhe shkrime tjera mjaft interesante nga problematikat e ndryshme islame, ku polemizonte me dijetarë dhe mësues të kohës, të cilët, sipas tij, e pengonin islamit në zhvillimet e tij shkencore, me ç'rast ndalonin që nëpunë medrese nxënësit të mësojnë lëndët e shkencave

matematikore, astronomike, filozofike etj., të cilat dikur i mësonin nëpër këto shkolla, ndërsa gjatë kalimit të kohës ato ishin hedhur tërësisht si dekadente. Për këtë si do të shohim edhe më vonë Katib Çelebiu për shkak të mospajtimeve ideologjike rreth problemeve të ndryshme të çështjeve fetare që u paraqitën në kohën e tij, u nda nga një grup i dijetarëve, veprat dhe ligjëratat e të cilëve dikur me një kënaqësi dhe admirim të madh i lexonte dhe i dëgjonte.

Emri i vërtetë i Katib Çelebiut ishte Mustafa iben Abdullah, në Lindje i njohur si Haxhi Halifa, ndërsa në Perëndim si Haxhi Kalfa, por është i njohur edhe me pseudonimin Katib Çelebi që thamë më parë, është njëri nga dijetarët dhe enciklopedistët osmanë më të mëdhenj. U lind në Stamboll, në vitin 1609.¹ I ati i tij ishte ushtarak, dhe sipas zakonisht të asaj kohe edhe ai hyri në radhët e ushtrisë. Por për dallim nga i ati, Katib Çelebiu qysh në fëmijërinë e hershme u dallua me inteligjencën e jashtëzakonshme të tij dhe interesimin që shfaqte për njohuritë shkencore. Në moshën 5-6 vjeçare mësoi leximin e Kur'anit me texhvid (rregullat e leximit të Kur'anit) te mësuesi Isa Halife i njohur si hoxha Kirimli, (me sa duket ishte me prejardhje nga Krimea, Gadishull i Ukrainës që shtrihet midis Detit të Zi dhe Detit Azov, plotësim SH.V.), më pas prej hoxha Ilijazit që pranohej si dijetar i kohës mësoi gjuhën arabe, ndërsa mësimet tjera rinore i përfitoi nga dijetari dhe mësuesi me autoritet të madh Ahmed Çelebiu. Në moshën 14-vjeçare u mor në shërbim të trupit zgjedhor-silahdar (kështu queshin personat që i shërbenin sulltanit në bartjen e të gjitha llojeve të armëve të tij personale, pl. SH.V.), të cilës i takonte edhe i ati i tij, dhe në të njëjtën kohë si kadet ushtarak që ishte u printe punëve financiare në Anadoll.²

¹ Ana Britanica-geneel kultur ansiklopedisi, cilt 18, sf. 264, Istambull 1994. Rreth lindjes dhe vdekjes së Katib Çelebiut datat lëvizin, ndërsa ne për këtë shkrim si vit të lindjes e kemi marrë vitin 1609, kurse atë të vdekjes 1657, sepse kështu qëndron në më shumë vende.

² Nerkez Smailagiq, "Leksikon Islama" fq. 227, Sarajevë 1990; www.kimkimdir.gen.tr; "Ana Britanica...cilt 18, 264.

Udhëheqja dhe evidencimi i fletoreve me punët financiare nuk ishte lehtë, dhe derisa të tjerëve puna e tillë u shkaktonte kokëçarje, për Çelebiun ato nuk paraqisnin vështirësi, ngase ai kishte një memorie dhe inteligjencë të jashtëzakonshme të dhuruar nga Zoti, të cilën për aq kohë sa jetoi diti edhe ta shfrytëzojë.

Në vitin 1623 bashkë me të atin dhe ushtrinë osmane shkoi në Kajzer dhe mori pjesë në luftë kundër kryengritësve të Abaz Mehmet Pashës. Ndërsa në vitin 1625, në betejën e zhvilluar me persianët, të cilët e kishin rrethuar Bagdadin, Katib Çelebiu, sërisht mori pjesë bashkë me të atin. Në të kthyer nga lufta e Bagdadit në vitin 1626 në Mosul, i vdes i ati, vdekja e të cilit i shkaktoi dhimbje dhe mërzi të madhe. Pas vdekjes së babait ai një kohë ndejti në Diyarbakir, dhe në vitin 1627 (diku tjetër 1628) me ushtrinë turke u kthye në Stamboll. Mu në këtë kohë duke u bazuar në meritat e tija personale, iu nda detyra e nënoficerit (që kishte të drejtën e punës civile), me shërbim në zyrën kontrolluese të trupave të kalorisë. Kjo njëherë ishte koha kur tek ai zuri fill ideja që të merret me shkrime,³ e që sipas një versioni tregohet kështu:

“Një ditë duke kaluar pranë xhamisë së Sulltan Mehmetit, ai u kthye që të dëgjojë ligjëratat e hoxhës Mehmet efendi Kadizade, dijetarit të njohur të kohës. Ky ishte një orator i mrekullueshëm, i cili me ligjëratat dhe diskutimet e veta që mbante nëpër xhamia dhe medrese i entuziazmonte të pranishmit. Katib Çelebiu me vëmendje të madhe i dëgjonte ato ligjëratat. Kadizade efendiu fliste për librat e shenjta të Zotit, duke porositur të pranishmit se njeriu gjithsesi duhet bënë përpjekje që të largohet nga injoranca (mosdija). Nga fjalimet dhe ligjëratat e tilla ky djalosh u entuziazmua dhe pa u hamendur shumë vendosi që të merret me shkencën. Në një farë mënyrë për t’u dhënë mbas shkencës ai trashëgonte edhe udhëzimet e të atit të vet, por që nga kjo kohë u dha tërësisht mbas shkencës, e veçanërisht duke mësuar gra-

³ Si nën dy...

matikën dhe sintaksën, dhe duke shkuar rregullisht në xhami që të ndjekë ligjëratat e dijetarit të njohur në fjalë.”⁴

Meqenëse gjatë viteve 1629-1630 dhe 1631-1632, Katib Çelebiu sërisht shkoi në Bagdad me njësitet ushtarake turke të prirë nga Husref Pasha, që të marrë pjesë në luftë kundër persianëve, atij iu desh që për një kohë të largohet nga ligjëratat e njohura të Kadizade efendit. Mirëpo, deshi Zoti që ai pas qëndrimit disavjeçar nëpër fronte të ndryshme luftarake, në të cilat mernte pjesë edhe si oficer edhe si sekretar të kthehet në Stamboll, dhe në shkollën e dijetarit në fjalë të angazhohet si bashkëpunëtor i tij. Në dimrin e vitit 1633 prapë me ushtrinë turke që komandohej nga Mehmet Pash Tabanjasi, u gjend në Halep, dhe derisa ushtria dimëroi në këtë vend Katib Çelebiu në vitin vijues shkoi në haxhillëk në vendet e shenjta. Ai sërisht qëndroi për një kohë në Diyarbakir, por këtë herë duke shfrytëzuar rastin e qëndrimit i ndoqi ligjëratat e dijetarëve të famshëm të vendit, prej të cilëve mbledhi mjaft shënime dhe grumbulloi literaturë me të dhëna dhe informata çfarë i interesonin. Në vitin 1635 sërisht iu bashkëngjiti ushtrisë që me Sulltan Muratin IV, udhëtonin në Revan. Dhe pas kalimit dhjetëvjeçar nëpër luftëra dhe fronte të ndryshme ai, më në fund kthehet në Stamboll. Gjatë këtyre udhëtimeve të njëpasnjëshme Katib Çelebiu, përpos punëve të kryera protokollare, shkruante edhe për gjërat dhe dukuritë që i shihte, si për shembull ato në Bagdat, Halep, Hixhaz Revan, dhe Diyarbakir.⁵ Ai kishte kaluar edhe nëpër vendet e Gadishullit Ballkanik, dhe mbresat e udhëtimeve të tij nga këto vise i përshkruan në një shkrim të veçantë me titull “Bosnja dhe Rumelia”⁶, e cila përfshihet në veprën e madhe gjeografike të tij Xhihanuma.⁷ Këtu Katib Çelebiu përveç vendeve të tjera bën fjalë edhe për viset e banuara

⁴ “Islam Ansiklopedisi” IV, sf. 275, Istambull 1978; dhe Stojan (St.) Novaković, ‘Hadji-Kalfa ili Catib-Celebija turski geograf XVII veka, Spomenik SRPSKA KRALJEVSKA AKADEMIJA (SKA), XVIII, Beograd 1892, fq. 6.

⁵ Ana Brit... cil.. 18 sf. 264; Katib Çelebi ve eserleri, nga rrjeti internetit si shënimi 2.

⁶ Mala Enciklopedija Prosveta-M-S(h), Beograd, 1967 fq. 834.

⁷ Hazim Sabanovic, “Putopis Evlije Celebije-Odlomci o Jugoslovenskim Zemljama” fq. 5, Sarajevë 1979.

me shqiptarë. Marrja me këto çështje nuk ishte punë e protokollit zyrtar, por më tepër punë fakultative që ia donte ëndja.

Pasi që kohës ia dinte vlerën dhe e çmonte shumë, ai nuk donte pushim, por nga ajo pakë pasuri që kishte trashëguar prej të atit, si dhe paratë e kursyera që i fitonte nga punët personale, ai i harxhoi në grumbullimin e një sasive të madhe të librave shumë të vlefshëm, dhe që nga kjo kohë tërësisht iu përkushtua hulumtimeve shkencore. U martua në vitin 1638 (diku 1639). Disa vite më vonë (1645), pasi që nuk e mori gradën e merituar për punët cilësore që i kryente me një disiplinë dhe përkushtim të madh në administratën e shtetit, duke qenë pak sa i zhgënjyer nga neglizhenca e autoriteteve të vendit, ai me vetëdëshirë u largua nga përgjegjësia e detyrës në zyrën e kontrollit, dhe për tre vjet sa qëndroi pa kryer ndonjë punë shtetërore mbeti edhe pa të ardhura financiare, por falë aftësive dhe dijes që kishte u angazhua në mbajtjen e mësimëve fetare nëpër medrese prej nga edhe ndihmohej nga pak, sa për të mbijetuar.

Ndërkaq tre vjet më vonë, më 1648, me sugjerimin dhe ndihmën e mecenit të tij Shejh-ul-islamit Abdurahim Efendiut, sërish u kthye në punën e njëjtë, por këtë herë kryente detyrën e përgjegjësitetë të zëvendësit të dytë, dhe që nga kjo kohë ai u quajt Haxhi Kalfa.⁸

Për të kryer detyrat që kërkoheshin nga ai, në zyrën e punës shkonte vetëm një apo dy ditë brenda javës, jo pse ky vetë dëshironte ashtu por, pse aq kërkoheshin prej tij. Ndërsa kohën tjetër e kalonte duke lexuar libra të ndryshëm dhe pas analizave dhe krahasimeve të thella ato i hidhte në letër. Katib Çelebiu, përveç gjuhës arabe dhe persishte si gjuhë jo amtare, mësoi edhe gjuhën frëngjishte dhe latinishte, prej të cilave përkthente në gjuhën turke, arabe dhe persishte shkrimet nga fusha e gjeografisë dhe historisë. Disa nga veprat e tij, si do të shohim më poshtë janë përkthyer edhe në gjuhët europiane si gjermanisht, anglisht, dhe italisht, kurse në gjuhën frëngjishte i përkthente vetë. Katib Çelebiu vdiq nga gjakderdhja në tru, më 1657 në Stamboll, pa i mbushur ende pesëdhjetë vjet, dhe u varros në oborrin e Zejrek xhamisë po në Stamboll.⁹

⁸ N. Smailagic, fq. 227;

⁹ St. Novakovic...vepra e cituar fq. 6; Ana Bri...cil...18 sf. 264; www.kim...

Katib Çelebiu shkroi më tepër se njëzet vepra shumë të vlefshme, prej të cilave më të rëndësishme janë ato nga fusha e gjeografisë, historisë, bibliografisë dhe fesë. Por, kishte përkthyer shumë edhe nga latinishtja dhe frëngjishtja, dhe siç kishte treguar edhe vetë se njohja e gjuhës latine dhe frëngjishte i kishte ndihmuar shumë në plotësimin dhe përmirësimin e shkrimeve nga historia e vjetër si dhe në deshifrimin e hartave gjeografike gjithashtu të vjetra. Por, për fat të keq, disa nga veprat e tij, siç do të shohim edhe më poshtë, sipas gjitha gjasave janë humbur.

Vepra kryesore e tij, me të cilën njihet më së shumti në shkrimet turke, është "*Xhihannuma*", nga fusha gjeografisë dhe kozmografisë, në të cilën paraqet një pasqyrim të botës. Kjo vepër e tij ka bërë që në shkencën e gjeografisë osmane të hapet një etapë e re. Këtë vepër Katib Çelebiu e shkroi dy herë. Të parën e fillon në vitin 1648, dhe në të bën fjalë për vendet që i përfshinte Perandoria Osmane e pjesës europiane dhe ato të Anadollit, Spanjës, dhe Afrikës Veriore, e cila përveç shkrimeve është e pasur edhe me harta të shumta gjeografike. Sipas studiuesit të madh dhe shumë të frytshëm nga Banja Llukë, Nerkez Smailagiq (1927-1985), veprës së cilit iu kemi referuar disa herë (shiko fusnotat), Çelebiu këtë vepër ia kishte kushtuar Sulltan Muratit IV (i lindur më 1609, sundoi gjatë viteve 1623-1640).

Katib Çelebiu para se të fillojë së shkruari "*Xhihanuman*" për herë të dytë, ai me ndihmën e Mehmed efendi Ihlasi-t (një francez i konvertuar në fenë islame), në vitin 1653 diku qëndron 1654 bëri përkthimin nga latinishtja në turqishte të veprës gjeografike shumë të rëndësishme "*Atlas Minor të Merkatorit dhe të Hondiusit*" (i pari gjeograf Flaman, ndërsa i dyti hartograf Holandez SH. V.), me ç'rast ai kishte përfutur njohuri të reja shkencore, në veçanti nga fusha e gjeografisë. Çelebiu duke shqyrtuar këtë përkthim të kësaj vepre madhore kishte pranuar superioritetin e gjeografisë perëndimore, kurse për ta shtuar dijen e tij mbi Europën e kishte përkthyer edhe "*Choronikle*" nga Karioni. Ky përkthim e kishte bindur Katib Çelebiun se bota është e rrumbullakët dhe ai përpiquej të vërtetonte nga burimet islamike se ky pikëvështrim nuk ishte në kundërshtim me religjionin,

meqë ky në çfarëdo lloji të hulumtimit shkencor, provat e para gjithmonë i kërkonte në Kur'an.¹⁰ Të shtojmë se në vitin 1662, do të thotë pas vdekjes së Çelebiut, është përkthyer edhe “*Atlas Major*” i Joan Blaeu-t, ndërsa që më 1685 studiuesi arab nga Damasku Abu Bakër e përkrahu këtë përkthim, i cili i njohu osmanlinjtë për herë të parë me sistemin e Kopernikut.

Ndërkaq, që në vitin 1654 filloi së shkruari *Xhihannuma-n* për herë të dytë, në të cilën me përpjekje të mëdha dhe argumente mundohet t'i rumbullakojë ngjarjet e rëndësishme botërore që nga gjeografia fizike, duke bërë fjalë përveç tjerash edhe për udhëtimet dhe zbulimet e Kristofor Kolombos dhe Magelanit. Pastaj duke filluar nga Japonia, vazhdon shkrimin me të dhëna mjaft të verifikuara për historinë, ekonominë, mënyrën e qeverisjes etj., të vendeve aziatike, kurse në fund të pjesës së dytë të veprës në fjalë jep të dhëna për provincën turke Van.¹¹ Në *Xhihannuma-n* e dytë, Katib Çelebiu u shërbye më tepër nga literatura europiane, por veprën nuk arriti ta përfundojë, ndërsa që disa pjesë të saj kanë humbur. *Xhihannuma* është libri më i vjetër turk nga gjeografia, dhe siç thonë shkencëtarët turq, kjo veprë shërbente si literaturë referuese për librat e gjeografisë që u shkruan më vonë.

Vepra në fjalë e Çelebiut u shtyp shtatëdhjetë vjet pas vdekjes së tij, atëherë kur në Stamboll u themelua shtypshkronja e parë turke. Të shtojmë se shtypshkronjën e parë turke në Stamboll e futi në veprim një hungarez i konvertuar në islam, Ibrahim Muteferik diku i njohur edhe si Basmaxhiu (1674-1745), por një gjë është e vërtetë se në Turqi ekzistonte edhe më herët shtypshkronja, të cilën e kishin sjellë me vete hebrenjtë e dëbuar nga Spanja kah fundi i shekullit XV, e cila u hynte në punë vetëm atyre, sepse, madje edhe në fillim të shtypshkronjës së Ibrahim Muteferikut integritetet islame kundërshtonin që të mekanizohen shkronjat e Kuranit.¹²

¹⁰ Halil Inalxhik, “PERANDORIA OSMANE-periodha klasike 1300-1600” Gjilan 2002, fq. 236.

¹¹ www.kimkimdir.....

¹² Rober Mantran, “Istorija Osmanskog Carstva”, Beograd, 2002, fq. 862.

Pas “*Xhihannuma-s*” vepra më e rëndësishme e Katib Çelebiut, e cila konsiderohet si veprë jetësore e tij në të cilën punoi plot njëzet vjet, dhe e cila është njëra prej veprave më të njohura të tij në Perëndim, e shkruar në gjuhën arabe, është “*Keshfu’z-Zunun an Esami’l-Kutubi ve’l-Funun*”. Kjo veprë e Çelebiut është një fjalor i madh enciklopedike e bibliografike, e cila së pari u botua në Egjipt, pastaj edhe në Gjermani, në të përfshihen 14500 libra dhe broshura, me rreth 10.000 autorë të njohur.¹³ Historiani i njohur turk me renome botërore Halil Inalgjik, i lindur 1916 në Stamboll, për këtë enciklopedi bibliografike thotë se deri në këtë ditë ajo ka mbetur në shërbim të një libri preferencial standard. Vepra e njëjtë është përkthyer dhe përgatitur për botim edhe në gjuhën latine. Interesant është se në Turqi, sipas të dhënave që disponojmë, kjo veprë kaq e madhe e Katib Çelebiut për herë të parë u botua gjatë viteve 1941-1943 në dy vëllime, do të thotë shumë kohë pas themelimit të shtypshkronjës turke dhe u ribotua gjatë viteve 1971-1972, po ashtu në dy vëllime.

Libri i parë nga historia i Katib Çelebiut është “*Fadllaka*”, të cilën e shkroi në vitin 1641 diku qëndron 1642 në gjuhën arabe, por e kishte përkthyer edhe në gjuhën turke. Në këtë libër Çelebiu kishte përshkruar historinë e rreth 150 dinastive, në të cilën përfshihen peygamberët dhe mbretërit. Sipas gjitha gjasave, kjo veprë është humbur. Më vonë Katib Çelebiu në gjuhën turke shkruan vazhdimin e *Fadllaka-s*, në të cilën i përfshin ngjarjet e historisë osmane prej viti 1591-1654. Ndërsa në faqet e fundit të librit Katib Çelebiu shkurtimisht dhe në formë të poezisë paraqet të dhëna interesante rreth jetës dhe veprimtarisë së njerëzve të rëndësishëm dhe të dijsëm, duke i ndarë ngjarjet për çdo vit veçmas. *Fadllaka* e shkruar në turqishte është botuar me dy vëllime në vitet 1869-1870.

“*Takvimu’t-Tevarih*”, është një veprë tjetër e Katib Çelebiut, të cilin për dy muaj e kishte përfunduar. Është kjo një veprë në të cilën në mënyrë kronologjike paraqiten ngjarjet prej kohës së largimit të profetit Adem nga xheneti e deri në vitin 1648. Vepra është shkruar në

¹³ www.kimkimdir...

gjuhën turke, ndërsa është përkthyer në gjuhët arabe, persishte, dhe pjesërisht në disa nga gjuhët perëndimore. Ndërkaq, që një italian me emrin Rinaldo Karli sipas gjitha gjasave kishte përkthyer dhe botuar në Venedik në vitin 1697, me titull “Choronologia Historika” pjesën kronologjike tabelore të ngjarjeve historike të kësaj vepre. Ndërsa që vepra “*Takvimu’t-Tevarih*”, në Turqi u botua në vitin 1733.

“*Sullam all-vusul ila tabaqat all-fuhull*”, është një fjalor biografik i njerëzve të famshëm, një vëllim i së cilës është përkthyer në gjuhën arabe. Nuk e kemi të njohur se në cilin vit u shkrua dhe kur u botua kjo vepër e Katib Çelebiut.

“*Tuhvat all-ahyar fi all-hikam va all-amtal va all-ashar*”, Kjo është një antologji e fjalëve të urta, proverbave dhe vjershave e shkruar sipas renditjes alfabetike, ndërsa është hartuar në vitin 1650 apo 1652. Nuk kemi njohuri se a është botuar ndonjëherë.

“*Tuhfetul’l-Kibar fi Esfari’l Bihar*”, në këtë vepër Katib Çelebiu shkruan për historinë e forcave detare të osmanlinjve, e cila shikuar nga aspekti i historisë detare paraqet një vepër mjaft të rëndësishme. Këtë vepër Katib Çelebiu e shkroi në vitin 1656, ndërsa në Turqi u botua në vitin 1729, kurse me alfabetin e ri turk u botua dy herë, në vitin 1973 dhe 1980 në dy vëllime. Kjo vepër është përkthyer dhe botuar edhe në gjuhën angleze dhe franceze.

“*Dusturu-ull-Amel fi Islahil-Hallall*”, është shkruar në formë broshure në katër vëllime. Në këto broshura duke komentuar shkurtimisht ngjarje dhe ndodhi të ndryshme, si dhe duke bërë kritika në adresën e administratës dhe politikës shtetërore herë pas here tek ai vërehen ndikimet e historianit, sociologut dhe filozofit të madh arab Ibn Halldunit (1332-1406), veprat e të cilit i kishte studiuar për vite të tëra e sidomos “*Mukkadime-n*”. Katib Çelebiu këtu bën kritika të ashpra ndaj udhëzimeve për reformime të padrejta në financa. Në mes tjerash kritikon dukuritë negative që ishin paraqitur si ndër popullatë po ashtu edhe ndër struktura ushtarake dhe në vetë ushtri, të cilat ishin shkaktar që shteti kishte filluar të çalonte, dhe nuk ecej përpara. Për shembull flet për ryshfetin (lexo korrupsioni) që shkonte vazhdimisht duke u rritur, për të cilën shprehet kështu: “Kjo punë e ndyrë (ryshfeti), është

e turpshme dhe e ndaluar madje edhe në mesin e udhëheqësve jobesimtarë”, pastaj për përçarjet dhe mosujditë e udhëheqësve të ndryshëm, qofshin civilë apo ushtarakë, për drejtësinë, pajtueshmërinë apo ujdinë, të cilat në çdo shoqëri kanë vlerë të madhe, e që nga mosrespektimi i saj tani bereqeti kishte filluar të ikë. Ndërsa për moralin ushtarak thotë se në stomakun e ushtarit (duke aluduar në haram) ka zënë vend frika, dhe armiku prej tij nuk frikësohet, dhe shton se puna është kthyer së prapthi.¹⁴ “*Dusturu-ull-Amel...*” është shkruar në vitin 1653, në turqishte është botuar në vitin 1863, kurse me alfabetin e ri turk në vitin 1982.

“*Ilhamu’l-Mukaddes fi Feyzi’l-Akdes*”, është njëra nga veprat e tij mjaft të ndërlikuara. Këtu Çelebiu, duke i shprehur qëndrimet dhe mendimet e veta, natyrisht duke u mbështetur në leximin dhe përvojën e tij, shkruan për ceremonitë dhe rregullat e ndryshme islame, të cilat për shkak të rrethanave të caktuara është vështirë të zbatohen në praktikë. Si shembull për këto ai cek vendet e Polit të Veriut, ku për shkak kushteve hemisferike netët në ato vende zgjasin nga gjashtë muaj, dhe që është vështirë të bëhet përcaktimi i kohëve të namazit, të agjërimit, lindjes dhe perëndimit të diellit etj. Vitin e shkrimit të kësaj vepre nuk e dimë, ndërsa që botimi i saj në turqishten e re u bë në vitin 1971 në katër vëllime.

Vepra tjetër me radhë (sipas autorit të këtij shkrimi) e Katib Çelebiut është “*Ravnak as-Salltana*”. Në këtë vepër, që është shkruar në gjuhën arabe, autori paraqet historinë e Kostandinopojës. Edhe kjo vepër e tij sikurse disa të tjera konsiderohet e humbur.¹⁵

Ravnak as-Salltane-n e shkroi (lexo përktheu) edhe në gjuhën turqishte me titull *Tarih-i Kostantiniyye ve Kayasire*. Nuk ka shënime rreth vitit në të cilën është shkruar kjo vepër.

¹⁴ Katib Çelebi, “Bozuklukların Duzeltmesinde Tutulacak Yollar” në përgatitjen e Ali Can, Ankara, 1982, s. 18-34; Remzi Demir, “Philosophia Ottomanica, Osmanli Imperatorlugu Doneminde Tyrk Felsefesi; Eski Ile Yeni Felsefe Arasinda”, cilt 2, s. 27, pa vit botimi:

http://tr.wikipedia.org/wiki/Bozukluklar%C4%B1nD%C3%BC2eltmesindeTutulacak_Yollar.

¹⁵ N. Smailagic, vep cituar fq. 227.

“*Ragim ar-ragim bi as-sin va all-gim*”, është një përmbledhje, në të cilën shtjellohen raste të rëndësishme juridike dhe *fetvatë* që kanë të bëjnë me to. Por, për fat të keq dhe sipas gjitha gjasave edhe kjo vepër e tij konsiderohet të jetë e humbur.

“*Ahsemu’l-Hediyje bi sherhi’l-Risaleti’l-Muhammediyye*”, është ky një komentim i veprës së dijetarit të madh turk në shkencat matematikore dhe astronomike Ali Kushxhi (?-1474) i cili jetoi dhe veprroi në kohën e Sulltan Mehmetit II-pushtuesit të njohur si Fatihu (lindur 1429, sundoi prej 1451-1481). Dihet se ky sulltan për të qenë një sundimtar i suksesshëm dhe sa më i drejtë rëndësi të madhe u kushtoi arritjeve dhe njohurive shkencore, duke filluar nga feja, filozofia, matematika, astronomia, historia etj. Gjatë kohës së tij ai i nxiste dijetarët që të shkruajnë vepra nga fushat me të cilat merren. Fatihu përreth vetes kishte tubuar shkencëtarë dhe dijetarë më me zë të kohës, të cilët i mbante nën mbikëqyrjen e vet. Sulltani kishte kërkuar prej dijetarit grek nga Trabzoni, Georgius Amituzes dhe birit të tij që të përkthehet në gjuhën arabe “*Geografia*” e Ptolomeut. Historinë e Romës dhe të Perëndimit i kishte mësuar nga italianii Ciriaco d’Ancona. Ndërsa patriku Gennadios për Fatihun kishte shkruar “*Itikad-name-n*”,¹⁶ në të cilën shpjegohet besimi krishterë. Pas pushtimit të Stambollit ai i konvertoi tetë kisha në medrese për tetë dijetarë të famshëm, kurse kur midis viteve 1463 dhe 1470 e ndërtoi Xhaminë e Pushtuesit, rreth saj vendosi tetë medrese të njohura si *Sahn-i seman* ose si *Semanije*, dhe përsëri secilës ia caktoi nga një dijetar.¹⁷ Në kohën e tij nëpër medrese filloi të mësohet filozofia si lëndë e veçantë.¹⁸ Mirëpo, për fat të keq më vonë lënda e filozofisë gradualisht u përjashtua nga mësimet nëpër medrese. Për këtë arsye Katib Çelebiu më vonë filloi t’i kritikojë këto institucione mësimore. Fatihu ishte një sulltan me vizionin e

¹⁶ Franc Babinger, “Mehmed Osvajac i njegovu doba”, Novi Sad, 1968, fq. 100, 168, 360-361; ndërsa në versionin shqip të këtij libri në përkthim të Ali H. Llunit, “Mehmeti Pushtuesi dhe koha e tij”, Prishtinë 1989, fq. 134,229, 490-491.

¹⁷ H. Inalxhik, vepr.cit.fq. 219.

¹⁸ Ekmeludin Ihsanoglu, “Historija Osmanske Drzave i Civilizacij”, fq. 308, Sarajevë 2004.

një mbretërie të madhe dhe të fuqishme, të cilës i siguronte një zhvillim harmonik në bazë të jo vetën trashëgimisë turko-myslimane, por edhe të përvetësimit të trashëgimisë bizantine dhe përvojave të Perëndimit, mbretëri e cila kishte me bërë përshtatjen dhe bashkimin e tri religjioneve dhe tri kulturave.¹⁹ Në mesin e dijetarëve që vepronin pranë Fatihut ishte edhe shkencëtari turk Ali Kushxhi, të cilit sulltani i dha një përparësi të posaçme, duke e ftuar atë në Stamboll dhe duke e inauguruar një epokë brilante në matematikën osmane. Kushxhiu nga fusha e matematikës kishte shkruar pesë vepra, prej tyre katër në arabishte dhe një në persishte. Vepra më e rëndësishme e tij nga matematika është versioni arab i “*Risale der Ilm-i Hisab*” me titull “*er-Risaletul-Muhammediyye fil-Hisab*”. Kjo vepër e Ali Kushxhiut përbëhet nga parathënia dhe dy kapituj, nga të cilat e para ka të bëjë me aritmetikë ndërsa e dyta me gjeometri.²⁰ Ndërkaq, që Katib Çelebiu e ka shkruar komentimin e pjesës së parë të kësaj vepre siç shkruam më lart, pra atë për aritmetikë, ndërsa për jetën dhe veprimtarinë shkencore të Ali Kushxhiut, Çelebiu ka bërë fjalë në veprën e tij bibliografike e enciklopedike “*Keshfu’z-Zunun...*”, për të cilën kemi folur më herët. Të shtojmë se Ali Kushxhiu ka shkruar edhe disa vepra nga astronomia.

“*Magmu’a*”, është një përmbledhje me anekdota historike dhe letrare, të cilat i ka shkoqitur nga 300 fletore me përmbajtje të njëjta, por që të gjitha së bashku të humbura.²¹

Në opusin e gjerë të tij zë vend edhe një redaktim i komentimit të Kur’anit të dijetarit islam të el-Bejdeviut, por për fat të keq edhe ky sipas gjitha gjasave është humbur.

“*Mizanu’ll-Hakk fi Ihtijari’l-Ahakk*”, është vepra e fundit e Katib Çelebiut, të cilën e shkroi në vitin 1656²². Sikurse që shihet, sipas titu-

¹⁹ Ramiz Crnisanin, “Sanxhak Izmedju Srbije i Crne Gore”, Novi Pazar, 2005, fq. 264.

²⁰ Ana Britanika-genel kultur ansiklopedisi cilt 1 sf. 387, Istamboll 1993; H. Inalxhik, vepr.cit.fq. 231; E. Ihsanoglu, vepr.cit.fq. 961-962; F. Babinger, ne serbisht, fq. 426-428, dhe versioni i përkthimit në shqipe fq. 584,585.

²¹ N. Smailagic, vepr.cit.fq. 228

²² Njëjtë, fq. 228.

llit është shkruar në gjuhën arabe, ndërsa në turqishte mbanë titullin “*En Dogruyu Sevmeğin İçin Hak Terazisi*” që në përkthim në shqip përafërsisht i përgjigjet ky titull “*Terazia e saktë për me dashtë rrugën e drejtë*”. Në turqishten e vjetër u botua në vitin 1864, ndërsa me alfabetin e ri turk më 1972 dhe më 1980.²³

Në këtë vepër Çelebiu rrah çështje dhe probleme të ndryshme të pazgjidhura teologjike të kohës së tij, duke shkruar në mënyrë kritike për sferat shoqërore dhe shkencore, dhe duke i analizuar problemet që kishin kapluar medresetë osmane. Për shembull, ai thotë se krishterimi dhe shkencat filozofike gjenden në një konflikt të përhershëm, derisa bota islame asnjëherë nuk i ka mohuar rëndësinë e këtyre shkencave, përkundrazi, ajo mendohej që t’i paraqesë sa më afër mësimet islame. Më tej vazhdon Çelebiu dhe thotë se në kohët e hershme të islamit ekzistonte një dozë e dyshimit ndaj shkencave dhe pikëpamjeve të huaja për shkak drojës që mos të vijë deri te turbullimi i fesë së vërtetë, por kur feja islame u stabilizua atëherë edhe u lejua marrja me shkenca të ndryshme, madje u përkthyen dhe u komentuan veprat filozofike dhe shkencore greke. Në këtë mënyrë, janë lajmëruar shumë dijetarë të mëdhenj siç janë Gazaliu, Fahredin er-Razi, Alaudin Ixhi, Sadedin Teftazani, Sejjed Sherif Xhurxhani. Tek Osmanlinjtë që nga periudhat e hershme e deri në kohën e Sulltan Sylejmanit dijetarët arsimoheshin në frymën e bashkimit të shariatit dhe të shkencës. Në medresetë Sahn-i dhe Seman, të cilat i kishte themeluar sulltan Mehmed Fatihu (që kemi cekur më parë Sh.V.), si lëndë e detyruar është bërë edhe të mësuarit mbi abstrakten, por më vonë erdhën të tjerët dhe thanë se kjo është filozofike, gjë që u ndalua mësimi i kësaj lënde. Katib Çelebiu vazhdon më tej dhe thotë, se disa dijetarë që vijnë nga bota Lindore e që arsimit i tyre është i vjetruar, duke gjetur këtu hapësirë të lirë filluan së vepruari. Disa nga anëtarët e ulemasë e vërenin këtë gjendje, ndërkaq që u munduan përsëri të futin këto lëndë mësimore që nxënësit sërish të orientohen në këto drejtime. Pastaj me shembuj konkretë Çelebiu tregon se sa është dallimi mes një myftiu apo

²³ Ana Britanika...cil...18, fq 264.

kadiu, i cili e njeh shkencën e matematikës dhe e atij që këtë shkencë nuk e njeh.²⁴

Për shkak dekadencës së shkencave ekzakte dhe teologjike, Katib Çelebiu kështu vajtonte: “Por, shumë njerëz jo inteligjentë...mbetën sikur shkëmbi të palëvizshëm, dhe të ngrirë në përkrahjen e lashtësisë. Pa menduar fare, ata i braktisën shkencat e reja dhe hoqën dorë prej tyre. Ndërsa ata i konsideronin për njerëz të dijsëm, edhe pse gjithë kohën kanë qenë njerëz të paditur që kishin dëshirë të nënçmojnë apo zhvlerësojnë atë që e quanin “shkencë filozofike”, derisa për rruzullin tokësor dhe për qiellin asgjë nuk dinin...” Vërejtja për këtë është ajeti i Kur’anit “*A nuk vështruan ata më vëmendje pushtetin e madh në qiëj e në tokë...*” (*El A’rafë 185*), por kjo tek ata nuk prodhoi kurrfarë ndikimi; ata, thotë Çelebiu, mendonin se vështrimi i tokës dhe i qiellit do të thotë të zgurdullosh në ta sikurse lopa.²⁵

Në shoqërinë osmane gjithmonë kishte një klasë të ulemasë fanatike, e cila i konsideronte shkencat intelektuale, misticizmin, muzikën, vallëzimin dhe poezinë si jo të devotshme; kundër këtyre ishte një klasë, e cila i mbronte si të ardhura brenda fushës së religjionit. Këtë klasë zakonisht e përbënin shehlerët dhe ulemaja e popullarizuar, të cilët predikonin dhe jepnin mësim në xhamia, derisa ulemaja në medresetë e larta ose në shërbime qeveritare e formonte grupin e dytë. Njëri prej tyre ishte Tashkyprylzade. Ai ankohej me zemërim në këta ulema, të cilët e eksploatonin injorancën e njerëzve për t’i shpënë ata në rrugë të mbrapshta: “Na ruaj Zot prej atyre që tregojnë fanatizmin në fe.” Ai besonte se secili njeri është i lirë ta zgjedhë shkollën e tij të fesë, kurse ta konsiderosh shkollën tënde të drejtë e të pamohueshme dhe të tjerat false, dhe t’i mëveshët secilit mysliman si i pabesë, është në kundërshtim me fenë e vërtetë.²⁶ Vetëm Zoti mund ta njohë fenë e

²⁴ E. Ihsanogllu, vep...cit..fq. 336-337.

²⁵ G.L. Lewis, Katib Çelebi, *Ravnoteza istine*, (Balance of Truth), Londer 1957, fq. 25, përkthim nga turqishtja në anglishte, në Fazllur Rahman, “Duh Islama”, fq. 259-260, 351, Beograd, 1983; KUR’ANI-përkthim dhe komentim nga Sherif Ahmeti, Prishtinë, 1988.

²⁶ H. Inalxhik, vep...cit..fq. 238.

vërtetë. Ai kështu e konsideronte fanatizmin në paraqitjen e jurisprudencës si gjë të pavlerë, sepse askush nuk mund të pretendojë të jetë i pagabueshëm në këto çështje.

Tashkyprylzade i pranonte pikëpamjet e moderuara të al-Gazalit, duke besuar se si fanatikët religjiozë, batinitët dhe filozofët e kishin gabim. Batinitët përpqeshin ta shkatërronin sheriatin, kurse filozofët vepronin me parime të papranueshme për Islamin.

Duhet themi se që nga kohët e hershme ulemaja në medresetë osmane shkoi në besimin mistik një hap më tutje nga al-Gazali dhe vijoi traditën e Ibën al-Arabit (1164-1240, filozof prijatar mistik i Islamit), dhe al-Suhravardiut (1145-1234, filozof, mistik dhe themelues i rendit suhravardian)...Nga Tashkyprylzade mësojmë se në vitet e hershme të sundimit të Sylejmanit (është fjala për sulltan Sylejmanin I ligjdhënësin Sh. V.) ulemaja fanatike i nxiste njerëzit kundër misticizmit.

Tashkyprylzade, që rridhte nga njëra prej familjeve të njohura turke të profesionit të ulemave, nuk e shikonte muzikën dhe vallëzimin në ceremoniale të rendeve mistike si diç kundër religjionit, meqë ato e zgjonin në shpirt dashurinë ndaj Zotit dhe hyjnisë; marrëdhënia midis muzikës dhe shpirtit është fshehtësi hyjnore, kurse shpirti i trazuar nga muzika arrin gnozën hyjnore. Muzika dhe vallëzimi duhej të ndalohej vetëm kur të përdroreshin për t'i nxitur dëshirat e përbotshme. Megjithatë, ulemaja tradicionale i konsideronte recitimin muzikor dhe vallëzimin si blasfemi, dhe njëherë sulmonte gjëra të tilla si dekorimin e xhamive, këndimin e Kur'anit me melodi dhe pagesën e mësuesve fetarë. Aq sa e sulmonin misticizmin ata i sulmonin edhe shkencat intelektuale dhe teologjinë skolastike si besime të nënçmuara fetare²⁷.

Këto lëvizje të fanatizmit së shpejti morën forma, të cilat rrezikonin rendin publik dhe e alarmuan qeverinë. Me shekuj kishte qenë një grup i vogël predikuesish që ishin damkosur si “inovacione bamirëse” dhe e nxitnin popullin kundër besimeve dhe praktikave, të cilat edhe pse ishin jashtë fushës së Kur'anit dhe traditës së Profetit, komuniteti islamik i kishte përvetësuar.

²⁷ Njëjtë, 239.

Njëri ndër këta ulema ishte dijetari turk Birgivi, emri i vërtetë Mehmed inb Pir Ali, i lindur më 1520, diku qëndron 1522-1573. Kati Çelebiu thotë se ka vdekur në moshën 55-vjeçare.²⁸ U shkollua në kohën kur Perandoria Osmane ishte në shkallën më të lartë të fuqisë politike dhe administrative e ushtarake. Megjithatë, dhe në të njëjtën kohë kjo ishte një periudhë kur mbretëria ballafaqohej me disa probleme të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore, kur filloi një periudhë e ndryshimeve të rëndësishme në shoqëri. Afrimi i Birgiviut me religjionin ishte një afrim tipik i reformatorit apo të një “puritani”. Rrënjët intelektuale të një afrimi të tillë me religjionin mund të gjenden në veprat e reformatorit të njohur islam (apo selefije) të Ibn Tejmi el-Harani,²⁹ (1263-1328), teolog dhe logjist i madh hanbalit³⁰, edhe Bergivi po si ky me vendosmëri të madhe u ngrit kundër të gjitha risive, për ta mbrojtur ligjin e shenjt-sheriatin, ndërkaq që kurrfarë pozitash në rangjet e larta nuk mund ta lëkundnin atë nga parimet e tij.

Birgivi thoshte: “Është detyrë e imja të mbroj njerëzit me penën time dhe me gojën time nga ajo që Zoti e ka ndaluar, dhe është mëkat për mua të hesht”. Me këtë ai në njërin anë i sulmonte teologët skolastikë dhe mistikët, kurse nga ana tjetër, ulemanë e rangut të lartë në shërbim të shtetit. Ky purist mysliman i konsideronte praktikatat e tilla si mbajtjen e ceremonive për t'i përkujtuar të vdekurit ose vizitat e varreve e të mauzoleve për të kërkuar ndihmë nga ajo që ka pushuar si diç në kundërshtim me shpirtin e Islamit. I refuzonte praktikatat e tilla të vendosura si përshëndetje me zgjatje dore, përkulje për të përshëndetur dhe puthjen e dorës ose të gunës, sepse ishin në kundërshtim me sunizmin, sepse ato nuk kishin ekzistuar në kohën e Profetit. Ai i sulmonte shumë institucionet e shoqërisë osmane, si pagesën e atyre që shërbenin për fe, kurse trashëgimi i të hollave ose i mallit të tundshëm si vakëf, ishte kërcënim ndaj rendit të vendosur, ndërsa Ebu Sujudi (shejhullislami pl. Sh.V.), mendonte se ishte e nevojshme të jepej një fetva për të konfirmuar legalitetin e këtyre institucioneve. Mehme-

²⁸ N. Smailagic, cep...cit..fq. 96.

²⁹ E. Ihsanogllu, vep...cit...fq. 764

³⁰ H. Inalxhik, vep...cit...fq. 260.

ti i Birgiviut nuk nguroi të sulmonte shejhuislamin drejtpërsëdrejti, duke pretenduar se fetvatë e tij ishin gabim. Po në këtë kohë shkrimet e tij kundër këndimit dhe vallëzimit në ceremonitë fetare i shqetësonin anëtarët e rendeve fetare.³¹

Idetë e tilla Birgiviut haptazi i parashtron gati në të gjitha veprat e veta, por me një vështrim të posaçëm në veprën e njohur të tij të shkruar në gjuhën arabe “Tarikat-i Muhammediye”, e cila përmban fjalimet dhe ligjëratat e tija. Kjo vepër e tij çmohej shumë nga njerëz të arsimuar. Birgiviut ishte i mendimit se zgjidhja e vetme e problemeve që i ka vërejtur ai në sistemin e administratës osmane dhe të shoqërisë në përgjithësi është që të pranohen idetë e tilla.³²

Me një fjalë Birgiviut kritikonte dhe refuzonte islamin ashtu si e praktikonte shteti, si dhe zakonet, besimin dhe traditën, të cilat në emër të Islamit dhe nën ndikimin e mistikëve përbënin fenë popullore. Me vlerësime dhe idetë e Birgiviut shumë dekada më vonë nuk u pajtua Katib Çelebiu, i cili i mbronte mistikët, posaçërisht Ibni al-Arabiun, sepse Çelebiu e shihte shërimin e fanatizmit në studimin e shkencave intelektuale, si në kohën e Mehmetit II, duke thënë se Birgiviut nuk e kishte kuptuar rolin shoqëror të ligjit zakonor dhe përdorimin e tij sepse ai nuk kishte studiuar historinë dhe filozofinë, dhe ndërhyrjet e tij në traditën dhe zakonet janë të pa arsyeshme. Çelebiu besonte se debatet gjithmonë janë të dobishme; megjithatë, vetëm ulemaja, e jo njerëzit, duhej të bisedonin për çështje fetare.

Rrugën e Birgiviut e vazhdoi studenti i tij Kadizade Mehmet efendiu (?-1635), myfti i Stambollit dhe ligjërues në Xhaminë Aja Sofija të Sulltan Mehmet Fatihut. Ky kishte arrit që rreth vetes të tubojë, dhe të bashkojë ithtarë të kësaj ideje puritane-reformiste të cilët u njohën me emrin *faki*. Fushatat e tyre propaganduese në katedrat e xhamive të Stambollit shpënë në përmbysje të madhe shoqërore, duke i ndarë njerëzit në dy grupe. Fakinjtë gjykonin të gjitha praktikatat e paraqitura që nga koha e Profetit si “inovacione”, ndërsa ata që i praktikonin kë-

³¹ H. Inal.. fq. 240.

³² N. Smailagic, fq. 96; dhe E. Ihsanoglliu, fq. 764.

to si jobesimtarë. Kjo lëvizje që u quajt sipas emrit të Kadzadeliut nxiti luftën kundër tarikateve sikur që ishin mevlevi dhe halveti, dhe ishin kundër mënyrës së mësimi tradicional të mekemit të Ku’ranit, kundërshtonin mevludin, thirrjen për lutje, dhe kohë pas kohe bënë përpjekje për të parandaluar praktikatat e tilla.³³ Kadizadeja lëshoi fetvanë me anë të cilës u ndalua rreptësisht pirja e kafesë dhe përdorimi i duhanit, të cilat i konsideronte absolutisht të ndaluara nga feja, ndërsa Murati IV (1623-1640) që rastisi të jetë sulltan në atë kohë, nuk tregonte aspak mëshirë ndaj atyre që nuk i përfillnin këto rregulla. Këta fakinjtë gjithashtu vepronin kundër këndimit, muzikës dhe vallëzimit nëpër ahengjet e sufijëve, si dhe kundër vizitës së atyre vendeve ku janë të varrosur shehlerët apo njerëzit që mistikët i konsideronin të shenjtë. Kjo lëvizje i kundërshtonte qëndrimet e Ibn al-Arabiut, dhe i thërriste myslimanët e vërtetë jo vetëm të bëjnë jetë morale dhe të pastër, por që edhe të tjerët t’i nxisin që ta trasojnë “rrugën e vërtetë”,³³ si dhe kërkonin heqjen e matematikës dhe të shkencave intelektuale nga medresetë.

Mirëpo, autorët bashkëkohës të Kadizades, siç ishin Katib Çelebiu, dhe Evlija Çelebiu, madje edhe vëzhguesit evropianë të asaj kohe si Paul Ricaut dhe një numër i historianëve të periudhës së mëvonshme, si Naima (1655-1716 me një vend tjetër 1718), i cili pa dyshim se ishte historiani më i rëndësishëm zyrtar i mbretërisë Osmane, shprehimisht na përcjellin informata kritike për idetë dhe veprimtarinë e kësaj lëvizjeje. Për shembull Katib Çelebiu na informon se përkrahësit e kësaj lëvizjeje, e sidomos Kadizade Mehmed-efendiu, prej të cilit dikur ky kishte mësuar shumë dhe më pas edhe kishin studiuar bashkë, ndërsa që më vonë kishte heq dorë prej tij, kurrë nuk e kishin shprehur sinqeritetin apo respektin e tyre ndaj Birgiviut, dhe as që kanë mundë të arrijnë sinqeritetin dhe nivelin e tij etik.³⁴

³³ E. Ihsanoglliu, vep...cit.. fq. 766

³³ Ajra M. Lapidus, “Sultanati i Barutna Carstva-srednji istok”, në Xhon Espoxite, “Oksfordska Istorija Islama”, fq. 401, Beograd, 2002.

³⁴ Evlija Çelebi, “Evlija Çelebi Seyahatnamesi”, besenci kitab, sf. 248, Istamboll 1970, Turkçelesteren: Zuhri Danisman; N. Smailagic...fq. 228; E Ihsanoglliu, fq.767.

Demagogët fakinj, siç iu drejtohet këtyre, studiuesi turk Halil Inalxhik, nuk iu paraqitën vetëm fanatizmit popullor fetar, por një herë ata sulmuan luksin dhe ekstravagancën e klasës sunduese dhe u drejtuan kundër padrejtësive dhe moralit të lirë të asaj kohe.

Dihet që gjatë tërë shekullit XVII në Stamboll ishin zhvilluar luftëra të ndryshme feudale³⁵, ndërsa situata ishte keqësuar pas vdekjes së Kadizades dhe të Shejh Sivasit, e posaçërisht gjatë viteve të para të pushtetit të sulltan Mehmetit IV (1648-1687) i cili në histori njihet edhe me nofken Avxhi (gjuetar) dhe i cili erdhi në pushtet si fëmijë shtatë vjeçar.³⁶ Një gjendje e tillë kaotike në mbretëri zgjati deri në kohën kur në pushtet erdhi veziri i madh nga familja shqiptare Mehmet Kyprily (1656-1661), i cili qëndroi në detyrën e krye vezirit pesë vjet e një muaj e pesëmbëdhjetë ditë,³⁷ të cilit i shkoi ndoresh që në vend të vendoset paqja dhe qetësia.³⁸ Dominimi i situatës së keqe kishte arritur kulmin e saj kur pas vdekjes së Kadizades lëvizja filloi të udhëhiqet nga Mehmet efendi Ustuvani, një predikues me prejardhje arabe. Ishte për t'u habitur se pse ulemaja e asaj kohe, e posaçërisht sheh-ul-islami Behaji efendiu, nuk qe në gjendje ta ushtrojë ndikimin e vet, dhe mbeti si një vështrues pasiv i ngjarjeve që u zhvilluan asokohe. Sipas gjitha gjasave sheh-ul-islami i takonte grupit komplotist që dëshironin ta rrëzonin sulltan Mehmetin IV dhe në vend të tij ta sillin sheh-ul-Islamin, me që sulltani ishte i moshës shumë të re.

Në marsin e vitit 1656, Kadizadelit treguan agresivitetin e tyre kur ndërmorën një sulm mbi të gjitha teqetë e Stambollit, duke shkaktuar një masakër të përgjithshëm, me ç'rast ata kishin për qëllim ta goditnin në rrënjë herezinë fetare, ndërsa pjesën më të madhe të përkrahjes e gjetën te studentët e varfër të medreseve dhe tregtarët e dobët. Klasa burokratike që mbante poste të larta zyrtare, ishin kundër lëvizjes du-

³⁵ Petrika Thengjilli, "Historia e Perandorisë Osmane", fq. 44, Tiranë, 1997.

³⁶ Turk Sultanlari Ansiklopedisi" e ilustruar me fotografi, pa vit botimi, fq. 131, Istanbul.

³⁷ Nazim Tektas, "SADRÂZAMLAR-Osmanli'da İkinci Adam Saltanati", sf. 227, Istanbul, 2002.

³⁸ Zoran Sv. Tomoc, "KAMAL ATATURK-Tvorac Nove Turske", fq. 11, Beograd, 1939.

ke thënë se ata nuk e përfillin shtetin dhe shoqërinë dhe mbillnin përçarje midis njerëzve. Dhe kjo qe arsyeja pse kryeveziri i madh Mehmet Kyprilyju ndërmori masa për ta qetësuar situatën e krijuar, me ç'rast u detyrua që udhëheqësit e Kadizadelive t'i dëboi nga Stambolli.

Baza teorike e kësaj përçarjeje ishte çështja e "inovacioneve" në islam, një problem që ndikonte në gjithë kulturën dhe shoqërinë osmane. Duke i parë dhe vështruar prej së afërmi gjitha ato veprime dhe sjellje të tërbuara, siç i quajti edhe vetë Katib Çelebiu, i cili më pas bëri përmbledhjen e mendimit të përgjithshëm të ulemasë së lartë dhe shkroi: "Praktikat dhe rritet e zakonshme të cilat i kishte përvetësuar pjesa dërrmuese e shoqërisë islame nuk mundeshin dhe nuk duhej të hiqeshin me forcë. Një risi mund të mos përputhej me shariat, por atëherë njeriu, rob i Zotit, është i pamundur dhe i papërsosur, kurse Zoti është ai që i fal të gjitha. Islami parapëlqen më shumë tolerancën sesa forcën, dhe sidoqoftë përdorimi i forcës është gabim, meqë nga ajo rrjedh rezistenca e cila si e tillë prodhon trazira dhe ndarje në shtet dhe shoqëri. Në fund, ligjet nuk ndryshojnë me kohë, dhe vazhdon duke thënë se profeti kishte bërë ligje për disa arsye dhe kur ato arsye nuk ekzistonin më, po ashtu edhe ato ligje nuk kishin efekt më."³⁹

Historia e religjionit në Mbretërinë osmane, e cila manifestohej në lëvizjet shoqërore, gjegjësisht, historia e religjionit, e cila shënoi lëvizjet shoqërore dhe fetare mori fund në shekullin e XVII me lëvizjen e Kadizadelive.

Shikuar në esencë kjo lëvizje për shumëçka paraqiste një lëvizje kundër osmane, sepse dihet që Osmanlinjtë dhe mbretëria e tyre për një kohë të gjatë kanë shprehur tolerancë ndaj dallimeve fetare, ndërsa që paraqitja e këtyre dallimeve përbënte një pjesë të traditës osmane.

³⁹ Islam Ansiklopedisi", cilt IV, sf. 275, Stamboll, 1978; dhe Inalxhik, vep...cit...fq.241.

Në fund do të përqendrohemi me pak fjalë për veprën e Katib Çelebiut “*Rumelia dhe Bosnja*”. Kjo vepër e Çelebiut është pjesë e veprës së madhe gjeografike “*Xhihanumma*” për të cilën kemi folur më lart, por është interesant të theksojmë se kjo vepër nuk është gjetur në Turqi, veçse në një vend, e cila thua se për çdo gjë dallohet nga Turqia përveç të një tradite të ngjashme të mbretërisë shekullore. Në vijim do të shohim se kush, si dhe në ç’vend u zbulua kjo vepër që ka rëndësi të madhe gjeografike dhe shkencore edhe për ditët tona.



Joseph F. Von Hammer
(1774-1856)

Filologu, arkeologu, gjeografi, dhe historiani i letërsisë, e para së gjithash orientalist i diplomuar pranë Akademisë orientale vjeneze, njohës i shkëlqyeshëm i lindjes myslimane, nga Austria, Joseph F. Von Hammeri, i cili punoi shumë në themelimin e ASHA Vjeneze, dhe u zgjodh kryetar i parë i saj, por që është i njohur edhe për veprën e tij kapitale “*Historia e Mbretërisë Osmane*”,⁴⁰ tregon se si në Stamboll kishte bërë kërkime të pandërprera shumëvjeçare me një përkujdesje të veçantë që të gjejë ndonjë vepër turke, ku mund të gjenden të dhëna për gjeografinë e Turqisë europiane, dhe sikurse që na bën me dije edhe vetë ai, se e tërë ajo kohë e kaluar në Stamboll në kërkim të një vepre të tillë i kishte shkuar huq.

Megjithatë, ai më në fund arrin ta gjejë veprën aq shumë të kërkuar “*Rumelia dhe Bosnja*”, por jo në Stamboll siç kishte pretenduar, veçse në Austri në një koleksion të kontit Vjeçesllav Rozhevunski. Hameri thotë se dorëshkrimin të cilin ai e gjeti aty kryesisht ishte shkruar nga vetë dora e Haxhi Kalfes, dhe se bashkë me te gjendej

⁴⁰ <http://tr.wikipedia.org/wiki/biografiya>

edhe vepër gjeografike për vendet aziatike që kemi përmendur më parë, por që kjo e kishte parë dritën e botimit (fjala është për Xhihanumman, e botuar në vitin 1732), ndërsa ajo e bejlerbejllëkut të Rumelisë dhe Bosnjës nuk ishte botuar fare. Hameri dorëshkrimin e gjetur te Rozhevunski e përkthen në gjermanishte *Rumeli und Bosna. Geographisch beschrieben von Mustafa ben Abdalla Gadschi Chalfa*. Aus dem turkischen übersetzt von Joseph von Hammer. Wien 1812, të cilin edhe e boton në vitin 1812 në Vjenë.⁴¹

Pasi që viset e banuara me shqiptarë i takonin Ejaletit të Rumelisë, ne me këtë rast duke mos u përqendruar rreth detajeve me të dhëna që na ofron Katib Çelebiu do t’i përmendim emrat e të gjitha atyre vendeve të Ejaletit të Rumelisë, pa ato Bosnjës.

Sipas Katib Çelebiut, Ejaleti i Rumelisë, në gjysmën e shekullit XVII, ndahej në 26 sanxhaqe, ato ishin: Viza, Kirk-klise, Silistra, Nikopola, Vidini, Çirmeni, Sofja, Galipola, Selaniku, Qystendili, Shkupi, Tirhalla, Agrobosi, Morea, Inabahta, Karli-ili, Janina, Delvina, Vlora, Elbasani, Shkodra, Ohri, Prizreni, Vuçitërna, Dukagjini, Krushëvci, dhe Smedereva.⁴²

Dhe për fund t’i referohemi studiuesit dhe historianit të mirëfilltë të çështjes së Historisë Osmane, francezit Rober Mantrant, i cili Katib Çelebiun e definoi me këto fjalë:

“...Ai prezantoi një kritik shpirtëror dhe shkencor, gjykoi akademizmin dhe metropolitantin, dhe në këtë mënyrë disa institucioneve u miratonte vendime të paanshme. Ai ishte shkencëtari më i madh i Osmanlinjve i shekullit XVII.”⁴³

⁴¹ Stojan (St.) Novakovic, vepër e cituar, fq. 7-8.

⁴² Kjo radhitje është sipas veprës së njëjtë fq. 17-63, përkthim nga gjermanishtja në serbishtë me plotësime dhe sqarime të Stojan Novakoviçit (1842-1915), i cili si i dërguari i Serbisë kishte qëndruar disa vite në Stamboll; dhe në Skënder Riza, “Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII”, fq. 47, Prishtinë, 1982, i cili po ashtu i referohet librit të Novakoviçit.

⁴³ R. Mantrant, vepër...cit..fq. 861.

Shevki Sh. Voca

BIOGRAPHIC DATA ON, HAJJI KALFA (1609-1657), A DISTINGUISHED TURKISH TRAVEL WRITER

(Summary)

The oldest Turkish author in the field of geography is Hajji Kalfa. Among Turkish authors he is better known as Katib Celebi. In the beginning of his carrier, Katib Celebi was a government official. Celebi was the author of a number of books in the fields of history and geography as well as a number of writings regarding different problems (having to do with Islam), arguing with scholars, who according to him, were preventing Islam from moving forward (the latter prevented their students (in the madrassas) from studying different subjects such as math, astronomy, philosophy, etc. Katib Celebi (Mustafa bin Abdallah) was born in Istanbul in 1609.

شوقى فوسا

سيرة موجزة عن الرحال التركى الحاج خلفا (1609-1657)

(خلاصة البحث)

ان أكبر عالم و كاتب تركى في مجال جغرافيا البحتة هو الحاج خلفا و هو معروف بنفس الاسم حتى في الكتب الاوربية. و يجدر بالذكر انه معروف بين الاتراك بلقبه الكاتب شلى. و كما هو معروف فان لقب خلفا لا يمكن ان يكون اسما مميزا لانسان بعينه لان هذا اللقب عادة في الماضى كان يطلق على المعلم الذي كان يقوم بتعليم التلاميذ مهن مختلفة و هذا يعنى بانه لقب يتعلق بالمهن مما هو لقب يطلق على الاشخاص.

VËSHTRIME

Nexhat Ibrahim

HISTORIA E LIBRIT DHE E BIBLIOTEKAVE

Shqyrtim hyrës

Leximi i veprës së Behxhet Jasharit, “**Biblioteka e Aleksandrisë - histori e bibliotekave antike**“, në botim të Furkan ISM, Shkup, /14272006, fq. 243, paraqet një shtet për shkencën dhe lexuesin shqiptar. Siç tregon edhe vetë titulli, ajo flet për bibliotekat e hershme dhe Bibliotekën e njohur të Aleksandrisë. Për t’u shmangur përsëritjeve nuk do të flas për vetë librin, por për disa pikëpamje islame-kulturore, që për shkak të natyrës së veprës nuk janë trajtuar, sikurse është ngjyra, lapsi, letra, libri, të cilat përbëjnë lëndën e parë të bibliotekave!

Mjetet të cilat sot njerëzit i përdorin për komunikim të shkruar, si-kurse ngjyra, lapsi, letra, libri dhe format tjera të shkrimit, gjurmët i kanë të hershme. Qysh kinezët e njihnin shtypin, me bazë fshikëzën e krimbit të mëndafshit. (A. Stipçeviq, R. Escarpit). Po në këtë kohë edhe dinastia myslimane e fatimitëve në Egjipt e njihnte shtypin (K. Grimberg), por ky shtyp ishte primitiv dhe mund të prodhonte pak shkrim. Vetëm zbulimi i shtypshkronjës në vitin 1450 nga Gutengergu, do të bëjë revolucion në planin e shtypit. (M. Handzic).

Librat e shenjtë, e sidomos Kur’ani, po ashtu konfirmojnë se të dërguarit e Zotit gjatë historisë kanë pranuar mesazhe nga Krijuesi i tyre. Ajetet e shumta kur’anore, si El-Hixhr, 10; Er-Rrum, 47; Gafir, 78, etj., këtë qartazi e pohojnë. Mesazhet hyjnore të peygamberët janë quajtur suhufe dhe kitabe. Musai a. s. mesazhin hyjnor e ka pranuar në formë pllakash. (N. Smailagic).

Burimet arkeologjike dhe librat e shenjta dëshmojnë se shkrimi dhe leximi janë nga ato më primitive drejt formave më të përsosura. Mirëpo, njohësit e kësaj fushe pohojnë se shkrimi ka kaluar nëpër tri faza kryesore: shkrimi nëpërmjet figurave; shkrimi kalimtar (mes fazës së parë dhe asaj që do të pasojë) dhe; shkrimi modern, ku çdo tingull ka shkronjën e vet. Po ashtu, kemi shkrime nga e majta në të djathtë, nga e djathta në të majtë dhe nga lart poshtë. (M. Handzic). Këto forma të lashta por të avancuara, të transformuara dhe funksionale i kemi të pranishme edhe sot, natyrisht shumë praktike për përcjelljen e porosive ndërmjet vete por edhe të brezave të ardhshëm.

Shprehja *libër*, që një periudhë të gjatë kohore dominon ndër ne, është fjalë latine me kuptimin: lëkurë druri (pëmësh), pergamenë e mbështjellë; kapitull, kaptinë; listë, katalog; letër, mesazh. Fillimisht shkrimi është bërë në pllaka qerpiçi, argjile, duke e bërë së pari pllakën e pastaj duke e gravuar shkrimin në pllakë. Kjo pllakë sërisht është pjekur, për t’u ruajtur më gjatë. Kështu është vepruar në Asiri dhe Babiloni. Këtë e argumentojnë bibliotekat e gjetura. Në Romën e Vjetër me shprehjen *libër* kuptohej teksti i shkruar në letër e papirusit ... (Prav. encikl., I, Bgd.). Sipas K. Grimbergut, qytetërimi perëndimor ua detyron arabëve fletën e parë të vërtetë prej letre. Dorëshkrimi më i vjetër mbi fletën e pambukut është zbuluar në Eskorial, pallat i vjetër mbretëror i vendosur në veri të Madridit. Ai është shkruar në arabisht dhe daton në vitin 1009.

Libri në burimet islame dhe gjatë historisë islame

Në burimet islame dituria (ngjyra, lapsi, letra, libri etj.) gëzon respekt të lartë. All-llahu xh.sh. nëpërmjet ajeteve kur'anore (si El-Kehf 109; El-Kalem 1-5; Ali Imran 3; El-Mulk 1) nxit leximin, mësimin dhe përsiatjen, betohet në laps dhe obligon në analizimin e shumë çështjeve të botës fenomenale. Ata që merren me statistikë konsiderojnë se ajete të tilla janë rreth 850 sosh.

Muhammedi a.s. nëpërmjet urdhëresave, porosive, rekomandimeve, miratimeve dhe veprimeve të tij, diturinë, leximin, lapsin, letrën, librin e të ngjashme i ka ngritur në shkallët më të larta. Kërkimi i diturisë prej djepit deri në varr; Kërkimi i diturisë qoftë edhe në Kinë; Kërkimi i diturisë për çdo mysliman (dhe myslimane) e shumë të tjera, më së qarti flasin për këtë problematikë. (Buhariu).

Një fjalë e urtë arabe “Çdo gjë është diç, kurse injoranca është hiç” dhe një fjalë e urtë shqipe “Sa di, aq edhe vlen”, në mënyrë eksplicite dëftojnë rëndësinë e lapsit dhe të letrës, do të thotë, të librit.

Shekujt e parë të Islamit, periudha e katër halifëve të parë, pastaj periudha emevite dhe abasite, janë themele të denja për zhvillim të gjithanshëm dhe solid të myslimanëve deri në ditët tona. Thesari i bibliotekave të Bagdadit, Kairos, Kajrevanit, Kordobës, Buharës, pastaj më vonë të Stambollit, Sarajevës, Shkupit, Prizrenit etj., dëshmojnë për qëndrimin afirmativ të myslimanëve ndaj diturisë dhe ndaj fjalës së shkruar në të kaluarën.

Si objekt trajtimi, libri e sidomos Kur'ani ka qenë tejet i respektuar nëpër shtëpitë myslimane. Libri është konsideruar si miku më i mirë që përcjell tërë jetën, që mbron shpirtërisht e fizikisht, që rafinon shpirtin dhe mendjen. (M. Handzic). Ai është ruajtur në raft të veçantë, shpesh nëpër rafte të gravuara, kurse te të pasurit është ruajtur në rafte të dekoruara me gurë të çmueshëm, me sedef, me eshtra e të ngjashme. Libri po ashtu është ruajtur edhe nëpër dollapë, nëpër arka speciale etj. Kurse në xhami, Kur'ani dhe librat e tjerë fetarë janë

ruajtur në kuti të posaçme, kurse janë lexuar nëpër peshta e rahle. (Z. Janc).

Nëse kalimthi lexojmë historinë islame ndër iliro-shqiptarët, do të lexojmë se prania e vëllimshme e librave myslimane dhe të myslimanëve në shekullin IX në mbretërinë e atëhershme bullgare (toka të pushtuara iliro-shqiptare) ka paraqitur problem për kanin bullgar Borisin dhe për papën e Vatikanit. Mirëpo, papa e eliminoi problemin duke i sugjeruar Borisit që t'i djegë librat myslimane pasi që Bibla u mjafton të krishterëve.

Po ashtu, ka indikacione se letra është prodhuar edhe te ne në Ballkan, e edhe te shqiptarët në shekullin XVI e XVII, që flet mjaft se lapsi, letra, leximi e mësimi, mjetet për shkrim, zeja e përshkrimit etj., ishin çështje me rëndësi të parët tanë.

Kam bindjen se të parët tanë, ndonëse nga të tjerët edhe sot e kësaj dite quhen si të prapambetur e primitivë, janë udhëhequr me mësimet kur'anore e sunnetike ndaj librit, me mësimet e Et-Taberit (vdiq 310 h.), i cili brenda një dite shkruante 40 faqe shkrim libri, nga shembulli i Imam Maturidiut, El-Gazaliut, Ibn Arebiut, Sujutiut, Ebu Hanifes, Shafiut, duke udhëtuar këmbë, me kalë e deve, me muaj të tërë për një çështje fetare si shembull për ne, nga shembulli i Suzi Prizrenit (vd. 1524), me bibliotekën e tij të parën në Kosovë, të legalizuar në vitin 1513, i Mesih Prishtinasit dhe bibliotekat përgjatë tokave shqiptare dhe rajonale.

Mesazhi i veprës për lexuesin shqiptar

Por, kjo që u theksua quhet e kaluar dhe sado qoftë e shkëlqyeshme dhe e bukur, prej saj vetëm mund të mësohet por jo edhe të jetohet. Me këto rezultate mund dhe duhet të mburremi aq sa jemi në gjendje t'i lëmë edhe gjurmët tona në tanishmëri dhe sa jemi në gjendje të krijojmë predispozicionet për veprim të brezave të ardhshëm në ardhmëri. Gjendja aktuale e fjalës së shkruar ndër ne, përkundër përparimeve, mund të vlerësohet si e pamjaftueshme dhe e patolerueshme, e herë-herë edhe komprometuese.

Që të mësojmë nga e kaluara së pari duhet ta mësojmë atë. Për ta mësuar atë, rruga më e mirë është të lexohet e hulumtohet. Pikërisht këtë e ofron vepra e zotëri Behxhet Jasharit. Nëpërmjet kësaj vepre lexuesi shqiptar për herë të parë në mënyrë sistematike, analitike, informative dhe popullarizuese na njofton me thesaret e pasur të popujve dhe feve, të kulturave dhe qytetërimeve botërore nga kohët më të lashta.

Kemi bindjen se vepra është e nevojshme për lexuesin shqiptar, sepse hap shtigje për punë shkencore edhe më serioze. Me këtë nënkuptoj, para së gjithash, hulumtimin e bibliotekave individuale dhe kolektive në trojet tona. Shpresoj se me përmirësimin e strukturës së lexuesve, me të drejtë duhet pritur që fjala e shkruar të dalë nga ane mia dhe stereotipi ekzistues, nga puna individuale në atë ekipore, nga “ad hoc”-i në punë me projekte me planifikim.

Nexhat Ibrahimimi

THE HISTORY OF BOOKS AND LIBRARIES

(Summary)

The latest work of Behxhet Jashari, “The library of Alexandria – a history of ancient libraries” is a great gift to Albanian readers. The book has 243 pages. It was published by the Furkan ISM Printing House. In order to avoid any repetition, I will not talk about the book but will focus on things that are closely related to them.

The means, which are used for written communication (color, paper, etc.), were well known since antiquity. Yet, it was only with the invention of Gutenberg’s printing press in 1450 that a revolution in this direction took place.

نجد إبراهيم

تاريخ الكتاب و المكتبات

(خلاصة البحث)

مدخل:

قرأ كتاب بمحت يشارى "مكتبة الاسكندرية - تاريخ المكتبات القديمة" الذي صدر حديثا عن دار النشر الفرقان اسم بمدينة شكوبي 1427هـ/2006، عدد الصفحات 243 يعتبر حدثا سارا للقارئ اللبناني. و حسب ما يفهم من عنوان الكتاب فانه يتحدث عن المكتبات القديمة و مكتبة الاسكندرية. و تفاديا للتكرار فإني لا أود أن أتحدث عن الكتاب ذاته و لكنني سوف أتحدث عن بعض المبادئ الاسلامية و الثقافة التي لم تذكر فيه مثل الحبر و القلم و الورقة و الكتاب و التي تحتوى المادة الرئيسية للمكتبات.

VËSHTRIME

Frithjof Schuon

MENDIME RRETH ARTIT SIPAS VËSHTRIMIT TRADICIONAL

Arti: Në kuptimin më të gjerë, arti është kristalizimi i vlerave arketipore. Ai përbën të kërkuarit dhe të zbuluarit e qendrës brenda dhe përreth nesh. Arti është veprimtari, eksteriorizim, dhe kësisoj varet me përkufizim nga një dije që e tejkalon dhe i jep atij një rend; veçmas një dijeje të tillë, arti nuk ka për ligjje: është dija ajo që përcakton veprimin, manifestimin dhe formën - e jo anasjelltas.

Arti autentik dhe normativ: Arti autentik dhe normativ priret gjithmonë të kombinojë vëzhgimin inteligjent të natyrës me stilizime fisnike e të thella, në mënyrë që: pikësëpari, ta asimilojë veprën sipas modelit të krijuar nga Zoti në natyrë dhe, së dyti, ta ndajë atë nga kontingjenca fizike, duke i dhënë një vulosje shpirti të kulluar dhe sintezë të thelbësore.

Funksioni thelbësor i artit të shenjtë: Funksioni thelbësor i artit të shenjtë është të shndërrojë Substancën, e cila është si e vetme ashtu edhe e pashterueshme, në botën e aksidencës dhe ta rikthejë vetëdijen aksidenciale të Substanca. Mund të thuhet se arti i shenjtë e zhvendos Qenien drejt botës së ekzistencës, veprimit ose bërjes; apo që ai e zhvendos të Pafundmen drejt botës së të fundmes, apo Esencën të bota

e formave, duke sugjeruar kësisoj një vazhdimësi që vijon nga njëra te tjetra, një shteg që nis nga aparenca ose aksidenca dhe hapet drejt Substancës ose kumbimeve të saj qiellore.

Funksioni i artit: Arti ka një funksion që është si magjik, ashtu edhe shpirtëror: magjik sepse bën të pranishëm parime, fuqi si dhe gjëra që i tërheq falë një “magjie bashkëndjerëse”; shpirtëror sepse eksteriorizon të vërteta dhe bukuri në kuadër të brendësimit tonë, kthimit tonë në “mbretërinë e Zotit që ndodhet brenda jush.” Parimi bëhet manifestim në mënyrë që manifestimi të mund të ribëhet Parim, apo që “uni” të mund t’i rikthehet Vetes; ose thjesht, që shpirti njerëzor të mundet - përmes dukurish të caktuara - të kontaktojë arketipet qiellore dhe së andejmi arketipin e vet.

Arti përgjithësisht: Arti është, në përgjithësi, si mjet shprehjeje ashtu edhe asimilimi: shprehje e personalitetit tonë cilësor e jo arbitrar e kaotik, dhe asimilim i arketipeve të projektuara kështu. Kësisoj, ai përbën një lëvizje nga vetja jonë te vetja jonë, apo nga Vetja imanente të Qenia transhendente, dhe anasjelltas. Një “vete jonë” empirike e kulluar nuk do të thotë asgjë, pasi të gjitha vlerat i kanë rrënjët tek Absolutja.

Misioni i Artit: Heqja e lëvozhgave për të zbuluar bërthamat; distilimi i materialeve derisa të nxirren esencat. Fisnikëria nuk është tjetër veçse një prirje e natyrshme për këtë alkimi - në të gjitha rrafshet.

Konceptimi modern i artit: Konceptimi modern i artit është i rremë në atë që ai vë përfytyrimin krijues - ose thjesht impulsin për të krijuar - në vendin e formës cilësore; ose në atë që një vlerësim subjektiv dhe hamendësues i zë vendin një vlerësimi objektiv dhe shpirtëror. Të bësh këtë do të thotë të zëvendësosh me talent - goftë real apo iluzor - atë zotësi dhe mjeshtëri që duhet përfshirë patjetër në përkufizimin e artit, thua se talenti mund të ketë kuptim i shkëputur nga konstantet normative që janë kriteret e tij.

Arti i përsosur: Arti i përsosur mund të njihet nëpërmjet tre kriterëve kryesorë: fisnikërisë së përmbajtjes - që përbën një kusht shpirtëror veçmas kujt arti s’ka të drejtë të ekzistojë; pastaj përpikëmerisë së simbolizmit ose të paktën, në rastin e veprave profane të artit, har-

monisë së kompozimit; dhe së fundi pastërtisë së stilit ose elegancës së linjës dhe ngjyrës. Me anë të këtyre kriterëve mund të shquajmë cilësitë dhe të metat e cilësdo veprë arti, qoftë ky i shenjtë apo jo.

Arti piktorial - figurativ dhe dekorativ: Në kuptimin më të gjerë, arti piktorial, me të cilin nënkuptojmë animacionin e syprinave nëpërmjet ngjyrave, qoftë me piktura të mirëfillta, vizatime, gdhendje apo qëndistari implikon në thelb dy përmasa apo modalitete: figurativen dhe dekorativen, ku që të dyja shfaqen me raste në artin e veshjeve të indianëve si dhe në dekorimin e tendave të tyre. Modaliteti i parë ekzekutohet nga burrat, i dyti nga gratë, çka është mjaft kuptimplotë: efektivisht, arti figurativ i referohet të përcaktuarës - ose qendrores në njëfarë kuptimi - kurse arti dekorativ të papërcaktuarës dhe të gjerësishtes apo gjithëmundësisë; dhe kjo në mënyrë të pavarur nga kuptimet e veçanta që mund të kenë vizatimet dekorative apo motivet gjeometrike. Ose sërish: arti figurativ shpreh përmbajtjen e vetëdijes sonë, kurse dekorativi substancën tonë; kështu, burri përfaqëson një ide kurse gruaja mishëron një mënyrë të qeni, një *materie* ekzistenciale, në të cilën ideja mund të fiksohet dhe zgjerohet; kjo është ndërplotësueshmëria midis së Vërtetës dhe Virtytit.

Qëllimi i Artit: Qëllimi i artit nuk është *apriori* të induktojë emocione estetike, por të përçojë, bashkë me to, një mesazh pak a shumë të drejtpërdrejtë shpirtëror, dhe kështu sugjerimet që burojnë nga dhe rishpiejnë te - e vërteta çliruese.

Arsyeja e qenies së artit: Arsyeja e qenies së artit - si *a fortiori* e udhëve shpirtërore - është kalimi nga aksidentalja te substanca, ose nga bota e lëvozhgave tek ajo e arketipeve.

Arti i shenjtë: Arti i shenjtë është forma e Mbiformales, imazhi i së Pakrijuarës, gjuha e Heshtjes. Arti i shenjtë është Qielli i zbritur në tokë, para se të jetë toka në ngjitje drejt Qiellit. Arti i shenjtë ... përçjell jo vetëm të vërteta abstrakte që përçohen nga simbolizmi, por gjithashtu - pikërisht nëpërmjet bukurisë së tij - kundërmimet njëherësh rigjallëruese dhe paqëtuuese të Dashurisë Hyjnore.

Një art është i shenjtë, jo përmes qëllimit personal të artistit, por përmbajtjes, simbolizmit dhe stilit të tij, pra përmes elementesh obje-

ktive. Për nga përmbajtja: subjekti i përfaqësuar duhet të jetë siç u tha ose kur ndjek një model kanonik ose në një kuptim më të gjerë; por gjithmonë i përcaktuar kanonikisht. Për nga simbolizmi: personazhi i shenjtë, ose simboli antropomorfik, duhet veshur ose stolitur në një mënyrë të caktuar e jo ndryshe dhe mund të bëjë gjeste të caktuara por jo të tjera. Për nga stili: imazhi duhet të shprehet në një gjuhë hieratike të posaçme formale e jo në ndonjë stil të huaj apo të përfytyruar. Shkurt, imazhi duhet të jetë i shenjtë në përmbajtje, simbolik në detaj dhe hieratik në trajtim; përndryshe atij do t'i mungojë e vërteta shpirtërore, cilësia liturgjike dhe - për më tepër - karakteri sakral. Me çmimin e humbjes së të drejtës për të ekzistuar, arti nuk ka të drejtë t'i shkelë këto rregulla dhe as që i leverdis diçka e tillë, pasi këto kufizime në pamje të parë i dhurojnë, me anë të së vërtetës intelektuale dhe estetike, cilësitë e thellësisë dhe fuqisë, të cilat artisti individual ka shanse fare të pakta t'i nxjerrë nga vetja.

Një art që nuk shpreh të pandryshueshmen dhe nuk do që të jetë vetë i pandryshueshëm nuk është art i shenjtë.

Arti i shenjtë-profan: Arti i shenjtë është i bërë si mjet për praninë shpirtërore, ai është i bërë njëkohësisht për Zotin, engjëjt dhe njeriun; arti profan nga ana tjetër ekziston vetëm për njeriun dhe nga vetë ky fakt e tradhton atë.

Arti i shenjtë e ndihmon njeriun të gjejë qendrën e tij, atë bërthamë natyra e së cilës është dashuria për Zotin.

Detyra e vetme e artit: Nuk është detyra e vetme e artit që të zbresë drejt njerëzve të thjeshtë; ai duhet t'i mbetet besnik të vërtetës së brendshme, në mënyrë që t'i lejojë njerëzit të ngjiten drejt saj.

Vlera mbinaryrore e artit: Vlera mbinaryrore e artit të shenjtë buron nga fakti se ai përçon dhe komunikon një inteligjencë që i mungon kolektivitetit. Sikurse natyra e virgjër, ai zotëron një cilësi dhe funksion inteligjence, të cilën e shpalos nëpërmjet bukurisë, sepse në thelb ai i përket rendit formal; arti i shenjtë është forma e Mbi-formales, imazhi i së Pakrijuarës, gjuha e Heshtjes.

Arti - Bukuria: Sigurisht arti i përket me përkufizim rendit formal, dhe kush thotë përsosje forme thotë bukuri; pretendimi se arti

nuk ka të bëjë fare me bukurinë, me pretekstin se qëllimi i tij imediat është shpirtëror, është po aq i rremë sa edhe pohimi i kundërt: se bukuria është qëllimi i vetëm i veprës artistike. Në thelb, bukuria nënkupton një mbajtës dhe një përmbajtje: sa i përket mbajtësit, ai përfaqësohet nga konformiteti ndaj ligjeve të harmonisë, ose rregullsisë së strukturës, ndërsa përmbajtja është shpalosje e “Qenies” apo e “Dijes” ose prapë e “Lumtunisë” (Beatitude) - çka na rikthen tek aspekti i trefishtë i *Atmas* – apo më saktë tek një kombinim i larmishëm i tre elementeve; për më tepër, janë pikërisht këto përmbajtje ato që e përcaktojnë *apriori* mbajtësin.

“Art për hir të artit”: Gabimi në tezën “arti për hir të artit” qëndron në të vërtetë në të supozuarit se këto janë relativitete që kanë përlligjjen e tyre të mjaftueshme brenda vetes, në natyrën e tyre relative, dhe se për pasojë ekzistojnë kritere vlere që i janë inaksesibël inteligjencës së kulluar dhe të huaja së vërtetës objektive. Ky gabim përfshin heqjen e përparësisë së shpirtit dhe zëvendësimin e tij ose nga instikti ose nga shija, pra nga kritere që janë ose krejtësisht subjektive ose arbitrare. Kemi parë tashmë se përkufizimi, ligjet dhe kriteret e artit nuk mund të nxirren nga vetë arti, pra nga kompetenca e artistit si i tillë; themelet e artit qëndrojnë te shpirti, te dituria metafizike dhe mistike, jo vetëm te dija e zanatit dhe as te gjenialiteti, sepse ky mund të jetë çfarëdo. Me fjalë të tjera, parimet e brendshme të artit i nënshtrohen në thelb parimeve të brendshme të një rendi më të lartë.

Artisti / Mistiku: Eksteriorizimit krijues, që vazhdon nga qendra drejt periferisë, i përgjigjet një brendi iniciuese ose mistike, që vazhdon në kahen e kundërt duke pasur si parafigurim psikologjik virtytin. Në të vërtetë, virtyti priret nga aksidentalja drejt substanciale ose nga forma kontingjente drejt arketipit, “idesë”, thelbi i së cilës është E Mira Sovrane, *Agathoni*. E njëjta vlen për artin, qëllimi i të cilit është shndërrimi i arketipit në kontingjencë; dhe ky është “realizëm” i vërtetë, ngase realja qëndron mbi ne, e jo nën ne - siç ua ka ënda modernistëve. Është e vetëkuptueshme që shprehja artistike s’është asgjë më tepër se parafigurimi i alkimisë shpirtërore, lënda e të cilës është shpirti dhe e cila realizon - për së brendshmi dhe në mënyrë themelore -

atë që arti demonstroi dhe premtori në nivelin e perceptimeve dhe emocioneve imediate. Artisti sjell Hyjnoren në botë; mistiku e riintegron botën - shpirtin e tij - tek Hyjnorja; gjithmonë me ndihmën e Qiellit, sepse “pa Mua nuk mund të bëni asgjë.”

Përgatiti:
Edin Q. Lohja

Frithjof Schuon

OPINIONS REGARDING ART (TRADITIONAL VIEW)

(Summary)

Art: Art in the broadest sense is the crystallization of archetypal values. Art is the quest for – and the revelation of – the center, within us as well as around us. Art is an activity, an exteriorization, and thus depends by definition on a knowledge that transcends it and gives it order; apart from such knowledge, art has no justification: it is knowledge which determines action, manifestation, form, and not the reverse.

Art (authentic and normative): Authentic and normative art always tends to combine intelligent observation of nature with noble and profound stylizations in order, first, to assimilate the work to the model created by God in nature and, secondly, to separate it from physical contingency by giving it an imprint of pure spirit, of synthesis, of what is essential.

Art (essential function of sacred art): The essential function of sacred art is to transfer Substance, which is both one and inexhaustible, into the world of accident and to bring the accidental consciousness back to Substance. One could say also that sacred art transposes Being to the world of existence, of action or of becoming, or that it transposes in a certain way the Infinite to the world of the finite, or Essence to the world of forms; it thereby suggests a continuity proceeding from the one to the other, a way starting from appearance or accident and opening onto Substance or its celestial reverberations.

فريثيوف شوم

آراء حول الفن حسب الراى التقليدي

(خلاصة البحث)

الفن حسب الراى العام هو تصوير الفضائل العميقة هو يتناول البحث و الكشف عن المحتوى و الاشياء التي تحيط ببناء الفن هو عمل مركب يتناول الاشياء من نواح مختلفة وزوايا متعددة من حيث المضمون و الشكل.

veprën e tij si në prozë ashtu dhe në poezi. Ndër ata që i thurën kaside – poema lavdie për të gjallë të Pejgamberit a.s., kanë qenë poetët e njohur: Hasan bin Thabiti, dhe Ka’b bin Zuhejri. Në një kaside kush-tuar Muhamedit a.s., Hasan bin Thabiti, në mes të tjerash, thotë:

*“Ve ahsene minke lem tere kat-tu ajni
ve exhmele minke lem telidin-nisau
hulikte muberreen min kul-li ajbin
keen-neke kad hulikte kema teshau”.*

Në përkthim të rimuar do të thotë:

*“Më të mirë se ty s’kanë parë kurrë sytë e mi
më të bukur se ty s’kanë lindur gratë ndonjë fëmi
ti je krijuar i pastër nga çdo e metë
sikur t’ishe krijuar ashtu si ke dashtë vetë”.*

Në shekullin e dhjetë të e.r. kanë filluar të paraqiten tekstet e mevludit në gjuhën arabe kushtuar lindjes së Muhamedit a.s.. Mirëpo vepra e parë me këtë emër “El-Mevlidun-nebijj” është shkruar nga Ibni Xhevziu, i cili vdiq në vitin 1201. Ndërsa mevludi i parë në gjuhën turke është shkruar nga imami i “Ullu” xhamisë në Brusë, Sylejman, ef. Çelebiu në vitin 1409. Mevludi më i vjetër në gjuhën shqipe konsiderohet ai i Hasan Zuko Kamberit, i shkruar në gjysmën e dytë të shekullit të tetëmbëdhjetë. Pas tij vijnë mevludi i Hfz. Ali Riza Ulqinakut, që përdoret edhe sot në Shqipëri dhe në Malin e Zi, dhe mevludi i Tahir ef. Popovës, që përdoret në Kosovë dhe Maqedoni, të cilët u shtypën në fund të shekullit nëntëmbëdhjetë. Të gjithë autorët e përmendur, për bazë dhe shembull patën mevludin e Sylejman ef. Çelebisë.

Sikur në shumë vise të Perandorisë Osmane, ashtu edhe në trevat tona, deri me hartimit e mevludeve të lartpërmendura, mevludi është kënduar në gjuhën turke, ku shumica e njerëzve, sidomos në fshatra, përveç melodisë dhe zërit të bukur, nuk kuptonin asgjë. Lidhur me këtë tregohet se, derisa Tahir Efendia, me një rast, po fliste për afrimin e muajit të mevludit, nga të pranishmit një bashkëfshatar i kishte thënë:

VËSHTRIME

Hajrullah Hoxha

DISA FJALË PËR MEVLUDIN - si tekst dhe manifestim –

Fjala “mevlud” a “mevlid” do të thotë “lindje” dhe ka të bëjë me lindjen e të Dërguarit të fundit të Allahut të Madhërishëm, Muhamedit, bekimi dhe paqja qofshin mbi të.

Mevludi si tekst është një vepër artistike fetare, e radhitur në vargje, në të cilat janë përshkruar gjerësisht lindja, virtytet dhe meritat e Muhamedit a.s., me të cilat e dalloi Allahu xh.sh. dhe e bëri të pavdekshëm emrin dhe veprën e tij. Mevludi është një përmbledhje lëndatash kushtuar njeriut më të madh të të gjitha kohëve, Muhamedit a.s., të cilin Vetë Krijuesi i Gjithësisë e lavdëroi dhe i çmoi lart meritat e tij për njerëzimin, në shumë ajete kuranore:

“Me të vërtetë ti (Muhamed) je me moral të lartë”. (El-Kalem, 4).

“Ne ta kemi ngritur (lart) të përmendurit (emrin) tënd”. (El-Inshirah, 4).

“Ne nuk të kemi dërguar tjetër përveçse mëshirë për botët”. (El-Enbija, 107).

Vlerësimet e tilla të larta për Muhamedin a.s. në Kuran, dhe sje-lljet e veprimet e tij njerëzore, u bënë burim i pashtershëm frymëzimi i shumë njerëzve, të cilët shkruan vepra të çmueshme për jetën dhe

“çfarë hajri për ne, po shkojmë në Vushtri me ngu Mevludin në xhami, po kurgja nuk po e marrim vesh, se hoxhallarët po e kjojnë Mevludin turqisht”. Si duket, këto fjalë ndikuan në ndërgjegjen e Tahir Efendisë, saqë u premtoi se do të shkruante një mevlud shqip, që do ta kuptonin të gjithë dhe këtë premtim ai e përmbushi. Kjo nënkuptohet edhe nga ky rresht i Mevludit, në të cilin ai thotë:

“Për ata që gjuhën shqipe e dinë u maru ky mevlud gjithë le ta dinë”

Pas një pune më përkushtim të madh dhe me një mjeshtëri të rrallë artistike, ai e përfundoi me sukses këtë vepër të rëndësishme. Tahir Efendia, mevludin e tij e titulloi: “Mendhumetul-mevlud fi efdalil-mevxhud bilisanil-arnaud – Vargjet e mevludit për qenien më të vlefshme në gjuhën shqipe”. Mevludi i Tahir Efendisë, për mungesë të alfabetit shqip, u shtyp me shkronja arabe dhe u botua me lejen e Ministrisë së Çështjeve të Arsimit nr. 109, në Stamboll – pa vit botimi.

Përveç pjesës hyrëse, në të cilën autori flet për rëndësinë e mevludit, falënderon Allahun xh.sh. dhe i dërgon selam Pejgamberit a.s., teksti i mevludit për nga përmbajtja ndahet në tri pjesë: Në pjesën e parë autori flet për rëndësinë e përmendjes së Emrit të Allahut xh.sh., për ekzistimin e Tij të përherëshëm, për cilësitë e Tij, dhe vazhdon të tregojë për zanafillën e krijimit të gjithësisë nga nuri i Muhamedit a.s. dhe krijimit të njeriut të parë Ademit a.s.. Në pjesën e dytë flet për lindjen e Muhamedit a.s. dhe ngjarjet e jashtëzakonshme që kanë ndodhur para dhe pas lindjes së tij. Ndërsa në pjesën e tretë, e cila mund të quhet si shtojcë e mevludit, autori flet për disa muxhize-mrekulli të Muhamedit a.s. dhe për Miraxhin-ngritjen e tij në sferat më të larta të gjithësisë, për takimin e tij me Allahun dhe bisedën mes tyre. Mevludi zakonisht, përfundon me dua-lutje drejtuar Allahut të Madhërishtëm për ta pranuar dhe për falje të gabimeve.

Me qëllim të nxitjes së dashurisë ndaj Pejgamberit a.s. dhe të forcimit të shpresës tek njerëzit në mëshirën e Allahut xh.sh., si autorët e tjerë të mevludeve ashtu edhe Tahir Efendia, me rastin e lavdërimit të meritave të Pejgamberit a.s. dhe të bujarisë së Allahut xh.sh., përveç

burimeve të verifikuara islame, ka shfrytëzuar edhe burime të pavërfikuara, madje aty -këtu edhe mendimin e lirë të tij.

Në aspektin gjuhësor në shumë vende, autori ka përdorur fjalë orientale: arabe, turke ose persiane. Si shihet, disa prej tyre i ka shfrytëzuar për harmonizimin dhe rimën e vargjeve, kurse të tjerat për shkak se përdorshin në jetën e përditshme të asaj kohe si fjalë terminologjike fetaro-administrative.

Edhe pse, me vendimet e Kongresit të Manastirit në vitin 1908, mbi bazë të shkronjave latine, që zgjidhur çështja e alfabetit shqip, për shkak të ndalimit të përdorimit të tij në viset e mbetura nën okupimin sllav, mevludi edhe për një periudhë të gjatë nuk u shtyp me alfabet shqip. Mirëpo, tradita e këndimit të tij me alfabet arab në tubime të ndryshme vazhdoi dhe u bë pjesë e pandashme e jetës fetare në Kosovë e më gjerë.

Me qëllim që mevludi të mund të lexohet sidomos nga gjeneratat e reja tashmë të shkolluara, në vitin 1965 Shoqata Ilmije, me pëlqimin e Bashkësisë Islame, në Prishtinë e botoi mevludin për herë të parë me alfabet shqip. Komisioni bëri transkriptimin dhe e përgatiti Mevludin për shtyp, e spastroi atë nga fjalët e huaja duke zëvendësuar shumicën e tyre me fjalë e shprehje shqipe, madje bëri edhe ndryshime të disa fjalëve dhe vargjeve. Me botimin e Mevludit me alfabet shqip, fondit të literaturës fetare në gjuhën shqipe, që atëherë ishte i varfër, sepse ishin nbotuar vetëm Ilmihali i vogël dhe Mësime të shkurtra mbi namazin dhe Jasini, - iu shtua edhe një vepër, që për atë kohë kishte rëndësi të posaçme.

Në vitin 1984, Shoqata e Ylemave në Prishtinë, ribotoi Mevludin e Tahir Efendisë duke u bazuar në tekstin e tij me shkronja arabe. Transkriptimin dhe përgatitjen e tij për shtyp e bëri H. Sherif Ahmeti, i cili, me përjashtim të adaptimit të ndonjë fjale të caktuar, i qëndroi besnik origjinalit, kurse fjalët e huaja orientale i përktheu shqip (në fusnota në fund të çdo faqeje). Ky është ribotimi i tretë i Mevludit nga Bashkësia Islame e Kosovës, në të cilin fusnotat radhiten në fund sipas abecedes në formë fjalorthi.

Përveç ribotimeve të përmendura, Melvudi i Tahir Efendisë deri më tani është incizuar në disk gramafoni, në kasete kasetofoni dhe në kasetë video.

Kremtimi i mevludit

Mevludi si manifestim fetar që i kushtohet ditëlindjes së Muhamedit a.s., ka filluar në shekullin e katërt të Hixhretit, në kohën e sundimit të Dinastisë së Fatiminjve. Mënyrën e kremtimit të asaj kohe të ditëlindjes së Muhamedit a.s., më së miri e përshkruan Hafiz Es-Sehaviu me këto fjalë: “Pasuesit e Islamit në të gjitha krahinat dhe qytetet e mëdha e shënojnë kremtimin e mevludit të Muhamedit a.s. në muajin e lindjes së tij. Atë natë japin sadaka të shumta, gëzohen fytyrat e besimtarëve, këndohen salavate dhe bjerë bekim mbi ta”.

Ndërsa Ebu Shabe, i cili ka jetuar në kohën e sundimit të Muzaferruddin Kerkeberit, në veprën e tij “El-Bais” thotë: “Ndër gjërat më të bukura që janë bërë traditë në kohën tonë, bën pjesë ajo që veprohet për çdo vit në Erbil në ditën e lindjes së Muhamedit a.s. e ajo është se atë ditë njerëzit gëzohen dhe stolisen, ndihmojnë të varfrit dhe bëjnë vepra të tjera të mira. Kjo vepër, përveçse me të ndihmohen të varfrit, tregon se ai që e bën atë, e do dhe e respekton Pejgamberin a.s. dhe falënderon Allahun për dhuntinë më të madhe, që është se Ai në atë ditë e ka dhuruar të Dërguaritn e Tij të fundit, i cili është mëshirë për mbarë botën”.

Tradita e kremtimit të ditëlindjes së Muhamedit a.s. vazhdoi të praktikohet edhe gjatë periudhës së sundimit të Perandorisë Osmane dhe pas saj deri në ditët tona. Pas përhapjes së Islamit në Ballkan, edhe në trevat tona tradita në fjalë gradualisht filloi të praktikohet, dhe vazhdon edhe sot. Organizimin e manifestimit të mevludit në mënyrë zyrtare, zakonisht e bën Bashkësia Islame e vendit përkatës për çdo vit më 12 rebiul-evvel, në objektet fetare, kurse kohët e fundit edhe në ato publike. Në këto manifestime këndohen pjesë nga Kurani, mbahen ligjëratat rasti dhe këndohet mevludi. Në shenjë dashurie dhe respekti ndaj Pejgamberit a.s., gjithashtu Mevludi është traditë të këndohet në

shtëpitë e besimtarëve, me rastin e gazmendeve të ndryshme familjare. Kështu, përveç me rastin e ditëlindjes së Muhamedit a.s., zakonisht ai këndohet edhe me rastin e lindjes së ndonjë fëmije, synetisë, fejesës, martesës, diplomimit, punësimit, hyrjes në shtëpi ose banesë të re, shkuarjes ose kthimit prej Haxhit, me rastin e plotësimit të ndonjë dëshire të caktuar ose shpëtimit nga ndonjë fatkeqësi, madje edhe me rastin e përkujtimit të të vdekurit. Përveç këndimit të Mevludit dhe ndonjë pjese nga Kurani, në këto tubime jepen shpjegime për çështje të ndryshme fetare dhe këshilla edukativo-morale.

Traditën e këndimit të mevludit, si muhaxhirët e shpërngulur në Turqi e Arabi, ashtu edhe të shpërngulurit në Evropën Perëndimore dhe në ShBA e morën me vete si një kujtim të çmueshëm nga vendlindja. Madje pati raste që të kenë hartuar edhe mevlude të posaçme për bashkëkombësit e tyre në vendet ku jetonin, si p.sh. Hfz. Islam Çelebiu-Nekofci, i cili u shpërngul dhe vdiq në Siri në vitin 1929; z. Idriz Lamaj, i lindur në Shqipëri, që jeton në ShBA” etj.

Nga hartimi i Mevludit të Tahir Eefendisë ka kaluar më tepër se një shekull. Gjatë kësaj periudhe, përveç ndryshimeve të rrethanave shoqërore, janë bërë edhe ndryshime të mëdha si në aspektin gjuhësor ashtu në aspektin e botëkuptimit. Për këtë arsye, ka një kohë të gjatë që është paraqitur si nevojë e domosdoshme hartimi i një tekstit të mevludit, i cili do ta përfshinte jetën e Muhamedit a.s. në mënyrë më të gjithanshme dhe do t’u përgjigjej nevojave bashkëkohore, si nivelit intelektual të njerëzve ashtu rregullave të gjuhës letrare. Me këtë rast do theksuar se edhe programi i shënimit të Ditëlindjes së Muhamedit a.s. ka nevojë të modernizohet duke organizuar tribuna, seminare, simpoziume dhe akademi shkencore, kushtuar jetës dhe veprës madhështore të Muhamedit a.s. Një mënyrë e tillë bashkëkohore e organizimit tashmë ka filluar të praktikohet në Egjipt, Pakistan etj. dhe ajo duhet t’u shërbejë si shembull edhe vendeve të tjera myslimane.

Vlerësimet për mevludin

Meqë krenrimi apo këndimi i mevludit nuk është praktikuar në kohën e Pejgamberit as të shokëve të tij, dijetarët islamë kanë mendime dhe vlerësime të ndryshme për të. Mirëpo, që nga shekulli i shtatë i Hixhretit shumica e dijetarëve islamë janë të mendimit se Mevludi është i lejuar ose i preferuar (mustehabb). Ky qëndrim i tyre bazohet në faktin se mevludi, edhe pse është bid'at-risi, nuk është në kundërshtim me Kuranin as me Synetin (traditën e Pejgamberit) dhe se nuk është i dëmshëm po i dobishëm për çështje të fesë. Me këtë mendim nuk pajtohen vehabistët, përkatësisht selefijnjtë - që pretendojnë se ndjekin rrugën e myslimanëve të parë – sepse, sipas mendimit të tyre çdo bid'at – risi, në përgjithësi, në çështjet fetare - është i ndaluar.

Pasi që mevludi nuk është nga bidatet që kanë të bëjnë me çështje të imanit - besimit, as të ibadeteve – adhurimit, mendimi i këtyre të fundit është i paqëndrueshëm.

Përkitazi me rëndësinë e mevludit, një numër i madh i historianëve, shkrimtarëve dhe studiuesve të njohur kanë shprehur konsiderata dhe vlerësime të larta. Me këtë rast, po theksojmë vlerësimet e tri personaliteteve më të njohura islame shqiptare: Dijetari i mirënjohur, z. Vehbi Sylejman Gavoçi thotë:

“Shumë dijetarë janë shprehur se mevludi nuk është farz as synet, por është gjë e mirë, e dashur dhe e pëlqyer. Në një hadith tregohet një dialog në mes Profetit a.s. e një sahabi (shoku të tij):

“Pse agjëron ditën e hënë? Ajo është dita kur kam lindur”.

Me të vërtetë ai zotëri (a.s.) ka lindur ditën e hënë, është zgjedhur profet ditën e hënë, ka emigruar dhe ka ndërruar jetë ditën e hënë. Nga hadithi i sipërm shohim se ai Zotëri (a.s.) ka përmendur ditëlindjen e tij dhe na e ka bërë të ditur atë.

Para qindra vjetësh e deri më sot, ylematë në Hadith, Tefsir, Fikh etj. kanë festuar e festojnë ditëlindjen e Profetit (a.s.), ata kanë lexuar e shkruar për jetën e Profetit (a.s.) në disa faqe të zgjedhura, kanë lavdëruar cilësitë e tij, siç ka lavdëruar Hasani para vetë Profetit (a.s.),

kanë rënë salavate mbi Pejgamberin (a.s.) qindra herë, pastaj dikush ka shtruar sofrë, disa kanë bërë gostira prej gëzimit”.

Studiuesi i njohur dhe i përmendur H. Sherif Ahmeti për mevludin shprehet kështu: “Çdo punë që i sjell të mira bashkësisë e nuk është kundër ndonjë dispozite të fesë, Islami nuk e ndalon atë. Qëllimi Islam, fillim e mbarim është për të mirën dhe interesin e njerëzisë. Pra aty ku është dobia, aty është sheriat i Zotit. Ndërsa baza, motivi në manifestimin dhe përkujtimin e ditëlindjes është respekt i traditës së personit të ditëlindjes, është përfitim nga sjelljet dhe vetitë e tij të bukura, madje është tubimi i bashkimit dhe afrimit të njerëzve. i ndihmës dhe bamirësisë reciproke, ndërmjet njerëzve, është kthesë në të përkujtuar dhe përmendur më shumë Zotin xh.sh. duke dëgjuar pjesë të leximit nga Kurani dhe këshilla të larta nga hadithi. Të gjitha këto janë mirënjohje dhe falënderim ndaj Zotit, i cili u dhuroi atë të cilit i përkujtojmë ditëlindjen, dhuroi të mira në fe dhe në dynja. Padyshim, një përkujtim i këtillë është i dobishëm dhe i frytshëm”.

Personaliteti i shquar islam shqiptar Imam Vehbi Ismaili, në parathënien e mevludit të Idriz Lamajt, midis të tjerash, thotë: “Të gjithë kombet e popujt e ndryshëm sipas rasti e vendit, festojnë ditëlindjen e njerëzve të tyre në zë, të dalluar për vepra trimërie, bamirësie, letrare filozofike e shkencore duke u shërbyer jo vetëm kombeve përkatës por edhe mbarë njerëzisë. Këta njerëz të mëdhenj, jo veç u kanë sjellë dobi e përfitim popujve të ndryshëm, por bëhen më vonë shembuj për brezat e ardhshëm për të shkelë ndër gjurmët e këtyre. Në këtë kategori hyjnë edhe festimet historike si p.sh. Shpallja e indipendencës, hyrja në fuqi e një sistemit qeveritar mbretëror apo republikan, dita e nënshkrimit të një armëpushimi ose paqeje, porse janë veprime që zhvillohen vetëm brenda një kufiri të ngushtë gjeografik. Ato u përkasin vetëm atyre kombeve që kanë të bëjnë me to, pa shkaktuar pjesëmarrje nga kombet e tjerë.

Po në qoftë se ka ndonjë ngjarje, e cila mund të shkaktojë me të vërtetë gëzim dhe pjesëmarrje të përbotshme, ajo është padyshim lindja e Profetit të shenjtë Muhamedit. Ai i pruri mbarë botës mesazhin e paqes dhe të harmonisë në atë kohë kur ajo botë kishte nevojë më të

madhe për të. Ai ngriti një komb nga pluhuri i mbeturisë (të qenit “xhahil”) në kulmin e qytetësisë, atij kombi i cili i dha dritën e dijenisë dhe kulturës drejt Evropës dhe anëve të dheut në kohë të errëta të Mesjetës dhe pruri një rilindje morale, shoqërore e politike të çuditshëm”. (Më gjerësisht shih: F. Luli, I Dizdari, Mevludet në gjuhën shqipe, Shkodër, 2002)

Gjatë këndimit të Mevludit përmenden Emri dhe Atributet e Allahut xh.sh., përkujtohet Muhamedi a.s. dhe mrekullitë e tij, këndohet Kuran, bihet salavate mbi Pejgamberin a.s., dhe bëhet dua duke kërkuar nga Allahu i Madhërishëm falje, mëshirë dhe mirësi, - vepra nga të cilat pjesëmarrësit ndiejnë kënaqësi shpirtërore dhe kanë sevap. Këndimi i mevludit në një familje myslamiane është një dëshmi dhe manifestim i dashurisë dhe respektit që ka ndaj të Dërguarit të Allahut xh. sh. Dhe kjo ndikon pozitivisht në edukimin fetar të anëtarëve të familjes përkatëse.

Mevludi shërben edhe si mjet: për kultivimin e respektit dhe të dashurisë ndaj Allahut xh.sh., e të Dërguarit të Tij dhe të fesë islame në përgjithësi, për forcimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe fa-refisnore, për njojen e të pranishmëve me rregullat dhe parimet themelore të Islamit, dhe për kultivimin e ndjenjave njerëzore dhe ngritjen e vetëdijes së tyre fetare, kombëtare dhe atdhetare.

Në fund, edhe vetë tradita e shënimit të ditëlindjes së Muhamedit a.s. dhe e këndimit të mevludit, e cila është përcjellë prej gjenerate në gjenerate shekuj me radhë dhe praktikohet edhe sot nga myslimanët e gati mbarë botës, është një argument i mjaftueshëm që dëshmon për vlerën dhe rëndësinë e madhe që ka mevludi.

Recensione

FJALA E RASTIT E PROF. DR. AGIM ZOGAJT NË PËRURIMIN E LIBRIT, “LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT NË SHTYPIN EGJIPTIAN” (1878-1881)

i autorit, Mr. Qemajl Morina (Prishtinë, 10 qershor 2007)

Të nderuar të pranishëm,

I nderuar autor,

Sa herë që shkruajmë për historinë tonë kombëtare, pra edhe në mënyrën e shkrimit të librit të cilin e përurojmë sot, ne nuk i kthehemi të kaluarës sonë vetëm për të larë ndonjë borxh të kujtesës historike, as madje vetëm për të ndriçuar çaste të asaj historie të lavdishme, sa aq edhe të dhembshme. Kthimin në histori, gjithnjë përmes letrave shqipe e bëjmë edhe për të nxjerrë mësim nga e kaluara jonë, e ngritur mbi sukseset, pësimet, ngritjet, por jo rrallë edhe dështimet. Kthimi në të kaluarën tonë kombëtare, pra edhe përmes

monografisë me titull, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në shtypin egjiptian” (1878 -1881) na shërben, pra edhe në këto çaste vendimtare për Kosovën dhe mbarë kombin shqiptar për të analizuar drejt, pa iluzione dhe objektivisht rrugëtimin tonë 129-vjeçare të kombit, për të parë me qasje kritike se ku ishim dje, ku jemi sot dhe kah po shkojmë në këtë fillimshkull të XXI. Ndaj, botimi i monografisë së sipërcituar, në vigjilje të 130-vjetorit të madh të shënimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, veç tjerash e ka kuptimin dhe domethënien edhe të ndërgjegjësimit tonë intelektual për t’i hedhur një shikim të ri rrugës sonë kombëtare

nga viti 1878 dhe deri më sot, për të nxjerrë mësim dhe për të gjetur rrugët e realizimit të idealit të ideologëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të rilindësve tanë.

Fjala është pra, për ngjarjen më kulmore të kombit tonë, e ngritur në shekullin e XIX. Është fjala për organizatën e parë politike dhe ushtarake mbarëshqiptare, e cila organizoi luftën e armatosur çlirimtare për çlirimin e tokave shqiptare, të hapësirës etnike shqiptare, ngjarje ajo më e madhja që nga epoka e Skënderbeut. Lë të rikujtojmë se, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, u thirr, u organizua, u mbajt pas Kongresit të Shën Stefanit (03.03.1878) dhe në prag të Kongresit të Berlinit (13.06.-13.07.1878), ngjarje ato ndërkombëtare që ishin shumëfish të dëmshme për interesin dhe aspiratat e kombit tonë. Lidhja Shqiptare e Prizrenit, pra ishte zë i bashkuar i popullit tonë, i cili para kancelarive të Europës së Vjetër protestonte ndaj padrejtësive që na bëheshin si komb, duke u ndarë tokat shqiptare fqinjëve tanë të cilët, ishin vërsulur pamëshirshëm mbi trojet tona etnike.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, organizimi i saj politik, kombëtar dhe ai ushtarak e diplomatik nxiti jehonë të konsiderueshme edhe në nivelin ndërkombëtar, pra edhe në shtypin e kohës.

Në këtë aspekt, autori i referohet shtypit egjiptian, për të cilin shkruan se, për shqiptarët kishte një njohuri që nga historia e Ali Pashë Tepelenës. Duke iu referuar botimit të protestave të shqiptarëve, në shtypin egjiptian, autori i studimit vjen në përfundim se, shtypi egjiptian, para publikut të Egjiptit dhe përgjithësisht të botës arabe e kishte paraqitur Lidhjen Shqiptare të Prizrenit si krijesë autentike të popullit shqiptar dhe jo si rezultat i diplomacisë së Turqisë.

Duke lexuar studimin e prof. Morinës, konkretisht përmbajtjet e shumë memorandumëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit drejtuar kancelarive të Europës së vjetër, del në pah roli i veçantë që Rusia cariste kishte luajtur në copëtimin, grabitjen dhe dhënien e territoreve shqiptare shteteve sllave, si Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Bullgarisë. Në raportin e lordit Lajadar, ambasador i Britanisë së Madhe në Stamboll, botuar në numrin 766 të datës 23 qershor 1878 të gazetës “el-Vakia”, e cila i referohej gazetës “Kosova” shkruan se: “...banorët e këtyre krahinave... janë tepër të revoltuar për lëshimin e një pjese të tokave të tyre nën sundimin bullgar me ndihmën e Rusisë...Bullgarët, injorantë nuk janë në gjendje të përdorin armët, por fshihen pas tyre 100.000 ushtarë rusë”. Por, edhe gazeta tjetër

egjiptiane, “Vakai Misrije”, numër 848, të datës 17 shkurt 1878 njoftonte se “...Qeveria serbe lakmon të pushtojë tokat e prefekturës së Nishit, Jeni Pazarit, Prizrenit etj...”. Pra, botimi të cilin e kemi para vetes, gjithnjë përmes shtypit egjiptian të kohës, na sjell në mendje, të vërtetën historike, për rolin e Rosisë, Serbisë, Malit të Zi, Greqisë, Bullgarisë, 129 vjet më parë në copëtimin dhe pushtimin e hapësirave jetike shqiptare. Kjo e vërtetë historike, të cilën më në fund duhet pranuar se në fushën e studimeve shkencore, jo vetëm nga rrafshi i historiografisë nuk e kemi hulumtuar sa dhe si duhet, do të duhej të na ndërjegjësonte për rreziqet që, edhe sot 129 pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit i kanosen popullit shqiptar, trojeve tona etnike. Dje ishin Toplica, Vranja, Leskovci, Jeni Pazari, Ulqini, Shpuza, Gucia e Plava, sot rrezikon të jetë Mitrovica!

Gazeta tjetër egjiptiane, “el-Ahram” në numrin e saj 144, të datës 24 prill 1879, duke botuar një notë diplomatike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit citon pjesë të memorandumit në të cilin thuhej: “... Ata refuzojnë kategorikisht, që Greqia të ketë të drejtë në tokat shqiptare... Nëse Porta e Lartë dëshiron t’i japë Greqisë një pjesë të tokave tona, Janinën, Artën, Prevezën,... atëherë ne jemi në gjendje të bëhemi fli për atdheun...”.

Edhe në vitin 1878, 1879, 1880, 1881 dhe, edhe sot më 2007 ne vazhdojmë t’i drejtohem jo vetëm Amerikës mike, jo vetëm Ligës Arabe, por edhe Europës, e cila në rastin e tashëm të Kosovës, gjithnjë në kontekst të kundërshtimeve ruse për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, nuk po dëshmon vendosmëri të duhur.

Shtypi egjiptian, duke shkruar për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit në fakt, ndihmonte në ngritjen e çështjes shqiptare para diplomacisë së atëherëshme ndërkombëtare. Shtypi madje, shkruante se, “... nëse kryengritjes shqiptare nuk i pritët hovi, atëherë vendimet e traktatit të Berlinit do të jenë të pavlerë...”. Por, Europa e vjetër në vitin 1879 nuk e analizonte proklamatin e Princ Nikollës, malazez drejtuar shqiptarëve të pushtuar të Podgoricës, Shpuzës, Zhablakut, në të cilën thoshte :” Askush s’e mohon se këtë bashkim e kam blerë me gjakun e popullit tim dhe pëlqimin e Europës”!

A thua, 129 vjet pas këtyre zhvillimeve nëpër të cilat sot po kalon Kosova dhe mbarë kombi shqiptar, çfarë do të lexojnë brezat shqiptarë në shtypin egjiptian dhe përgjithësisht atë arab, pse jo edhe atë european, për vendimet e KS të OKB-së për caktimin e statusit përfundimtar të Kosovës, për kundërshtimin dhe ndoshta edhe veton ruse, për

kërcënimet e hapura edhe me luftë të Serbisë, për pavendosmërinë e diplomacisë europiane që sërish, ta mbajë anën e të drejtës në rastin e Procesit Kosova? Por, pse të mos pyesim edhe sot në 129-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit se përse, shqiptarët si në Tiranë, Prishtinë e Tetovë janë gjithnjë e më larg idealeve fundamentale kombëtare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, përse propagandohet kaq zhurmshëm dhe

paturpësisht teoria antishqiptare për “kombin kosovar”. Përgjegjësinë për këto projekte antikombëtare nuk i mbajnë vetëm grupe të caktuara të elitave “intelektuale” në Shqipëri dhe në Kosovë, por edhe udhëheqjet politike brenda kombit tonë.

Prandaj, sot dhe nesër ideal i çdo shqiptari kudo që është dhe kudo që do të jetë mbetet: Një gjuhë, një histori, një flamur, një shpirt, një komb, një Atdhe!

KRONIKË KULTURORE

Ramadan Shkodra

U MBAJT TRYEZA SHKENCORE: “MESAZHET E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT NË RAPORT ME REALITETIN SHQIPTAR SOT”

Në kuadër të shënimit të 129 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kryesia e BI të Kosovës më 12 qershor 2007, në Prizren ka mbajtur Tryezën shkencore "Mesazhet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në raport me realitetin shqiptar sot", në të cilën me kontribute u paraqiten studiues të fushave të ndryshme nga Kosova e Shqipëria, të cilët sollën të dhëna të reja për Lidhjen e Prizrenit si dhe për personalitetet kryesore të Lidhjes që lanë emër të paharruar në historinë e populli shqiptarë.

Në kuadër të Tryezës, u lexuan 17 kumtesa shkencore nga historiane që kishin ardhur nga vende të ndryshme

të Kosovës e Shqipërisë, si dhe një himnizim nga poeti ynë i njohur Enver Gjerqeku të cilët në dy seanca paraqitën rezultatet më të reja kushtuar LSHP nga këndvështrime të ndryshme duke ndriçuar kështu edhe disa segmente deri tash të panjohura për Kuvendin e LSHP-së.

Pas fjalës përshëndetëse që e mbajti Myftiu i Kosovës Mr. Naim Tërnavi i cili i përgëzoi studiuesit për punën e tyre u shprehu përkrahje në misionin e tyre, duke u premtuar se edhe në të ardhmen BI do të organizojë e do të mbështes aktivitetet shkencore e kulturore.

Seanca e paradites u hap me kumtesën e Dr. Pajazit Nushit: "Lidhja Shqiptare e Prizrenit pas 129 viteve" i cili në fillim të kumtesës së tij duke folur për ndikimin e kësaj ngjarjeje të rëndësishme për historiografinë tonë tha: "Realiteti shqiptar 129 vjet pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është një temë, e cila ka të bëjë në rend të parë me zhvillimin e mendimit politik. Në kuadrin e zhvillimit të mendimit politik shqiptar në relacionin kohor prej vitit 1878 deri në vitin 2007 me të drejtë parashtrohet pyetja: "çfarë janë raportet ndërmjet mesazheve të LSHP dhe realitetit shqiptar sot"? Natyrisht, harku kohor prej 129 vjetësh është i largët dhe përgjigja në këtë pyetje nuk do mund të gjendej sikur t'i bëjmë vështrim kronologjik zhvillimeve politike, ekonomike, sociale, kulturore e psikologjike të shqiptarëve, sepse shqiptarët gjatë gjithë kësaj kohe kanë krijuar historinë e kombit të tyre dhe realiteti i tyre sot është produkt i historisë së ndërlukuar kombëtare dhe ndërkombëtare. Por, edhe ky produkt i vënë në pozicion të rëndë dhe pak të çuditshëm edhe gjurmuesit e zhvillimit të mendimit politik e historik të shqiptarëve gjatë kësaj kohe prej 129 vjetësh. Në këtë vazhdë të mendimit edhe autori i këtyre rreshtave, sikur edhe gjurmuesit e tjerë, u gjend ndërmjet të vdekurve, të cilët para më shumë se një shekull kishin përpiluar

historinë e LSHP dhe kishin lënë për pasardhësit mendime, qëndrime dhe vizione të gjalla dhe të gjallëve, të cilët edhe pas kaq shumë kohësh nuk kishin arritur që të realizojnë plotësisht mesazhin për pavarësi politike të kombit shqiptar, për të drejtën e tij për të jetuar dhe zhvilluar në shtetin e vet dhe për emancipim kulturor të shqiptarëve në kuadrin e shtetit të përbashkët të tyre. Këto tri mesazhe kryesore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit edhe sot e kanë ruajtur aktualitetin e tyre. Prandaj, sa i largët është viti 1878 i LSHP, aq i afërt është vështrimi i raportit ndërmjet mesazheve të kësaj organizate politike e ushtarake të parë të shqiptarëve dhe përpjekjeve e luftërave të shqiptarëve për të drejtën e tyre për pavarësi politike, për zhvillim të pavarur dhe sovran dhe për emancipim kulturor të përgjithshëm dhe kombëtar".

Ndërsa historiani i njohur nga Tirana, dr. Gazmen Shpuza u paraqit me kumtesën "Përmasat historike të LSHP" ndër të tjerat në fillim të kumtës së tij veçoi:

"Tema e Tryezës "Mesazhet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në raport me realitetin shqiptar sot" është mjaft e qëlluar për vetë momentet vendimtare që po kalon çështja jonë kombëtare. Për t'u lexuar në të gjithë thellësinë dhe gjerësinë e vet kumtet që na vinë nga vitet 1878-1881 duhet të kemi një

përfytyrim të plotë rreth përmasave të Lidhjes së Prizrenit në rrafsh gjeografik, në rrafsh ideor dhe në rrafsh shoqëror, duke filluar nga ditët e para të Kuvendit të Prizrenit dhe nga qëndrimet politike të pjesëmarrësve që në vendimet më të para të miratuara në të. Në studimet tona këto përmasa deri më tani jepen jo pak të cunguara. Për t'u bindur lidhur me këtë fakt mjafton t'u drejtohem vendimeve, që u morrën në Kuvend, vendime të injoruar deri vonë dhe tash së fundi të kaluara kalimthi. Ndihmesën që ka dhënë Kosova në zhvillimin e këtyre ngjarjeve ata e ngushtojnë vetëm në kontributin e banorëve të këtyre trevave veçse në rrafsh luftarak. Ndërsa për rolin e intelektualëve islamë, kryesisht, klerikë, as që bëhet fjalë.

Vënia në qarkullim këto ditë në mënyrë të përmbledhur e burimeve egjiptiane na mundëson të zbulojmë dhe të vejmë në pah dhe një përmasë tjetër të Lidhjes së Prizrenit, të pavërejtur deri më tash: Jehonën e saj në botën arabe, ndikimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Perandorinë Osmane dhe më gjerë. Besohet se mund të pranohet pa e tepruar, që nacionalizmi shqiptar ka luajtur aso kohe një rol pararojë në ato anë.

Delegatët e Kosovës kishin ardhur në Prizren, më 10 qershor 1878, të merrnin pjesë në tubimin e organizuar jo për hir të interesave të veçanta dhe

lokaliste, por, ashtu sikurse nenvizion autori i librit "Shqiptarët në historinë osmane)" Sulejman Kylçe, "për mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë".

Kuvendarët, edhe pse përfaqësues vetëm të një pjese të viseve shqiptare, kryesisht të atyre verilindore arriten, siç dëshmojnë vendimet që u morrën në Prizren që në ditët e para, në të njëjtin mendim për formimin e një organizate kombëtare të njësuar mbarrëshqiptare, për krijimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" - tha dr. Gazmend Shuza.

Në seancën e paraditës referuan edhe: Akad. Jashar Rexhepagiq "Vlerat pedagogjike të LSHP-së", dr. Masar Rizvanolli - "LSHP dhe politika serbe ndaj saj", dr. Muhamet Mufaku - "Figura e Ismail Qemajlit në shtypin egjiptian 1878-1912", Nehat Krasniqit "Të dhëna të reja për Ymer Prizrenin".

Ndërsa në seancën e pasdites u paraqitën Prof. dr. Muhamet Pirraku "Roli i myderriz Jusuf efendi Podgoricës në afirmimin e çështjes shqiptare në periudhën e LSHP-së", Mexhid Yvejsi "Roli i Ulemave në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-1881)", Olsi Jazexhiu "Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe politika panislamiste e Sulltan Abdylhamidit II", Nexhat S. Ibrahim "Dimensioni poliform i Lidhjes së Prizrenit më 1878", Parim Kosova "Objektet fetare islame në shërbim të Lidhjes Shqiptare të

Prizrenit", dr. Jusuf Osmani "Dokumentet arkivore për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit", Adrian Muhaj: "Autonomia e territoreve shqiptare në kontekstin ballkanik", Mr. Menduh Bamja "Pozita e myslimanëve në Serbi, Mal të Zi dhe në Bosnje dhe Hercegovinë pas Kongresit të Berlinit (1878)", Dr. Riza Sadiku "Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në shtypin e mërgatës shqi-

ptare", Mr. Qemajl Morina: Faktori fe në kohën LSHP dhe sot.

Pas leximit të kumtesave u zhvillua një debat i frytshëm për përmasat dhe refleksione e LSHP-së, në të cilin morën pjesë 12 pjesëmarrës.

Tryeza u mbajt në selinë e Këshillit të BI në Prizren, ndërsa organizatori premtoi botimin e shpejt të materialeve.

Në xhaminë “Gazi Memhet Pasha” u zbulua Pllakë përkujtimora kushtuar Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Me rastin e përvjetorit të 129 të mbajtës së Lidhjes së Prizrenit në një solemnitë më 12 qershor 2007 ku qen të pranishëm studiues, historianë e të ftuar enkas për këtë solemnitë, ku qe i pranishëm edhe Myftiu i Kosovës Mr. Naim Tërnavë, në murin e jashtëm të xhamisë “Gazi Mehmet Pasha” (Bajrakli) në Prizren u zbulua Pllaka përkujtimore me të cilën përkujtohej mbajtja e Kuvendit të Lidhjes së Prizrenit në këtë xhami.

Fjala e Myftiut të Kosovës me rastin e zbulimit të Pllakës përkujtimore kushtuar Lidhjes së Prizrenit në murin e xhamisë “Gazi Mehmet Pasha” në Prizren

Pllaka për gjeneratat e reja që mos të harrojnë vendin ku u mbajt Lidhja Shqiptare e Prizrenit

Të nderuar pjesëmarrës

Të nderuar zonja dhe zotërinj

Pikërisht ky vend i bekuar tash e 129 vjet më parë kishte tubuar burrat më të shquar e kokat me të ngritura e të ditura të kombit tanë nga të gjitha trojet shqiptare për të ngritur zërin e tyre dhe për t’i bërë me dije botës mbarë se shqiptarët nuk do të pranojnë asnjëherë marrëveshje të kujtdo qofshin ato që çon në copëtimin e trojeve

Në tekstin e pllakës përkujtimore shkruan:

“Në këtë xhami është mbajtur Kuvendi i Lidhjes së Prizrenit më 10 qershor 1878”

Ky tekst pos që është shënuar në shqip është shënuar edhe në anglisht, serbisht (boshnjakisht) e turqisht.

Me këtë rast myftiu i Kosovës mbajti një fjalë rasti

shqiptare, marrjen me dhunë të tyre, duke ju bërë me dije të gjithëve se shqiptarët meritojnë lirinë brenda trojeve të tyre.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, kuvendi i së cilës u mbajt këtu në këtë vend të shenjtë, në këtë shtëpi të Zotit, në Prizrenin e lashtë, shënon një kthesë thelbësore në shpirtin e popullit shqiptar.

Jehona e lidhjes shqiptare të Prizrenit frymëzoi e fuqizoi shpirtat dhe ndjenjën kudo ndër shqiptarët, e kjo ndjenjë në vazhdimësi vinte duke u rritur dhe kalitur tek brezat e rinjtë për atdhedashuri dhe ruajtjen e trojeve tona.

Ndaj, ne me plotë respekt e mirënjohje nderojmë veprën madhore të gjyshërve tanë, të cilët në rrethana jashtëzakonisht të vështira dhe të disfavorshme për ta, të organizuar në LSHP ngritën zërin për të kërkuar njohjen e të drejtave të kombit shqiptar dhe luftuan me armë në dorë, duke sakrifikuar gjithçka për t’i mbrojtur ato të drejta.

Jemi tubuar sot këtu, për të kujtuar edhe njëherë porositë, mesazhet që lanë emanet këta burra nga më të mëdhenjtë e kombit tanë, për të reflektuar pikërisht këtu se amanetin e tyre do ta çojmë në vend. Se trojet shqiptare duhet mbrojtur nga copëtimet, se ato duhet të frymojnë si një trup se duhet udhëhequr nga shqiptarët, se duhet mobilizuar që të gjithë në mbrojtje të atdheut, trojeve tona etnike, synim ky i të gjithë delegatëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Si përfaqësuese të gjithë kombit, Lidhja Shqiptare e Prizrenit ngriti si asnjëherë më parë e në mënyrë të organizuar çështjen shqiptare në arenën ndërkombëtare dhe i detyroi fuqitë evropiane që të merrnin parasysh ekzi-

stencën dhe të drejtat e këtij kombi në një kohë kur këto fuqi ua mohonin krejtësisht këto të drejta. Kjo lidhje bëri që çështja shqiptare të zinte vend në rendin e ditës së faktorëve ndërkombëtarë si një nga çështjet që kërkon zgjidhje.

Ani pse këto të drejta nuk u morën tërësisht parasysh nga faktori ndërkombëtar, megjithatë, jemi thellë të bindur se tashmë e 129 vjet nga mbajtja e Lidhjes së Prizrenit, shqiptarët, përkundër zvarritjeve, dhe sakrificave të shumta jemi më shumë se asnjëherë më parë në prag të realizimit të disa nga aspiratat e LSHP.

Sot kur faktori ndërkombëtar po i kushton një rëndësi të veçantë faktorit shqiptar në rajonin e Ballkanit duke e kuptuar edhe pse me vonësë se pa zgjidhjen e problemit të shqiptarëve kurrë nuk do të ketë qetësi në këtë rajon edhe ashtu të trazuar, sikur padrejtësitë e shumta kanë filluar të marrin kahe tjetër dhe ky popull i përvuajtur të shijoj lirinë.

Pikërisht gjatë këtij muaji po shpresojmë që Këshilli i Sigurimit i OKB-së të nxjerrë një rezolutë e cila do të konfirmon të drejtat e shqiptarëve të Kosovës për shtetësinë e tyre dhe se Kosova në një të ardhme të afërt do të bëhet anëtare e Evropës së bashkuar.

Këtë më tepër e fuqizon edhe deklarata e presidentit Bush para dy di-

tësh gjatë vizitës që i bëri Shqipërisë, se e vetmja zgjidhje për Kosovën është pavarësia e Kosovës, e ne duhet patur bindjen se me zgjidhjen e problemit të Kosovës në të ardhmen në mënyrë graduale të zgjidhen edhe problemet e tjera që kanë të bëjnë me shqiptarët në këtë rajon.

Edhe pse sistemi komunisto-ateist në shumë raste shtrembëroi fakte historike dhe luftërat e të parëve tanë, ata shtrembëruan-ndërruan edhe vendin se ku u mbajt LSHP-ja.

Ndaj me qëllim të informimit të drejtë të gjeneratave të reja që ato të mos harrojnë vendin ku u mbajt Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe ata të ndiejnë peshën dhe rëndësinë e saj e të prekin vendin ku dekada më parë qenë ulur ata burra të shquar të kombit shqiptar, kemi venë një mbishkrim të cilin sot po e zbulojmë, dhe i cili flet

mbi realitetin se LSHP që u mbajt mu në këtë vend .

Shpresojmë se duke lexuar këtë mbishkrim në këtë vend, do të rikujtojmë, dhe do të jetojmë për disa qaste me burrat e pavdekshëm, duke ndier emocione të veçanta me kuvendarët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me myderriz haxhi Ymer Prizrenin në krye dhe me porositë dhe mesazhet e këtyre kuvendarëve..

Duke ju dëshiruar punë të mbarë në emër te Kyesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës ju falënderoj për prezencën tuaj.

Ju faleminderit!

Prizren 12 qershor 2007
Myftiu i Kosovës
Mr. Naim Tërnavë

U promovua libri “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në shtypin egjiptian (1878 – 1881)” e studjuesit të njohur mr. Qemajl Morina

Libër i rëndësishëm për studiuesit e historisë për LSHP

Në vigjilje të 129-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 11 qershor 2007 në Prishtinë, në ambientet e BKUK-së, Mr. Qemajl Morina ka përruar librin “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në shtypin egjiptian 1878-1881”, i cili njëherësh paraqet punën studimore të këtij studiuesi të vyer në arkivat e Egjiptit.

Libri i përruar është vlerësuar lart nga referuesit dr. Muhamet Mufaku (Jordani), dr. Agim Zogaj dhe dr. Feti Mehdiu, të cilët kanë porositur studiuesit e historisë që të hulumtojnë edhe më shumë në arkivat e Egjiptit, sepse atje ka shumë materiale që flasin për shqiptarët dhe historinë e tyre.

Të pranishmit, në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, e cila është edhe botuese e këtij libri, i përshëndeti myftiu i Kosovës, Mr. Naim Tërnavë, i cili tha se botimi i këtij libri nga Sh.B. “Dituria Islame”, lexuesit shqiptar i ofron informacione të konsiderueshme për jehonën e Lidhjes së Prizrenit në Botën Arabe në përgjithësi si dhe në Egjipt, në veçanti.

“Dihet se Lidhja Shqiptare e Prizrenit për herë të parë në historinë tonë

arriti t’i mobilizonte në mënyrë institucionale energjitë e shqiptarëve dhe t’i orientonte drejt programit madhor të Rilindjes Kombëtare dhe afirmimit të kombit shqiptar në arenën ndërkombëtare dhe për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe formimin e shtetit shqiptar” - tha myftiu Tërnavë, sipas të cilit Lidhja Shqiptare e Prizrenit vazhdon të jetë aktuale edhe sot, kurse nga aspekti politik, sot jemi më afër se asnjëherë më parë për të realizuar disa nga aspiratat e lidhjes për pavarësinë e vendit tonë të shtrenjtë. Tërnavë tha se autori i librit ka qëndruar në Egjipt për disa vjet dhe me përkushtim të madh është angazhuar duke shfletuar me qindra e mijëra faqe shtypi dhe të tubuara e të sistematizuara t’ia sjellë lexuesit. Veprën e bëjnë edhe më komplete faksimilet origjinale të artikujve dhe kronikave të botuara në shtypin egjiptian, të cilat vetëm sa ia shtojnë vlerën kësaj vepre.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit – kthesë e madhe në arenën botërore

Ishin mjaft domethënëse fjalët e dr. Muhamet Mufakut, i cili ka bërë një punë kolosale në hulumtimin e dokumenteve dhe arkivave në Botën Arabe. Mufaku me këtë rast ka rikujtuar momente të njohjes e të punës me Mr. Qemajl Morinën që në vitin 1979, kohë kur ai pati shkuar atje për të gjurmuar në arkivin e shtypit egjiptian në lidhje me disertacionin për lidhjet shqiptare. Mufaku rikujtoi se pas këtij gjurmimi, ishte kthyer në Kosovë, kurse Mr. Qemajli kishte vazhduar edhe më tej hulumtimet duke u përqendruar në hulumtimet e shtypit egjiptian për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. “Në të vërtetë, e dimë se ka shumë shqiptarë që kanë shkuar për studime në Botën Arabe, ka edhe të atillë që i kanë kryer studimet atje, por shumë pak, ndoshta numërohen me gishta ata që janë marrë me shkencë. Vërtet autori Qemajl Morina është prej atyre që kanë vazhduar të merren edhe me studime si dhe kontributet e tij studimore në lidhje me shqiptarët e Egjiptit” - tha dr. Mufaku, duke e vlerësuar lartë librin dhe punën e Mr. Morinës.

Sipas tij, libri ka një vlerë, sepse paraqet rëndësinë e Lidhjes së Prizrenit për paraqitjen e çështjes shqiptare në Botën Arabe dhe arenën botërore. “Me Lidhjen e Prizrenit kemi një

kthesë të madhe në skenën botërore, sepse me këtë paraqitje të fuqishme të popullit shqiptar në këtë program të ri kombëtar dhe politik, shqiptarët kanë artikulluar çështjen e tyre në skenën botërore” - potencoi dr. Mufaku duke spikatur lajmet e shumta për jehonën e kësaj lidhjeje në shtyp.

Paraqitja e Lidhjes së Prizrenit në shtypin egjiptian ka një rëndësi të veçantë, sepse me shpalljen e programit kombëtar për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare, kemi njëfarë ndikimi në vetëdijen vendase, sepse arabët u distancuan më vonë në krahasim me shqiptarët. Ata janë paraqitur me kërkesat e tyre kombëtare më vonë, do të ishte një paralele shumë interesante, nëse krahasohet programi i lidhjes shqiptare me ato të arabëve, të cilat janë paraqitur 20 vjet më vonë, për lëvizjen e re arabe në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX. Shtypi egjiptian është interesuar edhe për figura të tjera të popullit tonë, për lëvizjen shqiptare për pavarësi”, - theksoi ndër të tjera Dr. Muhamet Mufaku.

Shqiptarët faktor qeverisjeje në Egjipt në fillim të shekullit XIX

Kurse referuesi Dr. Feti Mehdiu tha se Mr. Qemajl Morina, qysh në vitin 1978 i dha sinjal publikut shqiptar se në Egjipt fshihej një lëndë me interes për historinë shqiptare, kurse tash pas tri dekadash, me

përkrahjen e BI vjen para publikut shkencor e kulturor shqiptar me një vepër të rrallë: “Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881”. Kjo vonesë ka ndodhur si me porosi. Rastisi të realizohet në një moment kyç për Kosovën. Në këtë vepër hulumtuesit e historisë kombëtare gjejnë një pasqyrë të shkurtër se si është reflektuar një ngjarje shumë e madhe në një vend shumë të largët gjeografikisht për shqiptarët, por të afërt për shumë aspekte të tjera. “Këtu vetëm do të theksoj një fakt nga i cili del edhe një pyetje: Shqiptarët qysh në fillim të shekullit 19 u bënë faktor në qeverisjen e Egjiptit. Në kohën e tyre fillon shtypi i përditshëm në gjuhën arabe, në Egjipt - pikërisht në Aleksandri, dhe tash hulumtuesve tanë u mbetet të përgjigjen, a thua në ato gazeta mos ka vepruar, në prapavijë ndonjë Sami Frashër, sikur kishte ndodhur me gazetën e Stambollit Terxhuman – shark dhe Terxhuman-i hakikat” - tha dr. Mehdiu. Sipas tij. Vepra e Mr. Qemajl Morinës “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në shtypin egjiptian 1878-1881” është vepër e rrallë, një sihariq për studiuesit e historisë, sidomos për historianët e periudhës së gjysmës së dytë të shekullit 19, dhe jo vetëm për historianët.

Dr. Mehdiu në fund të fjalës së tij tha se kjo vepër mund dhe duhet t'u shërbejë edhe qarqeve diplomatike shqiptare – sidomos sot kur në qendrat e vendosjes botërore luhet lojë e ngjashme si në vitin 1878, për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës, nga e cila zgjidhje varet jo vetëm e ardhmja e popullit shqiptar, por edhe e tërë rajonit.

Kurse, sipas referuesit Agim Zogaj, ky libër është i rëndësishëm për të ndriçuar historinë dhe për të mësuar nga e kaluara jonë, por edhe nga pësimet etj. Libri “Lidhja Shqiptare e Prizrenit në shtypin egjiptian (1878-1881)” i autorit Mr. Qemajl Morina shtron këto çështje: ku ishim dje, ku jemi sot dhe ku do të jemi nesër. Kjo e ka edhe domethënien e vetëdijesimit tonë. Bëhet fjalë për ngjarjen më kulmore, më të madhe që nga koha e Skënderbeut, që u organizua në vijëlje të Kongresit të Berlinit e të Paqes së Shën-Stefanit. Organizim unik për çlirimin nga Perandoria Osmane.

Krijesë autentike e popullit shqiptar, tha Agim Zogaj, ishte vlerësuar nga shtypi egjiptian organizimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Në fund, me një fjalë rasti, u paraqit edhe autori i librit.

(R. Shkodra)

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----|
| <i>Qemajl Morina</i> <i>Origjina e fundamentalizmave</i> | 5 |
| <i>Orhan Bislimaj</i> <i>”Tekfiri” akuzimi i muslimanit për dezertim nga Islami</i> | 11 |
| <i>Abdullah Nasih Ulvan</i> <i>Liria e besimit në Ligjin Islam - (3)</i> | 45 |
| <i>Dr. Mustafa Ceriq</i> <i>Lëvizjet bashkëkohore shpirtërore në botën islamike</i> | 79 |
| <i>Mr. Almir Fatiq</i> <i>Ummeti në Kur’an dhe ummeti sot...</i> | 97 |
| <i>Prof. dr. Mehdi Polisi</i> <i>Qëndrimi i Sami Frashërit ndaj Islamit dhe qytetërimit të tij</i> | 113 |
| <i>Rrezehana Hysa</i> <i>Kontributi i Sami Frashërit në kulturën dhe qytetërimin islam</i> | 123 |
| <i>Gazmend Shpuza</i> <i>Aktualiteti i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit</i> | 149 |
| <i>Amr Halid</i> <i>Katër kalifët e të Dërguarit të Allahut alejhi selam</i> | 165 |
| <i>Hasan Kaleshi – Ismail Rexhepi</i> <i>Kukli Begu dhe përshpirtënimet e tij</i> | 201 |
| <i>Qemajl Morina</i> <i>Ahmeti Rami – shqiptari që mori ofiqin poet i Kajros</i> | 225 |
| <i>Shevki Sh. Voca</i> <i>Të dhëna biografike për udhëpërshkruesin e njohur turk me emrin Haxhi Kalfa (1609-1657)</i> | 237 |

| | |
|---|------------|
| <i>Nexhat Ibrahim</i> <i>Historia e librit dhe e bibliotekave</i> | 261 |
| <i>Frithjof Schuon</i> <i>Mendime rreth artit sipas vështrimit tradicional</i> | 267 |
| <i>Hajrullah Hoxha</i> <i>Disa fjalë për Mevludin</i> | 275 |
| <i>Prof. dr. Muhamed al-Arnauti</i> <i>Çka shkruante shtypi egjiptian për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit në mbarim të shekullit nëntëmbëdhjetë</i> | 285 |
| <i>Akad. Dr. Feti Mehdiu</i> <i>Një vepër e rrallë në historiografinë shqiptare</i> | 289 |
| <i>Dr. Agim Zogaj</i> <i>Libër me të dhëna interesante</i> | 294 |
| <i>Ramdan Shkodra</i> <i>U mbajt tryeza shkencore: “Mesazhet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në raport me realitetin shqiptar sot”</i> | 297 |
| Përmbajtja | 307 |